

RINIA

e përkushtuar ndaj Zotit

Osman Nuri Topbash





Shkodër / 2019

Titulli origjinal: Hakk'a Adanmiş GENÇLİK

Përktheu: Artur Tagani

Redaktor: Ilir Hoxha

Design: Bledar Xama



Adresa: Sheshi "2 Prilli" / Rr: Studenti / Shkodër / Shqipëri

Mob: +355 67 340 6182


http: www.progresibotime.com

e-mail: rev.etika@gmail.com

RINIA

e përkushtuar ndaj Zotit

Osman Nuri Topbash



PARATHËNIE

Falënderimet e pafundme qofshin për Allahun e Madhëruar, i Cili na dhuroi Islamin, imanin, Kuranin dhe një sërë dhuntish të panumërta!

Salatet dhe selamet qofshin mbi njeriun e pashembullt, mësuesin dhe udhërrëfyesin tonë më të madh, që e shpëtoi njerëzimin nga errësira e mohimit dhe injorancës, Muhamedin ﷺ, mbi familjen e tij të bekuar dhe sahabët e nderuar!

“**Jeta**” është një nga mirësitë më të mëdha që na ka dhuruar Allahu i Madhëruar, e cila përbën kapitalin tonë të **lumturisë** ose të **fatkeqësisë** në jetën e pafundme. Çdo çast i saj ka potencialin që në njërën anë të bëhet shkak i triumfit dhe lumturisë së përjetshme, ndërsa në anën tjetër të bëhet shkak i shkatërrimit të dinjitetit njerëzor dhe poshtërimit. Ndaj, jeta duhet vlerësuar brenda kornizave të Kuranit dhe Sunetit. Kjo është çështja më me rëndësi për secilin njeri që ka mend e ndërgjegje.

Megjithatë, çdo periudhë e jetës nuk është e njëjtë në perspektivën e përgatitjes për rrugëtimin e përjetshëm. Stina më e begatë, në një farë mënyre, koha pranverore për këtë, është “**rinia**”, sepse ajo është stina e punës, vigjilencës, guximit, trimërisë, emocionit dhe fuqisë. Ndaj është edhe periudha më e rëndësishme e jetës së njeriut.

Jeta mesatare 70 - 80 vjeçare e njeriut ngrihet mbi themelet që vendosen gjatë viteve të fëmijërisë dhe rinisë. Kështu që, kjo fazë e parë e jetës së njeriut, thuajse është e barasvlershme me tërë jetën e tij.

Thënë ndryshe, rinia është mjaft e rëndësishme në aspektin e formimit të shtratit ku do të rrjedhë lumi i jetës. Pra, rinia është stina e duhur për nga aspekti i formimit të cilësive kryesore dhe orientimeve. Një devijim i vogël nga e vërteta dhe e drejta, që mund të ndodhë në këtë stinë, bën që në vitet në vijim të hasen vështirësi në daljen prej luginave të devijimit. Për të shprehur këtë, populli ynë ka thënë: “*Dega përthyeret sa është e njomë*”.

Ndaj është mjaft e rëndësishme që të rinjtë të konsumojnë energjinë drejt Zotit dhe të mbarës, duke u sjellë me një vullnet të fortë, me inteligjencë, mençuri dhe mendjehollësi.

Rumi thotë:

“Lum për atë njeri që i vlerëson si thesar ditët e rinisë dhe e shlyen detyrimin si njeri. Pra, kryen detyrimet e tij njerëzore dhe fetare. Lum për atë që kryen detyrimin si rob i Zotit, atëherë kur trupin e ka të shëndetshëm, kur ka fuqi në zemër e në trup.

Ajo periudhë e rinisë, i ngjan një vreshti të gjelbër, të freskët dhe frytdhënës. Në pleqëri, trupi shpërbëhet dhe tretet si tokë e tharë . Dhe, në një arë të thatë nuk rriten kurrë bimë të mira.”

Në rini, e cila është edhe periudha më dinamike e jetës, ashtu si emocionet shpirtërore, edhe dëshirat e pashmërgueshme janë në kulmin e tyre. Prandaj, në krahasim me të moshuarit, të cilëve u janë dobësuar dëshirat e egos, të rinjtë që e mbizotërojnë egon e tyre dhe jetojnë të orientuar kah kënaqësia hyjnore, janë më të vlerësuar tek Zoti. Pra, të rinjtë përfitojnë një shpërblim shtesë për arsye të vështirësisë që kapërcejnë. E në fakt, vlera e një rezultati, është në varësi të vështirësive që janë kaluar për ta arritur atë.

Mirëpo, zakonisht njeriu tregon një shkujdesje të madhe lidhur me vlerësimin që i duhet bërë rinisë, si periudha më e vyer e jetës. Një nga të rinjtë më të rrallë, që ka parë historia e njerëzimit, **Aliu t**, ka thënë:

“Është e vështirë t'i vlerësosh këto dy gjëra pa i humbur ende: Njëra është shëndeti dhe tjetra është rinia.”

Për fat të keq janë të paktë ata që ia dinë vlerën dhuntive, pa i humbur ato. Për këtë arsye, fakti që të rinjtë e çojnë dëm kot dhe pa asnjë qëllim pasurinë e rinisë, më tepër hidhëron të moshuarit, që ia kanë kuptuar rëndësinë asaj mirësie, sepse e kanë humbur njëherë atë. Ndaj është thënë:

“Ah, sikur të dinin të rinjtë dhe të mund të vepronin të moshuarit!”

Njerëzit më fatlumë dhe më të zgjuar janë ata që ia dinë vlerën në kohë dhuntisë së rinisë; janë ata që kalojnë kohën me pjekurinë e njerëzve të ditur. Në një hadith thuhet:

“Allahu i Madhëruar e do të riun e pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që është drejtuar kah e mira dhe ka braktisur dëshirat e kënaqësitë (e ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151)

Fjala “**genç**” (djalosh, në shqip) në persisht do të thotë “**thesar**”. Nisur nga kjo, mund të thuhet se:

Rinia është thesari i jetës së njeriut. Dhe, sipas vlerësimit që i bën këtij thesari, ai ose do të fitojë një pasuri të madhe, ose do të pësojë një humbje dhe falimentim të madh.

Ndaj duhet reflektuar shpesh mbi gjendjen aktuale dhe mbi të ardhmen tonë. Duhet të meditojmë seriozisht rreth aventurës së jetës plot surpriza, zigzage dhe gjendje që ndryshojnë gjithnjë, që prej djepit deri në varr. Nuk duhet harruar se, një jetë e shkujdesur, është thjesht lojë në fëmijëri, pakujdesi në adoleshencë, epsh në rini dhe njëmijenjë pendesa dhe përmallime në pleqëri, për gjithçka që tashmë ka kaluar.

Të kesh njohuri paraprake lidhur me të ardhmen e popujve, nuk është as ndonjë superfuqi e as ndonjë profeci. Mjafton të shikosh se ku po e shpenzon energjinë rinia e atij populli.

Rinia e çdo periudhe zgjedh një mënyrë jetese duke shpenzuar energji në varësi të edukimit që ka marrë. Mënyra e jetesës së rinisë është një pasqyrë që tregon të ardhmen e atij kombi. Nëse rinia e një populli e shpenzon fuqinë në vepra të mira, në rrugë të përsëritshme dhe të virtytshme, për shërbim dhe përpjekje, atëherë do të thotë se e ardhmja e atij populli është premtuese.

Shembulli më i mirë në këtë kontekst është Lufta e Çanakalesë dhe ajo e Mbrojtjes Kombëtare, ku është treguar në mënyrë të qartë se si fuqitë materiale dështojnë tërësisht përballë fuqive shpirtërore. E gjithë bota është dëshmitare sesi fuqia shpirtërore e atij brezi të artë, të mbushur me iman, shkatërruan plotësisht fuqinë materiale shumëfish më të madhe.

Përkundër kësaj, nëse të rinjtë e një populli i shpërdorojnë fuqitë dhe aftësitë duke rendur pas dëshirave të egos, fundi i kombit të cilit i përkasin, nuk është asgjë tjetër veçse shkatërrim. Pavarësisht mirëqenies materiale që bota perëndimore ka arritur ditët e sotme, ajo nuk ka mundur të shpëtojë nga problemet shpirtërore. Prostitucioni, alkoolizmi, narkomania dhe vetëvrasjet kanë arritur nivele alarmante të papara në historinë njerëzore, gjë e cila është një tregues i qartë i mjerimit shpirtëror. Me gjithë tejngopjen materiale të çdo lloji, uria shpirtërore, prishja e vlerave etike e humane dhe industria e armëve, që ka marrë një trajtë të frikshme, bota materialiste po i drejtohet një fundi të tmerrshëm, si një akrep që vetëvritet duke pickuar veten.

Prandaj është shumë e rrezikshme që të rinjtë me zemrat e mbushura me iman, të admirojnë stilin e jetës perëndimore të zhytur në probleme shpirtërore, duke u mashtruar nga mirëqenia e tyre materiale. Kjo i ngjan njeriut të shëndetshëm që shikon me zili të sëmurin dhe e imiton atë.

Për rrjedhojë, në vend që të rinjtë tanë të përpiqen të shpëtojnë pasi të kenë rënë në vorbullën e ndjenjave, mendimeve dhe veprave të këqija, ata duhet të kapen pas parimeve fisnike të qytetërimit të tyre, i cili ka ndërthur materialen me shpirtëroren dhe të rizbulojnë identitetin e tyre kombëtar e fetar. Për këtë, ata duhet të veprojnë me mençuri e zgjuarsi dhe në mënyrë të veçantë, të marrin mësim nga përvojat historike.

Nuk duhet harruar se historia është memoria e popujve. Është poema e përvojave kombëtare. Ndaj dhe aty ku përfundon e kaluara, mbaron edhe populli, mbaron njeriu dhe mendimi, sepse kombi, në një farë mënyre, përbëhet nga historia e vet. Nëse e shkëpusni atë nga vlerat shpirtërore dhe vetëdija historike, mbetet vetëm një kope njerëzish.

Djalosh i vyer!

Mos harro se ti je biri i një populli fisnik dhe të fisshëm, i cili i mposhti përpëlitjet e para metafizike dhe u nderua me iman në çadrat e bardha të Maverannehr-it¹, e më pas përhap drejtësi mbi një mijë e kusur vite me radhë, si një superfuqi dhe që jeton me dëshirën për paqe në të gjithë botën.

Sërish mos harro se, veprat e reja dhe brezat e rinj, janë të gjallë, të fuqishëm dhe të vazhdueshëm në varësi të pasurisë së trashëguar nga e kaluara. Vazhdimësia e kombeve është e mundur në sajë të edukimit të brezave sakrifikues që kanë një zemër të ndjeshme, entuziaste dhe të madhe. Brezi që e ktheu në ninullë për fëmijët e tyre epopenë e Çanakalesë, do t'i dalë për zot fesë, gjuhës, historisë, flamurit, atdheut, kombit dhe të gjithë vlerave të veta shpirtërore e materiale.

Kështu që zemrat e brezave të rinj duhet të jenë të mbushura me guximin dhe emocionin e të qenit pasardhës të mbarë, që do t'i dalin për zot vlerave kombëtare dhe shpirtërore të vendit të tyre. Sa bukur që e shpreh poeti këtë:

*Hak e ka të zhduket vendi pa zot
E ky atdhe nuk do të zhduket nëse ti i del për zot...*

(Mehmet Akif Ersoj)

1. Zonë në Azinë e Mesme midis lumenjve Amu Darja dhe Sir Darja. Ndryshe njihet edhe si Transaksoni.

Ashtu siç nuk mund të mohohen dhe asgjësohen beteja e Melazgirti-t që hapi dyert e Anadollit si fryt i përpjekjeve të Alparsllanit në rrugë të Allahut, legjendat që shkroi Këllëçarllanin me njëmijenjë betejat në luginat e Anadollit dhe Çanakalesë u caktuan kufijtë me eshtrat e gjyshërve tanë, nuk do të mohohen dhe asgjësohen as vlerat kombëtare dhe shpirtërore që dhuruan këto fitore. Ndërgjegjja kombëtare nuk mund të asgjësohet!..

Djalosh trim!

Nëse në historinë tënde ke njerëz altruist si **Osman Gazi** dhe brezi i tij dhe njerëz shembullorë, e të përkushtuar ndaj Zotit;

Nëse në historinë tënde ke një **Fatih**, që i tregoi gjithë botës një botë-kuptim shembullor të drejtësisë, duke dalë në gjyq me një njeri të thjeshtë prej popullit;

Nëse ke një **Kanuni Sulltan Sulejman** që mendon për të drejtën e një milingone;

Nëse ke njerëz të zemrës si **Mevlanat, Junusët, Hydajitë, Abdulkadir Gejlanitë, Bahaudin Nakshibenditë**, që zemrën e tyre e kanë bërë vatër për të gjitha krijesat për hir të Krijuesit dhe njerëz të mirë që frymëzohen dhe ecin në gjurmët e tyre;

Nëse nënat me zemrat e mbushura me Kuran, lindin trima zemërluanë;

Nëse bota është e vogël në sytë e tu dhe nëse lumturia e Botës Tjetër dhe pëlqimi i Zotit janë bërë ideali yt;

Mos harro se **TI JE VAZHDIMI DHE PASARDHËSI I NJË POPULLI TË MADH!..**

Duhet ta gatuash shpirtin tënd me vetëdijen dhe pjekurinë e të qenit pasardhës i një qytetërimi të mbushur me virtyte dhe përfaqësues i një të shkuare të mbushur me nder dhe famë!

Djalosh i mençur!

Duhet të mësosh nga kultura jote se si mund të jetohet një jetë që i ka hije dinjitetit njerëzor, duke gjetur mënyrën që mundësitë e kufizuara që ke t'i kthesh në fitim të pafundmë;

Duhet të kuptosh se jeta jote duhet të ketë një kuptim për fenë, besimin, familjen, kombin dhe atdheun tënd;

Duhet të mendosh përgjegjësitë që kanë këto vlera! Po ashtu, nuk duhet

të harrosh kurrë që nuk jemi lënë pa kontroll në këtë botë dhe se Allahu i Madhëruar na ka krijuar për një qëllim sublim!

Djalosh i virtytshëm!

Duhet të marrësh një edukim të mirë, sa ekzoterik aq edhe ezoterik. Për rrjedhojë, duhet të marrësh edhe dijet për t'u bërë një rob i mirë i Zotit, por edhe të përpiqesh të mësosh një profesion që të fitosh prej hallalli.

Sërish mos e harro se, për të fituar lumturinë e kësaj bote dhe botës tjetër, është i domosdoshëm një shërbim dhe përpjekje vetëmohuese me një zemër të mbushur me dashuri ndaj imanit. Kjo, sepse sakrificat është edhe treguesi i dashurisë ndaj Zotit. Detyrat dhe përgjegjësitë duhen çuar në vend me sakrificë dhe kujdes të madh, duke synuar pëlqimin e Zotit dhe duhet qëndruar larg prej gjërave të shëmtuara që dëmtojnë dinjitetin e njeriut.

Nuk duhet të harrosh se kryerja e detyrimeve ndaj Allahut vjen para çdo gjëje tjetër. Duhet të ruhesh nga rrezikimi i ardhmërisë tënde të përjetshme duke humbur mes shqetësimeve për diploma dhe të ardhme afatshkurtra. Duhet të jetosh i vetëdijshëm se diplomat afatshkurtra nuk do të të nevojiten në frymën e fundit. Nuk duhet të harrosh se Ai që do ta dhurojë lumturinë dhe të ardhmen e vërtetë është vetëm Allahu i Madhëruar. Për rrjedhojë, bazuar edhe në ajetin: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”** (Fatiha, 5), sa më të bukur ta bëjmë adhurimin tonë, aq do ta meritojmë edhe ndihmën hyjnore.

Ja pra, të rinjtë që mund të rriten me këtë vetëdije, vlerësojnë në mënyrën më të mirë të mundshme edhe pasurinë e rinisë që kanë në duar. Kështu ata gjejnë derën e fitimit shpirtëror, nga i cili nuk do të dëmtohen kurrë.

Kjo vepër është shkruar me qëllim për t'u dhënë një ndihmë të rinjve, të cilët sado të zgjuar qofshin, kanë nevojë të degjojnë disa këshilla të marra përmes dijes, kulturës dhe përvojës.²

Asnjëherë nuk duhet harruar se çdo njeri do të merret në llogari lidhur me të gjitha dhuntitë që i ka dhënë Allahu dhe, veçanërisht lidhur me faktin se ku dhe si e ka shpenzuar rininë. Allahu i Madhëruar këtë të vërtetë e shpreh kështu:

2. Me këtë rast, dua të falënderoj Dr. Murat Kaja, M. Akif Gynaj dhe Ibrahim Haki Uzun, për ndihmën që kanë dhënë për të përgatitur këtë libër dhe lutem që Allahu i Madhëruar t'i konsiderojë përpjekjet e tyre si sadaka-i xharije!

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote!)” (Tekathur, 8)

Kurse Resulallahu ﷺ, thotë kështu:

“Ditën e Kiametit asnjë rob nuk do të bëjë qoftë edhe një hap pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën e tij, se çfarë ka bërë me dijen e tij, se ku e ka fituar dhe shpenzuar pasurinë e tij dhe se ku e ka konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi, Kiamet, 1/2417)

Zoti na e bëftë të mundur ne dhe veçanërisht të rinjve tanë, që të jetojmë një jetë të mbushur me iman, që të kemi mundësi t’i kthejmë përgjigje këtyre pyetjeve me faqe të bardhë dhe me qetësinë e ndërgjegjes! Zoti na ruajt nga shkujdesja e të harruarit të pengesave të vështira që kemi përballë, duke u mashtruar nga fuqia dhe mundësia që të jep rinia. Zoti na dhëntë të rinj, që zemrat i kanë të lidhura me xhaminë, që lëshojnë shtat duke adhuruar Allahun, që ndjejnë në të gjitha qelizat përshpirtshmërinë e Kuranit dhe Sunetit dhe janë ballëndritur nga nuri i imanit!

Amin!..

Osman Nuri Topbash

Shtator 2010

Yskydar



MUHAMEDUL-EMIN

Një djalosh, shembull
për të gjitha kohërat





Nevoja e njeriut për të marrë shembull

Njeriu ndjen nevojën e një udhërrëfyesi që mund ta udhëheqë, e një shembulli që mund ta marrë si model, në çdo fazë të jetës së tij. Njeriu e mëson fenë, gjuhën, sjelljet dhe zakonet që përbëjnë personalitetin e tij përmes njerëzve udhërrëfyesh dhe shembujve që ka zgjedhur për vete.

Për shembull, një fëmijë mëson atë gjuhë që flet e ëma. Shumë sjellje dhe lëvizje i mëson duke imituar prindërit. Me kalimin e viteve, me zhvillimin e perceptimit dhe aftësive, merr mësim të ndryshme nga shumë njerëz.

Edukimi dhe arsimimi i njeriut përbëhet nga imitimi që i bën shembujve pozitivë apo negativë, nëpërmjet aftësisë së imitimit që gjendet në natyrën njerëzore. Ndaj dhe veçoritë e njerëzve që dikush ka zgjedhur si shembuj për vete, janë shumë të rëndësishme.

Udhërrëfyesit e vërtetë të njerëzimit janë profetët. Për ata që nuk kanë arritur profetët, dijetarët, *arifët* dhe *evlijatë*, janë shëmbëlltyrat që kanë përhapur në kohë modelin e udhëzimit

Profeti ﷺ, ka manifestuar një model të veçantë në çdo aspekt të çdo faze të jetës. Çdo njeri, mund të gjejë shembuj të sjelljeve më të përsosura në jetën e Muhamedit ﷺ. Pra, jeta e Krenarisë së gjithësisë ﷺ, i ngjan një buqete me trëndafilat më të veçantë, me ngjyra, kombinime dhe lloje të ndryshme. Për rrjedhojë, ata që duan, mund të gjejnë aty trëndafilat më të veçantë dhe më të bukur.



Në ditët tona shumë njerëz po humbasin në erozionin e mungesës së besimit dhe të moralit duke u kapluar prej trendeve negative të kohës njësoj si trungjet që vihen para nga vërshimet e ujit. Prandaj, për çdo mysliman është një detyrë, që ia ngarkon besimi dhe ndërgjegjja, t'u afrohet atyre me gjuhë të ëmbël e butësi dhe t'u tregojë bukuritë e Islamit, e në veçanti botën e zemrës së Profetit ﷺ, si shembullin e pashoq.



profetik dhe sjelljen ideale, si trashëgimtarë të Profetit ﷺ, të cilët i kanë ndjekur gjurmët e tij në mënyrën më të bukur të mundshme. Të kesh ata për udhëzues, është shkak për lumturinë dhe shpëtimin e përhershëm.

Kurse ata që lënë mënjanë profetët dhe miqtë e Zotit dhe zgjedhin të tjerë si udhëheqës, nuk do të shpëtojnë pa u përballur me shkujdesjen, devijimin dhe pabindshmërinë. E në fakt, jeta e atyre që ndjekin udhëtarët e rrugës së gabuar dhe dëshirave të nefsit, përfundon me një falimentim të hidhur.

A nuk është pikërisht kjo gjë një nga problemet më të mëdha për njeriun e sotëm? Të rinjtë tanë hedhin në rrezik lumturinë e përjetshme, duke marrë si shembull disa të famshëm që bëjnë një jetë të mjerë shpirtërore, vetëm për t'u ngjasuar atyre, gjë e cila i çon ata në një humbje shumë të hidhur!..

Mevlana i nderuar me këtë shembull shpreh çudinë se si njeriu zgjedh modelet e gabuara:

“Nuk ka gjë për t'u habitur nga ikja e qengjit prej ujkut. Ujku është armiku i qengjit. Ajo që është për t'u habitur është dashuria e qengjit ndaj ujkut dhe vajtja pas tij.”

Shoqëria njerëzore thuhet se ngjan me një pyll që mban në vete kafshë të ndryshme, nga ato më të butat gjer tek ato më të egrat. Njerëzit aty, janë ose dinakë si dhelptra, ose grabitqarë si hiena, ose ambiciozë si milingona, e cila mbledh ushqimin e vet, ose helmues si gjarpri. Njëri të pickon duke të ledhatuar,

tjetri të pi gjakun si shushunjë, ndërsa një tjetër të qesh përballë, ndërkohë që mbrapa të bën gropën.

Sa humbje e madhe është për ata të rinj, të cilët kanë nevojë për një udhëzues me zemër të butë, të ëmbël dhe të dashur, të ndjekin nga pas njerëzit me natyrë ujku dhe asgjësues!

Shembulli më i përsosur që mund të përmbushë me meritë nevojën dhe prirjen për imitim të njeriut, është padyshim Muhamedi ﷺ. Suksesi që vjen kur marrim shembull Muhamedin ﷺ, pa dyshim është i lidhur me dashurinë e vërtetë që kemi për të, duke u lidhur shpirtërisht me personalitetin e tij të pashembullt.

Shembulli dhe lideri i vetëm: Muhamedi ﷺ

Njeriu i vetëm në botë, të cilit i është analizuar e gjithë jeta deri në detajet më të vogla, është Muhamedi ﷺ. Thuajse të gjithë veprat, fjalët dhe ndjenjat e tij janë regjistruar dhe transmetuar në histori. Mund të thuhet se të gjitha veprat Islame që janë shkruar që prej 1400 e kusur viteve, janë shkruar për të shpjeguar një libër dhe një njeri: Kuranin dhe Profetin ﷺ.

Allahu i Madhëruar e ka krijuar të Dërguarin e Tij të dashur ﷺ, si një vepër arti të mrekullueshme të manifestuar tek njeriu. Atë e ka bërë mëshirë për mbarë botët dhe model për t'u marrë shembull nga e gjithë njerëzia. Në këtë prizëm, jeta e të Dërguarit të Allahut do të jetë shembull i pashoq për të gjithë

“...Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër.”

(Hashr, 7)



Allahu i Madhëruar e ka prezantuar Profetin ﷺ, si personalitetin shembullor më të bukur për njerëzimin. Ndërsa sahabët fisnikë kanë arritur nivelin më të lartë në aspektin e marrjes shembull dhe ndjekjen e Profetit ﷺ.

Sahabët fisnikë përpiqeshin që t'i ngjanin atij në mendime, fjalë dhe sjellje. Kur ata pyeteshin prej njerëzve që nuk dinin, u jepnin përgjigje ashtu sikur kishin dëgjuar prej Profetit ﷺ dhe u lexonin ajetin: “Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (Ahzab, 21.)

Për ata që dëshironin të dinin arsyen e ndonjë sjelljeje, ata i tregonin atë çfarë kishin parë nga Profeti ﷺ dhe lexonin po këtë ajet fisnik.

Kur shikonin ndonjë sjellje të gabuar, menjëherë e rregullonin sipas Sunetit të tij dhe sërish lexonin po të njëjtin ajet fisnik.

Pra ata;

Ajetin: “Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (Ahzab, 21.), nuk e harronin kurrë ta përmendnin dhe, gjithnjë na e kujtojnë që gjithmonë duhet të marrim shembull Profetin ﷺ. (Shih. Buhari, Salat 30, Ezan 105, Vitir 5, Haxh 77, Tefsir 66/1, Ejman 32; Muslim, Musafirin 8; Ebu Davud, Tatavvu 26/1342; Tirmidhi, Vitir 14/472...)

brezat që do të vijnë deri në Ditën e Kiametit.

Jeta e Profetit ﷺ, është si një pasqyrë e pastër dhe e dëlirë. Është detyrë e çdo myslimani që, duke parë veten në këtë pasqyrë, të zbukurojë sjelljen e tij dhe të korrigjojë shtrembërimet e tij.

Allahu i Madhëruar ka bërë që Profeti ﷺ, ta fillojë jetën e tij prej shtresës më të ulët dhe më të dobët të shoqërisë, që është “fëmija jetim”. Pastaj atë e kaloi në të gjitha shkallët dhe nga aspekti i fuqisë dhe pushtetit, e ngjiti atë në pikën më të lartë dhe e bëri të Dërguar të Tij dhe lider. Për rrjedhojë, në çfarëdolloj shkalle shoqërore qoftë një njeri, ai mund të gjejë shembuj të përkryer për veten e vet tek jeta e Profetit ﷺ.

Allahu i Madhëruar në një ajet urdhëron:


“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (Ahzab, 21)

I Dërguari i Allahut ﷺ, është shembull për të pafuqishmit dhe jetimët, si jetimi i Abdullahut dhe Amines.

Një i ri i edukuar mund të përpilojë hartën e duhur të jetës së vet duke analizuar rininë e pastër të Profetit ﷺ.

Një tregtar që bart shqetësimin për fitimin hallall, mund të marrë shembull jetën e njeriut më të mirë të karvanit të tregtisë që shkonte nga Siria në Busra.

Një besimtar që dëshiron të ndërtojë një çerdhe familjare të devotshme, mund të arrijë lumturinë e të



Jeta e Profetit ﷺ, është si një pasqyrë e pastër dhe e dëlirë. Është detyrë e çdo myslimani që, duke parë veten në këtë pasqyrë, të zbukurojë sjelljen e tij dhe të korrigjojë shtrembërimet e tij.



*“O ju që keni
besuar! Bindjuni
Allahut dhe
bindjuni të
Dërguarit dhe mos
i çoni dëm veprat
tuaja!”*

(Muhammed, 33.)

dyja botëve duke marrë shembull familjen e lumtur të Profetit ﷺ.

Me qëndrimin e tij para Xhibrilit ﷺ, kur i sillte shpalljen hyjnore, Profeti ﷺ, është shembulli më i mirë për nxënësit. Ndërsa me edukimin që u jepte sahabëve kur u përcillte fjalët hyjnore, ai është shembull për të gjithë edukuesit.

Njeriu idealist që dëshiron të kumtojë të vërtetën dhe mirësinë, por që nuk ka asnjë ndihmës, mund të nxjerrë mësim të pashoqe nga jeta e Profetit ﷺ, në Mekë.

Uhudi është shembull për të mundurit, ndërsa çlirimi i Mekës për triumfuesit.

Nëse njeriu dëshiron të shpëtojë nga robëria e materies dhe të bëjë një jetë shpirtërore, duhet të marrë mësim prej bilalëve, jasirëve dhe thevbanëve që ka edukuar Profeti ﷺ. Bashkimi i zemrës me ata sahabë besnikë, i dhuron zemrës sonë delikatesë, finesë dhe butësi.

Për katërmbëdhjetë shekuj me radhë, Resulullahu ﷺ, ka qenë një trëndafil i rrallë që nuk vëshkej në zemrat e Umetit. Myslimanët e kanë mbajtur gjithnjë të gjallë me emrat, artin dhe shkencën e tyre. Ata kishin kuptuar se Islami mund të jetohet vetëm nëse jeta e tij merret shembull në çdo aspekt dhe, kështu kanë gjetur lumturinë e vërtetë.

Ftuesit në Islam, që kanë shijuar frymëzimin shpirtëror të Islamit, prej Resulullahut ﷺ, mësuan **“të bëhen shkak për udhëzimin”**; fakihët mësuan **“nxjerrjen**

e gjykimeve nga Kurani dhe hadithet”; mufessirët “kuptimin e Kuranit”; mutasavvufët “edukimin me moralin hyjnor”; mendimtarët “të vërtetën e gjësë”; poetët “dëgjimin e gjuhës së heshtur dhe me zë të ekzistencës” dhe muzikantët “tingujt e estetikës”.

Myslimanët, përsosmërinë e gjithësisë e kanë gjetur tek njeriu, ndërsa përsosmërinë e njeriut tek Resulullahu ﷺ. Ata kanë kërkuar të vërtetën tek Profeti ﷺ dhe përmes tij kanë kuptuar enigmën e krijimit.

Një gjë nuk duhet ta harrojmë kurrë, se njerëzit më të errët të Periudhës së Injorancës, u shndërruan në personalitete të shndritshme që udhëhoqën njerëzimin, duke ndjekur gjurmët e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Prandaj edhe ne, në rrugëtimin e jetës sonë duhet ta pranojmë Profetin ﷺ dhe miqtë e Zotit që ndjekin atë si udhërrëfyesit tanë, me qëllim që të meritojmë lumturinë e përrjetshme.

Çfarë rinie jetoi Resulullahu ﷺ?

I Dërguari i Allahut ﷺ, edhe në vitet e rinisë ka qëndruar larg të këqijave të Periudhës së Injorancës. Ai, edhe para se të ishte Profet, ishte njeriu më i ndershëm i shoqërisë nga aspekti i personalitetit dhe humanizmit. Po ashtu, edhe nga aspekti i edukatës ishte më i miri. Aq, sa për shkak se Allahu i kishte mbledhur tek ai të gjitha vetitë dhe virtytet më të bukura njerëzore, ai kishte merituar epitelin “**el-Emin**” (i besueshmi).³ “**Emin**” tashmë ishte bërë emri i dytë i tij, madje kishte kaluar edhe emrin e vërtetë të tij.



Një nga figurat më të rëndësishme të së Drejtës Islame, Karafi (vd. 684 h.), thotë:

“Sikur Resulullahu ﷺ, mos të kishte asnjë mrekulli tjetër, do të mjaftonin sahabët që edukoi ai si provë e profetësisë së tij.”

3. Ibn Hisham, I, 191; Ibn Sa'd, I, 121.

Para profetësisë, Resulullahu ﷺ, pati një mosmarrëveshje në tregun e Busras me një hebreu, të cilit i kishte shitur mallin. Hebreu kërkoi nga Profeti ﷺ, që të betohej në emër të Latit dhe Uzza-s. Mirëpo, i Dërguari i Allahut i tha:

“Unë nuk jam betuar asnjëherë në emër të tyre. Edhe kur kaloj pranë tyre, u kthej shpinën.” Hebreu tha:

“Ke të drejtë, ke thënë fjalë me vend!” Më pas, duke iu afruar Mejseres, ndihmëses së Hadixhes ﷺ, i thotë:

“Për Zotin, ai është Profeti, veçoritë e të cilit janë shpjeguar qartë në librat tanë!”

(Ibn Sa'd, I, 156)



Një ditë Resulullahu ﷺ, u pyet:

“O Resulullah! A keni adhuruar ndonjëherë dikë tjetër përveç Allahut?”

“Jo!” -tha ai.

“A keni pirë ndonjëherë alkool?” -e pyetën përsëri.

“Jo! Edhe kur nuk e dija se ç’është imani dhe Kurani, e dija se ajo çfarë bënin ata ishte e ndaluar.” -tha. (Dijarbakri, I, 254 - 255.)

Ummu Ejmen ﷺ, tregon:

Idhujtarët Kurejsh mblidheshin një herë në vit përreth idhullit Buvane dhe bënin ceremoni që zgjasnin deri në mbrëmje, duke prerë kurban, duke qethur flokët dhe duke bërë itikaf. Edhe Ebu Talibi ishte përgatitur për këtë festë. Por, kur Muhamedi ﷺ, ngurroi të merrte pjesë bashkë me ta, xhaxhallarët dhe hallat e tij u zemëruar shumë me të. Për këtë arsye, hallat i thanë:

“Kemi frikë mos të gjejë ndonjë e keqe për shkak se po ju kthen shpinën perëndioe tona!” Madje, ato këmbëngulën aq shumë, sa që Muhamedi ﷺ, u detyrua të shkonte bashkë me ta.

Për një farë kohe humbi nga sytë, por më pas u kthye sërish pranë nesh me një fytyrë të zverdhur nga frika.

“Çfarë ndodhi?” - e pyetën me kureshtje hallat e tij.

“Kam frikë mos më kanë prekur xhinët” - tha ai.

“Allahu nuk të mundon me

shejtanin! Tek ti gjendet çdo virtyt i bukur. Pa na thua, çfarë ndodhi me të vërtetë?” - i thanë.

Atëherë Muhamedi ﷺ, u tha:

“Sa herë që i afrohesha idhullit, më shfaqej një burrë i gjatë, i veshur me të bardha dhe më thoshte: «O Muhamed! Kthehu, mos e prek atë!»”

Pas kësaj, Muhamedi ﷺ, nuk mori më pjesë në festat dhe ceremonitë e tyre, megjithëse ende nuk i ishte dhënë detyra profetike. (Ibn Sa’d, I, 158.)

I Dërguari i Allahut ﷺ, kaloi një rini mjaft të pastër dhe të ndershme. Allahu i Madhëruar e ruajti atë nga veprime të pahijshme dhe nga imoraliteti.

Kur po rindërtohej Qabeja, Profeti ﷺ, po mbante gurë me xhaxhain e tij, Abbasin ؑ, i cili me qëllim që gurët të mos ia dëmtonin supin e tij të zbuluar, i tha Profetit:

“Vendose rrobën në sup!”

Ndërkohë që Profeti ﷺ, deshi të vendoste rrobën në sup, u rrëzua përtokë dhe duke i ngulur sytë nga qielli, i tha xhaxhait:

“Jepma rrobën!”

Më pas e mori menjëherë dhe u mbulua. (Buhari, Haxh, 42)

Në atë kohë, njerëzit nuk i kushtonin vëmendje veshjes. Veshjet jashtë etikës dhe moralit shiheshin natyrshëm. Megjithatë, i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk është vënë re të ketë veshur ndonjëherë rroba të papërshtatshme.



Sic transmetohet prej sahabëve, i Dërguari i Allahut ﷺ, ishte më i turpshëm se një vajzë beqare e mbuluar me rrobën e saj.

(Buhari, Edeb, 77)

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Dy herë kam tentuar të bëj një zakon të njerëzve të Periudhës së Injorancës. Mirëpo, Allahu i Madhëruar më ruajti nga kjo.



Profeti ﷺ duhet të jetë në qendër të jetës dhe zemrës sonë. Personaliteti i pashembullt i tij duhet të jetë arkitekti dhe kriteri i vetëm i karakterit tonë.

Një natë, po kullosnim kope-të e deleve me disa të rinj Kurejsh në pjesën e sipërme të Mekës. Shokut tim i thashë:

«Nëse kujdesesh për kopenë time, do shkoj të marr pjesë në muhabetet e natës të të rinjve mekas.»

«Dakord, bëj si të duash!» - më tha.

Pas kësaj, u nisa dhe kur iu afrova Mekës, fillova të dëgjoja zëra të defit, kavallit dhe të fishkëllimave.

«Ç’është kjo?» -pyeta.

«Filan burrë po martohet me filan grua.» - më thanë.

Menjëherë u ula dhe nisa të shikoj nga ajo anë. Ndërkohë, Allahu i Madhëruar më dha një rëndesë në veshët e mi dhe aty më zuri gjumi. Beto hem në Allah nuk u zgjova derisa lindi Dielli. Pastaj u ktheva dhe shkova menjëherë tek shoku im.

«Çfarë bëre?» -më pyeti.

«Nuk bëra dot asgjë!» - i thashë dhe i tregova ç’më ngjau.

Një natë tjetër, u përsërit e njëjta gjë dhe unë sërish mbeta në gjumë... Derisa Allahu më nderoi me profetësi, përveç këtyre rasteve nuk kam tentuar më për ndonjë punë të keqe!” (Ibni Is’hak, fq. 58 - 59; Ibni Kethir, el-Bidaje, II, 292.)

Resulullahu ﷺ, edhe gjatë rinisë së tij është marrë gjithmonë me gjëra të dobishme. Në moshë të vogël,

ka ndihmuar xhaxhain e vet në sigurimin e të ardhurave. Një ditë tha:

“Çdo profet që ka dërguar Allahu i Madhërua, r patjetër ka kullotur dele.”

“Edhe ju keni kullotur dele, o i Dërguari i Zotit?” - e pyetën.

“Po, kullotja delet e mekasve kundrejt pagesës” - tha. (Buhari, Ixhare, 2, Enbija, 29.; Ibn-i Maxhe, Tixharet, 5.)

Po ashtu, siç shprehet vetë i Dërguari i Allahut ﷺ, ai ka kullotur edhe delet e familjes së tij në Exhjad. (Ibn-i Sa’d, I, 126.)

Kur ishte ende dymbëdhjetë vjeç, ai filloi udhëtimet tregtare me xhaxhallarët e vet.⁴ Më pas, për shkak se Hatixheja mbeti e mahnitur prej besueshmërisë dhe personalitetit të tij, i propozoi Muhamedit ﷺ, administrimin e karvanëve të saj. E në fakt, Resulullahu ﷺ, ishte njeriu më i besueshëm, punonte mirë dhe fitonte më shumë.⁵

Profeti ynë i dashur, ka bërë edhe ortakëri me disa njerëz. Një nga tregtarët e Mekës, **Saib ibn Ebi’s-Saib** ؓ, tregon:

“Shkova tek i Dërguari i Allahut. Ndërkohë sahabët filluan të më lëvdonin dhe të flisnin fjalë të mira për mua. Resulullahu ﷺ, tha:

«Unë e njoh atë më mirë se ju!»

Aty ndërhyra unë dhe u thashë:

«Është e vërtetë, të qofshin falë nëna dhe babai im!»



Kudo qoftë në rruzullin tokësor, nëse ju bie në sy një drejtësi që qeveris mes njerëzve, një mëshirë që i lidh zemrat e njerëzve me njëri-tjetrin, të pasur që nxitojnë të ndihmojnë të varfrit duke u sjellë me mëshirë, të fuqishëm që mbrojnë të dobëtit, të shëndetshëm që ndihmojnë të sëmurët, të kamur që kujdesen për jetimët dhe ushqejnë vejushat, dijeni se të gjitha këto virtyte kanë mbetur prej profetëve dhe njerëzve të mirë që kanë ecur gjurmëve të tyre.

4. Ibn Ishak, Siret, fq. 53.; Ebu Nuajm, Delail, I, 168.; Dijarbekri, Tarihul-Hamis, I, 260.

5. Hakim, III, 200/4834; Halebi, Insanul-Ujun, I, 221, Ajni, Umde, X, 104; Dijarbekri, I, 262.



Gjatë tërë jetës, i Dërguari i Allahut ﷺ, është sjellë me drejtësi karshi atyre që ka pasur marrëdhënie tregtare dhe njerëzve të tjerë. Kur i ka dhënë fjalën ndonjërit, ai e ka mbajtur atë sado t'i ketë kushtuar. Ibn Abbasi ؓ, thotë:

“Kur Resulullahu ﷺ, thoshte diçka, medoemos e bënte atë.”

(Buhari, Shehadat, 28.)

Ti ke qenë ortaku im. E sa ortak i mirë ishe! As më kundërshtoje, e as polemizojë me mua!» (Ebu Davud, Edeb, 17/4836; Ibni Maxhe, Tixharat, 63.)

Abdullah ibn Ebi'l-Ham-sa ؓ tregon:

“Bëra një shitblerje me Resulullahun ﷺ, para se t'i vinte profetësia. I mbeta borxh dhe u ndava prej tij duke i premtuar se nëse më priste pak do t'ia sillja. Mirëpo, unë e harrova fjalën e dhënë. Kur u kujtova pas tri ditësh, shkova tek vendi ku i kisha dhënë fjalën dhe e gjeta aty. E ai as që ma përmendi gabimin që kisha bërë. Por vetëm më tha:

“O djalosh! Më lodhe pak, kam tri ditë që të pres këtu.” (Ebu Davud, Edeb, 82/4996)

Resulullahu ﷺ, që prej kohës së rinisë u gjendej gjithnjë pranë të papërkrahurve dhe nevojtarëve. Një ditë kishte ndihmuar një tregtar të shkretë që kishte ardhur gjer në Mekë, kishte shitur mallrat, por që nuk e kishte marrë shpërblimin. Pas kësaj ndodhie, ai bashkë me xhaxhallarët e vet formoi organizatën **Hilful-Fudul**, e cila u bë strehë për të shtypurit.⁶ Më vonë, lidhur me këtë organizatë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Në shtëpinë e Abdullah ibn Xhud'an-it, kam qenë edhe unë bashkë me xhaxhallarët e mi në Hilful-Fudul. Unë u gëzova aq shumë nga ai kuvend, sa nuk do gëzohesha aq shumë edhe sikur të më jepnin devetë e kuqe (d.m.th., pasuritë më të mëdha të botës) në këmbim të tij. Sikur të më ftonin, edhe tani do të merrja pjesë në një marrëveshje të tillë.” (Ibni Kethir, el-Bidaje, II, 295)

6. Ibni Kethir, el-Bidaje, II, 295 - 296; Ibni Sa'd, I, 128 - 129.

Profeti ﷺ, sillej me kujdes dhe edukatë ndaj familjes së vet, të afërmve dhe njerëzve të tjerë. Gjithmonë vepronte me mençuri dhe zgjuarsi.

Kur ishte i ri, Resulullahut ﷺ, i pëlqente të meditoonte thellë mbi gjithësinë dhe ngjarjet e ndryshme. Prandaj, ai qëndronte i vetëm dhe thellohej në mendime.

Shkurtimisht, Profeti ﷺ, e ka jetuar mirë rininë e tij dhe këtë etapë të vyer e ka kaluar me punë të mira dhe të mbara.

Profeti ﷺ dhe të rinjtë

Kur analizohet jeta e të Dërguarit të Allahut ﷺ, vërehet se të rinjtë që kanë marrë përsipër idealin profetik, gëzojnë një pozitë të veçantë.

Kur flitet për vlerat që Islami i solli njerëzimit, zakonisht jepen shembuj të tillë, si shpëtimi i vajzave të mitura që varroseshin të gjalla, të drejtat dhe liritë që iu dhanë gruas, drejtësia ndaj të gjithëve, etj. Mirëpo këtu është edhe një pikë shumë e rëndësishme që është lënë në harresë: **“Të rinjtë”**...

Kur shohim se në përgjithësi të rinjtë janë njerëzit më të përkushtuar për kauzën e shpëtimit të njerëzimit, që kishte edhe Profeti ﷺ...

Kur dëgjojmë ligjërimin që rrezaton zgjuarsi dhe urtësi të përfaqësuesit të të rinjve myslimanë **Xhafer ibn Ebi Talibit** ؓ, para mbretit të Abisinisë...

Kur analizojmë jetën e **Mus'ab ibn Umejrit** ؓ, i cili

Melankolia e Resulullahut ﷺ, ishte e përhershme dhe meditimi i tij ishte i pareshtur. Ai nuk fliste pa pasur nevojë. Gjendja e heshtjes i zgjaste shumë. Kur fillonte një fjalë, e përfundonte atë pa e lënë përgjysmë...



Mali Nur, Mekë

Që në ditët e para të profetësisë, i Dërguari i Allahut ﷻ, ishte i interesuar për të rinjtë, me të cilët krijoi një lidhje miqësore të veçantë, duke gjetur damarin e duhur për të arritur në shpirtin e tyre.



u dërgua në Medinë si mësues që përfaqësonte fenë e re hyjnore që ishte shpallur...

Kur mësojmë se trimi që prishi planet tinëzare të idhujtarëve duke vënë jetën e tij në rrezik për hir të të Dërguarit të Allahut ﷻ, gjatë hixhretit, ishte një djalosh rreth të njëzetave...

Kur lexojmë se shërbyesi i Profetit ﷺ, në Medinë, ka qenë vetëm dhjetë vjeç...

Kur mësojmë se Profeti ﷺ, emëroi si komandant në krye të një ushtrie të madhe **Usamen** ؓ, i cili ishte vetëm nëntëmbëdhjetë vjeç...

Dhe kur urdhrat dhe ndalesat e fesë sonë i mësojmë prej të rinjve sahabë që ishin dijetarë të Islamit; atëherë kuptojmë se sa pozitë të lartë kanë pasur të rinjtë në jetën e Profetit ﷻ.

Resulullahu ﷺ, i cili e njihte mirë vlerën e rinisë, u mor me të rinjtë që në ditët e para të profetësisë së tij, duke krijuar një lidhje të veçantë miqësie me ta dhe duke i edukuar ata në këtë atmosferë shpirtërore. Për rrjedhojë, të rinjtë sahabë arritën t'u rezistonin vuajtjeve dhe torturave të llojllojshme në rrugë të Allahut gjatë viteve të para të mundimshme të Islamit. Edhe në periudhën e Medinës, atëherë kur po hidheshin themelet e shtetit Islam, ata ishin në rreshtat e parë.

Të rinjtë i motivonte për dije

Profeti ﷺ, i kushtonte rëndësi të veçantë edukimit të të rinjve në fushën e dijes. Shpeshherë ata

i përgëzonte hapur dhe i motivonte që të mësonin më shumë. Arsyeja pse sahabët që merreshin me dije ishin kryesisht të rinjtë, ishte si rezultat i kësaj qasjeje pozitive të Profetit ﷺ, ndaj dijes.

Kur emigroi në Medine, në fillim Resulullahu ﷺ, ndërtoi xhaminë. Më pas, në një cep të saj ndërtoi vatrën e dijes, që u quajt "Suffa". Mësuesi i parë i sahabëve të Suffa-s, ishte vetë ai. **As'habi Suffa**, që morën një edukim të mirë rreth Kuranit dhe Sunetit dhe u emërtuan si "**kurra**", ishin një grup të rinjsh, numri i të cilëve shkonte nga 70 deri në 400 vetë.

I Dërguari i Allahut ﷺ, formoi një kuadër të rinjsh shumë ndikues dhe të përkryer. Në mënyrë të veçantë, ai u kujdes më nga afër me të rinjtë, mençurisë dhe aftësisë së të cilëve u besonte më shumë. Brezi që u edukuan nga duart e Resulullahut ﷺ, që kur ishin fëmijë, mes të cilëve ishin **Enes ibn Malik, Aliu, Usame ibn Zejd** ﷺ, etj., u bënë themelet e qytetërimit të madh Islam. Në sajë të vullnetit të tyre të palëkundur, feja Islame kapërceu vendet, kontinentet dhe shekujt.

Të rinjtë që pëlqen Allahu dhe i Dërguari i Tij ﷺ.

Profeti ﷺ, lidhur me të riun që i bindet Allahut dhe edukohet me moral Islam, ka thënë se Ditën e Kiametit, ai do të gjendet nën hijen e Arshit.⁷ Allahu i Madhëruar i do njerëz të tillë. Ndërsa Resulullahu ﷺ, ka thënë:

"Allahu i Madhëruar e

Resulullahu ﷺ, lidhur me sahabin e ri, Muadh ibn Xhebel ﷺ, ***ka thënë:***

"Ai që e njeh më së miri të lejuarën dhe të ndaluarën në mesin e Umetit tim është Muadhi."

(Tirmidhi, Menakib, 32/3790 - 3791.)



7. Buhari, Ezan, 36.

Në kohën e të
Dërguarit të
Allahut ﷺ, jetonin
dy vëllezër. Njëri
nuk i ndahej
Profetit ﷺ dhe
merrte dije prej
tij. Kurse tjetri
punonte, për të
fituar jetesën.
Vëllai që punonte,
u ankua tek Profeti
ﷺ për vëllain tjetër.
Mirëpo Resulullahu
ﷺ, iu përgjigj:

“Ndoshta në sajë të
tij po fiton edhe ti!”

(Tirmidhi, Zuhd, 33/2345.)



do të riun që kalon rininë e vet me bindje ndaj Tij.” (Sujuti, el-Xhamius-Sagir, I, 65/1867)

Edhe Profeti ﷺ, kishte një respekt të veçantë për këta të rinj. Ai u jepte mundësi që të edukoheshin dhe u hapte rrugën që të zhvilloheshin materialisht dhe shpirtërisht.

Le ta dëgjojmë të birin e Omerit, **Abdullahun**:

“Ishim në një ekspeditë ushtarake me Resulullahun ﷺ. Unë isha mbi një deve të re të babait tim, Omerit, të cilën po arrija ta komandoja si duhet dhe dilja herë pas here në krye të karvanit. Babai, i mërzhitur nga kjo situatë, vinte e merrte devenë, e tërhiqte mbrapa dhe më thoshte:

«Kontrollo devenën! Mos dil para të Dërguarit të Allahut!»

Pasi e vuri re këtë, Resulullahu ﷺ, iu drejtua babait duke e pyetur:

«A ma shet mua devenën, o Omer?»

«Qoftë e juaja, o i Dërguari i Allahut!» - i tha dhe ia shiti Profetit. Ndërkohë Profeti ﷺ, u drejtua nga unë dhe më tha:

«Abdullah, tashmë deveja është e jotja, përdore si të duash!»
(Buhari, Buju', 47; Hibe, 25/2.)

Ndonjëherë, Resulullahu ﷺ, e kapte për dore ndonjë të ri që pëlqente dhe, me gjithë sinqeritetin e tij e këshillonte. Një ditë, kapi për dore **Muadhin** ﷺ dhe i tha:

“O Muadh! Vallahi, unë të dua shumë ty!”

Muadhi ﷺ, i tha:

“Të qofshin falë nëna dhe babai im, o i Dërguari i Allahut! Edhe unë të dua shumë ty!”

Më pas, i Dërguari i Allahut ﷺ, i tha:

“O Muadh! Të këshilloj që të mos e lësh asnjëherë pa e bërë këtë lutje në fund të namazit: «Allahu im! Ndihmomë të të përmend Ty, të jem mirënjohës ndaj Teje dhe të të adhuroj siç duhet!” (Ahmed, V, 244 - 245; Ebu Davud, Vitir, 26; Nesai, Sehv, 60; Tirmidhi, Zuhd, 30.)

Të rinjtë ishin bashkudhëtarët e Profetit ﷺ.

Profeti ﷺ, kur udhëtonte me deve, nganjëherë i merrte mbrapa të rinjtë. Të rinjtë fatlumë, si Usame ibn Zejd, Muadh ibn Xhebel, fëmijët e Abbasit, Fadli, Kusemi dhe Ubejdullahu **Y**, ishin ata që Profeti ﷺ i kishte marrë mbrapa në deve dhe u kishte mësuar dije dhe edukatë.⁸ Madje, edhe gjatë një ngjarjeje të madhe si çlirimi i Mekës, Profeti ﷺ, hyri në qytet duke mbajtur pas vetes në deve Aliun, nipin prej Zejnebes. (Ibni Esir, Usdul-Gabe, IV, 126.)

Profeti ﷺ, i vlerësonte të rinjtë

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, vlerësonte shumë edhe mendimet e të rinjve. Kur mori lajmin se mekasit kishin ardhur me një ushtri të madhe për të sulmuar Medinën,



Në hadith thuhet:

“Allahu i Madhëruar e do të riun që kalon rininë e vet me bindje ndaj Tij.”

(Sujuti, el-Xhamius-Sagir, I, 65/1867)

8. Buhari, Tefsir 3/15, Ilim 49, Xhihad 46; Muslimi, Iman 48, 49; Ahmedi, I, 205; Hakimi, III, 655/6411.

Abdullah ibn Xhafer ؓ , na transmeton një kujtim shumë të bukur:

“Një ditë, Profeti ﷺ , më mori mbrapa në deve dhe atë ditë më tregoi një sekret, të cilin s’ia them askujt.”

(Muslim, Hajiz, 79.)

mendoi se do të ishte më mirë të qëndronin në Medinë dhe të bënin luftë mbrojtëse. Mirëpo, sahabët e rinj që nuk kishin mundur të merrnin pjesë në betejën e Bedrit, me një dëshirë dhe vullnet të madh deshën të luftonin ballë për ballë me armikun. Prandaj u vendos që beteja të bëhej në Uhud.

Të rinjtë që ishin të lidhur me një dashuri të madhe pas të Dërguarit të Allahut ﷺ , përjetuan revolucionin më të madh të jetës së tyre. Këta njerëz që para Islamit ishin thjesht asgjë, pasi u nderuan me besim, morën cilësinë e yjeve të Umetit. Shumë të rinj që më parë ishin të braktisur, në sajë të edukatës që u dha Profeti ﷺ , u bënë personalitete shembullore që i dhanë drejtim botës. E thënë ndryshe, nga të vdekurit dolën të gjallët dhe nga qymyri- diamantet.

Omeri para Islamit, ishte një njeri që kishte varrosur me duart e veta vajzën e tij për së gjalli, ishte i pamëshirshëm dhe me natyrë të vrazhdë. Pas Islamit, brenda së njëjtës siluetë, u bë Omeri ؓ , me sy të përlotur, me zemër të mbushur me dashuri e mëshirë, aq sa ruhej të mos shkelte me këmbë edhe milingonat në tokë.

Ai e llogariste aq shumë veten e tij, sa edhe shprehej: *“Kam frikë se Allahu do më kërkojë llogari edhe për një qengj, që mund të humbë në breg të Eufratit.”*

Një tjetër shembull është edhe **Abdullah ibn Mes’udi ؓ** . Në betejën e Bedrit, kur Ebu Xhehli ishte rrëzuar në tokë, ky sahab i nderuar,



iu hodh sipër dhe iu ul mbi kraharor. Ndërkohë që po jepte shpirt, ky idhujtar i tërbuar e ofendoi duke i thënë:

“Ke hipur në një kodër të lartë dhe të thepisur, o bari i shkretë delesh!” (Ibni Hisham, II, 277.)

Pra, në të shkuarën ai ishte “një bari i thjeshtë delesh”, që përbufej nga njerëzit. Por kur u udhëzua dhe mori edukimin e Resulullahut ﷺ, zemra e tij u bë si një det i gjerë dhe i thellë. Dhe, pikërisht në sajë të këtij sahabi të madh, mori jetë edhe Shkolla e famshme e Kufes, që përbën edhe një nga shkollat më të mëdha të Jurisprudencës Islame. Për rrjedhojë, tashmë, çfarëdo profili shkencor Islam të analizojmë, emrin e tij do ta shohim në krye

Bartën Islamit në kontinente të ndryshëm

Këta të rinj që i kishin zemrat të mbushura me iman, dashuri dhe plot emocion, në qendër të mendimeve dhe idealeve të tyre vendosën pëlqimin e Allahut dhe dashurinë ndaj Profetit ﷺ. Ata thujse garonin me njëri-tjetrin për të qenë korrierët e letrave të Profetit ﷺ, të cilat ftonin në Islam. Madje, për të përmbushur edhe dëshirat më të vogla të Profetit ﷺ, ata morën përsipër çdolloj sakrifice, pa nxjerrë asnjëfarë justifikimi. Kaluan male të thepisura dhe shkretëtira pa shfaqur aspak lodhje e mërzë. Me një trimëri që ua jepte besimi, kaluan përmes xhelatëve dhe lexuan letrat e Profetit ﷺ, para mbretërve. Ata nuk ngurruan të jepnin edhe jetën për hir të kësaj detyre të bekuar.



Në një hadith fisnik thuhet:

“Sahabët e mi janë si yjet (në qiell). Cilindo të ndiqni, do të gjeni rrugën e drejtë.”

(Ibni Abdi'l-Berr, Xhamiu Bejani'l-Ilm, II, 91.)

Ai brez i bekuar, ia kushtoi jetën Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ. Shërbimi në rrugë të Zotit, u bë kënaqësia dhe dëshira më e madhe e zemrës së tyre.

Muslimanët e parë



Kjo fe e bekuar, u forcua në atmosferën shpirtërore të të rinjve. Shumica e sahabëve që u bënë muslimanë, nuk i kishin mbushur ende të njëzetat. Mirëpo edhe në atë moshë të re, ata kapërcyen vështirësi të shumta për hir të fesë.

Letrën për Kisran e Iranit, e dërgoi Abdullah ibn Hudhafa ʿ . Kur Kisra vëren se emri i Profetit tonë të dashur ﷺ, ishte vendosur para emrit të tij, e

copëton letrën i nevrikosur dhe e ofendon rëndë korrierin. Pavarësisht kësaj, Abdullahu ʿ , me një trimëri prej djaloshi, e paralajmëron dhe e këshillon Kisran bashkë me ata që ishin përreth tij. Mirëpo Kisra, i cili nevrikoset edhe më shumë prej kësaj, urdhëroi që ta nxjerrin jashtë Abdullahun ʿ . Për rrjedhojë, Abdullahu ʿ , hipën mbi kafshën e vet dhe merr rrugën për Medinë. Ndërkohë, me vete thoshte kështu:

“Vallahi, tashmë nuk mërzitem cilado nga dy rrugët qofshin për mua (vdekja ose shpëtimi)! Unë dërgova letrën e Resulullahut ﷺ dhe e krevra detyrën time.”¹

1. Ahmed, I, 305; Ibni Sa'd, I, 260, IV, 189; Ibni Kethir, el-Bidaje, IV, 263 - 266; Suhejli, VI, 589 - 590; Hamidullah, el-Vesaik, fq. 140.

Në sajë të shërbimit të tyre me pasion dhe sakrificë, shumë qytete u ndriçuan me udhëzim dhe arritën paqen me moralin Islam.

Për shembull, kur **Aliu** ﷺ, pranoi Islamin me një vullnet të madh, ishte vetëm një fëmijë 10 vjeçar!

Ndërsa skllavi që liroi i Dërguari i Allahut ﷺ, **Zejd ibn Harithe** ﷺ, ishte vetëm 15 vjeç kur e pranoi Islamin. Ai ishte ende i ri, kur me trimëri të madhe e bëri trupin e vet mburojë për Profetin ﷺ, nga gurët e banorëve të Taifit. Po sot, pas cilave dashuri rend një djalosh 15 vjeçar?!

Abdullahu, i biri i Omerit ﷺ, kur përqafoi Islamin ishte vetëm 10 vjeç. Kur mbushi 13 vjeç kërkoi të merrte pjesë në luftën e Uhudit. Por për arsye se ishte shumë i ri, Resulullahu ﷺ, nuk e lejoi. Më vonë ai pati nderin të arrinte në krye të radhës së dijetarëve të mëdhenj dhe të bëhet sahabi i dytë që transmetoi më shumë hadithe. Po në ditët tona, vallë në çfarë niveli është bota e mendimit të një djalë të ri në këtë moshë?

Kur **Abdullah ibn Zubejri** ﷺ, mbushi 8 vjeç, i ati e dërgoi tek Profeti ﷺ, që t'i jepte besën (bej'at). Kur Resulullahu ﷺ e pa, iu drejtua me buzëqeshje dhe mori besën prej tij.

Abdullah ibn Hishami ﷺ, shkoi tek Profeti ﷺ, kur ishte vetëm gjashtë vjeç. Nëna e tij, Zejneb binti Humejd, e solli atë tek Profetit ﷺ, (gjatë çlirimit të Mekës) dhe tha:

“O i Dërguar i Allahut! Merre besën e tim biri, se ai është mysliman!”

“Ai është ende i vogël.” - i tha Profeti ﷺ dhe, duke ia përkëdhelur kokën u lut për Abdullahun.

Profeti ﷺ, ka thënë:

“Allahu i Madhëruar e do të riun e pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që është drejtuar kah e mira dhe ka braktisur dëshirat e kënaqësitë (e ulëta të egos)”

(Ahmed, IV, 151.)





Sahabi ia doli të vendoste tevhidin në qendër të mendimit dhe idealit dhe të nxirrte nga zemra interesat personale. Pasuria dhe jeta ishin thjesht mjete për të. Ai shijoi ëmbëlsinë e besimit dhe iu zgjerua mëshira. Shërbimi u bë stili i tij i jetës dhe shfaqti një sakrificë dhe personalitet të madh Islam. Sahabi bënte edhe një muaj udhëtim për të marrë një hadith. Por, nuk ia merrte hadithin atij që mashtronte goftë edhe kalin e vet.

Disa vite më pas, Abdullah ibn Hishami **†**, dilte në pazar dhe blinte ushqime. Kur e panë Ibni Omeri dhe Ibni Zubejri **✓**, i thanë:

*“Na bëj edhe ne ortakë në këto mallra, sepse i Dërguari i Allahut **ﷺ**, ka bërë duanë e bereqetit për ty!”*

Abdullahu i bëri ortakë ata. Nganjëherë ndodhte të fitonte sa një ngarkesë deveje dhe të gjithën e dërgonte në shtëpi. (Buhari, Shirket, 13.)

Xhafer ibn Ebi Talib **†**, ishte vetëm tridhjetetë vjeç kur ra dëshmor në Mute.⁹ Kjo do të thotë se kur pati emigruar në Abisini, ku pati ligjëruar me dije, urtësi dhe trimëri, si përfaqësues i myslimanëve përballë Nexhashiut, kishte qenë një djalosh 17 vjeçar.

Abdullah ibn Mes’ud dhe **Zubejr ibn Avvam **✓****, ishin vetëm 16 vjeçarë kur u bënë myslimanë. **Abdurrahman ibn Avf** dhe **Sa’d ibn Ebi Vakkas **✓**** ishin 17 vjeçarë kur përqaftuan Islamin, që do të thotë, se ata ishin në moshën e një nxënësi të shkollës së mesme. Mirëpo, kishin dhënë një vendim shumë të rëndësishëm për jetën e tyre dhe për botën e pasme, duke manifestuar vendosmërinë dhe guximin se mund të merrnin përsipër çdolloj sakrifice në rrugën që kishin nisur.

Vendimet më jetike merren në rini, sepse të rinjtë krahasuar me të moshuarit, janë më të gatshëm lidhur me përshtatjen me ndryshimet dhe zhvillimet e reja. Të rinjtë në vitet e para të Islamit, ndoqën Profetin **ﷺ** dhe morën përsipër çdolloj vështirësie. Ndërkohë, disa

9. Ibni Hisham, III, 434.


pleq me mendime statike si Ebu Lehebi, Ebu Xhehli, Umejje ibn Halef, Velid ibn Mugire dhe As ibn Vail, zemrat e të cilëve ishin kthyer në burgje, dolën me forcë kundër Islamit.

Studimet e bëra kohët e fundit e vërtetojnë këtë që sapo thamë. Sipas kësaj, të rinjtë, krahasuar me të moshuarit, tregojnë më shumë interes për fenë, kalojnë një jetë të devotshme, nën emocionin dhe kureshtjen lidhur me Allahun, botën tjetër dhe ringjalljen. Sot, të rinjtë në Evropë e pranojnë më lehtësisht Islamit, kurse të moshuarit më me vështirësi.

Kur një nga të rinjtë më të pasur dhe më të pashëm të Mekës, **Mus'ab ibn Umejri** ﷺ, u bë mysliman, familja e mbajti të ngujuar në shtëpi. Atë kohë ai ishte vetëm 18 vjeç. Ai Mus'ab që më pas shkoi në Medine dhe e çliroi atë me Kuran, zgjuarsi dhe ëmbëlsi fjale. A thua vallë që një i ri 18 vjeçar i kohëve të sotme, mund të bëjë një zgjedhje të tillë të rëndësishme dhe mund të marrë përsipër të kryejë një detyrë të tillë?!

Dhëndri i të Dërguarit të Allahut ﷺ, **Osman ibn Affan** ﷺ, **Ebu Ubejde ibn Xherrah** ﷺ, i cili në sajë të jetës së devotshme që bënte pati nderin të kujtohej si "i besueshmi i Umetit" dhe **Omeri** ﷺ, i cili ka ndriçuar shekujt me drejtësinë e tij, kanë qenë rreth moshave 25-31 vjeç kur përqaftuan Islamit.

Një nga sahabët që ka transmetuar më shumë hadithe, **Xhabir ibn Abdullahu** ﷺ, ishte vetëm



Çfarë kishte marrë Sahabi nga Resulullahu ﷺ?

1) Modelin (sahabët mundoheshin t'i ngjanin Profetit ﷺ, në sjellje dhe mendime).

2) Edukimin e njohjes së Allahut dhe afimit me Të

Në këtë mënyrë, në jetën e tyre, u bë e qartë e mira dhe e vërteta me tërë bukurinë e tyre dhe e liga me të kotën me gjithë shëmtinë e tyre.



Abdullah ibn Mes'ud ؓ , i cili ka qenë prej nxënësve të Suffes, ku u edukua pranë Resulullahut ﷺ , ka thënë:

"Tek ne pasqyroheshin gjendje të tilla prej të Dërguarit të Allahut ﷺ , sa që dëgjonim edhe dhikrin e kafshatave që na kalonin në fyt."

(Buhari, Menakib, 25.)

15 vjeç, kur mori pjesë në Besatimin e Dytë të Akabes.

Enesi ؓ , i cili i shërbente Profetit ﷺ , ka thënë:

"I Dërguari i Allahut ﷺ , erdhi në Medinë dhe mes sahabëve të tij, nuk kishte asnjë me flokë dhe mjekër të thinjur, përveç Ebu Bekrit. Por edhe Ebu Bekri i

kishte lyer flokët dhe mjekrën me kanë dhe bimën e ketemit."

(Buhari, Manakibul-Ensar, 45.)

*"Profeti i nderuar ﷺ , erdhi në Medinë dhe **Ebu Bekri ؓ** , ishte më i moshuari në mesin e sahabëve që emigruan..."*

(Buhari, Manakibul Ensar, 45.)

Gjithashtu ata që mbështetën Islamit dhe myslimanët në Medinën e përndritshme ishin përsëri të rinjtë.

Ndërkohë që mohuesi Ebu Amir, i cili ishte prej të parëve të Medinës ia ktheu shpinën Islamit, djali i tij **Handhala** u bë mysliman dhe ra dëshmor në Uhud. Po ashtu edhe djali i Abdullah ibn Ubejit, liderit të hipokritëve, **Abdullahu**, ishte një besimtar i sinqertë. Edhe **Es'ad ibn Zurare**, **Ukbe ibn Amir** dhe **Avf ibn Haris** ishin prej atyre të rinjve që i kanë shërbyer më së shumti Islamit.

Kur Resulullahu ﷺ , emigroi në Medinë, **Zejd ibn Thabiti ؓ** , ishte një jetim 11 vjeçar. Ai tregon kështu:

"Kur Resulullahu ﷺ , erdhi në Medinë, mua më nxorën para tij dhe ai më përkëdheli. Të pranishmit thanë:

«O Resulullah! Ky është një prej të rinjve nga fisi Bijtë e Nexharit dhe di përmendësh shtatëmbëdhjetë sure, prej atyre që të zbriti Allahu ty!»

Kjo gjë e gëzoi pa masë Profetin ﷺ ." (Ahmed, V, 186.)

Zejdi ﷺ, erdhi tek Profeti ﷺ dhe i tha:

“Edhe unë dua të marr pjesë në betejën e Bedrit!”

Mirëpo, i Dërguari i Allahut nuk lejoi pjesëmarrjen në luftë të një fëmije 13 vjeçar.

Sërish, një prej sahabëve që transmetoi më shumë hadithe, **Abdullah ibn Abbas** ﷺ, ishte vetëm 13 vjeç, kur Profeti ﷺ ndërroi jetë.

Sahabët që pranuan Islamin që në moshë të re, duke u bërë yjet në qiellin Islam, padyshim se nuk ishin vetëm kaq. Përveç këtyre, ka pasur edhe shumë sahabë të tjerë të rinj. Është me të vërtetë interesante se në mesin e myslimanëve të parë ka pasur edhe vajza të reja. Krahas vajzave të Profetit ﷺ, **Rukijjes, Ummu Kulthumit** dhe **Fatimes** ﷺ, edhe



Muadhi ﷺ, djali i Amr ibn Xhemuh-ut, foli me djemtë myslimanë të fisit të tij dhe një natë, e hodhi fshehurazi idhullin e të atit në një gropë të pisët që gjendej aty afër. Në mëngjes, kur Amri e vuri re këtë, u tmerrua dhe e nxori menjëherë idhullin nga gropa. Më pas, e pastroi, e leu me erëra të mira dhe e vendosi sërish në vendin e vet.

Mirëpo, kur e njëjta gjë u përsërit disa ditë radhazi, ai mori shpatën e vet dhe ia vari idhullit në qafë që të mbronte veten. Të nesërmen, kur e pa sërish në gropë idhullin, e kuptoi se ajo gjë pa jetë që adhuronte nuk kishte fuqi të mbronte as veten. Kështu, ai u zgjua nga errësira e idhujtarisë në mëngjesin e ndritur të Islamit. Më pas ai e nxiti edhe popullin e vet në Islam.¹

1. Ibn Hisham, II, 61 - 63; Dhehebitu, Sijer, I, 182.



“Kur ndonjë nga sahabët hynte në shtëpi të vet, e shoqja i bënte këto dy pyetje:

1. Sa ajete u shpallën sot nga Kurani?

2. Çfarë ke mësuar përmendësh nga fjalët e të Dërguarit të Allahut?

Ndërsa kur donte të dilte nga shtëpia, e shoqja e këshillonte në këtë mënyrë:

«Ki frikë Allahun; mos fito në mënyrë të ndaluar! Ne durojmë urinë në këtë botë, por nuk mund të durojmë vuajtjet e Xhehenemit!»

(Abdulhamid Keshk, Fi rihabit-tefsir, I, 26.)

e motra e Omerit **ﺗ**, **Fatime ﺀ**, vajzat e Ebu Bekrit **ﺗ**, **Esmaja, Aisha, Nehdije Hatun** me të bijën **ﻉ** dhe vajzat e Bijve të Naxharit që pritën ardhjen e Profetit **ﻍ**, në Medinë me ilahi, janë disa shembuj të këtij fakti.

Kur Profeti **ﻍ**, ndërroi jetë në dhomën e vet, nëna jonë

Aishja **ﻉ**, ishte shumë e re. Megjithatë, ajo ishte një nga njerëzit që kishte transmetuar më shumë hadithe dhe një burim dijeje, të cilit i referoheshin edhe dijetarët.

Detyrat që u jepte Resulullahu **ﻍ të rinjve**

Profeti **ﻍ**, të rinjve u ka dhënë detyra të rëndësishme, si përhapja dhe mësimi i Islamit. Periudha e rinisë që Allahu i Madhëruar i ka dhënë njeriut, është pasuria më e madhe për shërbime të tilla të rëndësishme. Njeriu në rini ka energji më shumë. Për rrjedhojë, edhe fuqia, guximi dhe trimëria që nevojitet për të kryer detyrat gjendet më shumë në kohën e rinisë.

Për shembull, le të mendojmë për **Aliun ﺗ** :

Idhujtarët që kishin për qëllim të eliminonin Profetin **ﻍ**, kishin përgatitur një kurth të madh.

Ata kishin planifikuar që kur i Dërguari i Allahut **ﻍ**, të ishte duke pushuar në shtëpi, t'i vërsuleshin nëntë a dhjetë vrasës përnjëherësh për ta eliminuar. Por, të shtriheshe atë natë në shtratin e Profetit **ﻍ** dhe të bëheshe objektivi vullnetar i heshtave që do të nguleshin në trup, ishte e mundur vetëm në sajë të dashurisë dhe entuziazmit

Një ditë Profeti ﷺ, i tha njërit prej ensarëve:

“Dua vajzën tuaj prej jush!” Sahabiu me një gëzim të madh i tha:

“Dakord, o Resulullah! Ky është nder për mua.” Më pas Resulullahu ﷺ, i tha:

“Nuk e dua për vete, por për Xhulejbibin!” (Xhulejbibi ishte një sahab i zi dhe jo shumë i pashëm.)

Ensari i tha:

“Atëherë, le ta pyes të ëmën e vajzës.” - dhe iku. Edhe e shoqja në fillim u gëzua, por kur dëgjoji emrin e Xhulejbibit, tha:

“Për Xhulejbibin? Jo vallahi, nuk mund ta jap vajzën për të!”

Vajza, e cila dëgjoji bisedën e tyre, i pyeti:

“Kush është shkesi juaj për mua?”

E ëma ia tregoi situatën. Atëherë vajza iu drejtua:

“Po refuzoni dëshirën e Resulullahut?! Më lini tek Resulullahu, ai patjetër që nuk lejon të dëmtohem.”

I ati shkoi tek Resulullahu ﷺ dhe i tha përgjigjen e vajzës. I Dërguari i Allahut ﷺ, e martoi vajzën me Xhulejbibin. Pas pak kohësh, Xhulejbibi ra shehid në një betejë. Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, tha këto fjalë për të:

“Ai ka vuarë shtatë mohues, e ata e martirizuan atë. Ai është prej meje dhe unë jam prej tij!”

Më pas, e mori në krahët e vet trupin e pajetë të Xhulejbibit dhe e vendosi personalisht në varr.

Ndërsa lidhur me të shoqen e Xhulejbibit, Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Allahu im! Bëj që mbi këtë grua të bien plot mirësi e begati dhe mos ia bëj të mundimshme jetën!” Begatia e kësaj duaje është vërejtur haptazi në jetën e saj. (Ahmed, IV, 422, 425; Hajthemi, IX, 367 - 368)



Një nga shkaqet kryesore që Islami u përhap si agimi i mëngjesit në mesin e popujve të dhunuar, të shtypur dhe të shfrytëzuar, ishte fakti se sahabët shfaqën një identitet të përkryer Islam kudo që shkuan. E në fakt, sahabët fisnikë, të cilët kanë qenë nxënësit më të zgjedhur të Resulullahut ﷺ, ishin besimtarë të singertë, altruistë, të drejtë, të ndershëm, zemërgjerë dhe plot entuziazëm në kumtimin e fesë, të cilët i shihnin njerëzit me syrin e mëshirës dhe dhembshurisë.

të besimit të një të riu besimtar të përkushtuar ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ. Ja pra, Aliu **ⓧ** ishte ai që ofroi jetën e vet atë natë, që ishte një pikë kthimi në historinë Islame, duke dhënë një kontribut të paharrueshëm.

I Dërguari i Allahut ﷺ, qëkur ishte ende gjallë, u ka dhënë të drejtë fetvaje të rinjve sahabë, si **Aliut**, **Abdurrahman ibn Avf-it**, **Abdullah ibn Mes'ud-it** dhe **Zejd ibn Thabit-it**. Përveç kësaj, edhe shkruesit e shpalljes hyjnore i ka zgjedhur kryesisht prej të rinjve. Gjithashtu edhe letrat e ftesës Islame, i ka shkruar dhe dërguar me anë të të rinjve.

Për shembull, përgjithësisht, marrëveshjet që bënte Resulullahu ﷺ, i ka shkruar **Aliu ⓧ**. Përveç këtyre, ai i shkruante edhe letrat drejtuar individëve të caktuar si dhe urdhrat në lidhje me pasuritë.¹⁰

I Dërguari i Allahut ﷺ, **Zejd ibn Thabiti ⓧ**, i cili nuk ishte as 15 vjeç, e ngarkoi me detyrën për të mësuar surianisht dhe hebraisht, gjuhë këto që ishin shumë të nevojshme për kohën.

Zejd ibn Thabiti ⓧ, tregon:

Resulullahu ﷺ, më tha:

“Zejd, mëso për mua të shkruash në gjuhën e hebrenjve. Vallahi, unë nuk u besoj hebrenjve lidhur me shkrimin!”

Pa kaluar 15 ditë mësova shkrimin e tyre. Tashmë kur hebrenjtë i shkruanin letër Resulullahut ﷺ, ia lexoja unë. Po ashtu, kur Resulullahu ﷺ, donte t'ua kthente përgjigje këtyre letrave, unë i shkruaja në emër të tij.¹¹

10. Ibni Sa'd, I, 267, 268, 272, 274, 285; Ibni Abdilberr, Istiab, I, 69; Ibni Ethir, Usdul Gabe, I, 62.

11. Ahmed ibn Hanbel, V, 186. Shih. Buhari, Ahkâm, 40; Ebu Davud, Ilim, 3/3645; Tirmidhiu, Istizan, 22/2715.

Profeti ﷺ, 25 vjeçarin **Mus'ab ibn Umejrin** ؓ, e dërgoi si mësues në Medinë. Ndërsa **Muadh ibn Xhebelin** ؓ, e caktoi si gjykatës (kadi) dhe mësues në Jemen, megjithëse ishte vetëm 21 vjeç.

Kur Resulullahu ﷺ, çliroi Mekën, aty caktoi si administrator (vali) **Attab ibn Esid**-in, i cili ishte vetëm 20 vjeç.

Gjithashtu, edhe në shumë beteja, Profeti ﷺ, ua ka dhënë flamurin të rinjve me duart e veta. Për shembull, në betejën e Tebukut, flamurin e Bijve të Naxharit ia pati dhënë **Zejd ibn Thabitit** ؓ, ngaqë e dinte Kuranin më mirë se të tjerët. Kur **Aliu** ؓ, u bë flamurtar në luftën e Bedrit, ishte rreth të njëzetave.

Sërish, në çlirimin e Hajberit, **Aliu** ؓ, kishte marrë përsipër detyrën më të rëndësishme. Myslimanët hasën shumë vështirësi gjatë rrethimit të Hajberit dhe, për shkak të zbrapsjes që i bënte armiku sulmeve të tyre, ata u lodhën jashtë mase. Në fund të asaj dite, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Nesër do t’ia jap flamurin dikujt, përmes dorës së të cilit Allahu do ta bëjë të mundur çlirimin e Hajberit. Ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Po ashtu edhe Allahu dhe i Dërguari i Tij e duan atë!”

Ata që morën pjesë në luftë, e kaluan natën duke menduar dhe biseduar se cilit prej tyre do t’ia jepte flamurin Resulullahu ﷺ. Sapo zbardhi dita, ata nxituan tek Resulullahu ﷺ, me shpresën për të fituar dashurinë e Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ. Profeti ﷺ, thërriti Aliun ؓ, të cilit i veshi një parzmore, i dha flamurin dhe i tha:



“Edukojini fëmijët tuaj sipas kohës që do të jetojnë ata, jo sipas kohës që keni jetuar ju.”

(Aliu r.a.)

“Shko o Ali dhe mos shih as majtas as djathtas, derisa Allahu i Madhëruar të të bëjë të mundur çlirimin!”

Aliu ﷺ , lëvizi menjëherë dhe çlirimi u bë i mundur nëpërmjet dorës së tij. (Buhari, As’habun-Nebi, 9; Muslimi, Fedailus-Sahabe, 32 - 34; Hajthemi, VI, 151.)

Në këtë mënyrë, Resulullahu ﷺ , i ka edukuar të rinjtë sahabë në formën më të bukur, u ka besuar atyre dhe u ka dhënë detyra të rëndësishme për fatin e Islamit. Po kështu, edhe ata i kanë kryer me një dashuri dhe entuziazëm besimi të madh detyrat që u janë besuar, duke e bartur sundimin e Islamit ndër kontinente dhe shekuj.



Kur Muadhi ﷺ , do të shkonte në Jemen, Resulullahu ﷺ , e

pyeti:

“Kur të të vijë ndonjë çështje, si dhe në ç’bazë do të gjykos?”

Muadhi u përgjigj:

“Do të gjykoj sipas Librit të Allahut”. Atëherë Resulullahu ﷺ , e pyeti:

“Po nëse nuk e gjen në Librin e Allahut gjykimin e çështjes që kërkon, si do ta zgjidhësh?” Muadhi u përgjigj:

“I referohem Sunetit të Resulullahut lidhur me çështjen e caktuar.” Resulullahu ﷺ , e pyeti sërish:

“Po nëse nuk e gjen atë gjykim as në sSunetin e Resulullahut?” Muadhi u përgjigj:

“Atëherë, do të gjykoj sipas ixhtihadit (mendimit, intuitës) tim.” Atëherë, Resulullahu ﷺ , i vuri dorën në kraharor të Muadhit ﷺ dhe i tha:

“Laudëruar qoftë Allahu, që e drejtoi përfaqësuesin e Profetit të tij drejt asaj që e kënaq atë!” (Ahmed, V, 230; Ibni Sa’d, III, 584; Dijarbekri, II, 142.)



TË RINJTË

Në Kuranin Famëlartë



TË RINJTË NË KURANIN FAMËLARTË

Në Kuranin Famëlartë, tregohen shembuj nga jeta e të rinjve, të cilët kanë shfaqur personalitet shembullor në histori, me qëllim për t'i treguar rrugën të rinjve besimtarë. Përpjekja e tyre në rrugën e besimit, trimëria dhe qëndresa që treguan përballë vështirësive, janë shembuj për të gjithë brezat që do të vijnë gjer në Ditën e Kiametit.

I pari prej këtyre të rinjve, të cilët janë bërë yje në qiellin e njerëzimit, padyshim është Ibrahim **U**.

Ibrahimi **U**

Ibrahimi **U**, ishte një i ri që kishte zbuluar misterin e miqësisë me Allahun. Në sajë të pjekurisë që i kishte dhuruar Allahu, ai gjeti besimin e ekzistencës dhe njëshmërisë së Allahut, duke e përdorur mendjen në mënyrën më të bukur.

Gjetjen e Zotit nga ana e Ibrahimit **U**, duke medituuar mbi bukuritë e gjithësisë, Kurani Famëlartë e shpreh kështu:

“O Zoti im, më dhuro dituri dhe më radhit me të mirët! Bëj që të përmendem për të mirë te breznitë e ardhshme dhe më bëj një nga trashëgimtarët e Xhenetit të begatë! Fale babanë tim, sepse ai është njëri nga të humburit, dhe mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit, në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që ujen me zemër të pastër tek Allahu!”

(Shuara, 83 - 89)





**Allahu i Madhëruar,
Ibrahimit ؑ , i ka thënë:**

**“Pa dyshim që ti je
miku Im dhe Unë
jam miku yt. Kujdes,
mos të gjej tjetërkënd
përveç Meje në zemrën
tënde kur të shoh në
të. Përndryshe, ta
ndërpres dashurinë që
ke ndaj Meje, sepse për
dashurinë Time, zgjedh
njerëz të tillë që, edhe
sikur t’i djeg në zjarr,
sërish zemra e tyre nuk
sheh tjetër përveç Meje.
Kur ai është i tillë për
Mua, atëherë edhe Unë
vendos dashurinë për
Mua në zemrën e tij. I
vazhdoj mirësitë e Mia
ndaj tij. Madje, e bëj të
afërm ndaj Meje.”**

**“Kur ra nata, ai pa një yll
dhe tha: «Ky është Zoti im!»
Por, kur perëndoi ylli, ai tha:
«Nuk i dua ata që perëndojnë!»
Kur pa Hënën duke lindur,
tha: «Ky është Zoti im!» Por,
pasi ajo perëndoi, ai tha: «Nëse
Zoti im nuk më udhëzon në**

**rrugën e mbarë, me siguri do të bëhem njëri
nga të humburit.» Kur vërejti Diellin duke
lindur, ai thërriti: «Ky është Zoti im, ky është
më i madhi!» Por, pasi Dielli perëndoi, ai tha:
«O populli im, unë jam larg nga idhujt që ju
ia shoqëroni Allahut në adhurim! Unë e kthej
fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe
Token, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk
jam nga idhujtarët!»” (En’am, 76-79)**

Ky djalosh kaq i gjallë dhe i mençur, pasi gjeti Zotin e tij, nisi një betejë të madhe të tevhidit (monoteizmit). Për të shpëtuar njerëzit që kishin mbetur në moçalin e idhujtarisë dhe mohimit, tregoi me vendosmëri çdo lloj përpjekjeje që kishte mundësi.

Ibrahimi ؑ , ishte mërzitur shumë për popullin e tij, që nuk e dëgjonte. Për t’u treguar paaftësinë e idhujve nga druri dhe gurët, bëri një plan mjaft të zgjuar. Mori një sëpatë, shkoi në tempullin ku adhuroheshin idhujt dhe i theu të gjithë. Ai la vetëm idhullin e madh, të cilit ia vari sëpatën në qafë. Në mbrëmje, kur fisi Keldani u kthye nga vendi i ceremonisë së festës për në tempull, u shokuan nga ajo çfarë po u shihnin sytë. Duke hamendësuar, thanë:

**“Kemi dëgjuar një djalosh që i përgojonte
(idhujt), i cili quhej Ibrahim.” (Enbija, 60)**

Më pas e gjetën Ibrahimin
U dhe e pyetën:

“Ti e bëre këtë?!”

*“Jo, këtë e bëri idhulli i madh.
Pyetni ata, nëse mund të flasin!”*
- u tha ai.

Populli idhujtar u ndërgjegjësua dhe e kuptoi se sa gabim dhe marrëzi ishte ajo që ata bënin. Mirëpo nuk hoqën dorë nga kokëfortësia e tyre dhe thanë:

“Ti e di shumë mirë se idhujt nuk flasin!”

“(Ibrahimi:) - “Mos vallë, ju adhuroni në vend të Allahut gjëra që nuk mund t’ju sjellin kurrfarë dobie e as dëmi?! Mjerë ju dhe mjerë ata që ju i adhuroni në vend të Allahut! A nuk arsyetoni?!” (Enbija, 66-67)

Populli idhujtar, megjithëse ishte i ndërgjegjshëm për të vërtetën, vazhdoi me kokëfortësi dhe vendosën ta hedhin në zjarr Ibrahimin U . Mirëpo, Allahu i Madhëruar, e ktheu zjarrin në një kopsht me lule për këtë djalosh kaq guximtar.

Allahu i Madhëruar është kënaqur nga Ibrahim U dhe e ka lavdëruar atë duke thënë:

“Ibrahimi, i cili i qëndroi fjalës” (Nexhm, 37)

Gjithashtu, Allahu i Madhëruar, përmes ajetit **“Kur Zoti i tij i tha: «Përu!» - ai u përgjigj: «Iu përula Zotit të gjithësisë!»** (Bekare, 131), e ka përmendur dhe lavdëruar atë si shëmbëlltyrën e dorëzimit tek Allahu.

Ibrahimi U , fliste me mençuri dhe urtësi. Allahu i Madhëruar shpjegon se si e mundi ai Nemrudin me zgjuarsinë e tij:



Ibrahimi U , atyre që kanë kërkuar këshillë prej tij, u ka thënë:

“Kur të shihni që njerëzit janë të zënë me punët e kësaj bote, atëherë ju merruni me punët e botës tjetër. Nëse ata merren me zbulimin e të jashtmes, atëherë ju merruni me zbulimin e të brendshmes suaj. Nëse ata merren me ndërtimin e tendave, kopshteve dhe sarajeve, atëherë ju merruni me ndërtimin e varreve. Nëse njerëzit merren me gabimet e njëri - tjetrit, atëherë ju merruni me gabimet tuaja.”



Një person erdhi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha:

“O Hajrul-Berijje /o më i miri i krijesave!” Profeti ynë i dashur, ndërhyri menjëherë dhe i tha:

“Kjo që sapo the është cilësi e Ibrahimit ﷻ!”

(Muslim, Fedail, 150.)

ti nga perëndimi”! Atëherë, ai (mohuesi) mbeti me gojën hapur. Allahu nuk i udhëzoi ata që janë keqbërës.” (Bekare, 258)

Ibrahimi **U**, ishte një djalë i veçantë. Që në fëmijëri, ai ka treguar përpjekje të mëdha në fushën e mendimit, duke u zhytur në botën e meditimit për të gjetur tevhidin dhe të vërtetën. Pastaj, për të jetuar dhe kumtuar të vërtetën e besimit që kishte mbërritur, ka marrë përsipër sakrificat të mëdha; ka bërë xhihad në rrugë të Zotit, me mendje, zgjuarsiri dhe guxim. Ai është bërë shembull i bukur edhe për të rinjtë, se si dhe ku duhet t’i harxhojnë energjitë, mendjen, idetë, trimërinë dhe përpjekjen e tyre për të arritur idealin.

ISMAILI **U : Djaloshi që iu flijua Zotit**

Ibrahimi **U**, kishte dhënë fjalën që, nëse do të kishte një djalë, do ta flijonte për Zotin. Erdhi dita dhe Allahu i Madhëruar kërkoi nga ai që ta mbante fjalën e dhënë.¹² Kështu, Ibrahimi dhe familja e tij filluan të

“A nuk ke dëgjuar ti (Muhamed) për atë që bëri fjalë me Ibrahimin për Zotin e tij, sepse Allahu i kishte dhënë pushtet? Kur Ibrahim i tha: “Zoti im është Ai që jep jetë dhe shkakton vdekje” - ai u përgjigj: “Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje”. Ibrahim i pas-taj i tha: “Allahu e sjell Diellin nga lindja. Sille

garonin në virtyte dhe punë të mira. Secili prej tyre manifestuan shembuj cilësish të larta, si mbështetjen tek Zoti (tevekkul), dorëzimin tek Ai (teslimijet), pëlqimin e Tij (riza), besnikëri dhe durim.

Për të realizuar dëshirën e Zotit, Ibrahim **U**, kërkoi nga e shoqja e tij, Haxherja, që ta lante djalin e tij, ta lyente me erëra të mira, pasi dëshironte ta çonte tek një mik i tij. Ndërsa të birin, Ismailin e porositi të merrte me vete një litar dhe një thikë. Pastaj i thotë:

“Biri im! Unë do të ther kurban për hir të Allahut!”

Ata u nisën drejt Arafatit -në vendin ku sot qëndrojnë haxhilerët. Ndërkohë shejtani, shkoi tek Haxherja në formë njeriu dhe i thotë:

“E di ti se ku po e çon Ibrahim të birin?”

“Tek miku i tij.” - i përgjigjet ajo.

“Jo, po e çon që ta presë!” - i thotë shejtani.

“Ai e do shumë të birin!” - i thotë Haxherja.

“Do ta bëjë kurban, sepse e ka urdhëruar Allahu!”, vazhdon me këmbëngulje shejtani. Atëherë, Haxherja i përgjigjet:

“Nëse e ka urdhëruar Allahu, është gjë e bukur! Ne mbështetemi tek Ai!”

Shejtani, pasi e pa se nuk arriti ta mashtronte Haxheren, iu drejtua Ismailit, duke i thënë:



***“O Ibrahim, ti e përmbushe
ëndrrën! Vërtet, Ne kështu i
shpërblejmë punëmirët! Kjo,
me të vërtetë ka qenë një
sprovë e qartë!”***

**“O njerëz!
Frikësojuni
Zotit tuaj dhe
frikësojuni Ditës,
kur prindi nuk
do të mund ta
ndihmojë aspak
fëmijën e vet, e as
fëmija nuk do të
mund ta ndihmojë
sado pak prindin
e vet! Premtimi
i Allahut është
vërtet i sigurt,
prandaj mos e lini
jetën e kësaj bote
t’ju mashtrojë dhe
as djallin mos e
lini t’ju mashtrojë
për Allahun.”**

(Lukman, 33.)



“A e di se ku po të çon babai?”

“Për një vizitë tek një mik i tij.” - i tha Ismaili.

“Jo, po të shpie të të bëjë kurban. Ai mendon se kështu e ka urdhëruar Zoti.” - i thotë shejtani.

Atëherë, Ismaili i tha:

“Nëse e ka urdhëruar Ai, ne e kryejmë me kënaqësi këtë gjë!” Më pas e përzuri shejtanin duke e gjuajtur me gurë. Shejtani nuk arriti ta mashtrojë as Ismailin. Prandaj shkoi tek Ibrahim i U dhe i tha:

“O plak! Ku po e çon djalin? Ty të ka mashtruar shejtani në ëndërr! Ato ëndërra janë djallëzore!”

Mirëpo, Ibrahim i U , iu drejtua duke i thënë:

“Ti je shejtani! Largohu prej nesh!” - dhe e gjuajti me gurë.

Kështu pra filloi edhe gjuajtja me gurë e shejtanit, e cila do të vazhdojë deri në Kiamet si një rit fetar i haxhit. Kjo ngjarje, si një shenjë e dashurisë ndaj mbështetjes dhe dorëzimit tek Allahu, u bë një shembull për gjithë Umetin Islam.

Ibrahim i U , i tregoi Ismailit të vërtetën e kësaj çështjeje:

“Biri im! Në ëndërr u urdhërova që të të bëj kurban ty!” Ismaili U , i tha:

“O baba! Allahu ta ka urdhëruar këtë?”

“Po!” - i tha Ibrahim i U . Atëherë Ismaili i tha:

“Babai im i dashur! Bëj atë që të është urdhëruar!

InshaAllah unë do të jem prej durimtarëve!”

Kështu, Ismaili i bëri të ditur, se ai ishte i gatshëm të sakrifikoje jetën e tij. Pasi e qetësoi të atin me këto fjalë, vazhdoi e tha:

“Babai im i dashur! Kur të hodhi Nemrudi në zjarr, ti durove. Allahu i Madhëruar e pëlqeu këtë veprim. Ndaj edhe unë jam i gatshëm që të më bësh kurban. InshaAllah unë do të jem prej durimtarëve. Kur të ndahem prej teje, do të arrij tek Zoti. Kur të ndahem nga dhuntitë e kësaj bote, do të arrij dhuntitë e botës tjetër.”

Atë kohë, Ismaili **U**, ishte vetëm 13 vjeçar.¹³

Më pas, Ismaili **U**, tha:

“Babai im i dashur! Kushti i dashurisë është të mos i vonosh urdhrat! Kryeje urdhrin që të është dhënë!”

Kur Ibrahim **U**, tentoi ta priste të birin, thika nuk preu. Atëherë, Allahu i Madhëruar urdhëroi:

“O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën! Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë!”

Pas kësaj, Allahu zbriti një kurban të madh për t’u bërë kurban në vend të Ismailit. (Shih. Saffat, 104-107.)¹⁴

Ja pra bindja ndaj Zotit e një djaloshi 13 vjeçar dhe respekti i tij për të atin...



**“Në të vërtetë,
Allahu ka blerë
nga besimtarët
jetën dhe pasurinë
e tyre, në këmbim
të Xhenetit.”**

(Teube, 111.)

13. Shih. Hakim, Mustedrek, II, 605-606/ 4040; Taberi, Tarih, I, 263-278.

14. Shih. Taberi, Tarih, I, 275; Ibni Ethir, el-Kamil, I, 112; Hakim, Mustedrek, II, 606/4040.



Personaliteti dhe sjelljet e një myslimani, duhet të kenë cilësitë, “e mirë, e bukur dhe e plotë”. Pra, çdo punë e tij duhet të jetë e mirë dhe gjithmonë duhet të përçojë mirësi përreth vetes. Po ashtu, ai duhet të ketë hijeshi dhe butësi, që i dhuron qetësi dhe ngrohtësi zemrave të të tjerëve. Përveç këtyre, ai duhet të jetë i pjekur dhe i përsosur në të gjitha aspektet. Për rrjedhojë, çdo punë dhe vepër e besimtarëve të tillë idealë, pasqyron bukurinë, madhështinë, estetikën, prehjen shpirtërore dhe fytyrën e bukur të Islamit.

Jusufi U

Një tjetër djalosh, jeta e të cilit përmendet në Kuranin Famëlartë, është Jusufi. Jusufi U , është shembulli i bukurisë, nderit, durimit dhe mëshirës.

Jeta e tij e mbushur plot mësimë, është një shembull i veçantë lidhur me faktin se si mund të përballohen fatkeqësitë dhe vështirësitë që sjell jeta dhe se si mund të shndërrohet e keqja në të mirë, kur ajo përballohet me durim. Në jetën e Jusufit U , shohim se çfarë lloji të këqijash mund të presë njeriu edhe nga vëllezërit, të cilët konsiderohen më të afërmit e tij. Po ashtu, në jetën e tij shohim se si një rrugëtim i mundimshëm fillon në një pus, vazhdon me një jetë burgu të gjatë dhe shkon deri në fronin e Egjiptit.

Një sprovë e rëndë

Një grua e re, e bukur, e pasur dhe e push-tetshme i përgatiti të gjitha kushtet. Pastaj e ftoi Jusufin U , në imoralitet, duke i thënë: “Hejte lek!: Jam e gatshme për ty!”. Mirëpo, ai i tha: **“Allahu më ruajt! Me të vërtetë, Zoti im ka treguar kujdes për mua dhe, pa dyshim, keqbërësit nuk do të shpëtojnë kurrë.”** Pastaj u largua me shpejtësi nga ajo. Kur Jusufi U , mbeti i detyruar të zgjedhë mes imoralitetit dhe burgut, pa ngurruar aspak tha:

“O Zoti im, më shumë e dua burgun se atë ku më shtyjnë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua).”

Kështu, Jusufi **U** , u mbështet tek Allahu dhe Allahu e ruajti nderin e tij. (Shih. Jusuf, 23-25, 33-34.)

Disa dijetarë të mëdhenj, kanë thënë:


“Shpëtimi nga e keqja e nefsit, nuk është e mundur me plotësimin e dëshirave të tij. Mënyra për të shpëtuar nga kjo, është mbështetja tek Allahu dhe përparimi në rrugën e devotshmërisë.”

Kumtimi i së vërtetës edhe në burg

Kur e hodhën në burg, Jusufi **U** , nuk e harxhoi kohën me mërzi të padobishme. Por mendoi se çfarë pune të mirë mund të bënte brenda kushteve që ndodhej. Në sajë të diturisë që i kishte dhuruar Allahu i Madhëruar, ai fitoi simpatinë e shokëve të burgut, të cilëve filloi t’u shpjegonte besimin e tevhidit.

Shokët e tij në burg kishin parë ëndrra mjaft të çuditshme. Jusufi **U** u tha se e dinte kuptimin e ëndrrave dhe kështu ai arriti të tërhiqte vëmendjen e tyre. Duke marrë shkas nga kjo, fillimisht ai u shpjegoi tevhidin. U shpjegoi atyre se ai ndiqte fenë e vërtetë, se diturinë që kishte ia kishte dhënë Allahu i Madhëruar dhe se egjiptianët janë në rrugë të gabuar. (Shih. Jusuf, 36-41.)

Sipas transmetimit, Jusufi **U** , vizitonte të sëmurët në burg, përpiquej t’i shëronte ata dhe kujdesej për shëndetin e tyre. Ai ngushëllonte ata që ishin të shqetësuar apo të mërziur, ndihmonte ata që kishin probleme dhe nevoja të ndryshme. (Kurtubi, IX, 190.)



“Dhe mos iu qasni zinasë (imoralitetit), se ajo është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar!” (Isra, 32)

Ai që shëtit buzë greminës, është i dënuar të shkatërrohet. Zinaja është helm i shoqërisë, jetës dhe trashëgimisë familjare...

Ajo që bie në sy në këtë pikë, është hijeshia dhe bukuria e metodës që përdorte Jusufi ﷺ. Një tjetër gjë që na tërheq vëmendjen tek ai, është fakti se besimtari nuk duhet ta neglizhojë kumtimin e Islamit dhe veprat e mira, qoftë edhe në kushtet më të vështira. Pra, jo të ulesh dhe të presësh në mënyrë pasive derisa të realizohen kushtet e përshtatshme për të shërbyer në rrugë të Allahut, por edhe në kushtet më të vështira madje, duhet të përpiqesh me aq sa është mundësia, të kërkosh mënyrat për të shërbyer për hir të Zotit dhe të krijosh mundësitë për një gjë të tillë.



Një besimtar të mençur, nuk e kap asnjëherë mërzia në çfarëdolloj gjendjeje qoftë. Ai gjithmonë di të gjejë mundësinë për të shërbyer, sepse rruga e vetme për të pashpresët, është Allahu!

Ekipi i Jusufit ﷺ , i përbërë nga të rinjtë

Pasi shpëtoi nga burgu dhe u bë sundimtari i Egjiptit, Jusufi ﷺ , formoi një ekip prej të rinjsh për të punuar së bashku. Këtë e kuptojmë nga ajeti “**Jusufi u tha të rinjve të vet...**” (Jusuf, 62.)

Krahasuar me të vjetrit, të rinjtë janë më rezistentë dhe më dinamikë. Sidomos kur janë edukuar mirë në të gjitha aspektet, ata arrijnë suksese të mëdha nën udhëheqjen e liderëve të tyre.

Musai ﷺ dhe ndihmësi i ri, Jusha ﷺ

Në Kuranin Famëlartë, historia e Musait ﷺ , zë një vend të veçantë. Aty tregohet se të rinjtë nuk duhet të jenë të nxituar dhe të padurueshëm, duhet të

ruhen nga veprimet e pamatura dhe duhet të qëndrojnë sa më larg gjynaheve. Po ashtu jepen këshilla për virtyte të bukura, si trimëria, maturia, mbështetja tek Allahu, sakrifica për hir të Zotit, bamirësia e sinqertë pa pritur shpërblim, edukata, turpi, besueshmëria, mbajtja e fjalës dhe cilësia në punë. Krahas këtyre, këtu tërhiqet vëmendja në faktin se të rinjve duhet t'u jepen detyra dhe përgjegjësi të rëndësishme. (Taha, 17-18; Kasas, 14-28.)



Kur po shkonte të takohej me Hidrin **U** , Musai **U** , kishte pranë ndihmësin e ri Jushan. Ky djalosh, i shërbente me sinqeritet Musait **U** dhe ishte shembull në shërbimin me respekt ndaj të mëdhenjve. (Shih. Kehf, 14-28.)

Sipas transmetimit, Musai **U** , këtë djalosh të mençur e caktoi komandant në krye të ushtrisë së vet. Ndërsa pas vdekjes e la si zëvendësin e tij.

Shokët e Shpellës

Shokët e Shpellës (Banorët e Kehf-it) kanë qenë një grup djemsh të rinj besimtarë që kanë jetuar në Tarsus, gjatë sundimit të një idhujtari tiran me emrin Dakjanus dhe janë përpjekur të kumtojnë besimin e vërtetë monoteist.

Ata janë lavdëruar për shkak të rezistencës në besimin e tyre, qëndresës ndaj padrejtësive dhe vendosmërisë në rrugën e Allahut. Për rrjedhojë, të gjithë besimtarët që do të vijnë deri në Ditën e Kiametit, do t'i përkujtojnë ata me admirim të thellë.

*“Gjatë udhëtimit në të cilin Hidri **U** , po i tregonte Musait **U** , ngjarje të çuditshme plotë urtësi e mistere, një harabel erdhi dhe u ul në cep të anijes. Pastaj, me sqepin e tij mori ujë nga deti. Ndërkohë, Hidri **U** , ia tregon këtë skenë Musait **U** dhe i thotë:*

“Në krahasim me diturinë e Allahut, dija jote, e imja dhe e gjithë krijesave të tjera është aq sa uji që mori ky zog me sqepin e tij nga deti.”

(Buhari, Tefsir, 18/4.)



Dy gjëra kanë ndikim të madh në gjendjen dhe sjelljen e njeriut:

1. Cilësia hallall apo haram e ushqimit që ka konsumuar: Ushqimi hallall i jep njeriut frymëzim dhe energji shpirtërore, kurse ushqimi haram e bën atë indiferent dhe të plogësht.

2. Gjendja shpirtërore e njerëzve që ai do: Njeriu përfiton mirësi nga gjendjet pozitive të njerëzve të mirë, për të cilët ushqen dashuri dhe ligësi prej të këqijave të gjynahqarëve.

Këta djem që ishin nga të afërmit e mbretit Dakjanus, kishin gjetur të vërtetën në mesin e errësirave dhe besëtytnive. Ata i ishin mbështetur Allahut dhe kanë jetuar gjithnjë duke iu lutur Atij. Kështu edhe Allahu ua kishte përforcuar besimin e tyre. Kur erdhi koha e duhur, ata e shprehën hapur besimin e tyre dhe shfaqën një guxim

besimi kundër tiranëve. Në Kuranin Fisnik, urdhërohet:

“Ne i forcuam zemrat e tyre, kur u ngritën e thanë: “Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Ne nuk do t’i lutemi asnjë zoti tjetër, përveç Tij, sepse atëherë do të thoshim një gënjeshtër të madhe. Ky populli ynë ka zgjedhur në vend të Tij zota të tjerë, ndonëse ata nuk u sjellin dot asnjë provë të qartë. E kush është keqbërës më i madh, se ai që trillon gënjeshtër për Allahun?” (Kehf, 14-15.)

Më pas, ata shpëtuan nga duart e tiranit Dakjanus dhe u fshehën në një shpellë. Aty u lutën duke thënë:

“O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe përgatitna për sjellje të drejtë!” (Kehf, 10.)

Zoti i Madhëruar i bëri ata të flenë për një kohë të gjatë në shpellë.

Rumi thotë:

“Më mirë është të flesh, sesa të gjendesh në mesin e indiferentëve (gafilëve) dhe të ndikohesh negativisht prej tyre. Ndaj dhe Zoti i Madhëruar i largoi Shokët e Shpellës nga mëkatarët dhe i ruajti zemrat e tyre nga indiferenca.”

Kur Shokët e Shpellës u zgjuan pas 309 viteve, menduan se kishin qëndruar për një kohë të shkurtër. Megjithatë, ata kishin nevojë të merrnin ushqime nga qyteti. Por shqetësimi i tyre më i madh ishte të qëndronin larg harameve për të ruajtur besimin e tyre. Zoti i Madhëruar urdhëron:

“(Ata thanë:) Dërgoni njërin prej jush në qytet me këtë monedhë argjendi tuajën e le të shikojë se cili ushqim është më i pastër. Le t’ju sjellë diçka prej tij, le të sillet mirë dhe askush të mos marrë vesh për ju. Me të vërtetë, nëse ju zbulojnë, ata do t’ju gjuajnë me gurë ose do t’ju kthejnë (me forcë) në fenë e tyre dhe atëherë nuk do të shpëtoni kurrsesi!” (Kehf, 19-20)

Si rezultat i këtij sinqeriteti, ata u bënë argument për vërtetësinë e premtimit të Zotit, për plotfuqinë e Tij dhe të vërtetat e padiskutueshme si Dita e Kiametit, ringjallja pas vdekjes dhe bota tjetër. (Shih. Kehf, 21.)

Shokët e Rakim-it

Shokët e Rakim-it, të cilët përmenden në Kuranin Famëlartë, janë tre djem të devotshëm prej Bijve të Israelit që kanë jetuar shumë kohë më parë. (Shih. Kehf, 9.)

Ngjarjen e tyre, e cila është e mbushur me mësim në shumë aspekte, na e tregon i Dërguari i Allahut ﷺ:

“Tre presona, të cilët kanë jetuar kohë më parë, dolën për udhë dhe, për të kaluar natën, u futën në një

“Qeni i Shokëve të Shpellës, fitoi nder të madh për shkak se ishte bashkë me njerëzit e mirë dhe, fama e tij u përmend në Kuran dhe në histori. Ndërsa bashkëshortet e profetëve Nuh dhe Lut, ranë në mohim për shkak se qëndruan bashkë me njerëzit gjynahqarë.”

(Shejh Sadi Shirazi)





Mos e harro Allahun në kohë pasurie dhe rehatie, që Ai mos të të harrojë kur je ngushtë dhe në vështirësi. Rrugën e paqes dhe lumturisë së vërtetë Kurani na bën të ditur me këto fjalë:

أَلَا بِذِكْرِ اللَّهِ
تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ

“Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”

(Ra'd, 28.)

shpellë. Ndërkohë (që ishin në shpellë), një shkëmb bie nga mali dhe zë hyrjen e shpellës. Pas kësaj që ndodhi, tre shokët i thanë njëri-tjetrit:

«Neve nuk na shpëton dot gjë prej këtu, përveçse të lutemi me veprat tona të mira!»

Njëri prej tyre tha:

«Zoti im! Unë kisha dy prindër shumë të moshuar. Unë nuk u jepja të hanë e të pinë as fëmijëve të mi dhe as kafshëve para tyre. Një ditë kisha shkuar larg për dru dhe nuk munda të kthehem para se ata t'i zinte gjumi. Unë e përgatita ushqimin e darkës, por i gjeta në gjumë. Prandaj, nuk m'u duk me vend t'i zgjoja, por, as ta pinim si familje qumështin e darkës pa qenë edhe ata. Prita me enë në dorë që të zgjoheshin. Më në fund zbardhi dita. Ndërsa fëmijët qanin tek këmbët e mia nga uria. Atë çast, prindërit e mi u zgjuan dhe e pinë qumështin e mbrëmjes.

Zoti im! Nëse këtë veper e kam bërë për kënaqësinë Tënde, na shpëto prej belasë së këtij shkëmbi!»

Shkëmbi lëvizti pak, por jo aq sa mund të dilnin.

I dyti u lut kështu:

«O Zot! Xhaxhai im kishte një vajzë, të cilën e doja më shumë se çdokush tjetër. Unë desha të bashkohesha me të. Por ajo nuk ma pranoi propozimin. Disa vjet më vonë, kur e kapi një kohë zie, erdhi tek unë. Unë i dhashë njëqind dërrhem me kusht që të pranonte dëshirën time. Ajo pranoi e detyruar. Por, sapo unë iu afrova, ajo më tha:

“Ki frikë Zotin dhe mos ma merr nderin pa asnjë të drejtë!”

Ndërsa unë duke u frikësuar nga Zoti, u largova nga ajo femër që e dëshiroja aq shumë, megjithëse ajo ishte e detyruar t'i dorëzohej dëshirës sime. Madje, edhe florinj të që ia pata dhënë, ia lashë asaj.

Zoti im! Nëse këtë gjë e kam bërë vetëm për të fituar kënaqësinë Tënde, na e largo belanë e këtij shkëmbi!»

Hyrja e shpellës u hap edhe ca, por përsëri jo aq sa për të dalë ata.

Personi i tretë tha:

«Zoti im! Mora disa argatë me pagesë dhe, pasi mbaruan punën, i pagova. Mirëpo, njëri prej tyre iku pa e marrë pagesën. Unë i bashkova paratë e tij me të miat dhe shtova mallin. Pas një farë kohe njeriu erdhi tek unë dhe më tha:

- Ma jep pagesën time!

Ndërsa unë i thashë:

- Këto tufa devesh, lopësh dhe delesh, janë shtuar prej parave të tua. Merri, janë të gjitha të tuat!

Ai tha:

- O rob i Zotit! Mos u tall me mua!

- Jo nuk tallem me ty!

Po them të vërtetën!


Pas kësaj, njeriu i mori të gjitha dhe shkoi pa lënë asgjë.

O Zot! Nëse e kam bërë këtë për kënaqësinë Tënde, na e largo këtë të keqe!»

Më në fund, shkëmbi rrëshqiti prej hyrjes së shpellës. Më pas, ata dolën

**“O besimtarë!
Kini frikë Allahun,
përpiquni që t'i
afroheni Atij me
vepra të mira
dhe luftoni në
rrugën e Tij për të
shpëtuar!”**

(Maide, 35.)



“...Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria.”

(Bekare, 197)

“Si të jetoni, ashtu do të vdisni, si të vdisni ashtu do të ringjallen!”

(Munavi, Fejdul-Kadir, V, 663.)



dhe vazhduan rrugën e tyre. (Shih. Buhari, Edeb, 5, Enbija 53, Buju' 98, Ixhare 12, Hars 13; Muslimi, Dhikr, 100; Ahmedi, IV, 274.)

Ashtu sikurse këta djem, duhet të bëjmë vepra aq të mira, saqë të mbështetemi tek ato atëherë kur do të përballemi me shqetësime, fatkeqësi dhe sprova! Duhet të kemi fytyrë që t'i kërkojmë ndihmë Zotit të Madhëruar duke ndërmjetësuar me këto vepra.

Lukmani U dhe i biri

Lukmani U , ishte njeri shumë i urtë. Kur e këshillonte të birin, pikësëpari i theksonte të mos i bënte shirk Allahut, pasi shirku është një padrejtësi dhe gabim shumë i madh. Në Kuranin Famëlartë, pas ajeteve ku njoftohemi me këto këshilla, Zoti ynë tërheq vëmendjen tek të drejtat e prindërve, duke folur për sakrificat që bëjnë prindërit për fëmijët e tyre. Aty bëhet fjalë për ndjenjën e mirënjohjes që duhet të kemi ndaj Allahut dhe ndaj tyre.

Ashtu sikurse përmendet edhe në ajetet e tjera, Lukmani U , e porositi të birin lidhur me besimin, adhurimin dhe moralin, në këtë mënyrë:

“O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njeh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë.

O djali im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo

që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!

Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhentë e mburracakët!

Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!” (Lukman, 16-19)

I riu mysliman duhet të zotërojë mirësjellje, edukatë dhe finesë. Dhe, esenca e të gjitha këtyre është përmendur në ajetet e mësipërme.

Jahja U

Jahja U , ishte djali i tezes së Merjemes. Ai ishte një besimtar, rritur dhe edukuar me adhurime që prej fëmijërisë. Ndërsa profetësia i është dhënë në moshën e pjekurisë. Jahja U , ka kaluar një jetë mjaft të ndershme, por u martirizua nga një sundues tiran, për shkak se ai kundërshtoi hapur imoralitetin e tij.

Ndërkohë që Allahu i Madhëruar i jep lajmin e mirë të atit të tij mjaft të moshuar për lindjen e tij të mrekullueshme, ka tërhequr vëmendjen edhe në këto cilësi që duhet t'i ketë një i ri besimtar:

- Fisnik
- I ndershëm
- I mirë. (Shih. Ali Imran, 39.)

Allahu i Madhëruar e urdhëroi Jahjan U , të kapet



I Dërguari i Allahut ﷺ, lidhur me Lukman Hekimin ka thënë:

“Lukmani i tha të birit: «Allahu i Lartësuar, e mbron atë që i është lënë amanet! Prandaj unë po të lë ty, pasurinë, fenë dhe përfundimin e veprave të tua si amanet tek Allahu!»”

(Ibni Hanbel, II, 87.)

Jahja U , ka gëzuar mëshirën e Allahut të Lartësuar në tri ditë të vështira:

“Paqja qoftë mbi atë ditën kur ka lindur, ditën kur të vdesë dhe në ditën kur do të ringjallet.”

(Merjem, 15.)

Bejdaviu këtë ajet e shpjegon në këtë mënyrë:

“Mos e cenoftë shejtani që cyt njerëzit! Qoftë i shpëtuar nga dënimi i varrit! Mos paftë llogari dhe ndëshkim xhehenemi!”



fort pas librit që kishte shpallur, që kur ai ishte ende në moshën e pjekurisë:

“(Pasi lindi djali, iu tha): “O Jahja, rroke fort Librin (Teuratin).” Dhe Ne, i dhamë mençuri kur ende ishte fëmijë.” (Merjem, 12.)

Jahja U , i cili e kishte kaluar rininë e tij sipas pëlqimit të Zotit, në Kuranin Famëlartë lavdërohet me këto virtyte të bukura:

“Ne i dhamë butësi dhe dëlirësi. Ai ishte besimtar i përkushtuar dhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte i ashpër dhe i padëgjueshëm.” (Merjem, 13-14.)

Në kohën kur u martirizua, Jahja U , ishte tridhjetë e ca vjeç.

Isai U

Isai U , ishte profeti i fundit që iu dërgua Bijve të Izraelit. Ai ishte një nga pesë profetët më të lartë, që quheshin **“ulu’l-adhm”**.

Kur Allahu i Madhëruar jep lajmin e mirë të lindjes së Isait, njofton se ai do të jetë i nderuar dhe i respektuar në të dyja botët dhe një rob i devotshëm nga të afërmit e Allahut. (Shih. Ali Imran, 45-46.)

Kur Isai U , foli që në djep me leje të Zotit, tërhoqi vëmendjen mbi këto virtyte të larta:

“Ai (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin

(Ungjillin), **më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm.**” (Merjem, 30-32.)

Në moshën tridhjetë vjeç, Isait **U**, iu dha detyra e profetësisë, të cilën ai filloi ta ushtrojë menjëherë. Ai i bëri ballë shumë vështirësive në rrugë. Kur hebrejtë tentuan ta vrisnin në moshën tridhjetetë vjeçare, Allahu i Madhëruar e ngriti në qiell.

Merjemja

Merjemja është një shembull i pashoq në aspektin e përkushtimit në adhurim që në moshë të re, ndershmërisë, durimit dhe dorëzimit ndaj Allahut. Ajo ishte një vajzë e re që kishte gëzuar pëlqimin dhe gostitjet e llojllojshme nga Allahu. Ajo u rrit si një lule e brishtë, nën edukimin e Allahut dhe kujdesin e Zekerijjas **U**. Ajo ka gëzuar prej mirësive të Xhenetit që kur ishte ende në këtë botë. Po ashtu, ajo ka parë Xhibrilin **U** dhe ka pasur nderin të jetë nëna e një profeti të madh, në sajë të një lindjeje të mrekullueshme.

Merjemja është e vetmja grua së cilës i përmendet emri në Kuranin Famëlartë. Konkretisht, emri i saj përmendet 34 herë në Kuranin Famëlartë.

Kur nëna e solli në jetë Merjemen, ajo kërkoi mbrojtjen e

*Isai **U**, ka thënë:*

“Bëhuni miq të Allahut, duke u bërë armiq të mohuesve të Zotit! Qëndroni afër Zotit, duke u qëndruar larg mohuesve të Tij dhe fitoni kënaqësinë e Allahut duke i urreyer ata!..”

*Besimi i vërtetë arrihet duke dashur ata që meritojnë dashuri dhe duke urreyer ata që meritojnë urrejtje. Për rrjedhojë, në suren Mesed këshillohemi ta urrejmë idhujtarin kokëfortë, Ebu Lehebin, megjithëse ishte xhaxhai i Profetit **U**.*



**Resulullahu
ﷺ, lidhur me
Merjemen ka
thënë:**

***“Merjemja, e
bija e Imranit,
ishte më e mira
prej grave që
gjendeshin atë
kohë në botë...”***

***(Muslim, Fedailus-
Sahabe, 69.)***

Allahut nga e keqja e shejtanit për të dhe pasardhësit e saj. (Shih, Ali Imran, 36.) Pra, edhe ne duhet të kërkojmë mbrojtjen e Allahut në çdo punë dhe në çdo kohë.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Edhe Merjemen, të bijën e Imranit, e cila ruajti virgjërinë e saj; Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë (shpirtin e Isait ﷺ). Ajo u besoi fjalëve të Zotit të saj dhe librave të Tij e ishte nga të devotshmit!” (Tahrim, 12; Enbija, 91.)

Merjemja kryente adhurim ditë e natë. Ajo shquhej për devotshmëri mes Bijve të Izraelit. Madje, prej saj kishin filluar të shfaqeshin edhe mrekulli. Në Kuran ajo është lavdëruar me emrin “siddika”.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“(Kujto) kur melekët thanë: «O Merjeme! Allahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka parapëlqyer ty mbi të gjitha gratë e botës. O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen (duke adhuruar Allahun)!»” (Ali Imran, 42-43.)



Resulullahu ﷺ, lidhur me Merjemen ka thënë kështu:

“Merjemja, e bija e Imranit, ishte më e mira prej grave që gjendeshin atë kohë në botë. Kurse Hatixhja është më e mira e grave të këtij Umeti.” (Muslimi, Fedailus-Sahabe, 69.)

Kështu, në sajë të jetës së pastër, të ndershme dhe

plot përkushtim ndaj Allahut, Allahu i Madhëruar, e bëri Isain dhe nënën e tij, Merjemen, argumente të fuqisë së Vet. (Shih. Mu'minun, 50.)

Asija

Asija, e cila ishte e shoqja e Faraonit, kur pa mrekullinë e bastunit, i besoi Musait **U**. Kur Faraoni e mësoi këtë, e torturoi rëndë Asijen. Ai e gozhdoi në tokë, i vendosi një shkëmb të madh mbi trup dhe e braktisi nën diellin përvëlues. Pikërisht atëherë Asija bëri lutjen e saj të famshme. Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Allahu ka dhënë si shembull për besimtarët gruan e Faraonit, kur ajo tha: «O Zoti im! Ndërtomë një banesë tek Ti, në Xhenet; më shpëto nga Faraoni dhe veprat e tij dhe më shpëto nga populli keqbërës!»” (Tahrim, 11.)

Menjëherë pas kësaj duaje, asaj iu tregua vendi i saj në Xhenet dhe iu mor shpirti pa ndjerë asnjë dhimbje.

Resulullahu **Γ**, ka thënë kështu:

“Gratë më të virtytshme të Xhenetit janë Hadixhe binti Huvejlid binti Muhamed, Merjem binti Imran dhe e shoqja e Faraonit, Asije binti Muzahim.” (Ahmed, I, 293.)

Në veprën e tij *Araisu'l-Mexhalis*, Thalebiu shprehet:

Dy gra janë më lart nga të tjerat në aspektin e zgjuarsisë. Që të dyja ia kanë qëlluar në mendimin



Besimtari është si ari në mesin e mineraleve. Edhe nëse të bie në baltë, nuk humbet asgjë nga pastërtia dhe vlera e tij. Ashtu sikurse Asija... Edhe pse ajo zonjë e nderuar ishte e shoqja e Faraonit mizor, sinqeriteti, besnikëria dhe devotshmëria në zemrën e saj ia ruajtën besimin. Ajo jetën e flijoj, por, prej besimit të saj pe nuk lëshoi.

*Në sajë të horizontit
të gjerë që u jep
besimi i tyre,
besimtarët e mirë
dhe të zgjuar, i
shohin ngjarjet nga
dritarja e ahiretit.
Për këtë arsye, ata
rrinë gjithnjë nën
një përllogaritje
plus-minus, pra
dobi - dëm. Përballë
dashurisë së tyre
ndaj besimit,
shqetësimet
dhe vuajtjet e
përkohshme të kësaj
bote, nuk ia vlejnë
as të përmenden...*

e tyre lidhur me Musain **U** . Njëra është e shoqja e Faraonit, Asija. Kur Musai **U** , u soll foshnje në saraj, ajo i tha Faraonit:

“Le të jetë ky fëmijë dritë syri për mua dhe për ty! Mos e vrit atë!”

Dhe vërtet ashtu ndodhi. Ajo i besoi Musait **U** dhe fitoi Xhenetin.

Ndërsa tjetra është vajza e Shuajbit **U** , e cila ka thënë kështu lidhur me Musain **U** :

“O babai im, - tha njëra nga ato të dyja - merre këtë njeri në shërbim! Sigurisht që njerëzit e fortë dhe të besueshëm janë më të mirët, që dikush mund të marrë në shërbim!” (Kasas, 26.)

Kur u pyet se si e kishte kuptuar këtë, ajo tha:

“Kur po vinim këtu, atij nuk iu duk e përshtatshme të ecte pas meje dhe më tha:

«O rob i Zotit! Ec pas meje dhe tregoma me fjalë nga cila anë duhet të shkojmë!»

Nga kjo sjellje, unë kuptova se ai njeri është shumë i besueshëm.”¹⁵



15. Për pjesën e dytë, shih. Darimi, *Mukaddime* 56/653; Ebu Nuajm, *Hilje*, III, 234 -236



BOTËKUPTIMI I JETËS

për të riun mysliman



Botëkuptimi i jetës për të riun mysliman

A nuk mendon njeriu, i cili zotëron mendje dhe gjykim të shëndoshë, se me çarjen e një fare të vetme fillon gëzimi pranveror dhe se gjithçka në gjithësi, që nga bota mikro deri tek ajo makro vazhdon të funksionojë me një rregull dhe harmoni madhështore!? Por, kush është artisti i kësaj harmonie? A nuk është shkak frymëzimi për njerëzit që meditojnë ky rend kaq i përsosur i gjithësisë me të cilin mahnitet mendja njerëzore? Përgjigjet e këtyre pyetjeve, gjenden në Kuranin Famëlartë në formën më të bukur. Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t’u zbavitur!” (Duhan, 38.)

“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!” (Mu’minun, 115.)

“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?”

(Kijame, 36.)

Njeriu duhet të jetojë me vetëdijen e këtyre të vërtetave. Madje, arritja e kësaj vetëdijeje gjatë periudhës së rinisë, është një çështje mjaft e rëndësishme.

Rinia merr vlerë aq sa perceptohet edhe entuziazmi i

Një jetë e shkujdesur, është thjesht lojë në fëmijëri, pakujdesi në adoleshencë, epsh në rini dhe njëmijenjë pendesa dhe përmallime në pleqëri, për gjithëcka që tashmë ka kaluar.





“Mendoj të sotmen, e djeshmja kaloi, po të nesërme ka?”

As rinisë s’i besoj, ata që vdesin veç të moshuarit janë?”

Në moshë për të vdekur është çdo njeri! E të vdekurit në varreza prej çdo moshe janë!..

besimit. Një rini që e hedh mbrapa botën e përhershme dhe ka mall vetëm për këtë botë, duke harruar të vërtetat si besimi, vdekja dhe ahireti, shkatërron edhe veten, edhe shoqërinë.

Mevlana i nderuar, njerëzve të tillë i drejtohet në këtë mënyrë:

“Eja në vete, o udhëtar!

Erdhi mbrëmja dhe dielli i jetës është në perëndim e sipër... Për sa kohë ke fuqi e energji, bëhu bujar dhe vepra mirë në këtë jetë dyditore!..”

Mbille mirë farën e jetës që ke në dorë dhe fito një jetë Xheneti përmes kësaj jete të përkohshme... Thirri mendjes dhe rregulloje fitilin e kandilit të kësaj jetë shumë të oyer, pa u fikur ende; vendosja shpejt vajin... pra, kaloji ditët e fundit me vepra të mira dhe adhurime! Zgjoje kandilin e zemrës tënde!

Thirri mendjes dhe këtë punë mos e lër për nesër, sepse shumë të nesërme kanë ardhur dhe kanë ikur! Fillo menjëherë punën me pendim e përgjërime për falje, që mos të të kalojë stina e mbjelljes!

Dëgjoje këshillën time! Egoja është një nyjë e fortë që na pengon për mirësi. Ajo të bëhet pengesë në rrugën e Zotit. Nëse do të rinovohesh dhe të korrighohesh, flake tutje të vjetrën, hiq dorë nga dëshirat e trupit dhe kërko kënaqësitë, entuziazmin dhe shijen shpirtërore!”

Allahu i Madhëruar, e ka krijuar njeriun vetëm që të jetë rob i Tij. Përsosmëria e besimit arrihet atëherë kur njeriu bëhet vetëm rob i Zotit dhe kur nuk pranon të bëhet rob i të përkohshmëve dhe interesave.

Muhamed Ikbali i fton ata që janë bërë skllëvër

të nefsit dhe të përkohshmëve që të mendojnë dhe të zgjohen nga gjendja e tyre, duke u thënë;

“Unë nuk kam parë asnjë qen që t’i përulet e t’i bëjë sexhde një qeni tjetër.”

Allahu i Madhëruar, gjithçka ndodhet në qiej dhe në Tokë e ka vënë në shërbim të atyre që do ta adhurojnë Atë.¹⁶ Dhe për ta bërë këtë adhurim me dashuri, pasion dhe entuziazëm, u ka dhuruar atyre veti shpirtërore, si meditimin, ndjenjën, dashurinë etj.

Edhe një i verbër e kupton lindjen e Diellit prej nxehtësisë së tij. Për rrjedhojë, është shumë e hidhur të shohësh që një njeri me mendje dhe arsye, të qëndrojë i mefshtë dhe i vrenjtur përballë manifestimeve të fuqisë hyjnore. E në fakt, për ata që kanë zemër të gjallë, që prej thërrmijave më të vogla, e deri tek objektet më gjigande, gjithçka është dëshmues i fortë i madhësitë dhe fuqisë hyjnore. Pra, një vitrinë madhështore e artit hyjnor.

Prandaj, objektivi i njeriut duhet të jetë kuptimi i së vërtetës, angazhimi me të dhe përgatitja për botën tjetër, që është e ardhmja e tij e vërtetë. Po ashtu, duhet që ai të mos mashtrohet me zbulurimet dhe stolitë e kësaj bote.

Sa bukur e ka krahasuar Mevlana rininë me pleqërinë:

“O ti që kafshon buzën përballë bukurisë së pranverës! Shih edhe gjendjen e zverdhur dhe ftohtësinë e vjeshtës! Kur shikon lindjen e Diellit të bukur në agim, kujto edhe kohën e perëndimit, që është vdekja

Një i urtë ka thënë:
“Për njerëzit me mendje të shëndoshë, kjo botë është shikim i krijesave si art hyjnor, me syrin e urtësisë për të marrë mësim. Ndërsa për mendjelehtët është vetëm ushqim dhe epsh.”



16. Shih. El-Xhathije, 13.

Mevlana thotë:

**“O udhëtar!
Shiko imazhin
e fundit në
pasqyrë! Mendo
që një bukuri,
do të shëmtohet
në pleqëri dhe
një ndërtesë do
të rrënohet...
prandaj mos
u mashtro me
gënjeshtrenë në
pasqyrë!..”**

e tij! Nën këtë çardak të këndshëm, në këtë natë me dritë hëne, ti sheh bukurinë vezulluese të Hënës së plotë; por, pa mendo edhe mallin që ndjen ajo për gjendjen e saj kur është në formë drapri, e hollohet porsì hark në fund të muajit!

Edhe njeriu këtë aventurë jeton. Pjekuria dhe bukuria e tij, në fund të fundit janë të dënuara të asgjësohen. Sot e sheh fëmijë të bukur që e duan të gjithë. Por nesër kthehet në një plak matuf, me të cilin qeshin njerëzit!

Nëse më parë të kanë quajtur bukuri lëkurë argjendtë, shikoje trupin tënd pas pleqërisë që është bërë si arë pambuku! O njeri që të shkëlqejnë sytë kur sheh ushqime të shijshme! Çohu njëherë e shko në tualet të shohësh fundin e tyre! Thuaji asaj ndyrësie: «Ku e ke atë bukuri, atë lezet, shije dhe hijeshi kur ishe në pjatë?» Dhe do të përgjigjet: «Ato që ti numërove ishin gonxhe. Ndërsa unë isha një kurth i ngrehur. Kur erdhe ti dhe re në kurth, gonxhet u shkrinë, u venitën dhe u kthyen në skorie.»

Ka duar të afta, të cilat i mahnitin mjeshtrat, por që në fund i kapin dridhjet. Po kështu, një sy të kristaltë me shikim të mprehtë, në fund e sheh në gjendje të rënduar dhe të përlotur! Ndodh që edhe një luftëtar trim, i cili sot ecën përkrah luanëve, një ditë të mposhtet nga një i dobët si mi.

Po ashtu, edhe një kaçurrele dredha-dredha me aromë të këndshme, që të merr mendtë, në pleqëri shëmtohet si bishti i gomarit të bardhë.

Sa më shumë që dikush të këtë shpëtuar nga robëria e egos dhe mashtrimi i hijeve, aq më shumë është afër Allahut.

O njeri! Nga kjo botë vijnë dy zëra të kundërt me njëri - tjetrin. Vallë, cilin prej tyre është i aftë të pra-



nojë veshi i zemrës tënde? Njëri prej zërave është gjendja e atyre që i afrohen Allahut, ndërsa tjetri gjendja e të mashtruarve. Nëse e pranon njërin nga këta zëra, tjetrin as që e dëgjon, sepse ai që dashuron, është i verbër dhe i shurdhër ndaj të kundërtave të asaj që do. O udhëtar! Shiko imazhin e fundit në pasqyrë! Mendo që një bukuri, do të shëmtohet në pleqëri dhe një ndërtesë do të rrënohet... prandaj mos u mashtro me gënjeshtren në pasqyrë!..”

VETËDIJA FETARE, GJUHËSORE DHE HISTORIKE

Një i ri mysliman duhet të ketë vetëdijen e **fesë**, të **gjuhës** dhe të **historisë**. Këto janë shtyllat kryesore të ndërtesës së kulturës, mbi të cilat qëndrojnë në këmbë dhe vazhdojnë ekzistencën individët dhe shoqëritë.

Tani le të qëndrojmë shkurtimisht mbi parimet kryesore si këto dhe të ngjashme me to, mbi të cilat do të ndërtojë jetën një i ri mysliman, i cili dëshiron të arrijë lumturinë e përjetshme:

a. Vetëdija fetare

Feja jep mundësinë të kuptohet qëllimi i krijimit të gjithësisë dhe njeriut. Ajo është rregullator i jetës së përkohshme mes djepit dhe varrit. Feja Islame e bën njeriun të arrijë qetësinë shpirtërore në



Qëllimi i jetës është të jetosh si rob i Zotit dhe të japësh shpirtin në të njëjtën gjendje. Sa bukur e ka shprehur këtë një poet arab:

Kur nëna të lindi, të nxori në dynja,

Ti qaje, e bota qeshte në një krah.

Tani, jeto ashtu që në vdekje të qeshesh

E bota pas teje në lot të shkrehet...



Mendjet e privuara nga drita hyjnore, janë si kandilat pa vaj dhe llambat pa rrymë elektrike. Për rrjedhojë, është e pamundur që një mendje e tillë, të bëjë dritë për të ndriçuar rrugën e njeriut dhe ta çojë atë tek e vërteta dhe e mbara.

këtë botë dhe lumturinë e pafundme në botën tjetër. Ajo i jep mundësinë besimtarit të jetojë me një dashuri dhe entuziazëm të madh. Për rrjedhojë, një mysliman duhet ta përcaktojë drejtimin e tij sipas Kuranit dhe Sunetit që prej moshës së fëmijërisë. Nuk duhet ta harrojmë se Allahu i Madhëruar është Ai që dhuron lumturinë dhe suksesin.

Ashtu si trupi i njeriut, i cili qëndron në këmbë me ushqime materiale, edhe mendja dhe ndjenjat duhet të ushqehen me vetëdijen fetare dhe entuziazmin e besimit. Përndryshe, mendja dhe ndjenjat, në vend që të bëhen udhëzuese, e çojnë të zotin në shkatërrim dhe e degdisin njeriun në qorrkakët e mendimeve dhe filozofive të prishura.

Mendjet e privuara nga drita hyjnore, janë si kandilat pa vaj dhe llambat pa rrymë elektrike. Për rrjedhojë, është e pamundur që një mendje e tillë, të bëjë dritë për të ndriçuar rrugën e njeriut dhe ta çojë atë tek e vërteta dhe e mbara.

Në Greqinë e lashtë ka ndodhur një ngjarje që shpjegon në mënyrë tipike paaftësinë e mendjes:

Një i ri, shkoi tek një filozof për të marrë dije në fushën e drejtësisë. Ata bien dakord që gjysma e pagesës të bëhet menjëherë, kurse gjysma tjetër të bëhet pasi i riu të fitonte çështjen e parë gjyqësore. Kjo do të thotë se, nëse nxënësi e fiton çështjen e parë gjyqësore, arsimimi i tij ka qenë i përkryer dhe profesori meriton të marrë pjesën tjetër të kështit. Mirëpo, kur mbaroi komplet programi mësimor, nxënësi mendoi se kësti i parë që kishte dhënë i mjaftonte profesorit dhe i kër-

kon atij të heq dorë nga kësti i dytë. Për arsye të këtij pretendimi, çështja e parë gjyqësore zhvillohet mes nxënësit dhe profesorit.

Nxënësi i drejtohet trupës së gjykatës:

“Edhe nëse e fitoj, edhe nëse nuk e fitoj këtë çështje, do të më duhet të mos ia jap këto para!”

Kur gjyqtari e pyet nxënësin “Pse?”, ai i përgjigjet:

“Nëse e fitoj këtë çështje, do të veprohet sipas vendimit tuaj. Por, edhe nëse e humbas, unë nuk duhet t’i jap këto para, duke u bazuar në marrëveshjen që kemi bërë me të paditurin, që nëse e humbas çështjen e parë, nuk do t’ia paguaj këstin tjetër.”

Po ashtu, edhe profesori i tij filozof arsyetoi në të njëjtën mënyrë dhe tha:

“Edhe nëse e fitoj këtë çështje, edhe nëse e humbas, unë paratë do t’i marr!”

Kur gjyqtari e pyeti “Pse?”, profesori i përgjigjet:

“Nëse e fitoj këtë çështje, do të veprohet sipas vendimit tuaj. E, nëse humbas, do t’i marr paratë në bazë të marrëveshjes që kam bërë me palën tjetër, sepse nëse unë humbas, çështjen do ta fitojë ai dhe kështu, do të plotësohen kushtet për pagesën e këstit të dytë.”

Siç shihet, pretendimet e të dyve janë mjaft të logjikshme dhe të arsyeshme. Kjo do të thotë se, nëse një mendje dhe logjikë nuk është e edukuar me shpalljen hyjnore, ashtu sikurse edhe në këtë shembull, herë-herë e burgos veten brenda murit që ka ndërtuar vetë dhe, hyrja e saj në rrugë pa krye është e pashmangshme. Një mendje, e cila është kyçur dhe



Shpëtimi i mendjes nga qorrsokakët, varet nga edukimi i saj me shpalljen hyjnore dhe kuptimi i domosdoshmërisë për t’iu dorëzuar shpirtërisht ligjërimeve hyjnore përballë të vërtetave që kalojnë kufirin e saj.



Ndërkohë që filozofët thonë: “Sipas meje është kështu”, profetët thonë: “Sipas urdhrut të Allahut është kështu.” Për shkak se profetët janë mbështetur në shpalljen hyjnore, ata gjithmonë kanë konfirmuar njëri-tjetrit. Ndërsa filozofët, për shkak se i besojnë vetëm mendjes së tyre në kërkimin e së vërtetës, ata gjithnjë i kanë hedhur poshtë dhe i kanë përgënjeshtuar mendimet e njëri-tjetrit.

ka dështuar të zgjidhë shumë mosmarrëveshje të tilla njerëzore, e ka të pamundur të kuptojë të vërtetat e pafundme me të gjitha aspektet e tyre. Ndaj dhe shpëtimi i mendjes nga qorrsokakët, varet nga edukimi i saj me shpalljen hyjnore dhe kuptimi i domosdoshmërisë për t’iu dorëzuar shpirtërisht ligjërimiave hyjnore përballë të vërtetave që kalojnë kufirin e saj.

Njeriut i sjellin lumturi dhe qetësi vetëm rregullat që ka vendosur Allahu i Madhëruar, i Cili di dhe ka krijuar gjithçka. Sistemet e prodhuara nga mendja njerëzore, s’kanë qenë asnjëherë të mjaftueshme për lumturinë e njerëzimit. Ndërkohë që filozofët thonë: “Sipas meje është kështu”, profetët thonë: “Sipas urdhrut të Allahut është kështu.” Për shkak se profetët janë mbështetur në shpalljen hyjnore, ata gjithmonë kanë konfirmuar njëri-tjetrit. Ndërsa filozofët, për shkak se i besojnë vetëm mendjes së tyre në kërkimin e së vërtetës, ata gjithnjë i kanë hedhur poshtë dhe i kanë përgënjeshtuar mendimet e njëri-tjetrit.

Për të arritur paqen në këtë botë dhe në tjetrën, është e domosdoshme që njeriu të ketë një vetëdije të shëndoshë fetare. Feja i mbledh individët përreth ndjenjave të shenjta, vetëdijes dhe ndërjegjes së përbashkët. Ajo i ngre dhe i zhvillon shoqëritë. Në të njëjtën kohë, si një institucion moral, feja i drejton njerëzit në rrugën e vërtetë të Allahut. Dobësia e vetëdijes fetare tek të rinjtë, çon në shtimin e krimeve morale e


penale dhe me kalimin e kohës i hap rrugën anarkisë. Për rrjedhojë, kur mungon feja, në aspektin moral nuk ka as fuqi zbatuese, sepse gjallëria e vetëdijes është e lidhur me fenë.

Bota e brendshme e njeriut nuk duhet neglizhuar asnjëherë. Feja është streha më e sigurt që i jep njeriut shpresë dhe ngushëllim përballë vetmisë, dëshpërimit, frikës, mërzive, sëmundjeve dhe fatkeqësive. Përveç kësaj, angazhimet fetare e largojnë njeriun nga shqetësimet e panevojshme dhe të dëmshme, duke e ruajtur atë nga lodhja shpirtërore. Tek besimtarët e vërtetë, janë më të gjalla ndjenjat morale si, bindja ndaj Allahut, respekti ndaj prindërve dhe të rriturve, dashuria ndaj të vegjëlve, përgjegjësia ndaj njerëzve në shoqëri, dhembshuria dhe mëshira ndaj krijesave.

Kjo ngjarje është një shembull i bukur që tregon se çfarë ndjenjash të larta i jep feja njeriut:

“Kur myslimanët çliruan qytetin Medain, të gjithë plaçkën e luftës e mblodhën në një vend. Ndërkohë, afrohet një person, i cili mbante në duar një qyp me flori dhe ia jep atë nëpunësit që mblidhte plaçkën e luftës. Ata që gjendeshin pranë nëpunësit thanë:

«Deri tani nuk kemi parë ndonjë thesar më të çmuar se ky. Madje, po të marrim të gjithë plaçkën e luftës që zotërojmë, nuk i afrohet aspak vlerës së këtij qypi!...» Pastaj, ata e pyetën njeriun që solli florinjte:



***As kultura nuk e lartëson moralin, e as ndërgjegjja,
Ndjenja e virtytit tek njerëzit, është prej frikës ndaj Zotit...***

(M. Akif Ersoj)



Besimtari është gjithnjë me Zotin e vet dhe i është dorëzuar plotësisht Atij. Ndërsa Allahu i Madhëruar, njeriun, që është dorëzuar dhe strehuar plotësisht tek Ai në kuptimin e vërtetë të fjalës, e ruan atë nga nënshtrimi ndaj të tjerëve dhe shqetësimet e panevojshme kalimtare.

«A ke marrë gjë prej këtyre?» Personi u përgjigj:

«Nëse në zemrën time nuk do të kishte frikë ndaj Allahut, vallahi nuk do jua sillja juve këtë qyp, por do ta mbaja të gjithë për vete.»

Nëpunësit e kuptuan se kishin të bënin me një njeri të sinqertë dhe të

devotshëm, ndaj dhe e pyetën:

«Kush je ti?» Ai u përgjigj:

«Vallahi nuk do t'ju tregoj se kush jam, me qëllim që të qëndroj larg lëvdatave tuaja dhe të shpëtoj nga arroganca e nefsit dhe hipokrizia. Por, mund t'ju them vetëm se, unë jam një rob që falënderon Allahun dhe nuk pret shpërblim nga tjetërkush, përveçse prej Tij.»¹⁷

Fuqia shpirtërore që sjell frika ndaj Allahut, nuk krahasohet me asnjë fuqi materiale. Roja më i mirë që duhet të vendoset në ndërgjegje është frika ndaj Allahut.

E vërteta është se, besimtari që meriton të bëhet rob i Zotit të tij, shpëton përfundimisht nga sëmundja e të qenit rob i njeriut. Ashtu siç jeta në kafaz është kundër natyrës së një luani, ashtu edhe robëria ndaj egos dhe të përkohshmëve, është kundër qëllimit të krijimit për një besimtar të vërtetë. Edhe sikur besimtari të jetë i kyçur fizikisht në qoshet më të errëta të burgut, ai në të vërtetë është i lirë. Po ashtu, sado në kushte të vështira qoftë, ai është gjithnjë i qetë.

Besimtari është gjithnjë me Zotin e vet dhe i është

dorëzuar plotësisht Atij. Ndërsa Allahu i Madhëruar, njeriun, që është dorëzuar dhe strehuar plotësisht tek Ai në kuptimin e vërtetë të fjalës, e ruan atë nga nënshtrimi ndaj të tjerëve dhe shqetësimet e panevojshme kalimtare.

Ataullah el-Iskenderi e shpreh shumë bukur gjendjen e prehjes shpirtërore të një besimtari që arrin pastërtinë e zemrës me një devotshmëri të tillë:

“O Zot! Çfarë humbi ai që të gjeti Ty? Çfarë gjeti ai që të humbi Ty?..”



Profeti Isa ﷺ, rastisi një njeri të sëmurë me njolla në lëkurë dhe tëmtha të bërë gropë nga sëmundja. Njeriu, sikur të mos e ndjente fare sëmundjen që kishte, thoshte me vete:

“O Zot! Falënderimet e pafundme të takojnë Ty, që më ke shpëtuar prej halleve, të cilat ua ke dhënë shumë njerëzve të tjerë!..”

Isai ﷺ, për të kuptuar nivelin e botëkuptimit të këtij njeriu dhe përsosmërinë e tij shpirtërore, i thotë:

“O njeri! Çfarë është ai hall prej të cilit Allahu të ka shpëtuar?!”

I sëmuri u përgjigj:

“O i Dërguar i Allahut! Sëmundja dhe belaja më e keqe, është shkujdesja e zemrës ndaj Allahut. Falënderuar qoftë Allahu i Madhëruar, që unë ndjej kënaqësinë dhe frymëzimin shpirtëror të të qenit bashkë me Të. Më duket sikur nuk ndjej asnjë prej sëmundjeve të trupit tim...”

Dobitë e besimit në botën tjetër

Besimi në botën tjetër i zhvillon njeriut vetëdijen e përgjegjësisë dhe strukturën morale. Po ashtu, ai eliminon efektin shkatërrues të fytyrës së frikshme të vdekjes mbi psikologjinë e njeriut.

Nga ana tjetër, kënaqësitë e kësaj bote kalimtare, nuk e ngopin shpirtin e njeriut, sepse një prej dëshirave më thelbësore që gjendet në natyrën njerëzore është “kërkimi i përjetësisë”. Ja pra, besimi në botën tjetër, i siguron njeriut horizontin e pafundshmërisë që ai kërkon.



***Psikiatri Dr. Jusuf
Karaçaj tregon:***

***“Nuk e harroj kurrë
atëherë kur isha i
vogël dhe e kam
pyetur nënën:***

***«Nënë, ç’do ndodh
me ne kur të vdesim?»***

«Do të shkojmë në Xhenet, bir!»

«Mirë, po pastaj ç’do të ndodh? Pra, sa do të qëndrojmë në Xhenet?»

***Me siguri nëna duhet të ketë menduar se, «ky fëmijë në këtë moshë,
nuk do ta kuptojë pafundësinë; por po i them një kohë të gjatë, e të mos
pyes më.» Prandaj dhe më tha:***

«Do të jetojmë njëmijë vite, bir!»

***U mërzita aq shumë, sa edhe unë me atë mendjen time të vogël
mendova:***

***«Qoftë pas dhjetë viteve, qoftë pas njëmijë viteve, e çfarë kuptimi
ka nëse një ditë do të asgjësohemi? Unë dua pafundësinë, nuk dua të
bëhem asgjë!»***

Kur hulumtohet historia e qytetërimeve, vërehet menjëherë kontributi që Islami i ka dhënë zhvillimit të botës shpirtërore dhe intelektuale njerëzore. Kështu, Resulullahu ﷺ, prej një shoqërie të zhytur në errësirën e injorancës, ndërtoi një shoqëri të virtytshme të Epokës së Lumturisë.

Feja gjithnjë i ka shpëtuar shoqëritë nga kalbja dhe shkatërrimi. Vetëm në sajë të fesë, njeriu ka shpëtuar nga egoizmi dhe robëria e dëshirave të

Dikush, bleu një kalë. Por, megjithëse kali ishte vetëm dy vjeç dhe mjaft i fuqishëm, ai ngordhi brenda tre ditësh. I zoti i kalit dyshoi tek ai që ia shiti. Pas kësaj, ai shkoi tri ditë me radhë tek gjykata, por asnjëherë nuk e gjente aty gjykatësin. Për shkak se nuk donte të humbte kohë, ai e çoi kafshën tek veterineri për të hetuar rastin. Informacionet që i dha veterineri, tregonin se kali ishte helmuar. Më vonë, kur shkoi përsëri në gjykatë, e gjen aty gjykatësin dhe i shpreh hallin. Gjykatësi i tha:

“Pse nuk erdhe tek unë në fillim, por shkove te veterineri? Të kishë ardhur që në fillim tek unë, e ta kishim gjetur zgjidhjen në kohë!” Mirëpo i zoti i kalit u hodh menjëherë e tha:

“Zotëri, unë erdha në filan ditë tek ju, por nuk ju gjeta këtu!” Atëherë gjykatësi tha:

“Ke të drejtë! Kur ke ardhur ti, nuk kam qenë këtu. Isha në vendlindje, sepse më kishte vdekur nëna...”

Pasi mendoi pak, gjykatësi iu drejtua sekretarit dhe i tha:

“Çështja u kuptua. Shkruaj sekretar! Për shkak se nuk është gjendur në vendin e punës, dëmshpërblimi i ngarkohet gjykatësit...”

**I Dërguari i Allahut
ﷺ, ka thënë:**

**“Kush thotë:
«Pranova Allahun
si Zot, Islamin si fe
dhe Muhamedin si
Profet», (duke qenë
nga kjo), Xheneti
bëhet detyrim për
të.”**

*(Ebu Davud, Salat, 36.;
Tirmidhi, Salat, 42)*

egos dhe ka gjetur mundësinë t’i shërbejë njerëzimit, sepse feja e vërtetë, ka predikuar gjithnjë dashuri, respekt dhe mirësjellje.

Feja gjithnjë e urdhëron njeriun për mëshirë, ndershmëri, drejtësi, respekt ndaj së drejtës së robit, sjellje të mirë ndaj njerëzve dhe pengimin e të keqes. Gjithashtu, ajo e mëson njeriun të sillet me dhembshuri ndaj krijesave të Zotit, të zbukurojë botën, të bëhet pengesë për të këqijat dhe të japë edhe jetën për këtë kauzë. Në këtë mënyrë, bota do të mbushet me paqe dhe lumturi. Përndryshe, bota kthehet në një sofër ujqërish, ku të gjithë njerëzit dëmtohen prej saj.

Sot, Islami është rruga e vetme e shpëtimit për njerëzimin. Fetë e tjera e kanë humbur vlefshmërinë e tyre, sepse padyshim gjërat që vijnë më pas, janë më gjithëpërfshirëse dhe të përsosura krahasuar me paraardhëset. Dhe, pikërisht për këtë arsye, ardhja

e Islamit, i ka zhvlerësuar, korrigjuar ose përmirësuar gjykimet e ligjeve para tij. Ashtu sikurse lindja e Diellit e bën të panevojshme ndriçimin e Hënës dhe të yjeve, duke i bërë ato të padukshme pranë Diellit, e tillë është edhe gjendja e feve të tjera përballë Islamit. Ato

ishin secila nga një kandil i veçantë dhe e ndriçuan vendin ku ndodheshin për një farë kohe, derisa lindi dielli. Pas lindjes së Islamit, si dielli i së vërtetës, tashmë nuk kishte më nevojë për to. Për rrjedhojë, të lësh Diellin dhe të përpiqesh të gjesh rrugën me dritën e yjeve, padyshim që është humbje e madhe. Ata që veprojnë kështu, nuk do t’i arrijnë qëllimet e tyre. (Ahmed Hamdi Akseki, Islam Dini, fq. 19 - 20.)

b. Vetëdija gjuhësore

“Vetëdija gjuhësore” është një nga parimet që bëjnë pjesë në botëkuptimin e një të riu mysliman, sepse gjuha është mjeti i shprehjes së të vërtetës së predikuar nga feja. Njerëzit mendojnë përmes fjalëve dhe zgjerojnë horizontin e mendimit nëpërmjet gjuhës. Prandaj një i ri mysliman, duhet të ketë kulturë gjuhësore dhe letrare dhe duhet të mësojë të përdorë “**shprehje ndikuese**”.

Allahu i Madhëruar thotë:

“...këshilloji dhe thuaju fjalë që i prekin në zemër.” (Nisa, 63.)

Disa të paditur, e kanë prishur gjuhën tonë, me qëllim që të largojnë popullin tonë nga kultura Islame, e cila përbën themelin e qytetërimit tonë. Fatkeqësisht, sot gjuha jonë është gjymtuar në atë nivel, sa nuk të jep mundësinë e një meditimi serioz. Gjoja në emër të mbrojtjes së gjuhës, është shkatërruar i gjithë thesari kulturor, duke hedhur mënjanë fjalët që janë bërë pasuri gjuhësore prej shekujsh.

Kjo fushatë “gjymtuese” që u bë në emër të “thjeshtësimit” të gjuhës, është një manifestim i hapur i tradhtisë ndaj kulturës sonë. Ndërkohë që secila prej fjalëve të gjymtuara ka nga një kuptim të veçantë, përdorimi i një fjale të vetme, bëhet shkak i humbjes së një sërë pasurish kuptimore, madje nuk mendojmë më për to.



Në Fjalorin Turqisht-Anglisht të Redhause-t, të botuar në vitin 1890, gjendeshin 92 mijë fjalë turqisht. Kurse në Fjalorin e botuar nga Institucioni Gjuhësor i Turqisë në vitin 1945, ky numër ra deri në 15 mijë fjalë. Nuk është e vështirë të imagjinohet se sa mund të ketë rënë ky numër në ditët tona. Kjo gjendje, tregon qartë se erozioni i gjuhës sonë është duke u vazhduar në mënyrë të tmerrshme nga disa caqe të caktuara.

*Nëse ndonjëri
prej gjuhëve
perëndimore i
hiqen fjalët me
origjinë greke dhe
latine, ajo gjuhë do
të bjerë në nivelin e
një gjuhe primitive.
Prandaj, asnjë
popull, nuk ia ka
bërë një gjë të tillë
gjuhës së vet.*

Objektivi janë fjalët Kuranore

Aspekti më i rrezikshëm në këtë çështje, është qëllimi i planifikuesve të kësaj katastrofe. Synimi i tyre është të eliminojnë aftësinë e “mendimit Islam” të brezave të rinj. Pra, ata kanë si objektivi Kuranin dhe mendimin që lind prej tij. Këtë e tregon fakti që ata kanë hequr fjalët me burim prej kulturës së Kuranit, e në vendin e tyre kanë vendosur fjalë që nuk e shprehin kuptimin e plotë, që janë të vështira të kuptohen, e madje akoma më keq, që bartin në vete kuptime nga kultura të huaja.

Një gjë nuk duhet harruar, se fjalët mbajnë në vete disa kuptime të holla dhe të thella. Çdo fjalë mbart në vete një kujtim, kuptim dhe konotacion që i është ngarkuar gjatë historisë. Fjala vjen, etërit tanë kanë marrë nga arabishtja fjalën “sofër”. Ky është emri i përdorur për “torbën e ushqimit” të atij që emigron ose lufton në rrugë të Allahut.¹⁸ Duke e përdorur këtë fjalë, etërit tanë kanë pasur për qëllim të shprehin se çdo kafshatë e hanë që t’u sjellë forcë për shërbimin në rrugë të Allahut.

Një mendimtar thotë:

“Nëse doni të ndryshoni një popull, pikësëpari duhet t’u ndryshoni fjalët.”

Nuk është shumë e vështirë të imagjinosh se në ç’gjendje do të bien të rinjtë, kur i bën të harrojnë gjuhën e tyre, u hap mendjen drejt mentaliteteve të huaja dhe i lar-



gon nga Kurani. Nuk thuhet: “Ç’u bë për një fjalë!”. E kush mund të thoshte para njëqind viteve, që të gjithë rrugicat, dyqanet dhe pothuajse gjithçka e jona do të dominohej nga kultura perëndimore me anë të gjuhës? Por tani, fatkeqësisht ne kemi rënë në një gjendje të tillë!

Shkurtimisht, nëse në ligjërimet apo shkrimet tona do të përdornim fjalë që burojnë nga kultura e Kuranit, patjetër që në horizontin e mendimit dhe ndjenjave tona do të manifestohej një gjendje e veçantë shpirtërore.

Nuk duhet harruar se, mes fesë dhe gjuhës ekziston një lidhje shumë e fortë. Feja shprehet me gjuhë. Gjatë gjithë historisë Fletët dhe Librat e Shenjtë janë përcjellë përmes gjuhës. Dhe, aspekti kryesor i mrekullisë së Kuranit Famëlartë, është se ai është zbritur në gjuhën njerëzore me një stil shprehjeje të mrekullueshme.

Feja jeton përmes gjuhës

Në jetën e një besimtari, çdo çast flitet për fenë dhe të shenjtën, që prej lindjes, e deri në vdekjen e tij:

Myslimanët bëjnë dhikr dhe dua me gjuhë për të shprehur besimin në zemrat e tyre. Kur në një familje besimtare vjen në jetë një fëmijë, thuhet: “Allahu i dhëntë jetë të gjatë e të mbarë! U bëftë fëmijë besimtar dhe pasardhës i mirë!”.

Kur vizitohen të sëmurët, thuhet: “Allahu ju dhëntë shërim! Qoftë shlyerje gjynahesh dhe ngritje grade (tek Allahut)!”

Të afërmve të xhena-

Çfarëdo profesioni të ushtrrojë, çdo mysliman e ka për detyrë fetare dhe kombëtare që edhe në bisedat e tij të përditshme, të rezistojë ndaj kësaj rryme të dëmshme dhe të përdorë fjalët e mbrujtura me kulturë Islame. Ne mendojmë se çështja e gjuhës, është një përgjegjësi e botës tjetër për çdo mysliman.





Feja jeton përmes gjuhës dhe ajo çfarë jetohet shprehet me gjuhë.

Kurani Famëllartë është zbritur me gjuhën më të pasur dhe më elokvente. Ndërsa etërit tanë, e kanë pasuruar gjuhën e tyre me gjuhën e Kuranit.

zes, u thuhet: *“Allahu e mëshiroftë dhe iu bëftë vendi Xhenet!”*, dhe u kujtohet atyre se të gjithë do të shkojmë tek Allahu.

Kush del për udhë thotë: *“Allahu të ruajt!”*. Ndërsa ai që e përcjell i uron: *“Shëndet!”*. Pastaj udhëtari bën duanë e udhëtimit.

Kush ulet të pushojë, bën dua, e kush zgjohet e falënderon Zotin. Kush fillon një punë, bën *“Bismilah”*, e kush bën tregti thotë: *“Bereqeti prej Allahu!”*

Kush takohet me një besimtar, fillimisht jep selam, e më pas tjetri ia kthen selamin... Këto shembuj mund t'i shtojmë edhe më shumë.

Përfundimi:

“Feja jeton përmes gjuhës dhe ajo çfarë jetohet shprehet me gjuhë.”

Gjuha është mjeti më i rëndësishëm që përdorin ata, të cilët ndjekin politikën për të shkëputur njerëzit nga feja. Pra, duke pastruar termat fetare prej fesë. Në ditët e sotme, fatkeqësisht feja por largohet prej gjuhës dhe, vendin e “duave dhe dhikrit” që përmendëm më lart, po e zënë shprehje të pakuptimta, që i përkasin kulturave të huaja larg fesë sonë.¹⁹

Duhet të jemi të kujdesshëm ndaj “gjuhës së trilluar”

Nëse nuk e shpëtojmë gjuhën tonë nga ky shkatërrim, është e pamundur të eliminojmë problemet

19. Prof. Dr. Hayrettin Karaman, Yeni Safak Gazetesi, 23 Janar 2005; <http://m.hayrettinkaraman.net/yazi/laikduzen/4/0133.htm>

e shumta që na kanë rënë mbi krye. Kjo, sepse njerëzit mendojnë përmes fjalëve. Është e pamundur të hapesh në horizontet e entuziazmit të mendimit Islam dhe kombëtar në mënyrë të thelluar, me një “gjuhë” me koncepte dhe fjalë të pakësuara, të gjymtuara dhe të deformuara. Për rrjedhojë, pa u bërë kjo gjë, mendimi, i cili përbën themelin e sjelljeve dhe ndjenjave tona, do të venitet dhe horizonti i shpirtit do të ngushtohet. Me një mendim shterpë dhe të cekët, që nuk prodhon ide të shëndetshme, nuk mund të qëndrohet përballë rrymave të dëmshme që kanë si objektiv rrënimin e strukturës sonë kombëtare e shpirtërore.

Për këtë arsye, asnjëherë nuk duhet t’i kushtojmë vëmendje **“gjuhës së shpikur”**, që përpiqen të sjellin duke prishur kuptimin dhe shqiptimin në kundërshtim me vetëdijen tonë kombëtare. Falsifikimet që bëhen në kuadër të thjeshtëzimit dhe pastrimit të gjuhës, kryesisht janë ndaj fjalëve që Libri ynë i shenjtë, Kurani, i ka dhuruar gjuhës sonë.

Djalë i shtrenjtë! Ti sakrifikon kaq shumë para, kohë dhe mund për të mësuar një gjuhë të huaj... Po sikur të tregosh pak përpjekje që të mësosh edhe gjuhën tënde?..



Zgjuarsia është një nur që Allahu i Madhëruar ua dhuron zemrave të njerëzve që do. Në sajë të ndjenjave të singerta dhe frymëzimit hyjnor që lind në zemër, ata i vlerësojnë drejtë ngjarjet dhe ato çfarë kalojnë në mendje dhe zemrat e njerëzve. Pa dyshim se këtë zgjuarsi mund ta përfitojnë vetëm ata që zhvishen nga krenaria e egos dhe që shohin me nurin e Allahut.



Behlul Dana, një ditë po qëndronte duke vëzhguar murin e anuar të një shtëpie të rrënuar dhe po meditonte thellë, muri rrëzohet papritur. Kjo gjë e lumturoi pa masë Behlul Danën. Njerëzit, të cilët e panë dhe nuk mundën ta kuptonin gëzimin e tij, e pyetën për shkakun e këtij gëzimi. Ndërsa Behlul Dana u përgjigj me këto fjalë:

"Muri u shemb nga ana që kishte anuar!"

Njerëzit përsëri nuk e kuptuan dhe e pyetën:

"Mirë, por çfarë ka për t'u habitur këtu?!"

Atëherë, ai u përgjigj me urtësi:

"Meqenëse në këtë botë çdo gjë rrëzohet andej nga anon, kur të vdes edhe unë do të shkoj tek Allahu InshaAllah, sepse edhe unë anoj nga Ai!"

c. Vetëdija historike

Historia është një pishtar që ndriçon rrugën e kombeve, duke analizuar shkaqet dhe përfundimet e ngjarjeve që ka përjetuar njerëzimi. Historia është memoria e një populli dhe tërësia e përvojave kombëtare. Po ashtu, historia është burimi më i rëndësishëm i dritës që do të ndriçojë shkaqet e rënieve dhe ngritjeve në fatin e popujve dhe të ardhmen e tyre.

E parë nga jashtë, shohim se shkakun e ndodhive historike, konsiderohet ngjarja e fundit. Mirëpo, para saj ekzistojnë edhe shumë shkaqe të tjera, të cilat janë akumuluar vazhdimisht përgjatë kohës. Ndodhia e fundit, është si pika e fundit e ujit që e bën gotën të derdhet. Por në fakt, ato që e kanë ngritur atë pikë deri në majë dhe e kanë përgatitur derdhjen e saj, janë të gjitha pikat e tjera brenda gotës.

Për shembull, shkakun e fillimit të Luftës së Parë Botërore, konsiderohet vrasja e princit austro-hungarez nga një serb. Mirëpo, ky nuk është shkakun e vetëm, sepse shumë shkaqe të tjera kanë ardhur duke u akumuluar me kohën. Për rrjedhojë, edhe vrasja e princit ishte pika e fundit e ujit që shkaktoi derdhjen e gotës.

Pra, njohja e historisë shton aftësinë e analizimit të shkaqeve dhe përfundimeve, duke na siguruar kështu edhe përparimin me hapa të sigurt drejt të ardhmes. E në fakt, ndërkohë që popujt vazhdojnë jetën e tyre në një pikë të caktuar gjeografike, jetën e tyre të vërtetë e vazhdojnë me rrënjët e tyre historike. Këto rrënjë janë

dinamika shpirtërore që mbajnë në këmbë pemën e popullit si, vepra madhështore, fitore dhe personalitete të lartë, të cilët janë shfaqur në të shkuarën. Kështu, të gjitha degët mund të jetojnë, të çelin lule dhe të japin fruta vetëm nëse ushqehen nga këto rrënjë. Dhe, degët e një populli, janë brazat e rinj që do t'i japin formë të ardhmes së tij.

Nëse një popull njih dhe vlerëson siç duhet historinë e tij të vërtetë dhe liderët e tij fizik e shpirtëror, do të thotë se ai është popull i përpunuar dhe i madh. Nëse brezat e rinj e njohin mirë historinë e tyre dhe marrin mësimet e duhura prej të shkuarës, atëherë s'ka nevojë të shqetësohemi për të ardhmen.

Nëse edukohet një brez, i cili demonizon historinë e vet, bëhet i huaj ndaj origjinës së vet, i shpall heronjtë tradhtarë dhe tradhtarët heronj, ardhmëria duket e errët dhe shqetësuese. Kjo, sepse ardhmëria e atij që nuk i jep rëndësi të shkuarës të vet, asnjëherë nuk ka qenë e sigurt. Prandaj, rrënjët tona duhet të shtrihen në të shkuarën, ndërsa degët në të ardhmen, sepse "ai që nuk di të llogarisë të shkuarën e tij mijëvjeçare, është i dënuar të jetojë vetëm në mënyrë ditore".

Konsiderimi i shken-cave historike vetëm si përmbledhje e ndodhjeve të parëndësishme, është një gabim tepër i madh. Historia nuk është vetëm një evidentim kronologjik. Historia e vërtetë, analizon ngjarjet, duke marrë parasysh "shkaqet

"Ngjarjet e së shkuarës me ato të së ardhmes, ngjajnë më shumë se dy pika ujë!" (Ibn-i Haldun)

"Kush nuk e njih të shkuarën e vet, nuk e njih as të ardhmen. Njih mirë të shkuarën tënde, që të shkelësh i sigurt në të ardhmen! Mos harro prej nga ke ardhur, që të dish se ku po shkon!.." (Shejh Edebali)



“Nëse luanët nuk e shkruajnë vetë historinë e tyre, janë të detyruar të besojnë tregimet e gjahtarëve.”



dhe përfundimet”. Ajo është një shkencë e çmuar që tregon truallin origjinal të së drejtës dhe të shtrembëtës, të së saktës dhe të gabuarës në ekzistencën e popujve të mbushur plot me ngjarje, surpriza dhe aventura të ndryshme.

Ndryshimi i së shkuarës nuk është në dorë të askujt. Mirëpo orientimi i së ardhmes, është në dorën tonë. Dhe kapitali i vetëm që kemi për të blerë të ardhmen tonë, është e sotmja. Prandaj, ne duhet të shohim gjithmonë përpara duke marrë mësim prej gabimeve tona të vjetra. Humbjen e së shkuarës mund ta kompensojmë me të ardhmen, gjë e cila është e mundur vetëm në sajë

të një vetëdijeje të fortë historike. Për këtë arsye, historia ka qenë këshilltari më i mirë i sunduesve dhe udhëheqësve.

Tablo krenarie


Popujt, brezat e rinj i mbajnë gjithmonë gjallë në sajë të vetëdijes historike. Për shembull, gjermanët, që në fillim të edukimit, u tregojnë të rinjve të tyre qytetet e bombarduara dhe pyjet e djegura. Ndërsa japonezët, u tregojnë qytetet e shkrumbuara nga bombat atomike, duke u kujtuar atyre fatkeqësitë që kanë përjetuar në të shkuarën. Përveç këtyre, ata u tregojnë fitoret dhe përparimin teknologjik që kanë arritur në sajë të bashkimit dhe unitetit kombëtar, duke u përpjekur të shtojnë entuziazmin e brezave të rinj.

Në fakt, shumë pak popuj në botë zotërojnë tablo të shembujve dhe krenarisë kombëtare, të cilat pranohen si burim përpjekjeje dhe entuziazmi për synime të larta. Madje, edhe ato janë vetëm disa ngjarje që numëro-

hen me gishta. Ndërsa ne, kemi një të shkuar të mbushur me legjenda të shumta, aq sa nuk e ka pasur fatin asnjë popull tjetër. Populli ynë, duke filluar nga Alparsllanët, prej shpirtit të të cilëve rridhte mëshirë, ka vendosur vulën e historisë së vet madhështore në zemrën e shekujve, duke ndërtuar një qytetërim virtytesh. Nga një anë çlirimi i Stambollit, nga ana tjetër fitoret e mëdha kundër kryqtarëve... Nga një anë flamujt e çlirimeve që shënuan 24 milion km², nga ana tjetër Lufta e Çanakalesë dhe e Pavarësisë, ku mposhtëm gjigandët e botës në një periudhë kur nuk kishim forcë fizike... Sikur vetëm këto të vlerësonim siç duhet, do të mjaftonin për t'i dhënë drejtimin e duhur të ardhmes sonë.

Përftimi i vetëdijes historike në mënyrë të plotë dhe të saktë, është një nga detyrat tona më të rëndësishme. Përndryshe, do të detyrohemi të jetojmë si një lypës i mjerë mbi një thesar gjigand. Kulturat e huaja përpiqen me gjithë forcën e tyre t'ua injektojnë të rinjve tanë një ndjenjë të tillë. Mbi të gjitha, ata po përpiqen ta edukojnë mendjen e freskët të brezave të rinj në mënyrë që të admirojnë punën e tyre me një kompleks inferioriteti të papranueshëm.

Një gjë duhet ta kuptojmë shumë mirë, se mbrojtja e fesë, e gjuhës, e historisë dhe trashëgimisë kulturore që janë amanete të shenjta të të parëve tanë, nuk nënkupton vetëm restaurimin e veprave historike të rrënuara. E rëndësishme është rigjallërimi i atij shpirti, entuziazmi dhe qytetërimi dhe përcjellja tek brezat e rinj.



***Mos pandeh se me shekuj fjetën etërit e tu,
Ku do ta gjeje atdheun që tani gëzon këtu?
Në tre kontinente vende-vende gjurmë të përgjakura dëshmojnë
Ai luftëtar me famë të madhe një ditë nuk u çlodh!..***

(M. Akif Ersoj)



“Nuk përsëritet historia, por gabimet!”

(Sulltan Abdulhamidi II.)

A përsëritet historia?

Edhe shtetet njësoj si njerëzit, lindin, rriten dhe vdesin. Ky është një paracaktim i pandryshueshëm. Shtetet që me popullin dhe drejtuesit e tij marrin edukim Islam në mënyrën më të bukur dhe e orientojnë jetën në atë drejtim, jetojnë gjatë në varësi të vazhdimësisë së sinqeritetit dhe dashamirësisë.

Por, kur fillojnë t’i humbin këto virtyte, zvogëlohen dhe largohen prej skenës historike, sepse në këtë botë kalimtare, asgjë nuk mund të vazhdojë pafundësisht. Të gjitha ngritjet përfundojnë me rënie. Mirëpo, edhe ajo rënie, nuk vazhdon përgjithmonë. Përsëri do të fillojë një ngritje tjetër. Ata që njohin të fshehtat e kaderit dhe vërejnë urtësinë në manifestimet hyjnore, as nuk u gëzohen, e as nuk u mërzhiten shumë këtyre ulje ngritjeve. Ata përpiqen vetëm të bëjnë detyrën e tyre në mënyrën më të mirë. Ata e dinë se ngjarjet e panumërta në histori, uljet dhe ngritjet, përsëriten si uljet dhe ngritjet e shiritit të zemrës për shkak se nuk merret mësim prej së shkuarës.

Në fakt, rregulli i përsëritjes së historisë, është një mirësi e madhe për të zotët e mendjes. Njerëzit e pjekur, duke marrë parasysh këtë rregull, do të përpiqeshin të përsëritnin periudhat madhështore të historisë. Po ashtu, ata do të merrnin masat e duhura ndaj periudhave të rënies, duke marrë mësim prej tyre. Në këtë mënyrë ata do ta orientonin të ardhmen në rrugën e kënaqësisë së Allahut me anë të vetëdijes së besimit.

Ti je një popull i madh!

Djalë i shtrenjtë!

Çështja më e rëndësishme që duhet të bësh kujdes, është të kapërcesh egon dhe të mos mashtrohesh prej dredhivë të saj, duke marrë mësim prej së shkuarës.

Popujt jetojnë me “besimin, gjuhën dhe historinë” e tyre. Kështu, edhe toka bëhet atdhe në sajë të këtyre elementeve të shenjta.

Kur ti kishe këto ideale, historia rrodhi mbi shtratin që shënoi dora jote. Bota ishte një ring për ty, e luginat e Evropës hipodrom. Ti ke fituar medalje të panumërta, që s’mund të fshihen prej faqeve të historisë. Mendoje këtë lavdi, sepse një lavdi e tillë të mjafton si trashëgimi!..

Po ashtu, si pasardhësi i një të shkuare të rrënjosur dhe të famshme, mos harro kurrë se:



Një nga mësuesit tanë me origjinë shqiptare, Hoxha Ali Jakub efendia, i donte shumë Osmanët dhe i kujtonte me respekt duke thënë:

“E si të mos i dua Osmanët!? Nëse ata nuk do të kishin ardhur, ne do të mbeteshim në errësirën e mohimit... Në vendin tonë, dashuria për Osmanët dhe fenë u ndërthurën aq shumë, saqë fjalët “osmanlli” dhe “mysliman” tashmë përdorëshin në vend të njëra-tjetrës. Për rrjedhojë, ndonjëherë padashur, në vend që të pyetej “sa janë kushtet e besimit”, pyetej “sa janë kushtet e turqizmit”, e si përgjigje janë numëruar kushtet e besimit. Nëse mbaroj çdo ditë një hatme Kurani dhe them në çdo frymëmarrje «O Zot! Mëshiroje këtë popull!», përsëri nuk do të mjaftonte për të falënderuar Osmanët!..”



“Ai që nuk di të llogarisë të shkuarën e tij mijëvjeçare, është i dënuar të jetojë vetëm në mënyrë ditore”

Nëse ke një Alparsllan që kur hapi dyert e Anadollit veshi rrobën e tij të bardhë dhe luftoi në krye të ushtrisë duke thënë: *“Ky është qefini im!”*;

Nëse ke njerëz të shpirtit që i kanë bërë zemrat e tyre vatër për të gjitha krijesat, duke iu afruar atyre me mëshirë e dhembshuri;

Nëse ke personalitete si Sulltan Muradi i I., i cili iu dorëzua Allahut duke thënë: *“Qofsha unë kurhani i kësaj fitoreje!”*,

Atëherë ti je një popull i madh!..

Nëse ke një dijetar që e bën sulltanin të heqë dorë nga vendimi i gabuar, duke i thënë: *“Sulltani im, detyra ime është të shpëtojë ahiretin tuaj”*, ose je duke i edukuar njerëz të tillë, atëherë, **ti je një popull i madh**, që edhe të ardhmen e ke ashtu si të shkuarën tëndel!..

Nëse ke personalitete të nderuar që i kënaq qytetarët e huaj më tepër se ç’i kënaqin udhëheqësit e tyre dhe ideali yt i drejtësisë e thur shoqërinë si një rrjet;

Nëse ke Ullubatllë Hasanë, të cilët hidhen mbi flakë gjatë çlirimit të Stambollit duke thënë: *“Sot e kemi radhën ne për të rënë dëshmorë”*, e më pas e ngrenë flamurin mbi bedena duke e paguar me jetë;

Nëse ke personalitete shembullore si Abdulhamidi i I., i cili u paralizua prej hidhërimit, duke menduar për vuajtjet dhe tmerrin që pësoi populli i tij kur ra Kalaja Ozi;

Nëse në horizontin tënd duket një Fuzul, i cili digjet nga dashuria për Profetin ﷺ dhe ndjenjat e tij i shkruan në ujë, ose ke idealin për të nxjerrë një Fuzul të ri,

Atëherë ti je një popull i madh!..

Mos u mërzit! Shpirti i Forcave Kombëtare, që dje u ngritën në këmbë dhe siguruan pavarësinë në Anadoll, edhe sot është ende në këmbë...

Kurrë mos u dëshpëro dhe mos u bëj pesimist përballë ndodhive! Besimtari është gjithmonë optimist dhe strehohet tek Zoti i tij, sepse dëshpërimi është haram.

Nëse këta ezanë të frymëzojnë shpir-

Profesori gjerman Neumark, i mbledh një ditë nxënësit e tij turq dhe u thotë:

“E pranoj në mënyrë shumë të sigurtë se, evropianët nuk i duan turqit.

Armiqësia e kishës ndaj turqve dhe Islamit, ka depërtuar deri në qelizat e të krishterëve, sepse ju keni kalëruar

të paktën katërqind vite mbi shpinën dhe qafën tonë. Nëse Selçukët dhe në mënyrë të veçantë, Osmanët, nuk do të kishin flijuar gjithçka për hir të Islamit, mbase sot, Islami do të ekzistonte vetëm në zonën e Hixhazit.

Për më tepër, ata që themeluan Vehabizmin, ishin njerëzit e Ministrisë së Dominionit të Anglisë. Perëndimi e kanalizoi Islamin drejt besimeve të devijuara në çdo vend. Kurse Osmanët vazhduan Islamin e pastër të Epokës së Lumturisë. Prandaj, jo të bëheni laikë, por edhe sikur të bëheni

të krishterë, ata do të vazhdojnë t’ju shohin si armiq. Ju nuk jeni të vetëdijshëm, por ata janë të vetëdijshëm ndaj kësaj të vërtete: Nëse heqim turqit nga historia, nuk do të mbetet më histori. Nëse arkivat Osmane do të hapeshin plotësisht, historia e sotme do të duhet të rishkruhet. Dhe, në

çastin kur ju të jeni kthyer në identitetin tuaj të vërtetë, mirëqenia dhe qytetërimi Evropian do të shembet. Për rrjedhojë, ata që nuk ju mposhtën dot me armë, përipiqen t’ju mbizotërojnë duke bërë t’ju ngjani atyre...”





Profeti ﷺ dhe sahabët e tij të nderuar, kanë treguar përpjekje dhe sakrificat të mëdha që mirësia e Islamit dhe Besimit të përcillen në brezat pasardhës. Në të njëjtën mënyrë, edhe ne duhet të përpiqemi me po të njëjtin shpirt që këto amanete të shenjta t'u përcillen brezave të ardhshëm.

tërisht dhe nëse flamuri yt, që valëvitet i lirë në qiellin e pamatë, të jep forcë, atëherë ti i zotëron këto amanete të shenjta!..

MËSIMI I ISLAMIT

Një delegacion prej trembëdhjetë vetash nga fisi Beni Tuxhib kishte ardhur në Medinën e Ndriçuar për t'u takuar me Profetin ﷺ, i cili ua uroi mirëseardhjen mysafirëve dhe e urdhëroi Bilal Habeshiun ﷺ, që t'u rezervonte një pritje sa më të mirë.

Të deleguarit e Beni Tuxhib iu drejtuan Profetit ﷺ, duke i thënë:

"O i Dërguari i Allahut! Të sollëm atë që i takon Allahut nga pasuria jonë!" Ndërsa Profeti ﷺ, u tha:

"Merrini me vete dhe shpërndajuni të varfërve tuaj!"

"O i Dërguar! Ne ju sollëm atë që teproi nga ajo që u dhamë të varfërve!" - u përgjigjën ata. Ebu Bekri ﷺ, tha:

"O i Dërguar! Të them të drejtën, ndër arabët nuk ka njerëz më të drejtë se këta!" Profeti ﷺ, tha:

"Udhëzimi është në dorë të Zotit, Allahu ia hap zemrën atij që dëshiron ta udhëzojë në rrugë të drejtë."

Delegatët e Tuxhibit e pyetën Profetin ﷺ, rreth disa çështjeve nga Kurani dhe Suneti, përgjigjet e të cilave iu dhanë me shkrim. Si rezultat i këtyre përpjekjeve të tyre, edhe Profeti ﷺ, iu shtua interesimi ndaj tyre. Pasi qëndruan ca ditë, kërkuan leje të largoheshin. Por, kur u pyetën: *"Përse po nxitoni?"*, ata u përgjigjën:

"Do të kthehemi tek populli ynë dhe do t'u tregojmë ato që pamë nga Profeti ﷺ dhe ato që mësuam nga përgjigjet e pyetjeve që bëmë."


Ata shkuan tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe u përshëndetën për t'u ndarë. Ndërsa Profeti ﷺ, dërgoi Bilal Habe-shiun ؓ, tek ata dhe e urdhëroi t'u jep-te dhurata prej tij, e t'i respektonin më shumë se të deleguarit e tjerë. (Ibn-i Sa'd, 1, 323; Ibn-i Kajjim, III, 650-651.)

I Dërguari i Allahut ﷺ, dëshiron-te që delegacionet që vinin tek ai, të qëndronin për një farë kohe në Medinë. Në këtë mënyrë, ai sigurohej që ata ta kuptonin Islamin, duke mësuar Kuranin dhe parimet themelore të fesë dhe duke i parë personalisht se si i praktikonin ato. Për shembull, kur erdhi delegacioni Abdu'l-Kajs, kërkoi prej ensarëve që t'i pranonin si mysafirë dhe t'i gostitnin ata. Ndërkohë, Profeti ﷺ, porositi që delegacionit t'i jepeshin informacionet e duhura fetare dhe t'i mësohej Kuran për të falur namazin.

Kur erdhën në mëngjes, Profeti ﷺ, i pyeti si ishin dhe a ishin të kënaqur nga mikpritja e ensarëve.

Ata shprehën kënaqësinë e tyre. Më pas, me qëllim që ata ta mësonin fenë më lehtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, i shpërndau dy nga dy nëpër shtëpitë e sahabëve. Profeti ﷺ, mbeti i kënaqur prej punës së sahabëve dhe përpjekjes për të mësuar të Abdu'l-Kajsëve. Në fund, ai u interesua një për një me ta, duke kontrolluar ato që kishin mësuar përmendësh, si et-Tahijatin, suren Fatiha, suret e tjera dhe ato që kishin mësuar prej suneteve. (Ahmed, III, 402.)

Në këtë mënyrë, Islami u përhap ditaditës në gjithë Arabinë. Ashtu siç shprehet edhe në



Omeri ؓ, tregon:

“Bashkë me një fqinjin tim prej ensarëve, banonim në vendin e Bijve të Umejje ibn Zejdit, e cila ndodhet në pjesën e sipërme të Medinës. Ne zbrisim me radhë, e shkonim për të marrë dije pranë të Dërguarit të Allahut ﷺ. Pra, një ditë zbriste ai, një ditë unë. Kur zbrisja unë, e lajmëroja fqinjin tim nëse atë ditë kishte zbritur ndonjë shpallje, ose çfarë kisha dëgjuar ndonjë gjë tjetër. Po kështu vepronte edhe ai kur zbriste vetë...”

(Buhari, Kitabu'l-Ilm, 27.)



“Më i miri prej jush, është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson të tjerëve!”

(Buhari, Fedailul-Kuran, 21.)

“Vetëm këta dy persona mund të kihen zili: Njëri është ai, të cilit Allahu i ka dhënë Kuranin dhe ai angazhohet e punon me të natë e ditë. Ndërsa tjetri është ai, të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai e shpërndan atë natë e ditë.”

(Muslim, Musafirin, 266, 267.)

suren el-Nasr, njerëzit filluan të hynin grupe-grupe në Islam. Medina mbushej përditë me mysafirë të rinj. Ndërsa Profeti ﷺ, i priste ata në mënyrën më të bukur, i respektonte, i gostiste dhe bisedonte me ta sipas gjendjes dhe traditave që kishin. Ai merrte informacione lidhur me zonën ku jetonin, dëgjonte kërkesat

e tyre, u përgjigjej pyetjeve të tyre dhe përpiquej t’u zgjidhte çështjet. Në këtë mënyrë, ai gdhendte në zemrat e tyre dritën, paqen dhe vetëdijen Islame. (shih. Nesai, Umre, 5.)

Nga sa kuptojmë edhe prej shumë transmetimeve të tilla të ngjashme, i Dërguari i Allahut ﷺ, dëshironte që sahabët dhe populli i tij, të përpiquej shumë për të mësuar fenë. Kur vinte dikush dhe bëhej mysliman, në fillim ia mësonte vetë dijet e para, pastaj ia dorëzonte sahabëve dhe thoshte:

“Shpjegojani mirë fenë vëllait tuaj! Mësojani Kuranin dhe Sunetin!”

Kur ushtritë Islame përballeshin me ndonjë popull, në fillim u shpjegonin Islamin. Nëse nuk pranonin, u ofronin paqe. Por, nëse nuk e pranonin as këtë, në fund vendosnin për luftë.

Nëse pala tjetër e pranon Islamin, menjëherë u mësonin Kuranin dhe Sunetin. Me këtë entuziazëm, sahabët e nderuar sakrifikuuan shumë për hir të mësimin të fesë, duke bërë rrugë të gjata dhe duke u larguar prej punëve, shtëpive dhe pasurive të tyre. Kjo, sepse është e pamundur që një fe të praktikohet pa njohur urdhëresat dhe ndalesat e saj. Po ashtu, është e pamundur që dikush të marrë rezultate të mira nëse të tjerëve u shpjegon parime, të cilat nuk i jeton as vetë. Për këtë arsye, mësimi i dijeve themelore fetare, është

farz (detyrë) për çdo mysliman, qoftë i ri apo i moshuar. Më pas, duhen bërë përpjekje të mëdha për t'i jetuar e praktikuar ato që janë mësuar.

I Dërguari i Allahut ﷺ, interesohej më nga afër me sahabët e tij në Medinë e ndritur. Madje, në disa raste nuk dëshironte që ata të qëndronin larg tij. Me qëllim që ata t'i shihnin më nga afër dhe t'i mësonin më mirë gjërat e nevojshme, u kërkonte që ata të qëndronin menjëherë në namaz pas tij. (shih. Ibn-i Maxhe, Salat, 44.)

Për këtë arsye, ai i nxiste myslimanët që jetonin në zonat e tjera, të emigronin në Medinë, sipas mundësive që kishin.

Prandaj, sot, detyra që kanë të rinjtë myslimanë, është të mësojnë fenë tonë në mënyrën më të mirë, ta jetojnë atë dhe t'ia mësojnë të tjerëve, duke përdorur të gjitha mundësitë që kanë.



Malik ibn Huvejrîs ؓ, tregon:

“Bashkë me disa të rinj vërsnikë, shkuam për të qëndruar nja njëzet ditë pranë të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai ishte shumë i mëshirshëm dhe i butë. Kur e kuptoi se neve na kishte marrë malli për familjen, na pyeti se kë kishim lënë në shtëpi. Ne i treguam dhe ai tha:

«Kthehuni tek familjet tuaja dhe qëndroni mes tyre. Mësojini atyre gjërat e nevojshme dhe u thoni ato që duhen thënë!»

Ai na tha edhe shumë gjëra të tjera, një pjesë të të cilave i kujtoj ende, e një pjesë nuk i mbaj mend. Më pas vazhdoi:

«Falni namaz, ashtu siç më keni parë mua të falem! Kur të vijë koha e namazit, njëri prej jush të thërrasë ezanin, ndërsa më i moshuari prej jush të fali namazin!» (Buhari, Ezan, 18.)

**“Nëse nuk jetoni
siç besoni, do
filloni të besoni
ashtu siç jetoni!”**

(Omeri r.a.)

TË JETOSH ISLAMIN

Një përfaqësi e fisit Thakif që banonin në Taif, kishin ardhur në Medinë për të bërë një marrëveshje me Resulullahun ﷺ, i cili i priti ata në xhami, me qëllim që t’u zbuteshin zemrat.²⁰ Përfaqësuesit dëgjonin Kuranin Famëlartë që këndohej natën, suret që këndonin sahabët në namazin e tehexhudit (natës) dhe shikonin sesi formonin rreshtat gjatë kohës së pesë kohëve të namazit.²¹

Pas një farë kohe, përfaqësuesit e Thakifit, njoftuan se do të besonin dhe do të bindeshin, me kusht që të përjashtoheshin nga detyrimi i namazit. Për këtë arsye, Profeti ﷺ, e refuzoi kërkesën e tyre duke thënë: *“Nuk ka mirësi në një fe që nuk ka ruku (namaz)”*. (Ebu Davud, Haraxh, 25 - 26/3026.)

Përfaqësuesve të Thakifit, iu mësuara farzet e Islamit dhe ligjet e tij. Po ashtu, Profeti ﷺ, i urdhëroi ata të agjëronin gjatë ditëve të mbetura të Ramazanit.

Bilal Habeshiu ؓ, u çonte atyre ushqimet e syfyrit dhe të iftarit.²²

Populli i Taifit, ishin njerëzit që rezistuan më shumë ndaj Islamit në Gadi-shullin Arab. Për rrjedhojë, ata ishin edhe populli që e pranuan të fundit Islamit në atë



20. Ahmed, IV, 218.

21. Vakidi, III, 965.

22. Vakidi, III, 968.

zonë. Kur ata pranuan besimin, Resulullahu ﷺ, i urdhëroi menjëherë adhurime të ndryshme, si namazin, agjërimin dhe zekatin, duke mos i toleruar aspak në këtë pikë, sepse adhurimet janë tregues i besnikërisë së njeriut ndaj premtimit që i dha Zotit (në botën e shpirtave)²³.

Janë çastet e takimit ato që e afrojnë besimtarin tek Allahu i Madhëruar. Nga ana tjetër, adhurimet janë burimet shëruese, qetësuese dhe ngushëlluese më me ndikim që mund ta shpëtojnë njeriun nga frika dhe shqetësimi i vdekjes e përtej saj. Gjithashtu, adhurimet janë burime të detyrueshme frymëzimi, që i sjellin njeriut paqe shpirtërore dhe e lartësojnë nivelin e devotshmërisë të tij.

Adhurimet janë si dheu që ushqen pemën e besimit. Ashtu sikurse pema nuk mund të jetë e panevojshme për dheun, që është burim i jetës për të, ashtu edhe besimi nuk mund të mendohet i ndarë nga adhurimet. E, padyshim se në krye të këtyre adhurimeve jetike, qëndron **“namazi”**. Nisur nga kjo, ndër të gjitha adhurimet, namazi është i pari që është bërë farz (i detyrueshëm).

Pas namazit, një tjetër adhurim që ushqen shpirtin, është **“agjërimi”**. **Ebu Umame** i ka bërë një kërkesë të tillë Profetit ﷺ:

“Këshillomë një adhurim të atillë, që Allahu i Madhëruar të më shpërblejë për të!” Profeti ﷺ, i është përgjigjur:

“Po ta këshilloj agjërimin, pasi nuk ka një tjetër të ngjashëm me të!” (Nesai, Sijam, 43.)



Një zjarrputist kishte plagosur Omerin ﷺ, me shtizë dhe ai po humbiste gjak vazhdimisht. Pas pak humbi veten dhe i ra të fikët. Ky ishte një të fikët si vdekje. Mirëpo, kur erdhi koha e namazit dhe i thanë në vesh: “Namazi, o Omer, namazi!”, ai u përmend me një vullnet të paparë dhe, në atë gjendje fali namazin. Më pas, tha: «Nuk ka vend në Islam për atë që nuk fal namazin!», e i ra sërish të fikët.

23. shih. A'raf, 172.

Një nga sulltanët Osmanë, Mehmed Reshadi, lidhur me edukimin e fëmijëve të dinastisë, caktoi zonjën Safije, në cilësinë “Mualime-i Salatin / Mësuesja e sulltanëve” dhe, si fillim e urdhëroi:

“Atyre që nuk falin namaz dhe nuk agjërojnë, ua kam bërë haram kripën dhe bukën që u jap! Ky urdhër t’u përcillet nxënësve prej trashëgimtarëve (të fronit) dhe sulltaneshave nga ana e mësueses!”

(Safiye Unuvar, Saray Hatiralirim, Istanbul 1964, f. 21.)



Agjërimi na mëson vlerën e mirësive që zotërojmë. Agjërimi është një adhurim i madh, i cili na ndihmon në maturimin e moralit, duke na përforcuar durimin, vullnetin dhe rezistencën ndaj egos.

Një tjetër adhurim farz në rendin shoqëror Islam, i cili është urdhëruar me qëllim që të ndërtohet ndjenja e dashurisë dhe të eliminohet smira dhe armiqësia mes të varfrit dhe të pasurit, është **“zekati”**. Ky adhurim, bëhet pengesë ndaj kalimit të kufijve nga ana e të pasurve, si pasojë e lakmisë së tyre për sa më shumë pasuri. Po ashtu, zekati bëhet pengesë që tek të varfrit të lulëzojnë mendime të këqija ndaj të pasurve. Në këtë mënyrë ruhet ekuilibri në jetën shoqërore.

Ne nuk duhet ta harrojmë asnjëherë se në Islam, pasuria është e Allahut, ndërsa njeriu është vetëm ruajtës dhe përdorues i kësaj pasurie.

Krahas këtyre, ekziston edhe një adhurim tjetër ekonomik dhe fizik, që është **“haxhi”**. Haxhi përsos besimin në zemër. Duke na dhënë mundësinë e përjetimit që në këtë botë të një skene të ngjashme me Mahsherin²⁴, ai bëhet shkak i kuptimit të urtësisë: **“Vdisni para se të vdisni!”**.

Njerëzit që neglizhojnë adhurimet si zekati dhe haxhi, përballen me dëme të shumta materiale dhe shpirtërore. **Ibn Abbasi** †, thotë:

24. Mahsher: Vendi/Sheshi ku do të mblidhen të gjithë njerëzit pasi të ringjallen Ditën e Kiametit.

“Kush ka pasuri aq sa të shkojë në Haxh dhe të japë zekat, e nuk i kryen këto, do të pendohet shumë në çastin e vdekjes dhe do të dëshirojë të kthehet përsëri në këtë botë.”

Pastaj, Ibn Abbasi **ؓ**, lexoi këtë ajet:

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin. Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t’i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: “O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!” Por Allahu nuk ia shtyn afatin askujt, që i vjen koha (e vdekjes); Allahu e di mirë gjithçka që bëni ju.” (Munafikun, 9 - 11.) (Tirmidhi, Tefsir, 63/3316.)

Adhurimeve duhet t’u kushtohet kujdes maksimal. Çdo adhurim që bëhet, duhet vlerësuar si një vizë për të hyrë në Xhenet dhe me këtë entuziazëm të lartë duhen kryer me kujdes.

Të rinjtë sahabë ishin të dhënë pas adhurimit

Të rinjtë sahabë, të cilët ishin edukuar nën kujdesin e Profetit **ﷺ**, ishin njerëz të dhënë pas adhurimit. Për shembull, **Abdullah ibn Mahreme **ؓ****, i cili emigroi në Medinë kur ishte 30 vjeç, në moshën 41 vjeç, kur mori pjesë në luftën e Jemames ishte agjërueshëm. Kur po jepte shpirt në fushëbetejë, ai pyeti Abdullah ibn Omerin **ؓ**, nëse kishte hyrë koha e iftarit dhe kërkoi ujë që të çelte iftarin. Mirëpo, derisa Ibn Omeri **ؓ**, i



“Nëse dikush zotëron ushqim, pije, mjet udhëtimi dhe ka mundësi të shkojë për Haxh në Shtëpinë e Allahut, por nuk e bën këtë, atë nuk e pengon asgjë që të vdesë si i krishterë apo si hebre!”

(Tirmidhi, Haxh, 3.)



Myslimanët janë treguar rigorozë ndaj adhurimeve edhe në kohë lufte dhe, në sajë të këtij përkushtimi kanë fituar ndihmën e Allahut. Travijani venedikas, e përshkruan kështu ushtrinë trime të Jëlldërëm Bejazidit:

“Në ushtrinë Osmane nuk bëhet fjalë të ketë gjëra si vera, kumari dhe prostitucioni, sikurse kemi ne. Ata, krahas edukimit ushtarak që nuk e neglizhojnë aspak, përmendin gjithnjë emrin e lartëmadhëruar dhe madhështor të Allahut dhe merren ditë-natë me adhurime. Për këtë arsye, ata janë gjithnjë fitimtarë.”

solli ujin, ai kishte pirë *sherbetin e martirit*.²⁵

Abdullah ibn Jezidi ﷧, i cili kishte marrë pjesë në Bej'atu'r-Riduan/Besatimin e Riduanit, kur ishte vetëm 12 vjeç, ishte një sahab i shquar për përkushtimin e tij ndaj adhurimit.²⁶

Megjithëse në moshë të vogël, **Abdullah ibn Omeri** ﷧, e kishte marrë jetën e Profetit ﷺ, si model të jetës së vet. Ai përpiquej të zbatonte tekstualisht çfarëdo që dëgjonte dhe shikonte prej tij.²⁷

Ebu Said el-Hudri ﷧, i cili në moshën 13 vjeç dëshiroi të merrte pjesë në Betejën e Uhudit, ishte një djalosh që praktikonte me rigorozitet rregullat e fesë.²⁸

Rregullat e jetës shoqërore (Muamelat)

Le të mos e harrojmë, se feja e njeriut nuk përsoset vetëm përmes adhurimeve. Prandaj, e rëndësishme është të vihet në jetë edhe aspekti “Muamelat” i fesë, pra rregullat e jetës shoqërore. Nisur nga kjo, **çdo hap që hedh një mysliman, madje çdo frymëmarrje dhe çdo mendim që i kalon nëpër mendje, duhet përshtatur sipas Islamit.**

Dhe, pika më e rëndësishme së cilës duhet t'i kushtojmë kujdes në jetën tonë fetare me gjithë adhurimet dhe “Muamelatin”, është

25. Kemal Sandikçi, Diyanet Islam Ansiklopedisi, I, 114.

26. Ismail Çakan, DIA, I, 143.

27. Yasar Kandemir, DIA, I, 127.

28. Rasit Kucuk, DIA, X, 223.

zotërimi i **zemrës së pastër** dhe **sinqeritetit**. Nëse dëshirojmë që devotshmëria jonë të jetë e pranuar tek Allahu, është e domosdoshme që veprat tona t'i bëjmë me sinqeritet. Vetëm në këtë mënyrë veprat tona fitojnë cilësinë "salih" (të mira, për hir të Allahut) dhe bëhen furnizimi ynë i lumturisë në botën tjetër.

DASHURIA NDAJ ALLAHUT

Dashuria është një nga prirjet më të forta të natyrës njerëzore. Për këtë arsye, njeriu përherë e do diçka. Dashuria e gjen medoemos një vend ku të rrjedhë, porsì një ujëvarë që rrjedh nga lart. Por, e rëndësishme është që dashuria



Gjatë rrugës për në Haxh, i nderuari Muhamed Parisa u ndal në Bagdad. Kur po kalonte në pazar, vëren një djalosh me fytyrë të ndritur, i cili merrej me tregti ari. Për shkak se djaloshi kishte shumë punë, ai ishte gjithnjë i zënë me diçka. Prandaj, fakti që ai ishte kaq shumë i angazhuar me punët e dynjasë, e mërzhisin Pirin e nderuar, i cili mendon me vete:

“Qenka dhënë pas dynjasë, pikërisht në kohën kur duhet t'i kushtohej adhurimit.”

Mirëpo, kur i drejtohet botës së brendshme të djaloshit, ai vëren se zemra e tij ishte vazhdimisht me Allahun. Kësaj here, e përgëzon djaloshin duke thënë:

“MasheAllah! Dora për dynja, zemra për Allah!..”

Nga kjo kuptojmë që edhe kur je i zënë me punët e dynjasë, zemra nuk duhet ta anashkalojë përkujtimin e Allahut.



***“Meqenëse Allahu
është shpirti i
shpirtit të çdo
gjëje, atëherë ki
frikë që shpirti yt
të mos ndahet nga
shpirti i shpirtit
tënd! Bindju
urdhrave të Tij!”
(Rumi)***

duhet të rrjedhë në vendin më të përshtatshëm dhe më të dobishëm. Kur rrjedh në vendet e gabuara, humbet kthjelltësinë, turbullohet dhe shkon kot, duke ushqyer kënetat. Madje, nuk mjaftohet as me kaq, sepse një dashuri që rrjedh në vendin e gabuar, i sjell shumë probleme edhe të zotit.

Për rrjedhojë, dashuria mund ta arrijë përsosmërinë e saj vetëm atëherë kur zemra njerëzore, ndjenjën e saj të natyrshme të dashurisë, e orienton nga Allahu. E në fakt, e vetmja qenie që meriton dashurinë e vërtetë, është burimi i të gjitha lumenjve të dashurisë, Allahu i Madhëruar, sepse:

- Ai është që i ka dhënë jetë gjithçkaje, i ka furnizuar dhe i ka mbrojtur gjallesat.

- Ai i do shumë robërit e Vet. Ai e ka krijuar Ademin, babanë e njerëzimit në Xhenet, në formën më të bukur dhe me kujdesin më të madh. Ai dëshiron t'i shohë sërish robërit e Vet të hyjnë në Xhenet. Shpërblimi i dashurisë është vetëm dashuria. (shih. Maide, 54.)

- Ai është Pronari i vetëm i dynjasë dhe i ahiretit.

- Në fund, njeriu do të dalë para Allahut të Madhëruar dhe nuk do të gjejë asnjë strehim dhe mbrojtje tjetër përveç Tij. Allahu, Zoti i botëve është ndihmësi dhe kujdestari më i mirë!

- Ai na ka krijuar si njerëz mes gjithë këtyre gjallesave, na ka bërë popullin e Profetit, të cilin e donte më shumë dhe na ka dhuruar Kuranin Famëlartë, si

librin më të përsosur. Kur mendojmë madhështinë e këtyre dhuntive, e kuptojmë më mirë pafundësinë e borxhit që i kemi Zotit tonë të Madhëruar.

Siç shihet, për arritjen e lumturisë dhe shpëtimit në këtë botë dhe në tjetrën, njeriu duhet t'i drejtohet Allahut me një dashuri të madhe besimi.

Resulullahu ﷺ, nuk e hiqte nga goja këtë lutje të Daudit ﷺ :

“Zoti im! Prej Teje kërkoj dashurinë Tënde, dashurinë e atyre që të duan Ty dhe mundësinë për të bërë vepra të mira, që më shpien në dashurinë Tënde! Zoti im! Bëma dashurinë ndaj Teje më të dashur se dashurinë ndaj vetes, familjes, pasurisë dhe ujit të ftohtë!” (Tirmidhi, Deauat, 72/3490.)

Kumtesa dhe ftesa e Profetit ﷺ, në radhë të parë ishte një thirrje drejtuar njerëzve për të dashuruar Allahun. Kjo, sepse për përsosjen e besimit në kuptimin e vërtetë të fjalës, nevojitet dashuria. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

قُلْ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ أَجْرًا إِلَّا الْمَوَدَّةَ فِي الْقُرْبَىٰ

Hasan el-Basriu dhe **Katade**, këtë ajet e kanë komentuar në këtë mënyrë:

“Thuaju: Për këtë nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi tjetër prej jush, përveçse t'i afroheni Allahut, duke e dashuruar Atë dhe duke iu bindur urdhëresave të Tij.” (Shura, 23.) (Kurtubi, Tefsir, XVI, 22.)

Saktësinë e këtij komenti e vërteton edhe ky hadith:

“Prej jush nuk kërkoj asnjë pagesë në këmbim të



Dashuria, është fillimi i përparimit shpirtëror. Në fakt, kjo pikë është filli i gjithçkaje. Vetëm kur shijon dashurinë e vërtetë, zemra fillon të hapet dhe të manifestojë bukuritë shpirtërore.



**Në një
hadith kudsî thuhet:**

“Kush tregon armiqësi ndaj ndonjërit prej miqve të Mi, Unë do t’i shpall luftë atij. Robi Im nuk mund të më afrohet në ndonjë mënyrë më të mirë se sa me ato që Unë ia kam bërë farz (të detyrueshme). Robi Im vazhdon të më afrohet edhe me (vepra) nafîle (vullnetare) dhe Unë e dua atë. Kur Unë e dua, bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon, syri i tij me të cilin shikon, dora e tij me të cilën prek dhe këmba e tij me të cilën ecën. Nëse kërkon diçka prej Meje, ia jap, nëse strehohet tek Unë e mbroj...”

(Buhari, Rikak, 38.)

argumenteve të qarta dhe udhëzimit që kam sjell si profet. Unë dua vetëm që ta doni Allahun e Madhëruar dhe t’i afroheni Atij duke iu bindur urdhrave të Tij.” (Ahmedi, I, 268.)

Nuk duhet harruar se, çdo pohim ka nevojë të argumentohet për t’u vërtetuar. Pohimet që nuk argumentohen, mbeten të zbrazëta. Argumenti dhe treguesi i dashurisë ndaj Allahut shfaqet përmes kryerjes me rigorozitet dhe përkushtim të farzeve dhe detyrave minimale të devotshmërisë. Më pas, duke bërë edhe përpjekje për shtimin e adhurimeve nafîle dhe veprave të mira, si shprehje e dashurisë që buron vetëm nga zemra.

Njerëzit që e duan Allahun e Madhëruar, nuk e heqin kurrë nga mendja Atë, sepse, të dashuruarit nuk i heqin nga mendja ata që dashurojnë dhe, nuk rrinë pa i përmendur ata. I Dërguari i Allahut thotë:

“Treguesi i dashurisë ndaj Allahut, është të duash përmendjen e Tij” (Sujuti, II, 52.)

Në fakt, për një rob besimtar, përmendja e Allahut të Madhëruar është puna më e rëndësishme. Asgjë s’duhet ta pengojë atë ta kujtojë Zotin e tij. Ajeti fisnik urdhëron:

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.”

(Munafikun, 9.)

Ai që dashuron, flijon gjithçka për atë që dashuron. Ky tregim që na rrëfen i nderuari

Molla Xhami është mjaft domethënës:

Në grupin e atyre që merrnin pjesë në bisedat e **Mevlana Sadedin Kashgari** ndodhej edhe një djalosh, i cili kishte përparuar shumë në rijazat²⁹, halvet³⁰ dhe ashk³¹. Mirëpo, ky djalosh kishte rënë në dashuri me një bukuroshe. Për rrjedhojë, një pjesë të cilësive që kishte akumuluar në zemër, e kishte transferuar në atë anë.

Djaloshi përgatiti një dhuratë të çmuar, të zbukuruar me ar e perla, të cilën e la në rrugën ku do të kalonte ajo bukuroshe dhe u fsheh diku në qoshe që të mos e marrë ndokush tjetër. Ai mendonte se vajza që dashuronte do të kalonte andej dhe do ta merrte dhuratën. Mirëpo, pa e ditur se nga kush dhe si kishte ardhur aty. Kur e mësova këtë, i thashë:

“Sa punë të çuditshme që po bën! E lë në rrugën e saj, gjithë atë që ke arritur me mundime të mëdha! Edhe nëse e gjen, e shikon dhe e merr, nuk do ta dijë se nga kush dhe përse. Të paktën, bëj diçka që ta dijë se e ka nga ti!”

Djaloshi i përlotur tha:

29. Rijazat: Metodë edukimi shpirtëror që konsiston në ushqyerjen e pakët, pengimin e dëshirave të egos dhe angazhimin vetëm me punë dhe mendime të mira.

30. Halvet: Metodë edukimi shpirtëror që konsiston në kryerjen e adhurimeve të ndryshme Islame në një ambient të vetmuar.

31. Ashk: Në mistikën Islame shpreh dashurinë absolute vetëm për Allahun dhe çdo gjë që vjen prej Tij.



“Ka njerëz të tillë, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun dhe të cilët falin namazin dhe japin zekatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuar.”

(Nur, 37)



I vetmi burim i dashurisë dhe mëshirës që mund ta shpie njeriun në detin e dashurisë për Allahun, është Profeti ﷺ!

“Çfarë po thua? Pandej se unë nuk e di pakuptimshmërinë e asaj çfarë po bëj? Por unë nuk pres asnjë shpërblim nga kjo punë, sepse, unë nuk dua që ajo të ndihet mirënjohëse ndaj meje për shkak të dhuratave të mia!”

Pas kësaj përgjigjeje, ndjeva që po më dridheshin të gjitha qelizat. Nëse një dashuri metaforike për një vdekatar manifestohet me kaq delikatesë, thellësi dhe bukuri shpirtërore, kushedi se sa madhështi të lartë kërkon manifestimi i dashurisë së vërtetë që ushqehet ndaj Allahut të Madhëruar.

Mirëpo, nuk është e lehtë që dashuria ndaj Allahut të arrihet përnjëherësh. Mënyra për ta arritur atë kalon përmes dashurisë ndaj atyre që do Allahu dhe urrejtjes ndaj atyre që nuk i do Allahu. Pra, dashuri për atë që e meriton dhe urrejtje për atë që e ka hak...

DASHURIA NDAJ PROFETIT

Allahu i Madhëruar, dashurinë dhe faljen e Tij e ka kushtëzuar me bindjen ndaj Profetit tonë të nderuar.³² Dhe, për t’ju bindur ashtu siç duhet Profetit ﷺ, duhet që ta duam atë më shumë se gjithçka. Njeriu merr shembull dhe imiton atë, ndaj të cilit ndjen dashuri dhe respekt. Krahas kësaj, njeriu ka shumë arsye që ta dojë të Dërguarin e Allahut ﷺ:

- I Dërguari i Allahut ﷺ, është shkak që njerëzit dhe xhinët të shpëtojnë nga dënimi i përhershëm i ahiretit, duke u mësuar atyre imanin dhe Islamin.

32. Shih. Al-i Imran, 31.

- Ai ka marrë përsipër vuajtje, shqetësime dhe mundime që nuk i ka përjetuar asnjëri, me qëllim që t'i tregojë rrugën e drejtë Umetit të vet.

- Ai është i mbushur me dashuri dhe mëshirë ndaj besimtarëve. Është shumë i lidhur me Umetin e vet dhe i vjen shumë rëndë kur Umeti i tij has probleme dhe vështirësi.³³

- Ai është personaliteti shembullor dhe ideal në devotshmërinë ndaj Allahut.

- Ai është bërë burimi i mëshirës dhe i dashurisë për të gjithë njerëzimin, madje edhe për të gjitha krijesat. Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.” (Enbija, 107.)


Mevlana, e shpreh në këtë mënyrë sesa mirënjohës duhet t'i jemi Resulullahut ﷺ, i cili rrënoi idhujt shpirtëror dhe material duke kaluar prej një rrethi vuajtjesh të pamendueshme:

*“O ti që sot je mysliman!
Sikur mos të ishte përpyekja e
Ahmedit në thyerjen e idhujve,
edhe ti do të ishe duke adhuruar
idhujt si etërit e tu!”*

Një nga ndjekësit e rinj të këtij udhërrëfyesi drejt udhëzimit, i cili ka ndriçuar shekujt, është edhe **Xhafer-i Tajjar**. Ky sahabe, kur ishte 17 vjeç, me fjalimin e tij që mbajti në Abisini, në audiencën e Nexhashiut, bukuritë e pashter-

“Thua ju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë!”

(Al-i Imran, 31)



33. Shih, Teube, 128.

*Padyshim se kur
besimtari i përjeton
me pasion dhe dashuri
drithërimat shpirtërore
dhe ndjenjat më
të bukura përballë
Resulullahut ﷺ, kur ta
ketë pastruar shpirtin
nga të gjitha format dhe
imazhet që i përkasin
egos dhe, kur të jetë bërë
njësh me atë, pra me
të Dërguarin e Allahut
ﷺ, atëherë, ai është në
rrugën e përfitimit prej
gjendjes shpirtërore dhe
dashurisë së tij.*



shme që i ka dhënë Profeti ﷺ, i ka shprehur në këtë mënyrë:

“O sundimtar! Ne ishim popull i injorancës. Adhuronim si zota idhujt e përbërë nga gurët e pemët. Ushqeheshim me mishin e kafshëve të ngordhura dhe bënim çdo lloj veprë të shëmtuar. Nuk bënim kujdes ndaj të drejtës së të afërmeve dhe prishnim lidhjet tona. Nuk njihnim të drejtën e fqinjëve dhe u bënim çdo lloj të keqe atyre. Të fuqishmit shtypnin të pafuqishmit dhe të papërkrahurit.

Ndërkohë që ishim në këtë gjendje, Allahu i Madhëruar na dërgoi nga mesi ynë si profet një njeri, të cilit ia dinim prejardhjen, ishte mjaft i besueshëm dhe i ndershëm. Ai na ftoi të besojmë në njëshmërinë e Allahut. Ai na ftoi që të adhurojmë vetëm Atë dhe të braktisim idhujt e bërë nga gurët e drurët, të cilët i patën

adhuruar etërit tanë. Na urdhëroi të jemi fjaldrejtë, të kujdesemi për amanetin, të forcojmë lidhjet tona me të afërmit dhe të bëjmë kujdes ndaj të drejtës së tyre, të krijojmë marrëdhënie të mira me fqinjët, të largohemi nga të ndaluarat dhe nga derdhja e gjakut. Ai na ka ndaluar nga imoraliteti, fjalët e këqija dhe gënjeshtria. Po ashtu, ai na ka ndaluar të hamë nga pasuria e jetimit dhe të akuzojmë gratë e pafajshme. Përveç këtyre, na ka urdhëruar të adhurojmë vetëm Allahun dhe të mos i bëjmë shok askënd tjetër në adhurim.

Ndërsa ne i pranuar ato çfarë kërkoj prej nesh, i besuar atij dhe iu bindëm në çështjet që na sollin. Ne adhuroim vetëm Allahun dhe nuk i shoqëruam asnjë ortak Atij. Gjithçka që na e ndaloj, e pranuar si haram, e ato që na i lejoi, i pranuar si hallall.



Për këtë arsye, populli ynë u armiqësua ndaj nesh. Ata na torturuan me qëllim që të linim adhurimin ndaj Allahut, t'i ktheheshim adhurimit të idhujve dhe të zhytëshim sërish në veprat e këqija që shkatërrojnë dinjitetin njerëzor. Po ashtu, ata u përpoqën të na fusnin në ngatërresa në lidhje me fenë tonë. Kur ata e shtuan dhunën ndaj nesh, e ne nuk ishim më në një gjendje t'u rezistonim atyre që na bënëin dhe, mbi të gjitha, kur nuk e kishim më të mundur ta jetonim fenë tonë ashtu siç duhet, erdhëm në vendin tënd. Të zgjodhëm ty, në mesin e sunduesve. E pamë të arsyeshme të vinim pranë teje, sepse shpresuar se nuk do të dhunohemi nga ti, o sundimtar!.." (Ahmed, I, 202 - 203., V, 290 - 291.; Hajthemi, VI, 25 - 27.; Ibn Hishami, I, 358 - 359.)

Kjo ngjarje që rrëfen **Abdullah ibn Hishami** ﷺ, e shpjegon më së miri se në çfarë niveli duhet të jetë dashuria që duhet të ndjehet për **Profetin** ﷺ:

"Një herë, ishim bashkë me Resulullahun ﷺ, i cili ishte ulur, duke mbajtur mes duarve të veta dorën e Omerit ﷺ. Në atë çast, Omeri ﷺ, e shprehu në këtë mënyrë dashurinë që kishte ndaj Resulullahut ﷺ:

"O Resulullah! Ti për mua je më i dashur se gjithçka tjetër, përveç vetes sime!"

Resulullahu ﷺ, i tha:

"Jo! Beto hem në Allahun, i Cili ka në dorë shpirtin

Njerëzit paguanë çmimin më të lartë për dashurinë e tyre, sepse çdokush, sakrifikon për dashurinë e tij, sipas nivelit të dashurisë që ka. Kur dashuria arrin në përsosje, edhe sakrificat dhe pasojat e saj, "vuajtja", arrijn kulmin. Tashmë, edhe vuajtja kthehet në kënaqësi. Për këtë arsye, edhe sahabët fisnikë kanë rendur gjithë jetën qoftë edhe për një dëshirë të vogël të Profetit ﷺ, duke thënë: "Të qofshin falë nëna, babai, pasuria dhe jeta ime, o Resulullah!"

Një nga të rinjtë sahabë, Halid ibn Saidi ؓ , një natë pa në ëndërr sikur po qëndronte pranë një grope të madhe zjarri dhe se i ati po e shtynte për ta hedhur në zjarr. Në çastin që po binte, Resulullahu ﷺ , e kapi për mesi atë dhe e shpëtoi. Kur u zgjua i frikësuar, Halidi tha me vete:

“Betohe në Allahun se kjo është një ëndërr e vërtetë!”

Më pas, me ndërmjetësimin e Ebu Bekrit ؓ , shkoi tek Profeti ﷺ dhe u bë mysliman.

Kur i ati e dëgjoi se Halidi ishte bërë mysliman, e dënoi atë. Mirëpo, Halidi ؓ , nuk u nda nga i Dërguari i Allahut ﷺ , derisa migroi në Abisini.

(Hakimi, III, 277 - 280.)



tim, se nuk mund të quhesh besimtar i vërtetë pa u bërë për ty më i dashur edhe se vetja jote!”

Omeri ؓ , menjëherë tha:

“Atëherë, betohe në Allah, se tani, ti je më i dashur për mua edhe se vetja ime, o Resulullah!”

Atëherë, i Dërguari i Allahut ﷺ , tha:

“Tani po, o Omer! (Buhari, Ejman, 3.)

Nëse një i ri bart gjithnjë në zemër dashurinë ndaj Resulullahut ﷺ , Allahu i Madhëruar e mbron atë nga shumë të këqija të dynjasë. Po kështu edhe në ahiret, Allahu e shpëton prej zjarrit të Xhehenemit zemrën e mbushur me dashuri për Resulullahun ﷺ . Në Kuranin fisnik urdhërohet:

“Por Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata, përderisa ti (o Muhamed) ishe në mesin e tyre dhe, Allahu nuk do t’i ndëshkojë ata, përderisa ata i kërkojnë falje Atij.” (Enfal, 33.)

Dashuria e sahabëve të nderuar

Sahabët fisnikë e donin Resulullahun ﷺ , më shumë se veten e tyre. Kur i drejtoheshin atij thoshin: *“Të qofshin falë nëna, babai, pasuria*

dhe jeta ime, o Resulullah!" Ata më mirë e kishin të vdisnin, sesa ta shponte një gjemb këmbën e Profetit ﷺ.

Zejd ibn Desine dhe **Hubejbi** ✓, të cilët ishin zënë rob nga idhujtarët, po torturoheshin dhe do të martirizoheshin. Para se të dorëzonin shpirtin, secili prej tyre u pyetën:

"A do të dëshiroje të ishte Profeti në vendin tënd, me kusht që të shpëtoje jetën tënde?"

Të dy ata e panë me dhembshuri këtë idhujtar, që ua bënte këtë pyetje fatkeqe dhe iu përgjigjën:


"Jo vetëm që nuk do të doja që Profeti im të ishte këtu, e unë pranë familjes sime, por nuk do isha i qetë edhe sikur në këmbën e tij të ngulej një gjemb tani atje në Medinë."

I shtangur nga kjo tablo dashurie e pashoqe, Ebu Sufjani tha:

"Çudi! Unë s'kam parë në botë ndonjë popull që e do udhëheqësin më shumë sesa e duan sahabët Muhamedin!" (Vakidi, I, 360 - 362.; Ibni Sa'd, II, 56.)

Ebu Talha †, ishte një shigjetar i aftë, që e tërhiqte fort harkun dhe qëllonte aty ku synonte. Ditën e Uhudit, i ishin thyer tre harqe. Ndërsa i Dërguari i Zotit ﷺ, kujt do që i kalonte pranë me çantë me shigjeta, i thoshte:

"Zbraze çantën me shigjeta pranë Ebu Talhas!"



Uhud - Medinë

Profeti ﷺ, ka thënë:

"Përveç të pabindurve nga njerëzit dhe xhinët, gjithçka që ndodhet mes Tokës e qiejve, e di se unë jam i Dërguari i Allahut." (Ahmedi, III, 310.)

Atë e njohu Uhudi, e njohu edhe trugu i hurmës, i cili rënkoj nga malli. Madje edhe kafshët kërkuan ndihmë prej tij dhe i qanë hallet e tyre... Mirëpo, Ebu Xhehli dhe të ngjashmit me të, si dje ashtu edhe sot nuk e njohën atë...

Sapo Resulullahu ﷺ, ngrinte kokën për të parë idhujtarët, Ebu Talha t , i thoshte:

“O Resulullah! Të qofshin falë nëna dhe babai im! Mos e ngrini kokën, se mos ju godet ndonjë shigjetë e idhujtarëve. Le të jetë kraharori im mburojë për kraharorin tënd dhe le të më prekë mua ajo që mund t’ju prekë juve!” (Buhari, Megazi, 18.)

Kur përfundoi beteja e Uhudit, Resulullahu ﷺ, donte të dinte se në ç’gjendje ishte Sa’d ibn Rebiu t . Prandaj ai dërgoi një nga sahabët për ta kërkuar. Mirëpo, sado që sahabi e kërkoj Sa’din, nuk arriti ta gjente dhe sado që e kishte thërritur, nuk arriti të merrte asnjë përgjigje. Më pas, me një shpresë të fundit, u drejtua nga sahabët e plagosur dhe dëshmorë, e thirri:

“O Sa’d! Më ka dërguar Resulullahu ﷺ. Më kërkoi që ta njoftoj nëse je në mes të gjallëve apo dëshmorëve!”

Në ato çaste, Sa’di t , që po kalonte momentet e fundit të jetës së tij dhe që nuk kishte fuqi të kthente përgjigje, kur dëgjoi se i Dërguari i Allahut ishte interesuar për të, mbledhi të gjithë fuqinë dhe me një zë të topitur tha:

“Tashmë unë jam në mesin e të vdekurve!”

Sahabiu nxitoi pranë Sa’dit



***Ti je mbreti zemrave
na solle Kuranin
shpirtin e trupin për ty
o Resulullah e falim...***

[Junus Emre]

t, trupi i të cilit ishte bërë vrima - vrima nga goditjet e shpatave. Me një zë të ulët, ai e shprehu kështu dashurinë e pashoqe që kishte për Resulullahun ﷺ:

“Pasha Allahun, nëse për aq kohë sa ju lëvizin qepallat, nuk e mbroni Profetin tonë të dashur nga armiqtë dhe lejoni t’i ndodh ndonjë gjë e keqe, ta dini se nuk do të keni justifikim para Allahut!” (Muvatta, Xhihad, 41.; Hakim, III, 221/4906; Ibni Hisham, III, 47.)

Kënaqësia më e madhe për sahabët ishte të donin atë që donte Profeti ﷺ, sepse treguesi më i qartë i dashurisë, është t’i ngjash atij që do dhe të duash atë që ai do.

Enesi t, tregon:

“Një rrobaqepës, ftoi për darkë Resulullahun ﷺ. Bashkë me të shkova edhe unë. (I zoti i shtëpisë) solli bukë elbi, një supë me kungull dhe kadid (mish të tharë). Unë vura re se Profeti ﷺ, zgjidhte kungujt në supë dhe i hante. Prandaj, që prej asaj dite edhe mua më pëlqen kungulli.” (Buhari, Et’ime 33, Buju’, 30; Muslimi, Eshribe, 144; Muvatta’, Nikah, 51.)

Kur ndërroi jetë Resulullahu ﷺ, sahabët e hidhëruar jashtë mase, ishin bërë si qirinjtë që shkrihen nga zjarri. Atë ditë zemrat e tyre po digjeshin nga malli për shkak të ndarjes nga i Dërguari i Allahut. Në një moment Omeri t, doli nga vetja, ndërsa Ebu Bekri t, vuajti shumë derisa i qetësoi njerëzit. Kjo sepse zemrat që nuk mund të duronin as edhe një ditë ndarjen prej tij, tashmë nuk do ta shihnin më atë në këtë botë të përkohshme. Dhe pikërisht për këtë shkak, Abdullah ibn



“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.”

(Teube, 128.)

Urve ibn Mes'ud, i cili kishte ardhur si përfaqësues i mekasve në Marrëveshjen e Hudejbijes, i ndoqi sahabët me bisht të syrit dhe, kur u kthye në Mekë, tha:

“O populli im, dëgjoni mirë! Pasha Allahun, unë kam dalë para shumë mbretërve. Kam qenë tek Kisra, tek Kajseri, tek Nexhashiu... Por, respektin dhe dashurinë që kishin myslimanët për Muhamedin, nuk ma ka zënë syri gjëkund... Nëse urdhëronte diçka, ata nxitonin të gjithë përnjëherësh. Nëse merrte abdes, ata garonin me njëri-tjetrin për të kapur prej ujit të abdesit. Nëse fliste diçka, ata menjëherë ulnin zërin. Për shkak të respektit që kishin për të, ata nuk e shikonin as në fytyrë, por ulnin kokën poshtë dhe e dëgjonin. Nëse i binte ndonjë qime floku, ata menjëherë e merrnin dhe e ruanin. Ky njeri, po ju bën një ofertë të arsyeshme, pranojeni!” (Shih. Buhari, Shurut, 15; Ahmed, IV, 323 - 324.)

Të njëjtën të vërtetë, janë detyruar ta pohojnë edhe shumë dijetarë jomyslimanë. Njëri prej tyre, shkrimtari perëndimor, Thomas Carlyle thotë:

“Asnjë perandor me kurorë në kokë, nuk ka parë më shumë respekt sesa Muhamedi, i cili vishte rroba të arnuara me dorën e vet.”

Zejdi **t**, i cili nuk arriti ta duronte dot këtë ndarje dhe mall, i hapi duart drejt Allahut me një zemër të hidhëruar dhe tha:

“O Zot! Tani merrma shikimin! S’dua të shoh gjë tjetër në këtë botë, pas Profetit tim që e desha aq shumë!..”

Pas kësaj lutjeje të sinqertë dhe përmes lotëve që s’reshtnin, atij iu mor shikimi përnjëherë. (Kurtubi, el- Xhami V, 271.)

Ata e plotësuan jetën e tyre me mallin dhe ëndrrën për ditët kur do të jenë sërish me të Dërguarin e Allahut **r** dhe do ta shohin përsëri atë. Në ëndrrat e tyre, ata ishin gjithnjë me të. Kështu, **Enes ibn Maliku t**, i cili i shërbeu Profetit **r**, ishte vetëm nëntëmbëdhjetë a njëzet vjeç kur ai ndërroi jetë. Në sajë të lutjes së Profetit **r**, ai u begatua me pasuri, fëmijë dhe jetë të gjatë mbi njëqind vjeç. Ky sahab i nderuar, thoshte:

*“S’ka natë që nuk e shoh në ëndërr të Dërguarin e Allahut **r**.” - më pas qante. (Ibni Sa’d, VII, 20.)*

Dashuria e brezave të mëvonshëm

Kjo dashuri kaq entuziaste ndaj Profetit **r**, ka vazhduar deri në ditët tona pa u pakësuar fare. Duke aluduar në këtë fakt, Resulullahu **r**, ka thënë:

“Një pjesë e atyre që më duan më shumë nga Umeti im, do të dalin prej atyre që do të vijnë pas meje. Ata sakrifikojnë me gjithë shpirt edhe pasurinë, edhe familjen e tyre për të më parë mua.” (Muslimi, Xhenet, 12; Hakimi, IV, 95.)



Resulullahu **r, ka thënë:**

“Sa jam gjallë, është në të mirën tuaj: Ju bisedoni me mua dhe unë bisedoj me ju! Edhe vdekja ime është mirësi për ju: Veprat tuaja më prezantohen mua. Kur shoh punët tuaja të mira, unë falënderoj Allahun për këtë. Por kur shoh punët tuaja të këqija, unë i kërkoj Allahut që t’ju falë.”

(Hejthemi, IX, 24.)



Abdulhamid Hani II. e ndërtoi hekurudhën e Hixhazit, që myslimanët e botës të arrinin më lehtë në Haramajn¹. Me qëllim që kjo linjë hekurudhore të ishte në përputhje me traditën profetike, ai urdhëroi që vendet ku Profeti ﷺ, kishte pushuar gjatë udhëtimeve të tij, të bëheshin stacione. Kësisoj, edhe hekurudhën e çoi në Medinë brenda një rrjedhe dashurie për Profetin ﷺ.

1. Haramajn: Dy xhamitë e shenjta, Qabeja dhe Mesxhidi Nebevi

Kur ndërtimi i hekurudhës Stamboll - Hixhaz iu afrua Medinës, Abdulhamid Hani II, urdhëroi:

“Nëse është e mundur, mbështillni me shajak të gjitha veglat, me qëllim që të mos bëhet shumë zhurmë, e të mos shqetësohen shpirtrat e Ehl-i Bejtit dhe të atyre

që prehen aty!”

Po sipas këtij urdhri, shinat e trenit janë veshur me shajak disa kilometra pa hyrë në Medinë. Për rrjedhojë, me qëllim që të mos cenonin përshpirtshmërinë që karakterizonte Ravzai Tahire-në, trenat e ulnin shpejtësinë dhe hynin në qytet pa zhurmë.

BINDJA NDAJ URDHRAVE TË ALLAHUT DHE TË DËRGUARIT TË TIJ

Për një të ri, i cili dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﷺ, e ka vënë në boshtin e jetës së vet, rruga e vetme është të bëjë një jetë në përputhje me urdhrat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ.

Asnjëherë nuk duhet harruar se njeriun e ka krijuar Allahu i Madhëruar. Për këtë arsye, vetëm Ai e di edhe rrugën më të bukur që do t'i sigurojë robit një jetë të begatë, në paqe dhe lumturi. Ashtu si një aparat, i cili për të punuar pa probleme dhe

Ishin ditët më të vështira të Luftës së Çanakalesë. Ushtria e armikut kishte filluar sulmin me armët dhe municionet më të përparuara që kishin. Atëkohë, shteti Osman ishte në aleancë me Gjermaninë. Një nga oficerët gjerman, Liman Von Sanders, tregon kështu në një nga kujtimet e tij të atyre ditëve:

Në momentet më të tmerrshme të sulmit armik, afërsisht pesëmbëdhjetë metra larg nga ku ndodheshim, papritur vjen një zë i tmerrshëm. Bashkë me zërin, një ushtar turk fluturon jashtë llogores dhe nis të vrapojë drejt armikut. Ai vraponte dhe i lëvizte duart djathtas e majtas, duke thirrur me zë të lartë. Pyeta përkthyesin që kisha pranë:

“Çfarë po thotë ushtari që po vrapon?”

“Po thërret: **«Eja o Muhamed, po ikën nga duart Libri yt!»**”

Një ndodhi të tillë, nuk kish parë historia! Edhe ushtarët e tjerë që e panë dolën nga llogoret dhe, në ato çaste nisi një luftë e ashpër. Pas një kohe të shkurtër, prej trupave angleze që kishin dalë në tokë, kishin mbetur vetëm kufoma.¹

1. Tahsin Yıldırım - Mehmet Kuzu, *Osmanlı'nın Peygamber Aşkı*, İstanbul 2007, f. 126.

në mënyrën më frytdhënëse, varet nga zbatimi i saktë i manualit të përdorimit që është përgatitur nga ai që e ka ndërtuar, ashtu edhe për njeriun vlen e njëjta gjë. Pra, nëse njeriu dëshiron të bëjë një jetë të qetë, ai duhet të respektojë rregullat që ka vendosur Allahu.

Ai që jeton me bindje ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, bëhet njeriu më i lumtur i kësaj bote dhe i tjetrës, duke përfituar shumë mirësi materiale dhe shpirtërore.

Një nga sahabët fisnikë, Theubani **ؓ**, një ditë shkon tek Profeti dhe i thotë:

“O i Dërguar i Allahut! Ju jeni më i dashur për mua se jeta ime, familja dhe fëmijët e mi. Kur ndodhem në shtëpi dhe më kujtoheni, nuk duroj dot dhe menjëherë vij të shoh fytyrën tuaj të bekuar. Ndërsa kur mendoj se një ditë, edhe unë, edhe ju do të vdesim, mbytem nga një pikëllim i papërshtatshëm. E di, se kur të hyni në Xhenet, do të ngriheni në një shkallë të lartë, bashkë me profetët e tjerë. Kurse unë, edhe sikur të hyj në Xhenet, kam frikë se nuk do të arrij t’ju shoh atje”.

I Dërguari i Allahut ﷺ, nuk i dha asnjë përgjigje. Por pak më vonë, erdhi Xhebraili dhe shpalli këtë ajet:



“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqerët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!” (Nisa, 69.) (Uahidi, f. 170.)

*O lajmëtari, shpëtimtari, zotëria, profeti im!
Çfarë nuk përshtatet me ty, edhe jetë qoftë i vë shkelmin!*

[Nexhip Fazëll]

A mund të mendohet ndonjë shpërblim më i madh se ky? Resulullahu ﷺ, lajmëron në këtë mënyrë:

“Zoti juaj i Madhëruar urdhëron:

«Sikur robërit e Mi të më bindeshin ashtu siç duhet, Unë edhe shiu do ta lëshoja natën, e ditën do të lindja Diellin mbi ta. Madje, do të bëja që të mos e dëgjojnë as zërin e bubullimës!»...” (Ahmed, II, 359; Hakim, IV, 285/7657.)

Pra, nëse njeriu i kthehet Zotit të vet me një vetëdije serioze fetare dhe e adhuron Atë me sinqeritet, ai do të gëzojë ndihmën hyjnore në çdo çështje dhe Allahu i Madhëruar do t'i vërë të gjitha krijesat në shërbim të tij.

Shembujt më të bukur të bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, i kanë shfaqur sahabët e nderuar. Bashkëshortja e Abdullah ibn Reuaha ؓ, tregon:

“Resulullahu ﷺ, kishte dalë në hutbe. Ndërkohë Abdullahu ؓ, që po vinte drejt Mesxhidit, dëgjoi nga larg që i Dërguari i Allahut po thoshte: “Uluni!”. Megjithëse Abdullahu nuk kishte mbërritur ende në Mesxhid, ai u ul menjëherë aty ku ishte. Më pas, kur Profeti ﷺ, e mësoi këtë, i tha Abdullahut:

«Allahu i Madhëruar ta shtoftë dëshirën për bindje ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij!»” (Ali el-Muttaki, Kenzu'l-Ummal, XIII, 450/37171; Hajthemi, IX, 316.)

Siç tregon Aishja ؓ, kur u shpallën ajetet³⁴ që urdhëronin mbulesën për femra, gratë myslimane, pa pritur të shkonin në shtëpi, i prenë pjesët e tepërta



***“O besimtarë!
Binduni Allahut
dhe të Dërguarit
kur ju thërret drejt
asaj që ju jep jetë!
Dhe ta dini se
Allahu ndërhy
midis njeriut
dhe zemrës së tij
dhe se tek Ai do
të mblidheni të
gjithë!”***

(Enfal. 24.)

34. En- Nur, 30 - 31.

të rrobave që kishin veshur dhe me to mbuluan kokën dhe kraharorin.
(Buhari, Tefsir, 24/12; Ebu Davud, Libas, 31 - 33/ 4102.)

Sjellja pasive në bindjen ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ, i sjell njeriut humbje të mëdha. Një herë, Resulullahu ﷺ, dërgoi një grup sahabësh për ekspeditë që në mëngjes herët. Njëri prej tyre mbeti pas dhe familjes së vet i tha:

“Unë mbeta pas me qëllim që ta fal namazin e drekës bashkë me të Dërguarin e Allahut, ta përshëndes dhe të ndahem me të. Po ashtu dëshiroj që ai të bëjë edhe dua për mua, që ajo të jetë ndërmjetësuasi im Ditën e Kiametit!


Pasi fali namazin me Profetin, ai iu drejtua atij dhe e përshëndeti. I Dërguari i Allahut ﷺ, i tha:

“A e di se sa të kanë kaluar shokët?”

Sahabiu iu përgjigj:

“Po, më kanë kaluar aq sa distanca e një udhëtimi prej në mëngjes herët!”

Atëherë, Resulullahu ﷺ, i tha:



Sipas transmetimit të Safije binti Shejbe C, kur u shpallën ajetet lidhur me mbulesën e femrës, burrat u kthyen në

shtëpi dhe ua lexuan këto ajete grave, vajzave, motrave dhe të gjithë të afërmve të tyre. Kësisoj, të gjitha gratë i prenë veshjet e tyre, madje edhe ato më të çmuarat dhe i bënë mbulesë për kokën, duke u mbuluar mirë nga koka te këmbët. Kështu, ato treguan sesi i zbatonin menjëherë urdhrat e Allahut të Madhëruar dhe sesi i bindeshin Atij dhe të Dërguarit të Tij ﷺ. Në namazin e sabahut, ato u lidhën në safu pas Resulullahut ﷺ, të mbuluara nga koka te këmbët. (Ibni Kethir, Tefsir, [Nur, 31.]

"Betohem në Atë që ka shpirtin tim në duar, se ata ta kanë kaluar ty në virtyte aq sa distanca mes lindjes dhe perëndimit." (Ahmed, III, 438.)

Sipas një transmetimi tjetër, Profeti ﷺ, ka kthyer këtë përgjigje:

"Sikur të dhurosh gjithçka ka mbi Tokë, nuk mund të arrish virtytin që kanë arritur ata duke dalë që në mëngjes herët." (Tirmidhiu, Xhuma, 28/527; Ahmed, I, 256; Bejhaki, III, 187.)

Një nga të rinjtë që i shërbenin Profetit ﷺ, Ebu Rafiu رضي الله عنه, tregon:

Në betejën e Hendekut, ishte pjekur një dele për Resulullahun ﷺ dhe i ishte shërbyer atij. I Dërguari i Allahut ﷺ, pëlqente pjesën e shpatullës së deles. Prandaj më tha:

"Ebu Rafi, më jep pjesën e shpatullës!"

Unë ia dhashë atë që kërkoi. Më pas Profeti kërkoi sërish duke thënë:



Profeti ﷺ, shkoi tek dy grupe prej fisit Eslem, të cilët po garonin në hedhjen e shigjetës dhe u tha:

"Hidhni shigjeta, o bijtë e Ismailit! Vërtet, babai juaj ishte një shigjetar i zoti. Në këtë garë unë jam me këtë grup.", duke u bërë kështu tifoz me njërin grup. Kur grupi kundërshtar dëgjoi këto fjalë të Profetit ﷺ, hoqën dorë nga hedhja e shigjetave. Për këtë arsye, Resulullahu ﷺ, u tha:

"Çfarë keni që nuk po gjuani?"

"O Resulullah! Si mund të gjuajmë me shigjeta, kur ju jeni me grupin tjetër?" - thanë ata.

Resulullahu ﷺ, tha:

"Hajde gjuani tani, sepse unë jam me të gjithë ju!" (Buhari, Enbija, 12.)



“O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm.”

(Huxhurat, 1.)

“Jepma pjesën e shpatullës, Ebu Rafi!

Unë ia dhashë edhe shpatullën tjetër të deles. Ndërkohë që i Dërguari i Allahut ﷺ, mishin po ia shërbente sahabëve. Kur më tha për së treti:

“Ebu Rafi, jepma pjesën e shpatullës!”, atëherë i thashë:

“O Resulullah! A nuk ka vetëm dy shpatulla një dele?”

Pas kësaj, Resulullahu ﷺ, më tha:

“Nëse s’do kishe folur, ti do të vazhdoje të nxirrje nga tenxherja dhe do më jepje sa herë që unë do të kërkjoja pjesë shpatulle! (Shih, Ahmed, VI, 8; Darimi, Mukaddime, 7/45; Hajthemi, VIII, 311.)

Nga kjo kuptojmë se ne duhet t’i bindemi tekstualisht dhe me dorëzim të plotë urdhrave të Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ. Parimin kryesor të kësaj çështjeje, **Nexhip Fazëll** e ka shprehur në këtë mënyrë:

Mos thuaj kam sy, mendje e ide, vriti të gjitha tani!

Nëse ai thotë është liqen ajo që të duket shkretëtirë, liqen është ai!

Është e qartë se ata që e kalojnë kohën, e cila është gjëja më e çmuar e tyre, larg bindjes dhe adhurimit ndaj Allahut, do të pendohen shumë në botën tjetër. **Omeri** ؓ, e shpreh kështu këtë fakt gjatë fjalimit të ngushëllimit, të cilin e mbajti i përlotur pas vdekjes së Profetit ﷺ:

“...Të qofshin falë nëna dhe babai im, o Resulullah! Ti ke një gradë kaq të lartë tek Allahu, saqë kur banorët

e Xhehenemit të jenë duke vuajtur, do dëshirojnë shumë të të ishin të bindur në jetën e dynjasë. Aq sa me një vajtim të tmerrshëm do të thonë:

«**Mjerë ne! Ah sikur t'i ishim bindur Allahut dhe Profetit!**» (Ahzab, 66.)” (Gazali, Ihja, I, 410 - 411.)

TË ZGJEDHËSH AHIRETIN NË VEND TË DYNJASË

Padyshim që njeriu, është një udhëtar i përkohshëm i udhëtimit drejt ahiretit. Mohimi i kësaj, është po aq e palogjikshme, sa edhe të mbyllësh sytë e të thuash: “Dielli nuk ekziston!”. Prandaj, ndërtimi i jetës në bazë të kësaj të vërtete, është një detyrim logjik dhe moral.



Ibn-i Mina tregon:

Shkova në varreza i veshur me një rrobë të hollë. Mirëpo moti u ftoh shumë dhe unë u strehova në qoshen e një varri. Fala dy rekat namaz aty dhe u shtriva në brinjë mbi varr.

Pasha Allahun, ndërkohë që isha zgjuar dëgjova një zë prej varrit:

“Ngrihu nga varri im! Ju mund të bëni akoma vepra, por nuk e dini gjendjen e varreve. Ne përfunduam jetën e dynjasë dhe filluam jetën e varrit. Këtu pamë dhe kuptuam gjithë të vërtetën! E kuptuam mjaft mirë sesa e vyer është vepra e sinqertë në dynja. Mirëpo, tashmë nuk na ka mbetur asnjë mundësi të bëjmë vepra të mira. Për Allahun, sikur të kisha mundësi të falja këto dy rekate namaz që i fale ti, do të ishte më e vyer dhe më e dashur për mua se e gjithë bota dhe gjithçka në të!”

(Bejhaki, Delail, VII, 40 - 41.)

“Kush sheh fundin e punës që në fillim të saj, bëhet më i lumtur dhe më fatlum. Njerëz të tillë i përkushtohen më shumë punës, mbjellin më shumë dhe në fund mbledhin fruta me tepriçë, sepse ata e dinë se kjo botë e të mbjellave, është krijuar si përgatitje për botën tjetër, ndërsa bota tjetër është krijuar për të korrur dhe mbledhur të mbjellat e dynjasë.”

(Rumi)

Nuk duhet harruar kurrë se përkrah punës së nevojshme për jetën në këtë botë, myslimani duhet të përgatitet edhe për jetën në botën e përtejme, sepse jeta e kësaj bote, nuk është dhuruar vetëm që të shijohen kënaqësitë dhe dëshirat kalimtare të egos. Përkundrazi, ajo është një afat kohor që është dhuruar për të mbledhur furnizimin për botën tjetër, për të bërë vepra të mira dhe për të lënë pas vepra, shpërblimi i të cilave nuk shteron as pas vdekjes (sadaka-i xharije). Prandaj, miqtë e Allahut kanë thënë:

“Sado të vuash për një lumturi të përjetshme, tekefundit vuajtja ikën dhe lumturia mbetet. Mirëpo, nëse bën gjynah për kënaqësitë e përkohshme, në fund kënaqësia ikën dhe ty të mbetet vetëm pendesa, ndëshkimi dhe vuajtja.”

Të zgjedhësh ahiretin, nuk do të thotë të shpërfillësh këtë botë. Kjo gjë ka të bëjë më shumë me rregullimin e qëllimit në zemër. Për rrjedhojë, nëse njeriu e rregullon jetën sipas pëlqimit të Allahut dhe punon me qëllimin që ta fitojë riskun e tij prej hallalli e të bëjë vepra të mira, atëherë çdo hap që hedh dhe çdo punë që bën, vlerësohet si adhurim.

Omeri t, tregon:

“Një ditë shkova tek Profeti ﷺ dhe vura re se ai ishte shtrirë mbi një rrogoz, i cili kishte lënë gjurmë në trupin e tij. Nuk kishte as dyshek që ta shtronte poshtë. Ai kishte edhe një jastëk lëkure të mbushur me fije hurmash...”

Kur pashë që Profeti



Γ, po buzëqeshte, u ula menjëherë pranë tij dhe pashë dhomën përreth. Pasha Allahun, aty nuk kishte asgjë me vlerë përveç tri lëkurave që prisnin të përpunoheshin. Nuk durova dot dhe i thashë:

«O Resulullah! Lutuni Allahut, që Ai t'i falë pasuri Umetit tuaj, sepse romakëve dhe persëve u ka dhënë pasuri dhe mirësi të kësaj bote, edhe pse ata nuk e adhurojnë fare Atë!»

Resulullahu Γ, u drejtua nga vendi ku ishte mbështetur dhe tha:

“O biri i Hattabit, a ke dyshim (lidhur me premtimin hyjnor për botën tjetër)?! Ata janë njerëz, të cilëve u është dhënë direkt në jetën e kësaj bote.”

Pas kësaj, i thashë:

“O Resulullah kërko falje për mua (tek Allahu)!” (Buhari, Medhalim, 25.)

Sërish një ditë tjetër, Resulullahu Γ, lidhur me këtë çështje ka thënë:

“E ç'më duhet kjo botë! Shembulli im lidhur me këtë botë është si ai i udhëtarit që udhëton një ditë vere, pushon nën hijen e një peme dhe më pas ngrihet e vazhdon rrugën.”

(Tirmidhi, Zuhd, 44/2377; Ibni Maxhe, Zuhd, 3; Ahmed, I, 301.)

Shumë njerëz tregohen tepër të dhënë pas posteve, pozitive dhe prestigjeve në këtë botë dhe, për t'i mbrojtur ato, neglizhojnë edhe botën tjetër. Mirëpo, një mysliman duhet të durojë çdolloj vuajtje të kësaj bote për ahiretin e tij dhe nuk duhet të marrë përsipër të vuajë në ahiret për hir të kësaj bote.



“Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t'u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes.”

(Naziat, 46.)

Abdullah ibni Mes'ud
ؓ , u thoshte kështu
miquë të vet:

**"Ju falni më shumë
namaz se sahabët dhe
përpiqeni më shumë se
ata. Mirëpo, ata ishin
më të virtytshëm se ju."**

**"Me çfarë u bënë më
të virtytshëm se ne?"-
pyetën ata.**

**"Ata ishin më asketë se
ju ndaj kësaj bote dhe
më të dhënë ndaj botës
tjetër!"**

(Ibni Xheuzi, *Sifatus-Safve*, I,
420.)



Në porosinë e tij të fundit ndaj besimtarëve para se të ndërronte jetë, Resulullahu ﷺ , lidhur me këtë çështje ka thënë:

"O njerëz! Kushdo që ka një hak (të dikujt) mbi supe, le ta shlyejë menjëherë atë dhe të të mos thotë, se po turpërohet në këtë botë! Dijeni mirë, se turpërimi në këtë botë, është shumë më i lehtë në krahasim me turpërimin në botën tjetër!" (Shih. Ibni Sa'd, II, 255; Taberi, Tarih, III, 191.)

Pasi dëgjuan këto fjalë të Profetit ﷺ , një pjesë e njerëzve rrëfyan disa padrejtësi dhe gabime që kishin bërë më parë dhe iu lutën atij që të kërkonte falje për ta (tek Allahu). Njëri prej tyre u ngrit në këmbë dhe tha:

"Pasha Allahun o Resulullah, unë jam shumë gënjeshtar dhe hipokrit. Nuk kam lënë gjë të keqe pa bërë!"

Omeri ؓ , i thotë:

"O njeri e turpërovet veten!" Mirëpo, Resulullahu ﷺ , i tha:

"O Omer! Turpi në këtë botë, nuk është asgjë në krahasim me turpin në botën tjetër!" Më pas u lut kështu për këtë njeri:

"O Allah! Fali atij drejtësi në fjalë dhe pjekuri besimi! E veprat e tij të këqija, shndërroja në mirësi!" (Taberi, Tarih, III, 190.)

Ja një shembull shumë domethënës, i cili tregon sesa rrezik i madh është neglizhimi i ahiretit dhe animi nga pasuria dhe pozitat e kësaj bote:

Në periudhën Emevite, ushtria Islame kishte nisur udhëtimin me shpresën për të merituar përgëzimin profetik lidhur me ngadhënjimin e Kostandinopojës. Në këtë ushtri gjendej edhe **Ebu Ejjub el-Ensari** **ؓ**. Ndërkohë që bizantinët po luftonin me kështjellën e qytetit pas shpine, një person prej ensarëve, u fut me kalë deri në mes të bizantinëve. Besimtarët që e panë, duke u nisur nga ajeti **“Mos e hidhni veten tuaj në rrezik!”**, e kritikuan sahabin duke thënë:

“La ilahe il-lallah! Po e hedh veten në rrezik!”

Kurse Ebu Ejjub el-Ensari **ؓ**, tha kështu:

“O besimtarë! (Mos të keqkuptohem!) Ky ajet ka zbritur lidhur me ne ensarët. Kur Allahu e ndihmoi Profetin dhe i dha triumf fesë së tij, ne thamë: «Tashmë të qëndrojmë pranë pronës sonë dhe të merremi me përmirësimin e saj!» Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar i pati shpallur këtë ajet të Dërguarit të Tij: **“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”**³⁵ Qëllimi i shprehjes, *“mos e çoni veten tuaj në shkatërrim”* që përmendet në këtë ajet, ishte për shkak se ne ishim mënjeluar dhe kishim lënë përpjekjen për rrugën e Allahut, duke u angazhuar me punët e kësaj bote, si vreshtat dhe kopshtet.” (Shih. Ebu Davud, Xhihad, 22/2512; Tirmidhiu, Tefsir, 2/2972.)



“Nëse dynjaja do të kishte vlerë sa një krah i mushkonjës për Allahun, Ai nuk do ta lejonte asnjë mohues të pinte qoftë edhe një gllënjë ujë.”

(Tirmidhi, Zuhd, 13.)

“Kujtojeni shpesh vdekjen, e cila shkul nga rrënjët të gjitha kënaqësitë!”

(Tirmidhi, Kiamet, 26.)

35. El-Bekara, 195.



“Kush dëshiron botën tjetër, Allahu e vendos pasurinë në zemrën e tij dhe ia bën mbarë punët. Tashmë, dynjaja i vjen pas e përulur. Por, kush synon këtë botë, Allahu e vendos varfërinë mes dy syve të tij dhe ia ngatërron punët. Si përfundim, prej kësaj bote nuk i mbetet më tepër sesa i është caktuar.”

(Tirmidhiu, Kijamet, 30/2465.)

Një nga princat (shehzade) e pafat të historisë Osmane, Xhem Sulltani, si rezultat i betejës për fronin, kishte rënë rob i Urdhrit të Kalorësve të Rodosit, të cilët e shitën atë tek Papa. Papa Innocent VIII, i premtoi se, nëse do të

bëhej i krishterë, do ta ndihmonte të merrte fronin e Perandorisë Osmane. Ky propozim i erdhi shumë i rëndë Xhem Sulltanit, i cili i mërzitur tha:

“Jo fronin Osman, por edhe gjithë botën të ma jepni, nuk e ndërroj fenë time!..”

Kur e kuptoi se do përdorej nga kryqtarët kundër myslimanëve, iu drejtua Allahut dhe u përgjërua duke thënë:

“O Zot! Nëse duan të më bëjnë vegël kundër myslimanëve, mos e lërë të jetojë më robin Tënd! Merrma shpirtin sa më parë pranë Teje!..”

Eliksiri i të riut mysliman: NAMAZI

Të gjithë krijesat në gjithësi, Dielli, Hëna, yjet, livadhet, barërat, pemët etj., janë gjithnjë duke përmendur Allahun e Madhëruar. Shpendët që fluturojnë tufa-tufa në qiell, malet, e shkëmbinjtë e madhërojnë Allahun në një formë të panjohur për ne. Adhurimi i bimëve bëhet në këmbë (kijam); ai i kafshëve bëhet gjysmëpërkulur (ruku); kurse ai i krijesave jofrymore bëhet i puqur me tokën, pra në sexhde. Edhe gjendja e krijesave të qiejve

Të bëhesh mbret i zemrave

Një ditë, padishahu i Telemsanit, Sulltan Jahja, kishte dalë të shëtiste qytetin me oborrtarët. Populli, të cilit po i shkëlqenin sytë përballë madhësisë së tij dhe të atyre që kishte përreth, u ngrit në këmbë nga frika dhe po e nderonte duke brohoritur: “Rroftë Padishahu!” Mirëpo, më shumë se masa, padishahut i tërhoqi vëmendjen një njeri që rrinte tutje i shkëputur nga masa, indiferent ndaj madhësisë së sulltanit, i dëlirë prej botës dhe që vezullonte dritë përreth vetes. Kur pyeti se kush ishte ai njeri me fytyrë të ndritur, i thanë:

“Madhëri, ai është Shejhu i njohur tunizian, i cili jeton si asket në një shpellë.”

Sulltanin e kap një kureshtje edhe më e madhe dhe, pasi e drejton kalin nga Shejhu tunizian e pyeti:

“A është e lejuar të fal namaz me këtë rrobë të mëndafshtë që kam veshur?”

Edhe pse Shejhu tunizian refuzoi të përgjigjej dhe e këshilloi të pyeste dijetarët e sarajit të vet, pas këmbënguljes së sulltanit, ai u përgjigj:

“Mendon një qen, i cili ka gjetur një kafshë të ngordhur dhe e ka ngrënë atë sa ka plasur, duke u bërë pis jashtë e brenda. E më pas, tregohet i kujdesshëm për të mos u ndotur, duke ngritur këmbën gjatë urinimit!..”

Sulltani nevríkose dhe thotë:

“Çfarë do të thuash me këtë?!”



Shejhu i tha:

“Dua të them se, stomaku dhe trupi juaj janë të ngarkuar me peshat më të mëdha të haramit dhe me padrejtësi ndaj njerëzve. Ndërkohë, ju me pyesni nëse është e lejuar apo e ndaluar të fal namaz me veshje të mëndafshta?!”

Këto fjalë të urta, ndikuan thellë tek Sulltani. Në sajë të begatisë së këtij ndikimi, ai i flaku menjëherë rrobat e bukura që kishte veshur. Pastaj, hodhi në një anë shpatën që kishte në mes dhe tha:

“Myslimanë! Bëmani hallall dhe gjeni tjetër sulltan për veten tuaj!”

Pasi tha këto, ai shkoi pas Shejhut tunizian dhe u bë nxënësi i tij besnik.

Sulltan Jahja, arriti në një gradë aq të lartë në edukimin shpirtëror pranë Shejhut, sa që kur populli i kërkonte të lutej për ta, Shejhu tunizian u thoshte:

“Kërkojeni lutjen nga Jahja, sepse po të isha unë në vendin e tij, nuk mund ta bëja atë që ka bërë ai... Nëse sulltanët do ta dinin thesarin e lumturisë që ka arritur ai, edhe ata do të sakrifikon gjithçka të tyre si Jahja.”

Po ashtu edhe Ibrahim ibn Ed’hemi, i cili la fronin e kësaj bote dhe arriti fronin shpirtëror, ka thënë:

“Nëse pasioni dhe përkushtimi ynë në dashurinë hyjnore do të ishte diçka konkrete; mbretërit do të flijonin të gjithë pasurinë dhe fronin e tyre për ta përvetësuar atë.”

është e tillë. Një pjesë e melekëve bëjnë tesbih dhe tehlil në kijam, një pjesë në ruku dhe një pjesë në sexhde.

Kurse namazi, të cilin Allahu ua ka dhuruar besimtarëve si një miraxh, i përfshin të gjitha adhurimet. Prandaj, një besimtar që fal namazin, konsiderohet se ka kryer të gjitha adhurimet që bëjnë të gjitha krijesat në qiej e Tokë dhe, për këtë arsye arrin shpërblime të pafundme.

Ndër të gjitha gjallesat, Allahu i Madhëruar e ka përshtatur më mirë fizikun e njeriut për sexhde. Prandaj mes namazit dhe njeriut ekziston një lidhje mjaft e fortë.

Namazi është koha e takimit me Allahun, është si një intervistë me Të dhe, Umetit i është dhuruar si një miraxh i vogël. Nisur nga urdhri i Kuranit; **“Bëj sexhde dhe afrohu Zotit tënd!”**³⁶, mirësia e daljes para Allahut, arrihet përmes namazit.

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Namazi është drita e syve të mi” (Nesai, Ishretu’n-Nisa, 10; Ahmed, III, 128, 199.)

Namazi është shtyllë e fesë dhe dëshmues i myslimanizmit. Ai nuk krahasohet me asnjë adhurim tjetër në aspektin e shpërblimeve.

Tre vetë nga fisi Beni Udhre, shkuan tek Profeti ﷺ dhe u bënë myslimanë. **I Dërguari i Allahut** i pyeti:


“Kush do t’i mbajë si mysafirë këta?” **Talha ṭ**, tha:



“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shturja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithëka që ju bëni.”

(Ankebut, 45.)

36. El-Alak, 19.



Shkalla e namazit në këtë botë, është sikur të shohësh Allahun e Madhëruar në botën tjetër, sepse momenti kur njerëzit gjenden më afër Allahut në këtë botë, është ai i sexhdes. Po ashtu edhe kënaqësia më e madhe dhe manifestimet shpirtërore gjenden në namaz.

“Unë o Resulullah!”

Kur po banonin tek Talha, Resulullahu ﷺ, dërgoi një njësi ushtarake për ekspeditë. Njëri nga ata të tre u bë pjesë e kësaj njësie dhe ra shehid në luftë. Pas një farë kohe, i Dërguari i Allahut ﷺ,

dërgoi një tjetër njësi ushtarake për ekspeditë, ku ra shehid edhe i dyti prej tyre. Kurse i treti ndërroi jetë në shtrat, pas një periudhe kohe.

Talha ﷺ, tha:

“Këta tre persona që banuan tek unë, i pashë në ëndërr, në Xhenet. Ai që vdiq në shtrat ishte më përpara se të tjerët. Ai që kishte vdekur i dyti ishte menjëherë pas tij, kurse ai që vdiq i pari ishte i treti. U habita dhe më erdhi pak rëndë, që ai i cili vdiq në shtrat, ishte më i favorizuar sesa ata që ranë shehid. Menjëherë u nisa tek Profeti dhe ia tregova ëndrrën. Resulullahu ﷺ, më tha:

“Këtu nuk ka ndonjë gjë për t’u habitur! Nuk ka njeri më të virtytshëm sesa besimtari që bën një jetë sipas Islamit dhe nuk i heq nga goja tesbihët, tekbirët dhe tehlilët.” (Ahmed, I, 163.)

Profeti ﷺ, për t’i treguar sahabëve vlerën e të jetuarit si mysliman, dha këtë shembull:

“Ai që vdiq në shtrat, a nuk agjëroi Ramazan pasi vëllai i tij ra dëshmor? A nuk i fali brenda një viti gjashtë mijë e kusur rekatë namaz?” (Prandaj, padyshim që mes tyre do të ketë kaq dallim.) (Ahmed, II, 333.)

Ky transmetim, tregon se në aspektin e nivelit shpirtëror, namazi bën dallim të madh jo vetëm mes besimtarit dhe jobesimtarit, por edhe mes besimtarit dhe besimtarit.

Ata që nuk falin namazin

Njerëzit që janë larg namazit, bëjnë një jetë pa begati në këtë botë. Në fytyrat e tyre nuk ka më dritë prej bukurisë hyjnore. Po ashtu, këta njerëz janë të privuar edhe nga dashuria e njerëzve të dashur të Allahut. Nisur edhe nga fjala e Profetit

ﷺ: *“Do të vdisni ashtu si jetoni!”*³⁷, ata do të vuajnë shumë në frymën e fundit dhe do të japin shpirt në mënyrë të mundimshme. Ndërsa varri do t’i shtrëngojë dhe do t’u bëhet si gropë Xhehenemi. E në fund, pas një llogaridhënie shumë të ashpër, do të hidhen në Xhehenem.

Një mëngjes, Resulullahu ﷺ, u tha sahabëve:

“Këtë natë erdhën dy vetë (Xhebraili dhe Mikaili), më zgjuan dhe më thanë: «Eja të ikim!» Kështu unë ika bashkë me ta. Shkuam tek një njeri që po flinte në një krah. Ndërsa tek koka e tij qëndronte një tjetër me një gur të madh në duar dhe po ia shtypte kokën me gur atij që ishte shtrirë. Sa herë që guri rrokullisej në një anë, ai shkonte menjëherë ta merrte. E, ndërkohë që ai merrte gurin, tjetrit i rregullohej sërish koka si më parë. Më pas, ai e përsëriste nga e para veprimin, duke ia shtypur kokën me gur atij që rrinte shtrirë...

Pyeta melekët:

«Subhanallah, ç’po ndodh këtu?»

«Ta shpjegojmë!»- më thanë: «Ky është një person që e ka ditur Kurandin përmendësh dhe e ka braktisur atë. Po ashtu, ai i linte t’i kalonin namazet farz (veçanërisht namazin e sabahut) duke fjetur!»...” (Buhari, Ta’bir, 48, Xhenaiz, 93.)

Një i ri besimtar, duhet të ruhet nga kurthet e



“Vepra e parë për të cilën do të pyetet njeriu në Ditën e Kiametit, është namazi. Nëse e ka kryer me rregull namazin, punët e tjera i shkojnë mbarë dhe del i fituar. Nëse nuk e ka të rregullt namazin, atëherë do të humbasë dhe do të dalë i dëmtuar...”

(Tirmidhi, Salat, 188/413.)

37. Munavi, Fejzul-Kadir, V, 663.



shejtanit në këtë rrugë dhe duhet të nxitojë që të falë kaza namazet që ka lënë për arsye të ndryshme. Ndaj dhe në hadith thuhet:

“Kush harron ndonjë namaz, le ta falë atë kur t’i kujtohet; nuk ka mënyrë tjetër shlyerjeje përveç kësaj.”

(Muslimi, Mesaxhid, 314.)

Nëse nuk zbatohet kjo këshillë e Profetit ﷺ, borxhet e namazeve që janë bërë mal, do ta shpien robin drejt falimentimit në botën tjetër.

Pesë kohët e namazit

Secila nga pesë kohët e namazit ka vlerën dhe rëndësinë e vet. Ndarja e tyre në kohë të caktuara të ditës, ka njëmijënjë dobi dhe urtësi për njeriun, si shpirtërisht ashtu edhe fizikisht. Ndaj dhe secila prej kohëve duhet kryer me kujdes dhe përkushtim.

I Dërguari i Allahut ﷺ, lidhur me pesë kohët e namazit, e ka porositur kështu Umetin e tij:

“Allahu i Madhëruar urdhëroi:

«Umetit tënd i kam bërë obligim pesë kohët e namazit! Unë kam bërë një premtim: Kush i fal ato namaze në kohë, patjetër do ta vendos në Xhenet. Por, kush nuk i mbron ato namaze, nuk kam asnjë premtim për ta!» (Ibn Maxhe, Ikametu’s-Salah, 194.)

“Nëse një mysliman, kur vjen koha e namazit farz, merr mirë abdes, fal namazin si duhet me përkushtim, duke bërë kujdes rukutë dhe sexhdet, ai namaz i shlyen të gjitha gjynahet e mëparshme, përveç gjynaheve të mëdha. Kjo vlen për çdo kohë.” (Muslimi, Taharet, 7.)

Në hadith thuhet:

“Allahu e mëshiroftë vëllain tim Abdullah ibn Reuaha! Kudo që e zinte koha e namazit, e ndalte kafshën dhe menjëherë e falte aty namazin.”

(Hajthemi, IX, 316.)

Namazi i Xhumasë

Namazi i Xhumasë është farz për meshkujt. Zoti i Madhëruar thotë kështu:

“O besimtarë, kur të thirreni ditën e xhuma për (të falur) namazin, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju!” (Xhuma, 9.)

Nga ky ajet kuptohet se, gjatë kohës së faljes së Xhumasë, është e ndaluar të merresh me punë të tjera jashtë namazit të Xhumasë, sikurse është tregtia.

Resulullahu ﷺ, lidhur me namazin e Xhumasë ka thënë:

“Nëse një njeri merr abdes, vjen në namazin e Xhumasë dhe dëgjon hutben me qetësi, i falen të gjitha gjynahet që ka bërë që nga Xhumaja e kaluar dhe kësaj i shtohen edhe tri ditë. Kush luan me gurë, ndërkohë që dëgjon hutben, (konsiderohet se) është marrë me punë të kota dhe ka humbur mirësinë e Xhumasë.”

(Muslim, Xhuma, 27.)

“Disa njerëz ose të heqin dorë nga lënia e namazit të Xhumasë, ose Allahu i Madhëruar do t’ua vulosë zemrat dhe do të bëhen prej gafilëve.” (Muslim, Xhuma, 40.)

Përkushtimi në namaz

Të gjitha adhurimet duhen kryer me një entuziazëm të lartë shpirtëror. Në mënyrë të veçantë namazi, duhet falur me përkushtim. Në Kuran urdhërohet:



Abdullah ibn Mes’udi
ؓ, ka thënë:

“Për Allahun! Unë s’kam parë askënd prej nesh të ketë lënë namazin, përveç ndonjë dyfytërëshi që i dihet hipokrizia. Beto hem në Allah se, edhe kur dikush (i sëmurë), të jetë duke u lëkundur në këmbë mes dy njerëzve, ai sillet në namaz dhe me ndihmën e tyre mbahet në rresht.”

(Muslimi, Mesaxhid, 256 - 257.)

Gjatë një beteje, Aliu ﷓ , ishte plagosur me shigjetë në këmbë, të cilën nuk ia hoqën dot për shkak të dhimbjes së madhe. Më pas qëndroi në namaz dhe, pasi dha selam pyeti:

“Çfarë bëtë?”

“E hoqëm, o Ali!”-i thanë.

E në fakt, trupi i Aliut ﷓ , nuk kishte ndjerë gjë për shkak të përkushtimit të tij në namaz dhe kënaqësisë shpirtërore që përjetonte gjatë tij...



“Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet.” (Maun, 4-5.)

Ndërsa Profeti ﷺ , ka thënë:

“Nëse njeriu e kryen namazin në mënyrë të saktë, duke bërë siç duhet rukunë dhe sexhden, namazi i thotë atij njeriu:

«Të ruajtë Allahu, ashtu siç më ke ruajtur ti mua!» Namazi ngrihet lart (dhe pranohet). Nëse njeriu nuk e kryen saktësisht namazin, duke mos e bërë siç duhet sexhden dhe rukunë, namazi i thotë:

«Të humbtë Allahu, ashtu siç më ke humbur ti mua!» Namazi i tij mblidhet si leckë dhe i përplaset në fytyrë.” (Bejhaki, Shuab, III, 143; Sujuti, Xhami, I, 58/364.)

Përkushtimi në namaz është shumë i rëndësishëm, sepse rruga e robit drejt shpëtimit kalon përmes kësaj dere. Në Kuran urdhërohet:

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlulur në namazin e tyre.”

(Mu’minun, 1-2.)

Ndërsa Profeti ﷺ , tregon se namazi pranohet nëse ai falet me përkushtim:

“Kur robi kryen namazin, atij i shkruhet vetëm një e dhjeta, një e nënta, një e teta, një e shtata, një e gjashta, një e pesta, një e katërta, një e treta ose gjysma!” (Ebu Davud, Salat, 123-124/796; Ahmed, IV, 321.)

“Njeriut, prej namazit i shkruhet (pranohet) vetëm pjesa kur zemra është e gatshme.” (Suhejli, Ravdu’l-Unf, II, 208.)

Pra, njeriu merr shpërblim

nga namazi vetëm kur e fal me përkushtim dhe qetësi.

Gjatë namazit, i duhet dhënë rëndësi të gjitha pjesëve të tij. Një herë, Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Hajduti më i keq është ai që vjedh nga namazi i tij.”

Sahabët e pyetën:

“O Resulullah, si mund të vjedh njeriu nga namazi i tij?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, ktheu këtë përgjigje:

“Atëherë kur nuk bën si duhet rukunë dhe sexhden. E, kur ngrihet nga rukuja dhe sexhdeja, nuk e drejton mesin si duhet.” (Ahmed, V, 310; Darimi, Salat, 78.)

Në një tjetër hadith, Resulullahu ﷺ, ka thënë kështu:

“Allahu nuk e sheh (pranon) namazin e atij që nuk e drejton si duhet belin mes rukuve dhe sexhdeve.” (Ahmedi, II, 525.)

Sado të bëjmë kujdes t'i falim namazet siç duhet, mbase nuk mund ta realizojmë këtë. Ngaqë jemi njerëz, kemi të meta dhe gabime. Prandaj, për t'i plotësuar mangësitë tona, duhet t'i drejtohem Allahut me istigfar dhe duhet t'i japim rëndësi namazeve vullnetare. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Vepra e parë për të cilën do të pyetet njeriu në Ditën e Kiametit, është namazi. Nëse e ka kryer në rregull namazin, punët e tjera i shkojnë mbarë dhe del i fituar. Nëse

Resulullahu ﷺ, pa dikë që po luante me mjekrën e tij në namaz. Për këtë arsye, i tha:

“Shikoni! Nëse zemra e këtij njeriu do të ishte e përkushtuar, edhe gjymtyrët e tij do të ishin të përkushtuara (të qeta).”

(Ali el-Muttaki, VIII, 197/22530; Abdurrezak, Musannef, II, 266-267.)



Gjatë një ekspedite, Profeti ﷺ, kishte ndaluar për të pushuar. Ai u kthye nga sahabët dhe u tha:

“Kush do të na ruajë sonte?”

Ammar ibn Jasiri ؓ, prej muhaxhirëve dhe Abbad ibn Bishri ؓ, prej ensarëve, menjëherë u hodhën e thanë:

“Do ruajmë ne, o Resulullah!”

Profeti ﷺ tha:

“Atëherë qëndroni në hyrje të luginës!”

Abbadi ؓ, i thotë Ammarit ؓ :

“Në cilën pjesë të natës do bësh roje, në fillim apo në fund?”

Ammari u përgjigj:

“Dua të qëndroj në pjesën e fundit!” - dhe ra të flejë.

Kurse Abbadi filloi të falë namaz dhe po lexonte suren Kehf. Në ato çaste erdhi një idhujtar, i cili kur pa një siluetë të zezë që rrinte në këmbë, e kuptoi se dikush po bën roje dhe menjëherë e gjuajti me shigjetë. Shigjeta goditi Abbadin ؓ, i cili e nxori shigjetën dhe vazhdoi namazin. Më pas idhujtari gjuajti për herë të dytë e të tretë, duke goditur në shenjë. Por saherë që goditej, Abbadi ؓ, qëndronte në këmbë pa lëvizur, i hiqte shigjetat dhe vazhdonte namazin. Pasi mbaroi rukunë dhe sexhden, dha selam dhe zgjoi shokun e tij, duke i thënë:

“Zgjohu! Jam plagosur!”

Ammari ؓ, u ngrit menjëherë nga vendi. Kur idhujtari e pa, ia mbathi nga frika se mos kapej. Ammari ؓ, e pa shokun e vet të gjakosur dhe i tha:

“Subhanallah! Pse nuk më zgjove sapo të goditi shigjeta e parë?

Abbadi ؓ, i ktheu këtë përgjigje të mrekullueshme:

“Po lexoja një sure dhe nuk dëshiroja ta prishja namazin pa e përfunduar atë. Mirëpo kur shigjetat filluan të më vinin njëra pas tjetrës, u detyrova ta ndërprisja dhe të bija në ruku. Sikur të mos kisha frikë se do ta humbja pozicionin që i Dërguari i Allahut më urdhëroi ta ruaj, pasha Allahun më mirë të vdisja sesa të ndërprisja suren dhe të lija namazin!”¹

1. Shih. Ebu Davud, Teharet, 78/198; Ahmed, III, 344; Bejhaki, Delail, III, 459; Ibni Hisham, III, 219; Vakidi, I, 397.

nuk e ka të rregullt namazin, atëherë do të humbasë dhe do të dalë i dëmtuar. Nëse do ketë ndonjë gjë mangët nga farzet, atëherë Allahu, i Cili është Aziz dhe Xhelal, do të thotë:

“Shikoni, a ka namaze vullnetare robim?” Mungesa e farzeve plotësohet me namazet vullnetare. Pastaj në këtë mënyrë merret në llogari edhe për veprat e tjera.”

(Tirmidhi, Salat, 188/413.)

Falja e namazit në kohën e parë

Falja e namazeve në kohën e parë, është një prej çështjeve që kërkon kujdes të madh. Përndryshe, të lësh namazin në kohën e fundit, duke e marrë me ngadalë dhe të falësh namazin me nxitim sikur po e heq qafe dhe pa dëshirë (Allahu na ruajt!), mund ta çojë njeriun në dyfytirësi.³⁸

Lidhur me rrezikun në vonesën e faljes së namazit, **Resulullahu ﷺ**, tërheq vëmendjen në këtë mënyrë:

“Në kohën e parë të namazit është pëlqimi i Allahut, ndërsa në kohën e fundit është falja e Tij.”

(Tirmidhiu, Salat, 13/172.)

Pra, falja e namazit në kohën e parë, është tregues i kujdesit dhe vullnetit të robit ndaj urdhëresave hyjnore, gjë e cila bëhet shkak për kënaqësinë e Allahut. Përkundër kësaj, negli-



Mevlana thotë:

“Thirri mendjes dhe përpiku të përfitosh nga namazi, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë shpirtëror! Mos e ul dhe mos e ngri kokën nga toka si zogu që mbledh thërrime, pa njohur madhësitinë e Allahut!..

Dëgjo ç’thotë Profeti ﷺ :

“Hajduti më i keq është ai që vjedh nga namazi i tij.”

(Hakimi, el - Mustedrek, I, 353.)”

38. Shih. Nisa, 142.



“Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por është Ai që i mashtron ata. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak.”

(Nisa, 142.)

zhimi i namazit dhe falja e tij në kohën e fundit, është tregues i mungesës së kujdesit dhe bindjes ndaj urdhëresave hyjnore, gjë e cila nuk i sjell ndonjë shpërblim njeriut, por i siguron vetëm mundësinë e shlyerjes apo faljes së borxhit të namazit farz.

Ala ibn Abdurrahman t, rrëfen:

Një ditë pasdreke shkua tek Enes ibn Maliku t. Kur ne arritëm atje, ai u ngrit menjëherë dhe fali namazin e ikindisë.

Ne i thamë se po e falte herët namazin. Ndërsa ai, për të na e shpjeguar se përse veproi ashtu, tha:

“Profeti r, tha tri herë: «Ai është namazi i dyfytyrëshve!», e më pas vazhdoi:

«Njëri prej tyre rri sa rri dhe, kur Dielli fillon të perëndojë e hyn mes dy brirëve të shejtanit, ai çohet dhe ashtu si një zog që mbledh ushqim, ulet e ngrihet katër herë me shpejtësi, ndërsa Allahun e kujton shumë pak në namaz.»” (Muvatta, Kurani Kerim, 46; Muslimi, Mesaxhid, 195.)

Ebu Dheri t, tregon:

“Resulullahu r, tha:

«Si do të jetë gjendja jote kur të jesh drejtues në krye të njerëzve që e vonojnë namazin, ose e kanë kthyer atë në një kufomë pa shpirt?» Unë e pyeta:

«Ç’më urdhëroni të veproj në këtë situatë?»

I Dërguari i Allahut r, tha:

«Fale namazin në kohën e vet! Nëse mbërrin në namaz kur ata janë duke u falur, falu përsëri! Ky do të

jetë namaz nafile për ty.» (Muslimi, Mesaxhid, 238 - 240; Darimi, Salat, 25.)

Profeti ﷺ, është pyetur:

“Cila prej punëve është më e virtytshme?”

“Namazi që falet në kohën e parë!” - është përgjigjur ai.

(Tirmidhiu, Salat, 13/170; Ebu Davud, Salat, 9/426.)

I Dërguari i Allahut ﷺ, këtë virtyt që ia këshillonte Umetit, pikësëpari e jetonte vetë, sepse atij i pëlqente shumë ta falte namazin menjëherë sapo të hynte koha, kudo dhe sido të gjendej.³⁹ Nëna jonë **Aishja** **ؓ**, ka thënë:

“Allahu i Madhëruar e mori Resulullahun ﷺ, pranë Vetes, pa e vonuar as dy herë namazin deri në kohët e fundit.” (Tirmidhiu, Salat, 13/174; Ahmedi, VI, 92.)

Falja e namazeve me xhemat

Një nga pikat më me rëndësi lidhur me namazin farz, është falja e tij me xhemat. Falja e namazit me xhemat është sunnet muekked, në gradën e vaxhibit. Përveç ditëve të fundit të jetës, Profeti ﷺ, nuk e ka lënë asnjëherë namazin me xhemat.

Urdhërimi me këmbëngulje që namazet të falen me xhemat, tregon rëndësinë që i kushton feja jonë edukimit shoqëror. Vepra e mirë më me rëndësi, që forcon ndjenjën e bashkimit dhe unitetit, është falja e namazeve



“Ata në kopshtet e Xhenetit pyesin njëri-tjetrin për keqbërësit:

«Çfarë ju ka sjellë në Sekar?»

Ata do të përgjigjen:

«Nuk ishim nga ata që falnin namaz dhe as prej atyre që i ushqenin të varfrit.»”

(Muddeththir, 40-46.)

39. Shih. Buhari, Salat, 48.

**Në një hadith
thuhet:**

**“Kush e fal jacinë
me xhemat, është
sikur e ka kaluar
gjysmën e natës
me adhurime.
Kush e fal edhe
namazin e sabahut
me xhemat, është
sikur e ka kaluar
gjithë natën me
adhurime.”** (Muslimi,
Mesaxhid, 260.)

**Allahu i
Madhëruar ka
krijuar trupin e
njeriut në mënyrën
më të përshtatshme
për sexhde, me
qëllim që t'i bëjmë
sa më shumë
sexhde Atij.**



me xhemat. Aty ku falen namazet me xhemat, aty ka nisur të kuptohet përbërja shpirtërore dhe shoqërore e Islamit.

Në ajetin **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”** (Fatiha, 5.), që e këndojmë në çdo rekat të namazit, Allahu na këshillon të jemi me xhemat, të paktën dyzet herë në ditë.

Disa nga hadithet lidhur me këtë temë, janë këto:

“Namazi që falet me xhemat, është 27 gradë më lart se namazi që falet vetëm.” (Buhari, Ezan, 30.)

“...Dëshiroj shumë të jeni së bashku si xhemat dhe t'i shmangeni ndarjes ndërmjet jush, sepse shejtani është bashkë me ata që jetojnë vetëm. Ai qëndron larg atyre që jetojnë bashkë, qofshin edhe dy vetë. Kush dëshiron të jetë në mes të Xhenetit, le të vazhdojë xhematin...” (Tirmidhiu, Fiten, 7/2165.)

Një ditë **Resulullahu ﷺ**, vuri re dikë që po falte namaz i vetëm dhe tha:

“A s'ka njeri që dëshiron të bëjë mirë duke falur namaz së bashku me atë njeri?” (Ebu Davud, 55/574; Tirmidhiu, Salat, 164; Darimi, Salat, 98.)

Nga sa kuptohet prej transmetimeve të tjera të këtij hadithi, personi në fjalë po falte namazin e drekës. Prandaj, Resulullahu ﷺ, dëshiroi t'ia shtonte shpërblimet duke bashkuar dikë tjetër me të si xhemat.

I Dërguari i Allahut ﷺ, nuk ka toleruar aspak lidhur me çësh-tjen e xhematit. Një ditë, sahabiu i verbër, **Abdullah Ibni Umri Mektum ؓ**, tha:

“O Resulullah! Medina ka plot insekte helmuese dhe kafshë grabit-qare. (Unë kam frikë mos më dëmtojnë këto kafshë. A mund të mos dal me xhemat e ta fal në shtëpi?)”

Resulullahu ﷺ, i tha:

“A e dëgjon ftesën: “Hajje ala’s-salah” dhe “hajje ala’l-felah”? Atëherë mos ndalo, eja në xhami!” (Ebu Davud, Salat, 46/553.)

Jezid ibn Amir ṭ, rrëfen:

“Shkova pranë Resulullahut ﷺ, kur ai po falte namaz. U ula dhe nuk u bashkova me xhematin. Kur i Dërguari i Allahut ﷻ, u kthye nga ne pas namazit, vuri re se po qëndroja në qoshe dhe më tha:

«O Jezid, a nuk je bërë mysliman ti?»

«Jam bërë, o Resulullah!» - i thashë.

«Atëherë, çfarë të pengoi të bashkoheshe me xhematin?» - më tha.

«Unë e fala në shtëpi namazin duke menduar se ju mund ta kishit falur.» - u përgjigja unë.

Atëherë, Resulullahu ﷺ, më tha:

«Nëse vjen në namaz dhe i gjen njerëzit duke u falur, fale edhe ti namazin bashkë me ata! Nëse e ke falur namazin më parë, ky (namaz) do të jetë nafile për ty. Ndërsa ai që ke falur në shtëpi është farz.» (Ebu Davud, Salat, 56/577.)

I Dërguari i Allahut ﷻ, u ka bërë qortime të ndryshme atyre që nuk falen me xhemat. **Ubej ibn Ka’b** ṭ, rrëfen:

“Një ditë Resulullahu ﷺ, drejtoi faljen e namazit të sabahut dhe pyeti:

«A erdhi në namaz filani?»

«Nuk ka ardhur!» - i thanë.

«A ka ardhur filani?» - pyeti përsëri.

«Jo, nuk ka ardhur!» - i thanë.



Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Namazi që fal një njeri bashkë me një tjetër, është më i begatë dhe më me vlerë sesa namazi që falet vetëm. Namazi që fal një njeri me dy të tjerë, është më i begatë dhe më me vlerë sesa namazi që falet me dy njerëz. Sa më shumë të jetë numri i atyre që falen së bashku, aq më shumë i pëlqen Allahut të Madhëruar.”

(Ebu Davud, Salat, 47/554; Nesai, Imamet, 45/841.)

Siç transmetohet, Ditën e Kiametit Allahu i Madhëruar do të pyesë:

“Ku i kam fqinjët?”

Melekët do thonë:

«Kush mund të jetë fqinj me Ty, o Zot?»

Allahu i Madhëruar do të përgjigjet:

«Ata që ndërtojnë xhamitë e Mia (pra, ata që vazhdojnë të falin namaz me xhemat.)»

(Ali el-Muttaki, VII, 578/20339.)

Atëherë, ai ﷺ, tha:

«Ja, këta dy namaze (jacia dhe sabahu), janë namazet që i vijnë më rëndë hipokritëve. Sikur ta dinit se sa sevape kanë këto, do të vinit në xhemat edhe këmba dorazi. Rreshti i parë është si rreshti i melekëve. Sikur t'ia dinit vlerën, do të vinit duke garuar...»” (Ebu Davud, Salat, 47/554; Nesai, Imamet, 45.)

Për shkak të rëndësisë që feja jonë i kushton namazit me xhemat, një nga dijetarët e mëdhenj Osmanë, Molla Fenari, nuk e ka pranuar dëshminë e Sulltanit Jëlldërëm Bejazid në gjykatë, sepse ai nuk e falte namazin me xhemat. Kur Sulltani i habitur pyeti për arsyen, ai iu përgjigj hapur:

“Madhëri! Nuk po ju shoh të falni namaz me xhemat. Në fakt, ju si udhëheqësi i këtij populli, duhet të ishit në rreshtin e parë. Pra, ju duhet të jeni besimtar i mirë... Nëse nuk merrni pjesë në namazet me xhemat, bëheni shembull i keq për popullin, gjë që pengon pranimin e dëshmisë suaj...”

Pas kësaj ngjarjeje, ose sipas një transmetimi tjetër, në shenjë mirënjohjeje ndaj Allahut për fitoren e betejës së Nigbolu-s, Jëlldërëm Bejazidi ndërtoi Ullu Xhaminë e famshme të Bursas dhe filloi të falë me xhemat pesë kohët e namazit.

Namaz deri në frymën e fundit

Lënia dhe shpërfillja e namazit, nuk ka asnjë lloj justifikimi të arsyeshëm. Edhe në kohë lufte madje, myslimanët falnin namazin me radhë.⁴⁰



Prandaj, zemra jonë duhet të jetë gjithnjë vigjilente lidhur me namazin, deri në frymën e fundit.

Enesi t, tregon:

“Ne ishim afër të Dërguarit të Allahut ﷺ, në çastet e tij të fundit dhe ai na tha tre herë:

«Kini frikë Allahun lidhur me namazet!» Pastaj vazhdoi:

«Kini frikë Allahun lidhur me njerëzit që janë nën varësinë tuaj! Kini frikë Allahun lidhur me dy të pafuqishëm: gruan e ve dhe fëmijën jetim. Kini frikë Allahun lidhur me namazin!»

Më vonë **Resulullahu ﷺ**, filloi të përsëriste fjalët: “Namaz, namaz...”. Ai vijoi ta përsëriste këtë derisa shpirti i tij i bekuar u ngrit tek Miku më i Lartë. (Bejhaki, Shuab, VII, 477.)

VËLLAZËRIA NË FE

Allahu i Madhëruar, në Kuranin Famëlartë është shprehur se besimtarët janë vëllezër. Po kështu, edhe Profeti ﷺ, na ka bërë të ditur se asnjë besimtar nuk mund të arrijë besimin e plotë pa pasur një marrëdhënie të fortë dashurie me vëllezërit e tij të fesë.

Resulullahu ﷺ, rëndësinë e vëllazërisë së fesë e shpjegon në këtë mënyrë:

“Besimtari është shumicë bashkë me vëllain e tij!” (Axhluni, Keshfu'l-Hafa, nr. 2800.)

“Njeriu nuk është i panevojshëm për vëllain e tij. Njësoj si dy duart, asnjëri prej tyre nuk mund të jetë i panevojshëm për tjetrin.” (Dejlemi, Firdeus, III, 409/5251.)



Evlja Çelebiu tregon:

“Kur përfundoi ndërtimi i Xhamisë Bejazid, ajo u hap për adhurime një ditë xhumaje me një ceremoni madhështore. Sulltan Bejazidi tha:

«Kush nuk i ka braktisur asnjëherë në jetën e vet sunetet e para të namazeve të ikindisë dhe jacisë, le të bëhet imam në këtë namaz të begatë!..»

Mirëpo, kur nuk doli askush nga mesi i gjithë xhematit si det, Sulltan Bejazidi u detyrua të thotë: «Elhamdulillah! Ne nuk i kemi lënë këto sunete as në luftë, e as në paqe!»

Më pas doli si imam dhe priu namazin.



Ajo çfarë kërkohet nga ne, është një namaz që shpreh para Zotit të Madhëruar nevojat tona materiale dhe shpirtërore... Një namaz si bisedë me Zotin e Madhëruar, i Cili dëshiron shoqërimin me robin e Vet, duke thënë: "Bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!" (Alak, 19.)... Një namaz ku kibra e trupit të jetë Qabeja, ndërsa kibra e zemrës të jetë Allahu i Madhëruar...

"Kur besimtarët takohen me njëri-tjetrin, janë si dy duar që lajnë njëra-tjetrën."

(Dejlemi, Firdeus, IV, 132/6411.)

Pra, vëllezërit besimtarë ndihmojnë, plotësojnë mangësitë, korrigjojnë gabimet dhe këshillojnë njëri-tjetrin në mënyrën më të bukur.

Virtyti i dashurisë së vëllait të fesë për hir të Allahut, shprehet në këtë

mënyrë:

"Ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar urdhëron: «Ku janë ata që e duan njëri-tjetrin për hatrin Tim dhe si bindje ndaj Meje? Sot, kur nuk ka asnjë hije, Unë do t'i strehoj dhe do t'i ruaj ata nën hijen (e Arshit)!»" (Muslim, Birr, 37.)

Një ditë Resulullahu (s.a.s), tha:

"Janë disa robër të Allahut, të cilët nuk janë as profetë, e as dëshmorë. Mirëpo, Ditën e Kiametit, për shkak të gradës së tyre tek Allahu, ata do t'i kenë zili edhe profetët dhe dëshmorët."

Sahabët e nderuar thanë:

"Kush janë këta dhe çfarë veprash të mira kanë bërë? Tregona, që t'i respektojmë dhe të shoqërohemi me ata, o Resulullah!"

I Dërguari i Allahut ﷺ, u përgjigj:

"Ata janë njerëz të atillë, që megjithëse nuk kanë lidhje farefisnore, tregtare, apo pune me njëri-tjetrin, duhen vetëm për hir të Allahut. Pasha Allahun, fytyrat e tyre janë dritë dhe ata janë të ulur në ndenjësë prej drite. Ata nuk frikësohen kur frikësohen të tjerët dhe nuk dëshpërohen kur dëshpërohen të tjerët."

Triumfi që vjen me namazin

Ishte ditë arefeje e Bajramit të Ramazanit, gjatë ditëve të Luftës së Çanakalesë. Komandanti i frontit, Vehip Pasha, thirri imamin e divizionit të nëntë dhe me dëshpërim i tha:

“Hafiz! Nesër është Bajrami i Ramazanit. Ushtarët duan të falin së bashku namazin e Bajramit. Çfarëdo që u thashë nuk ua ndërroi mendimin. Mirëpo, një gjë e tillë është mundësi e papërsëritshme për armikun që të na shfarosë masivisht. Prandaj, shpjegojua edhe ti me një gjuhë të përshtatshme!..”

Pa u larguar mirë nga komandanti, imamit i doli para një njeri me fytyrë të ndritur, i cili i tha:

“Bir! Mos u thuaj asgjë ushtarëve! Ditë e re, nafakë e re... Ç’ të dëshirojë Allahu bëhet!”

Në mëngjesin e ditës tjetër, u përjetua një manifestim hyjnor, që i mahnti të gjithë. Nga qielli zbritën re shtëllunga-shtëllunga dhe mbuluan ushtarët besimtarë, zemra e të cilëve ishte e mbushur me dashurinë e adhurimit ndaj Allahut. Forcat armike që i vrojtonin ata vazhdimisht me dylbi, tashmë nuk arrinin të vërenin gjë, përveç reve të bardha. Atë mëngjes, në qiell u ngritën valë-valë tekbirët e namazit të Bajramit, që u fal me një emocion shpirtëror shumë të veçantë.

Pikërisht në këtë çast, mes forcave angleze u krijua një trazirë dhe kryengritje e madhe. Kjo, sepse ushtarët myslimanë që ishin sjellë me mashtrim nga kolonitë e ndryshme angleze, e kuptuan nga thirrjet e tekбирëve dhe shqiptimi i teuhidit, se po luftonin me një popull mysliman. Anglezët zullumqarë, që s’dinin çfarë të bënin nga shushatja, një pjesë prej tyre i ekzekutuan menjëherë, ndërsa të tjerët u detyruan t’i tërhiqnin pas vijës së frontit.

Në Kuranin Famëlartë urdhërohet:

“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit.” (Bekare, 153.)

*Enes ibn Maliku
ؓ, tregon:*

*“Kur Resulullahu
ؐ, nuk e shihte
tri ditë ndonjë
prej vëllezërve të
fesë, ai pyeste për
të. Nëse ndodhej
larg, lutej për të,
nëse ndodhej në
shtëpi, e vizitonte
dhe, nëse ishte i
sëmurë, shkonte
për t’i uruar
shërim.”*

(Hajthemi, II, 295.)

Më pas këndoi këtë ajet:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.” [Junus,

62.] (Ebu Davud, Buju, 76/3527; Hakimi, IV, 170; Shih. Tirmidhiu, Zuhd, 53/2390.)

Shembujt më të bukur lidhur me vëllazërinë në fe, i vërejmë në kohën e emigrimit të Profetit ﷺ, nga Meka në Medinë. Në ditët e para që kishte mbërritur në Medinë, Resulullahu ﷺ, i shpalli vëllezër të gjithë myslimanët. Muhaxhirët, të cilët kishin lënë në Mekë të gjithë pasurinë, të afërmit dhe familjarët, Profeti ﷺ, i la nën kujdesin e ensarëve. Kështu, ai krijoi bashkësinë dhe unitetin në aspektin fetar, shoqëror dhe politik.

Vëllazëria fetare, ishte mbjellë dhe rritur në një kohë të shkurtër në zemrat e ensarëve dhe muhaxhirëve. Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, ftoi fillimisht ensarët që t’ua ndante tokën e **Bahrejnit**, ata u tërhoqën dhe thanë:

“O Resulullah! Nëse nuk u jep vëllezërve tanë muhaxhirë edhe njëherë më tepër se neve, ne nuk marrim asgjë!” (Buhari, Menakibu’l-Ensar, 8.)

Xhabiri ؓ, rrëfen:

“Kur ensarët mblihdnin hurmat, i ndanin ato në dy pjesë. Në njërin anë vendosnin shumë, në tjetrën pak. Më pas vendosnin degë dhe gjethe nën hurmat që ishin pak, duke i bërë të duken më shumë se ana tjetër dhe u thoshin muhaxhirëve:

«Merreni atë që dëshironi!»
Ndërsa ata, me mendimin që ensarëve t’u mbeteshin ato që ishin më shumë, zgjidhnin ato



që ishin më pak. Në këtë mënyrë shumica e hurmave u shkonte prapë muhaxhirëve. Pra, me anë të kësaj metode ensarët i linin vetes pjesën më të vogël. Kjo bujari e ensarëve vazhdoi në këtë formë deri në çlirimin e Hajberit.” (Hajthemi, X, 40.)

Të mos mbash mëri

Vëllazëria islame, kërkon që vëllezërit të mbështesin gjithmonë njëri-tjetrin, si në gëzime, ashtu edhe në hidhërim. Ndërsa mërinë mes vëllezërve të fesë, nuk e sheh asnjëherë të përshtatshme, sepse kjo e helmon vëllazërinë. **Resulullahu** ﷺ, ka thënë:

“Nuk është hallall që një besimtar ta braktisë vëllain e tij në fe dhe të rrijë i zemëruar me të më shumë se tre ditë. Pasi të kalojnë tre ditë, duhet të takohet me të dhe t’i japë selam. Nëse tjetri e pranon selamin e tij, që të dy kanë sevape. Përndryshe, ai që nuk e pranon selamin ka hyrë në gjynah. Ndërsa ai që ka dhënë selamin nuk konsiderohet i zemëruar.” (Ebu Davud, Edeb, 47/4912)

“Kush e braktis vëllain e fesë dhe rri i zemëruar një vit me të, ka hyrë në gjynah sikur t’i ketë derdhur gjakun.” (Ebu Davud, Edeb, 47/4915)

Sipas haditheve të Profetit ﷺ, veprat e njerëzve i paraqiten Allahut ditën e hënë dhe të enjte. Por, përveç atij që mban mëri me vëllain e fesë, çdo robi tjetër që nuk ka bërë shirk, i falen gjynahet. Ndërsa melekët urdhërohen vazhdimisht: *“Vonojeni procesin e faljes së këtyre dy personave, derisa të pajtohen me njëri-tjetrin!”* (Muslim, Birr, 35-36; Ebu Davud, Edeb, 47.)



Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Kur dikush njihet me një besimtar dhe bëhet vëlla, le ta pyesë për emrin e tij, emrin e të atit dhe prej cilit fis është, sepse kjo e shton dashurinë mes tyre!”

(Tirmidhi, Zuhd, 54/2392.)

Të pajtossh dhe të rregullosh marrëdhëniet mes vëllezërve të fesë, është një nga punët më të mira. Një ditë, **Resulullahu** ﷺ, iu drejtua **Ebu Ejjub el-Ensarit** ؓ dhe i tha:

“Ebu Ejjub! Të tregoj një punë të mirë, me të cilën kënaqet Allahu dhe i Dërguari i Tij?”



“Po tregomë, o Resulullah!” - tha Ebu Ejjubi ؓ .

Profeti ﷺ, tha:

I Dërguari i Allahut ﷺ, rrëfen një ngjarje të tillë:

“Një njeri doli për udhë që të shkonte për vizitë tek një

vëllai i tij (i fesë) që ndodhej në një fshat tjetër. Allahu i Madhëruar i dërgoi një melek (në formën e njeriut) për ta vëzhguar (dhe sprovuar). Kur njeriu kaloi pranë melekut, ai e pyeti:

«Ku po shkon?» Njeriu u përgjigj:

«Tek ai fshat kam një vëlla të fesë, të cilit po i shkoj për vizitë.» Meleku pyeti përsëri:

«Ke ndonjë interes tek vëllai yt?» Njeriu përgjigjet:

«Jo, unë e dua atë vetëm për hir të Allahut, prandaj po i shkoj për vizitë.» Pas këtyre fjalëve, meleku thotë:

«Ashtu siç e do ti atë, edhe Allahu të do ty. Unë jam i dërguari i Allahut dhe kam ardhur të të përgëzoj për këtë.»» (Muslim, Birr, 38; Ahmed, II, 292.)

“Kur njerëzit fyejnë njëri-tjetrin, pajtoji; kur largohen nga njëri-tjetri, afroji!” (Bejhaki, Shuab, VII, 490; Hajthemi, VIII, 80.)

Të zgjidhësh problemet e vëllait

Njërit prej sahabëve, iu dhurua një kokë deleje. Ai tha:

“Filan vëlla dhe familja e tij janë më nevojtarë sesa unë.” - dhe ia dha atë dhuratë vëllait që përmendi. Po kështu edhe ai, me të njëjtin motiv ia dha një tjetri. Kështu, dhurata u soll dhe përfundoi sërish tek sahabi i parë. Për këtë arsye u zbrit ky ajet fisnik:

“...(ata) duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë...” (Hashr, 9.)

(Hakim, Mustedrek, II, 526.)

Një ditë, kur Abdullah ibn-i Abbasi **ؓ**, ndodhej në itikaf në Xhaminë e Profetit **ﷺ**, erdhi një person, i cili dha selam dhe u ul. Abdullah ibn-i Abbasi **ؓ**, i tha:

“Vëlla, po të shoh të mërzhitur dhe të dëshpëruar!”

*“Po, o djali i xhaxhait të Profetit, jam i trishtuar. I kam borxh filan personi dhe për hir të së vërtetës së këtij që prehet në këtë varr (Profetit **ﷺ**), nuk mund ta paguaj dot këtë borxh.”*

“A të flas me të për ty?”

“Nëse dëshiron, fol.”

Ibn Abbasi **ؓ**, veshi këpucët dhe doli nga xhamia. Personi në hall i thërret dhe i thotë:

“Harrove që je në itikaf, pse dole nga xhamia?”

Ibn Abbasi **ؓ**, i dha këtë përgjigje:

“Jo! Nga ky njeri i nderuar që prehet në këtë varr dhe që sapo është ndarë nga ne (duke thënë këto fjalë i rrodhën lot nga sytë), kam dëgjuar se:

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.”

(Huxhurat, 10.)

“...Prandaj, frikësojuni Allahut, rregulloni marrëdhëniet midis jush dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë”.

(Enfal, 1.)



**Vëllazëria fetare
kërkon lënien e
debateve të llojit
“Unë kam të
drejtë, ti nuk ke të
drejtë”, harrimin
e armiqësive të
vjetra dhe arritjen
e virtytit të faljes
së vëllait besimtar
duke sakrifikuar
edhe prej vetes nëse
është e nevojshme,
sepse mëria është
pabindshmëri ndaj
urdhrit të Allahut.**

«Kushdo që mundohet t’ia plotësojë nevojën një vëllai mysliman dhe ia plotëson atë, për të është më e mirë se dhjetë vjet qëndrim në itikaf. Ndërsa kush hyn një ditë në itikaf për hir të Allahut, Ai krijon tri hendeqe mes tij dhe Xhehenemit; gjerësia e çdo hendequ është sa largësia ndërmjet lindjes dhe perëndimit.»” (Bejhaki, Shuab III, 424-425. shih. Hejthemi VIII, 192.)

Mbështetja e vëllait të fesë

Pas çlirimit të Stambollit, **Fatih Sulltan Mehmeti**, shkoi tek disa priftërinj të drejtë, të cilët ishin burgosur në kohën e Bizantit dhe i pyeti në lidhje me shtetin Osman. Ndërsa ata i thanë se do t’i jepnin përgjigje pasi të bënin pak analizë.

Priftërinjtë hynin e dilnin kudo me fermanin që u ishte dhënë. Herët në mëngjes, shkuan në dyqan për të blerë diçka. Dyqanxhiu i tha:

“Zotërinj, unë e kam bërë seften për sot. Shkoni merrni nga ky fqinji që nuk e ka bërë ende sefte!”

Priftërinjtë mbetën të mahnitur nga kjo tablo e vëllazërisë Islame... Vërtet, a mund të mos kihet zili një personaliteti i tillë i pjekur, që mbështet vëllain e tij mysliman, larg interesit?!

Miqësia e vërtetë që është për Allahun, është sikur trupa të ndryshëm të jetojnë në një zemër. Jeta e atyre që përpiqen të çojnë në vend përgjegjësinë e vëllazërisë fetare, duke shërbyer me delikatesë dhe vetëmohim, vazhdon edhe pas kësaj jete kalimtare. Ata kujtohen gjithnjë me mëshirë. Njësoj si muhaxhirët, ensarët dhe



besimtarët që arritën ta bëjnë botën e tyre shpirtërore vend shërbimi.

HAKU I ROBIT

Allahu i Madhëruar është shprehur se e ka krijuar njeriun si qenie të nderuar dhe në trajtën më të bukur.⁴¹ Ai u ka dhuruar atyre begati të panumërta dhe disa të drejta. Dhe, për të mbrojtur këto të drejta ka vendosur ligje e rregulla, që sistemojnë rrjedhën e jetës.

Një i ri mysliman, s' duhet ta harrojë asnjëherë se shkelja e të drejtave të Allahut është një gjynah i madh. Por, gjëja kryesore që nuk duhet harruar aspak, është se, megjithëse Allahu ynë i Madhëruar i fal të gjitha gabimet dhe gjynahet që bëhen kundrejt Tij, Ai ka bërë përjashtim për hakun e robit. Faljen e tyre ia ka lënë në dorë njeriut që i është bërë padrejtësi. Rrjedhimisht, për atë që do të pendohet për shkeljen e ndonjë të drejte, para së gjithash, duhet t'i kërkojë falje personit të cilit i ka shkelur të drejtën.

Një ditë, Resulullahu ﷺ, tha:

“Allahu ia bën haram Xhenetin dhe ia bën farz Xhehenemin atij që i merr të drejtën një myslimani, duke u betuar rrejtshëm.” Kur u pyet:

“Edhe nëse është shumë pak, o Resulullah?” - ai u përgjigj duke e përsëritur tri herë:

“Qoftë edhe një degë misvaku!” (Muslimi, Iman, 218; Muvatta', Akdije, 11.)

Sërish një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, i pyeti sahabët:



Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Nëse do të zija një mik nga njerëzit, ky do të ishte Ebu Bekri. Mirëpo, vëllazëria Islame është më e lartë.”

(Buhari, Salat, 80.)

41. Shih. Isra, 70; Tin, 4.

Ebu Hurejre thotë:

“Besimtari është pasqyra e vëllait të tij. Kur shikon një të metë tek ai, e rregullon.” (Buhariu, el-Edebu'l-Mufred, Nr. 238.)

Pra, besimtari e tregon me dashamirësi çdo gjë që sheh tek vëllai i tij. Nëse sheh diçka të bukur, e laudëron dhe e nxit për më mirë. E nëse sheh ndonjë të keqe i tërheq vërejtjen dhe përpiqet ta korrigjojë.



“A e dini kush është i falimentuar?” Ata u përgjigjën:

“Sipas nesh, i falimentuar është ai që nuk ka para dhe mall.” Por i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“S’ka dyshim, se të falimentuarit e Umetit janë ata, të cilët Ditën e Kiametit do të vijnë me sevapet përkatëse të adhurimeve si namazi, agjërimi, zekati etj., por, për shkak se këtë e ka sharë, për atë ka shpëfatur për amoralitet, këtij i ka ngrënë mallin padrejtësisht, atij tjetrit i ka derdhur gjakun dhe një tjetër e ka rrahur, të gjitha sevapet e mirësive të tij, i kalojnë këtyre. Nëse sevapet i mbarojnë pa larë hakun e atyre që u ka bërë padrejtësi, gjynahet e atyre që kanë për të marrë hak, do t’i ngarkohen këtij dhe si përfundim ai do të hidhet në Xhehenem.” (Muslim, Birr 59; Tirmidhi, Kijamet 2; Ahmed, II, 303, 324, 372.)

Forma më e rrezikshme e cenimit të së drejtës së tjetrit, është marrja dhe dhënia e kamatës. Allahu i Madhëruar ka përgatitur një dënim të madh për ata që bëjnë një padrejtësi të tillë.⁴² Allahu i Madhëruar e mallkon atë që ha nga kamata, atë që i jep tjetrit të hajë nga kamata, atë që shkruan marrëveshjen mes këtyre të dyve dhe atë që bën dëshmitarin.⁴³

Krahas kësaj, vjedhja apo marrja pa leje e pasurisë së tjetrit, njollosja e nderit dhe dinjitetit të tjetrit, mërzitja ose frikësimi i njerëzve qoftë edhe me shaka, mashtrimi, tradhtia ndaj amanetit, marrja dhe

42. Shih. Nisa, 161.

43. Shih. Ebu Davud, Buju’, 4/3333; Tirmidhiu, Buju’, 2; Ahmed, I, 393.

dhënia e ryshfetit, vonimi i borxhit ose mosshlyerja i tij, janë të gjitha shkelje të së drejtës së robit.

I Dërguari i Allahut ﷺ, në ligjëratën e fundit që u ka mbajtur sahabëve para se të ndërronte jetë, ka thënë:

“Edhe unë njeri jam! Është e mundur që ndonjërit t’i kem hyrë në hak. Kujt i kam marrë diçka padashje nga pasuria, ja ku është pasuria ime! Le të vijë ta marrë!”

Dijeni mirë se, më i dashuri tek unë, është ai që e ka marrë hakun prej meje, nëse ka, ose ma ka bërë hallall. Në këtë mënyrë, do të takohem me Zotin tim i hallalluar dhe me zemër të ngazëllyer!

Askush nuk mund të thotë: «Kam frikë se Resulullahu do ushqejë urrejtje dhe armiqësi ndaj meje!» Dijeni mirë se, ushqyerja e urrejtjes dhe armiqësisë nuk është aspak vesi im!”

Pasi fali namazin e drekës, i Dërguari i Allahut ﷺ, u kthye, u ul në minber dhe i përsëriti tri herë këto fjalë. Ndërkohë, një njeri ngrihet në këmbë dhe thotë:

“Një person kërkoi diçka prej jush. Ju më urdhëruat t’i jepja tre dirhem dhe unë ia dhashë.”

Resulullahu ﷺ, ia dha menjëherë atë që i takonte. (Ibni Sa’d, II, 255; Taberi, Tarih, III, 190.)

Më pas u lut me këto fjalë:

“O Allah! Kujtdo prej besimtarëve t’i kem thënë në ndonjë fjalë të rëndë, Ditën e Kiametit, atë fjalë bëje shkak afrimi me Ty për atë njeri!”

(Buhari, Dea-uat, 34.)

Kanuni Sulltan Sulejmani kishte shumë frikë nga haku i robit. Kur

Pak para se të ndërronte jetë, i Dërguari i Allahut ﷺ, për të tërhequr vërejtjen lidhur me hakun e robit, dha një shembull nga vetja duke thënë:

“Kujt i kam rënë në shpinë, ja ku e ka shpinën time! Le të vijë, të më gjuajë! Kujt i kam marrë diçka padashje nga pasuria, ja ku është pasuria ime! Le të vijë ta marrë!”

(Ahmed, III, 400.)





Në një hadith thuhet:

“O njerëz! Kush ka hak (robi) mbi shpinë, le ta paguajë atë menjëherë, e të mos mendojë se «po turpërohem para botës»! Dijeni mirë, se turpërimi në këtë botë, është shumë i më i lehtë se ai në botën tjetër.”

(Ibni Ethir, el-Ethir, el-Kamil, II, 319.)

për-fundoi ndërtimi i Xhamisë Sulejmanije dhe kompleksit të saj, ai i mblodhi të gjithë, që nga arkitekti deri tek punëtori më i thjeshtë dhe u tha:

“O vëllezër në fe! Kjo xhami u përfundua me lejen e Allahut. Nëse gabimisht, ndokush prej jush nuk e ka marr rrogën, le të vijë ta marrë! Mundet që ai të mos jetë i pranishëm. Prandaj ju

lutem juve që jeni të pranishëm, t’i lajmëroni ata që nuk janë, që të vijnë ta marrin të drejtën e tyre prej nesh!”

Nga sa kuptohet prej analizimit të dokumenteve, në kohët më të vështira të ndërtimit, është bërë një program edhe për kafshët, duke u kujdesur që kafshët e punës, si kuajt, gomarët dhe mushkat, të kenë orarin e pushimit dhe kullotjes në livadhe. Kështu, është bërë kujdes që asnjë krijesë të Zotit të mos i hyhet në hak. Ndoshta ky kujdes i Sulltan Sulejmanit, është një prej shkaqeve kryesore të përshtirshmërisë së Xhamisë Sulejmanije.

Shkurtimisht, një i ri mysliman, duhet të bëjë kujdes ndaj së drejtës së tjetrit, duke menduar botën tjetër.

Sa bukur që e ka thënë Resulullahu ﷺ :

“Mysliman i vërtetë është ai që prej gjuhës dhe dorës së të cilit nuk dëmtohen të tjerët...” (Buhari, Iman, 4-5.)

Ditën e Kiametit, edhe kafsha pa brirë, do të marrë hak prej asaj me brirë që e ka dëmtuar dhe, askush nuk do të mbesë pa marrë hakun e vet.⁴⁴ Prandaj, nëse

44. Shih. Muslimi, Birr, 60; Tirmidhiu, Kijame, 2; Ahmed, II, 235, 323, 372, 411.

njeriu i ka hyrë dikujt në hak, me dashje apo padashje, ai duhet t'i japë hakun të zotit dhe t'i kërkojë hallallëk. Më pas duhet të pendohet.

E drejta e prindërve

Më e rëndësishmja ndër të drejtat njerëzore, është ajo e prindërve. Pas bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, vjen menjëherë bindja ndaj prindërve, sepse prindërit tanë janë shkaku i ardhjes sonë në këtë botë dhe begatia e jetës sonë. Ata janë arkitektët e veçantë të personalitetit tonë, që ndërtuan jetën tonë materiale dhe shpirtërore. Ndaj, ata kanë aq shumë të drejta mbi ne, sa nuk mund të numërohen.

Abdullah ibn Mes'ud ؓ, ka thënë:

E pyeta **Resulullahun** ﷺ:

“Cila është vepra që Allahu pëlqen më shumë?”



Omer ibn Hattabi ؓ, tregon:

“Ishte dita e Betejës së Hajberit. Një grup nga sahabët e Resulullahut ﷺ, erdhën dhe thanë:

«Filani është shehid, po ashtu edhe filani është shehid!» Më pas, kur po kalonin pranë një personi thanë:

«Edhe filani paska rënë shehid!» Mirëpo, Resulullahu ﷺ, tha:

«Jo! Unë e kam parë atë në Xhehenem, brenda një veshjeje që kishte marrë padrejtësisht nga plaçka e luftës.» (Muslimi, Iman, 182.)

Nga kjo kuptohet se, edhe rënia dëshmor, që është një nga gradët më të larta dhe shpëtim për shumë gjynahe, nuk mund ta shlyejë gjynahun e vjedhjes së pronës publike dhe hakun e robit.

“Namazi që falet në kohën e vet.” - më tha.

“Pastaj, cili adhurim vjen?” - i thashë.

“Bindja dhe mirësia ndaj prindërve.” - më tha.

“Po pastaj?” - i thashë.

“Xhihad i në rrugë të Allahut.”

- më tha. (Buhari, Meuakit, 5; Xhihad, 1; Muslim, Iman, 137 - 139.)

Zoti i Madhëruar e ka lidhur



Njëri nga sahabët, Xherir ibn Abdullahu ؓ , deshi të blinte një kalë. Ai e pëlqeu atë kalë, shitësi i të cilit kërkonte pesëqind dirhem. Mirëpo,

Xheriri ؓ , i tha se ai mund ta blinte kalin për gjashtëqind dirhem, madje, mund ta ngrinte çmimin edhe deri në tetëqind dirhem, sepse kali kishte vlerë të madhe dhe i zoti nuk e dinte këtë. Shitësi e pyeti:

“Pse dhatë tetëqind dirhem, ndërkohë që mund ta blije kalin për pesëqind dirhem?”

Xheriri ؓ , dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

“Ne i kemi dhënë fjalën Resulullahut ﷺ , që nuk do të bëjmë hile në tregti.”¹

Ja pra, ky është kujdesi ndaj “hakut të robit”, që morali Islam reflekton në jetën tregtare... Një myslimani nuk i ka hije të mos mendojë për të drejtën e tjetrit, me idenë që “ta vjel sa më shumë klientin”.

1. Ibn Hazm, el-Muhal-la, Egjipt 1389, IX, s. 454 dhe vazhdim.

kënaqësinë e Vet me kënaqësinë e prindërve. Resulullahu ﷺ, thotë:

“Kënaqësia e Allahut të Madhëruar fitohet duke kënaqur prindërit. Ndërsa zemërimi i Allahut të Madhëruar meritohet duke zemëruar prindërit.” (Tirmidhi, Birr, 3/1899.)

Kjo lutje e Profetit ﷺ, bëhet shkak begatie për një besimtar:

“Lum ai që sillet mirë me prindërit! Allahu i Madhëruar, ia shtoftë jetën atij!” (Hajthemi, VIII, 137.)

A është e mundur ta shlyejmë hakun e prindërve tanë, të cilët na kanë kushtuar gjithë qenien e tyre vetëm e vetëm që neve të mos na prekë asnjë e keqe në furtunat e jetës? Në një hadith, kjo e vërtetë shprehet me një shembull të tillë:

“Asnjë fëmijë nuk mund ta shlyejë hakun e babait të vet, përveçse nëse e gjen si skllav, e blen dhe e liron.” (Muslimi, Itk, 25; Ebu Davud, Edeb, 119 - 120; Tirmidhi, Birr, 8/1906.)

Lidhur me këtë çështje, **Mevlana** ka thënë:

“Kujdes ndaj hakut të nënës! Bëje kurorë mbi kokë, sepse sikur nënat mos të vuanin dhimbjet e lindjes, fëmijët nuk do të gjenin rrugë të vinin në këtë botë.”

Për këtë arsye, një i ri mysliman, pas bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, e ka për detyrë të respektojë prindërit e vet, t’u bindet atyre dhe t’u shërbejë sipas nevojave. Nëse jeton në një




“Asnjë kohë nuk ka qenë më e vështirë dhe më e mundimshme për të reformuar njerëzimin, sesa koha kur ka ardhur Muhamedi. Mirëpo, ne nuk njohim ndonjë reformë dhe arritje më të përsosur se paqja dhe sukcesi që ka lënë ai kur ndërroi jetë.”

(Sir Muir)

**Abdurrahman
Xhami ka thënë:**

“E si mos ta dua nënën; ajo për një kohë më ka mbajtur në trupin e saj, pastaj për një kohë të gjatë më ka mbajtur në prehër dhe, derisa vdiq më mbajti në cepin e mëshirës së zemrës së saj. A mund të ketë ndonjë gjë më të keqe sesa të mos e respektosh atë?!..”



vend të largët, duhet t'i fitojë zemrat e prindërve, duke i vizituar dhe duke kërkuar bekimin e tyre. Shërbimi ndaj prindërve, fjalët e bukura dhe gostitja e tyre, janë borxhe që fëmijët kanë ndaj tyre. Veçanërisht në kohën e pleqërisë, duhet bërë shumë kujdes në këtë çështje. Allahu i Madhëruar nuk ka lejuar të tregohet qoftë dhe një pakënaqësi e vogël karshi tyre.

Shërbimi ndaj prindërve, është një vepër e mirë shumë e virtytshme. Ata që nuk e vlerësojnë këtë mundësi, janë në një humbje të vërtetë. I Dërguari i Allahut ﷺ, duke na paralajmëruar dhe duke na tërhequr vëmendjen në këtë çështje, është shprehur:

“U shkatërroftë, u shkatërroftë, u shkatërroftë ai që nuk arrin të hyjë në Xhenet, megjithëse i ka mbërritur ditët e pleqërisë së prindërve të vet, apo vetëm të njërit prej tyre!”

(Muslimi, Birr, 9, 10.)

Allahu i Madhëruar urdhëron të sillemi mirë me prindërit, edhe sikur ata të jenë jomuslimanë, duke u plotësuar kërkesat dhe duke ua gëzuar zemrat. Përrjashtim bëjnë vetëm rastet kur ata të nxisin të veprosh në kundërshtim me ligjet e Allahut.⁴⁵

Vajza e Ebu Bekrit **ؓ**, **Esmaja C**, tregon:

“Nëna ime, e cila ende nuk e kishte pranuar Islamin, më erdhi për vizitë. Për të marrë mendimin e Profetit ﷺ, e pyeta:

«Nënën time e paska marrë malli për mua dhe më ka ardhur për vizitë. A të sillem mirë me të?»

Resulullahu ﷺ, u përgjigj:

«Po, patjetër! Sillu mirë me

45. Shih. Llukman, 15.

nënën tënde!» (Buhariu, Hibe, 29, Edeb, 7 - 8; Muslimi, Zekat, 50.)

Nuk duhet harruar se, ashtu si njeriu sillet me prindërit e vet, ashtu do të sillen edhe fëmijët e tij me të. Profeti ﷺ, ka thënë:

“...Silluni mirë më baballarët tuaj, që edhe fëmijët tuaj të sillen mirë me ju!...” (Hakim, IV, 170/7258.)

Shpeshherë është dëshmuar se të rinjtë që janë sjellë keq me prindërit, kanë marrë të njëjtin trajtim nga fëmijët e tyre, kur kanë arritur moshën e pleqërisë.

Shkurtimisht, rruga për në Xhenet, kalon përmes kënaqësisë së prindërve. Allahu i Madhëruar, e ka vendosur Xhenetin nën këmbët e nënave besimtare, ndërsa babanë e ka bërë portën e mesme të Xhenetit. Tashmë, kush dëshiron, t'i gëzojë ata, e kush dëshiron, t'i mërzisë!..

E drejta e familjes

Babai, nëna dhe fëmijët kanë të drejta mbi njëri-tjetrin.

Babai duhet ta përgatisë familjen e tij për botën tjetër, duke i edukuar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe duke u plotësuar nevojat në rrugë hallall.

Nëna duhet të jetë e kujdesshme kundrejt detyrimeve që ka ndaj bashkëshortit dhe duhet të kujdeset për shtëpinë dhe fëmijët. Duke u nisur nga shprehja, **“Zogu femër e ndërton folenë”**, gruaja duhet të jetë e vetëmjaftueshme, duhet të ruhet nga shpërdorimi dhe duhet të veprojë me maturi të madhe në çdo çështje.



Një prej të dashurve të Allahut, Bahaudin Nakshibendi, duke dashur të tregojë arkitektin e parë të edukimit të tij shpirtëror, ka thënë:

“Kush dëshiron të vizitojë varrin tim, më parë të vizitojë varrin e nënës sime.”

“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as «uh!», mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti.”

(Isra, 23.)



Prindërit duhet të sillen me drejtësi ndaj fëmijëve të tyre dhe nuk duhet të bëjnë dallime mes tyre. Detyra e tyre më e rëndësishme, është t’u japin edukatë Islame pjesëtarëve të familjes dhe të përpiqen që ata të fitojnë lumturinë e përhershme. Për rrjedhojë, para së gjithash, ata duhet t’u mësojnë atyre njohuritë themelore të fesë. Pastaj, duhet t’i ndihmojnë të marrin njohuritë dhe aftësitë e duhura në lidhje me profesionin e ligjshëm që do të zgjedhin.

I Dërguari i Allahut ﷺ, është pyetur:

“O i Dërguari i Allahut! A kanë edhe fëmijët tanë të drejta mbi ne, ashtu siç kemi ne të drejta mbi ta?” Profeti ﷺ, është përgjigjur:

“E drejta që ka fëmija mbi të atin, është që i ati t’i mësojë shkrimin e këndimin, notin, qitjen dhe ta ushqejë me ushqime prej hallalli. (Bejhaki, Shuab, VI, 401; Ali el-Muttaki, XVI, 443.)

Disa prej haditheve të tjera lidhur me këtë temë, janë:

“E drejta që ka fëmija mbi të atin, është që i ati t’i vendosë një emër të bukur, ta martojë kur t’i vijë koha dhe t’i mësojë shkrim e këndim!” (Ali el-Muttaki, XVI, 417.)

“... Duhet të bëjë të mundur që i biri të fitojë një vend të respektuar në jetë dhe t’i japë një edukatë të mirë.” (Bejhaki, Shuab, VI, 401 - 402.)

Pas të drejtave që kanë lidhje me fenë dhe botën tjetër, vijnë ato që kanë të bëjnë me nevojat në jetën e kësaj bote.

Muauje ibn Hajde ؓ, tregon:

“E pyeta të Dërguarin e Allahut ﷺ: «O Resulullah! Cilat janë të drejtat e grave tona mbi ne?»

Ai m’u përgjigj:

«T'i ushqeni njësoj siç ushqeheni vetë, t'i vishni siç visheni vetë, të mos i godisni në fytyrë, të mos u thoni që punët e tyre dhe ato vetë (në paraqitje dhe edukatë) janë të shëmtuara dhe të mos i mallkoni e t'i fyeri...» (Ebu Davud, Nikah, 40 - 41; Ibni Maxhe, Nikah, 3.)



Sërish i Dërguari i Allahut ﷺ, ka bërë të ditur se puna që bëhet aq sa për të siguruar furnizimin e nevojshëm për familjen, konsiderohet si adhurim dhe bamirësi.⁴⁶

Pjesëtarët e familjes duhet t'i ndajnë detyrat sipas aftësive dhe gjendjes së tyre. Kur Resulullahu ﷺ, bëri ndarjen e punëve brenda familjes, vajzës së tij, **Fatimes C**, i këshilloi punët e shtëpisë, ndërsa dhëndrit të tij, **Aliut T**, punët jashtë shtëpisë.⁴⁷

Kryefamiljari, nuk duhet të bëjë udhëtime të gjata pa e vënë në dijeni bashkëshorten. Gjithashtu, ai nuk duhet të sjellë në shtëpi mysafirë pa njoftuar dhe pa i njohur. Ai nuk duhet të kërkojë nga bashkëshortja e tij, që ajo t'u shërbejë njerëzve të huaj dhe të dalë para tyre, jashtë kriterëve të lejuara. Po ashtu, brenda mundësive, ai duhet ta ruajë familjen nga tubimet e përziera burra me gra.

Një nga detyrat kryesore të babait, është të

46. Shih. Buhariu, Iman, 41; Muslim, Zekat, 39.

47. Shih. Kasani, Bedaius-sanai fi tertibish-sherai', Bejrut 1982, IV, 24.

Aishja C, transmeton:

«Një person erdhi tek Resulullahu ﷺ, bashkë me një burrë të moshuar. I Dërguari i Allahut ﷺ, e pyeti:

«O filan! Kush është ai që ke pranë?»

«Është babai im!» - u përgjigj ai.

Pas kësaj, Resulullahu ﷺ, i tërhoqi vërejtjen duke i thënë:

«Mos ec para tij, mos u ul para tij, mos e thirr në emër dhe mos lejo të ta fyejnë babanë!»

(Hajthemi, VIII, 137.)

**“O ju, që besoni!
Ruani veten dhe
familjet tuaja
nga zjarri, lënda
djegëse e të cilit
janë njerëzit dhe
gurët...”**

(Tahrim, 6.)



ketë moral të bukur karshi pjesëtarëve të familjes dhe të sillet mirë me ta.

I Dërguari i Allahut ﷺ, lidhur me detyrat e gruas, ka thënë:

“Gruaja e mirë e gëzon të shoqin kur ai e sheh në fytyrë, ia përmbush dëshirat e ligjshme që ka dhe e ruan pasurinë dhe nderin e tij kur ai nuk ndodhet në shtëpi.” (Ibni Maxhe, Nikah, 5.)

“Një grua që vdes ndërkohë që bashkëshorti i saj është i kënaqur me të, hyn në Xhenet!” (Tirmidhiu, Rada’, 10/1161; Ibni Maxhe, Nikah, 4.)

Pjesëtarët e familjes duhet të jenë vigjilentë ndaj hileve dhe intrigave të egos, shejtanit dhe njerëzve shpirtligj që kanë përreth dhe duhet t’i mbështeten gjithnjë Allahut, sepse këta bëjnë ç’të munden për të

shkatërruar follenë familjare, e cila është institucioni më i shenjtë. Ata e dinë shumë mirë se, kur të shkatërrojnë familjen, mund të rrënojnë edhe moralin, edhe fenë e shoqërisë.

Lidhur me këtë çështje të rëndësishme, **Resulullahu** ﷺ, na ka tërhequr vëmendjen me këto fjalë:

*“Iblisi vendos fronin e tij mbi ujë dhe aty ndërton qendrën e vet. Më pas dërgon ushtarët e tij në çdo anë të botës. **Më i afërti dhe më i dashuri për Iblisin, është ai që shkakton të keqen më të madhe.** Njëri prej ushtarëve kthehet dhe thotë:*

«Sot bëra kështu e ashtu!»

«Asgjë s’passe bërë!» - i thotë Iblisi

Një tjetër vjen dhe thotë:

«Iu vura njërit dhe nuk iu shqepa derisa e ndava nga bashkëshortja e tij!»

Pas kësaj, Iblisi e afron pranë, e përqafoi dhe i thotë:

«Sa i mirë, sa i mbarë që je!» (Muslimi, Munafikin, 67)

Shkurtimisht, brenda një familjeje, të gjithë duhet të kujdesen për detyrat e veta dhe të drejtat e njëri-tjetrit.

Detyrat ndaj të afërmeve

Ruajtja e marrëdhënieve me të afërmit dhe kujdesi ndaj tyre, është një nga parimet që feja jonë i kushton shumë rëndësi. Madje, kjo është një çështje e lidhur drejtpërdrejt me besimin. Ndaj dhe Profeti ﷺ, ka thënë:

“... Ai që beson Allahun dhe botën tjetër, të sillet mirë me të afërmit!...” (Buhariu, Edeb, 85; Muslimi, Iman, 74, 75.)

Allahu i Madhëruar, i ka bërë të afërmit trashëgimtarë të njëri-tjetrit dhe i ka përforcuar lidhjet mes tyre përmes disa detyrave dhe të drejtave të ndërsjella.

Marrëdhëniet mes të afërmeve, duhet të ndërtohen mbi themelet e mëshirës dhe dhembshurisë, si manifestim i cilësisë **Rahman** të Zotit tonë të Madhëruar. Ky hadith, thekson një kriter shumë të rëndësishëm:

“Kush i përgjigjet mirësisë së të afërmit të vet me të njëjtën mirësi, nuk konsiderohet se po kujdeset

“Të gjithë jeni barinj dhe të gjithë jeni përgjegjës për ata që janë në kujdesin tuaj... Burri është bariu i familjes së vet dhe është përgjegjës për anëtarët e familjes së vet. Gruaja është bareshë e shtëpisë së burrit dhe përgjegjëse për familjen e vet!”

(Buhari, Vesaja, 9; Muslimi, Iman, 20.)



për të. Ai që kujdeset (vërtet) për të afërmit, vazhdon t'u bëjë mirë atyre, edhe kur ata të kenë prerë lidhjen me të.” (Buhariu, Edeb, 15; Ebu Davud, Zekat, 45; Tirmidhiu, Birr, 10.)

Kur një sahab pyeti se cilat janë veprat më të vyera, Resulullahu ﷺ, iu përgjigj se, njëra prej tyre, është ruajtja e marrë-dhënieve edhe me të afërmit që i ndërpresin ato.⁴⁸

Allahu i Madhëruar i lëvdon në këtë mënyrë ata që ruajnë marrë-dhëniet farefisnore:

“Ata që mbajnë lidhjet (familjare) që ka urdhëruar Allahu të mbahen, që kanë

48. Shih. Ahmed, IV, 148, 158.



Haule binti Hakim C, ishte një grua që vishej bukur. Një ditë shkoi tek nëna jonë Aishja C, me një veshje të leckosur. Aishja C, e pyeti:

“Ç’të ka gjetur kështu?”

“Burri im, gjatë natës fal namaz, gjatë ditës agjëron dhe nuk interesohet fare për mua!” - i tha.

Ndërkohë, hyn Resulullahu ﷺ dhe Aishja C, ia tregoi atij këtë situatë. Ndërsa Resulullahu ﷺ, u takua me Osmanin, bashkëshortin e Haules dhe i tha:

“Osman, neve nuk na është urdhëruar murgëria! A nuk jam unë shembulli më i mirë për ty? Pasha Allahun, unë jam ai që i frikësohet më shumë Allahut dhe i respekton më tepër urdhëresat e Tij, ndër të gjithë ju!”

(Ahmed, VI, 226; Ibni Haxher, el-Isabe, IV, 291.)

frikë Zotin e tyre e i frikësohen llogarisë së rëndë”

(Ra'd, 21.)

Ndërsa Profeti ﷺ, na ka bërë të ditur se radha që duhet ndjekur në kujdesin ndaj të afërmeve është kjo:

“Shpenzimin filloje nga vetja! Atë që të mbetet, shpenzoje për familjen! Nëse të mbetet diçka prej familjes, shpenzoje për të afërmit. Nëse sërish të tepron diçka, atëherë jepu fqinjëve që ke djathtas dhe majtas!” (Shih. Nesai, Zekat, 60, Buju', 84; Muslimi, Zekat, 41.)

Bamirësia që bëhet për të afërmit, shpërblehet edhe si sadaka, edhe si ruajtje e marrëdhënieve fafëfisnore. (shih. Tirmidhi, Zekat, 26.)

Ruajtja e marrëdhënieve me të afërmit mund të ketë disa vështirësi të caktuara. Por, shpërblimi që është premtuar për të, është shumë më tepër dhe shumë më i madh. Lidhur me këto shpërblime, Profeti ﷺ, është shprehur:

“Kush dëshiron t'i shtohet rizku dhe jeta, le të kujdeset për të afërmit!” (Buhariu, Edeb, 12, Buju', 13; Muslimi, Birr, 20, 21.)

Përkundër kësaj, ata që nuk interesohen për të afërmit dhe i shkëpusin marrëdhëniet me ta, janë qortuar dhe kërcënuar në këtë mënyrë:

“Sa për ata që shkelin besëlidhjen me Allahun, pasi janë zotuar për atë e, që këpusin lidhjet (familjare) që ka urdhëruar Allahu të ruhen dhe bëjnë çrregullime në Tokë - mbi ta rëndon mallkimi dhe përfundimi i keq!” (Ra'd, 25.)

Në një hadith thuhet:

“Martohuni, e mos u ndani!.. Sepse për shkak të ndarjes, dridhet Arshi...”

(Ali el-Muttaki, IX, 1161/27874.)





Allahu i Madhëruar ka thënë: “... Kush kujdeset për lidhjen farefisnore, Unë do i fal mirësi. Ndërsa atë që i shkëput (këto lidhje), Unë e privoj nga mirësia dhe mëshira Ime.”

(Ebu Davud, Zekat, 45/694.)

Sërish lidhur me këtë temë, Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Gjynahet që e meritojnë më shumë ndëshkimin e shpejtë të Allahut që në këtë botë, përveç ndëshkimit që do të kenë në botën tjetër, janë padrejtësia dhe shpërfillja ndaj të afërmeve.” (Ebu Davud, Edeb, 43; Tirmidhiu, Kijame,

57; Ibni Maxhe, Zuhd, 23.)

“Kush i shkëput lidhjet me të afërmit, nuk mund të hyjë në Xhenet!” (Buhariu, Edeb, 11; Muslimi, Birr, 18, 19.)

Këto ajete dhe hadithe vënë qartazi në dukje rëndësinë që kanë marrëdhëniet me të afërmit.

Së fundmi, dhënia rëndësi të afërmeve, kujdesi dhe ndihma ndaj tyre, është një çështje mbi të cilën Allahu i Madhëruar dhe Profeti ﷺ, janë ndalur shumë. Ndërsa ndihma më e rëndësishme që mund t’u bëhet atyre, është ndërtimi i botëve të tyre shpirtërore, duke këshilluar të drejtën dhe të mbarën. Më pas, t’u ndihmohet për çdo nevojë të tyre materialo-shpirtërore, duke iu gjendur pranë në ditë të mira e të këqija dhe t’u bësh vizita herë pas here.

Në urdhrin me insistim për kujdesin ndaj marrëdhënieve farefisnore, janë të fshehura plot urtësi, disa prej të cilave dihen, e disa të tjera nuk dihen nga njeriu. Detyra jonë, është t’i bindemi me gjithë shpirt urdhrin të Allahut, duke i forcuar lidhjet farefisnore dhe të presim shpërblimin vetëm prej Tij.

THIRRJA ISLAME

T'i ftosh njerëzit në besim, tek e vërteta dhe sjelljet e mira dhe t'i ndihmohet ata të largohen nga të shëmtuarat, është një prej detyrave më të mira. Pasi kjo, do të thotë t'i ftosh ata në shpëtimin e përjetshëm. Vlerën e kësaj detyre sublime, Allahu i Madhëruar na e bën të ditur me këto fjalë:

“E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: «Unë, me të vërtetë jam mysliman.»” (Fussilet, 33.)

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kush fton në rrugë të drejtë, merr sevape aq sa marrin të gjithë ata që e ndjekin. Kjo nuk i pakëson aspak sevapet e atyre që e ndjekin atë. Kurse kush fton në rrugë të keqe, merr aq gjynahe sa të gjithë ata që e ndjekin atë. Dhe kjo nuk i pakëson aspak gjynahet e atyre që e ndjekin!..” (Muslimi, Ilim, 16; Ebu Davud, Sunnet, 6; Tirmidhiu, Ilim, 15.)

Thirrja Islame dhe shërbimet fetare, janë si një “mjekësi mbrojtëse” ndaj prirjeve të egos, si për atë që shërben, ashtu edhe për atë që i shërbehet. Pra, kjo i ruan nga gabimet të dyja palët.

Resulullahu ﷺ, ka bërë një përpjekje të madhe për t'i shpallur njerëzimit ftesën e shpëtimin të përjetshëm. Prandaj, si mirënjohje dhe falënderim që kemi nderin dhe fatin të jemi Umeti i tij, edhe ne duhet bëjmë të njëjtat përpjekje. Po ashtu, edhe Resulullahu ﷺ, kërkon që kjo detyrë të vazhdohet nga Umeti i tij. Lidhur me këtë, në hadithe të ndryshme thuhet:

Në një hadith kuds, Allahu i Madhëruar ka urdhëruar:

“... Ata që nuk i shkëpusin marrëdhëniet me të afërmit dhe miqtë dhe vizitojnë njëri-tjetrin për hatrin Tim, e meritojnë edhe dashurinë Time.”

(Ahmed, V, 229.)



“Kur një mysliman mbi tokë dëshiron diçka nga Allahu, Ai patjetër ia realizon dëshirën e tij, ose ia largon një të keqe, aq sa e mira që do t’i japë, përveçse nëse ajo që dëshiron është gjynah, ose dëshirë për të shkëputur marrëdhëniet me të afërmit!”

(Tirmidhiu, Deauat, 115/3537; Ahmed, III, 18.)



“Përcillni tek njerëzit, qoftë edhe një ajet nga unë.”

(Buhari, Enbija, 50.)

“Allahu ia zbardhtë fytyrën atij që, atë që ka dëgjuar prej nesh ua përcjell të tjerëve njësoj siç e ka dëgjuar! (Sepse) ka shumë njerëz, të cilët, dijet që u përcillen i kuptojnë dhe i praktikojnë më mirë se ai që i ka dëgjuar ato.” (Tirmidhi, Ilim, 7.)

Allahu i Madhëruar ka premtuar se do ta plotësojë nurin e Tij, pra që Islami do të triumfojë. Ne edhe sikur të përpiqemi, edhe sikur mos të përpiqemi, Allahu i Madhëruar do ta mbajë premtimin. Për rrjedhojë, një mysliman i mençur mundohet të marrë hisen e tij nga ky triumf i garantuar, duke u përpjekur për thirrjen Islame.

Nëse në ndonjë kohë apo vend vihet re se jeta fetare është venitur dhe njerëzit kanë rrëshqitur në rrugë të gabuara, thirrja Islame në atë vend, vjen si detyrë parësore, pas besimit dhe farzeve. Për rrjedhojë, pa u kumtuar e drejta dhe e mbara, nuk kanë dobi as shumë prej veprave të mira. Për shembull, ushqyerja me gji e një fëmije nga nëna e saj, është një detyrë e rëndësishme. Por, nëse

nëna shikon se shtëpia e saj është duke u djegur dhe vazhdon ta ushqejë fëmijën me gji, atëherë ky është një gabim shumë i madh, sepse në ato çaste, ndërhyrja për të shuar zjarrin, është më me rëndësi dhe më emergjente sesa ushqyerja e fëmijës.

Fitimi i atij që kryen siç duhet thirrjen Islame, është më i çmuar sesa të

Në Mekë kishte rënë një skamje dhe uri e madhe. Gjendja ekonomike e Ebu Talibit ishte e dobët, kurse familja, mjaft e madhe. Prandaj ai gjendej në vështirësi. Profeti ﷺ, shkoi te xhaxhai tjetër, Abbasi ʿAbbas dhe i tha:

“O xhaxhai im! Ti e di se familja e tët vëllai, Ebu Talibit, është shumë e madhe. Njerëzit e saj vuajnë nga uria. Eja të shkojmë te Ebu Talibi dhe të bisedojmë me të. Njërën nga djemtë ta marr unë, kurse tjetrin merre ti. Kështu, t’ia lehtësojmë pak barrën!”

Abbasi ʿAbbas, e pranoi ftesën bujare dhe shkuan bashkë tek Ebu Talibi dhe i thanë:

“Ne dëshirojmë të na japësh disa nga fëmijët e tu, e të kujdesimi për ta me qëllim që të ta lehtësojmë barrën, derisa populli të shpëtojë nga kjo skamje që i ka pllakosur.”

“Akilin ma lini mua, nga të tjerët mund të merrni kë të doni!” - tha ai.

Kështu, Profeti ﷺ mori Aliun ʿAlī, ndërsa xhaxhai, Abbasi mori Xhaferrin. Aliu u rrit pranë Resulullahut ﷺ, derisa atij i erdhi shpallja hyjnore. Edhe Xhaferrin ʿAbbas, qëndroi pranë Abbasit ʿAbbas, derisa u bë mysliman dhe s’kishte më nevojë për ndihmë. (Ibn Hisham, I, 264.)

**I Dërguari i Allahut
ﷺ, ka thënë:**

**“Nëse dikush
udhëzohet për
shkakun tënd, kjo
është më e mirë
për ty sesa devetë
e kuqërremta (të
cilat janë gjëja më e
çmuar në botë).”**

(Buhari, Xhihad, 143.)

gjithë thesaret e kësaj bote.

Enesi t, transmeton:

Një ditë, Resulullahu ﷺ, tha:

“A t’ju tregoj për disa njerëz, të cilët nuk janë as profetë, e as dëshmorë? Mirëpo, Ditën e Kiametit, për shkak të gradës së tyre tek Allahu, ata do t’i kenë zili edhe profetët dhe dëshmorët.”⁴⁹ Ata janë të ulur në ulëse prej drite dhe të gjithë i njohin ata.”

Sahabët e nderuar pyetën:

“Kush janë ata, o Resulullah?”

“Ata janë njerëz, që i bëjnë robërit të dashur për Allahun dhe Allahun të dashur për robërit e Tij. Ata shëtisin në tokë duke këshilluar dhe duke shpjeguar Islamin.”-tha i Dërguari i Allahut ﷺ.

Unë pyeta:

“O i Dërguari i Allahut! Ta bësh Allahun të dashur për robërit, e kuptojmë! Por si mund t’i bësh robërit të dashur për Allahun?”

Ai u përgjigj:

*“Ata i urdhërojnë
njerëzve ato që pëlqen
Allahu dhe i pengojnë
nga ato që nuk i pëlqen
Ai. Dhe, kur njerëzit u
binden këtyre, Allahu i*



49. Qëllimi i kësaj shprehjeje, është që të tregojë vlerën që kanë njerëzit që gjenden në rrugë të kumtesës Islame. Kjo nuk do të thotë se ata janë më lart se profetët dhe dëshmorët, pasi edhe vetë profetët dhe dëshmorët janë njerëz që kanë sakrifikuar jetën e tyre për kumtesën Islame.

Madhëruar i do ata.” (Ali el-Muttaki, III, 685-686; Bejhaki, Shuab, I, 367.)

Sufjan eth-Theuri ka thënë:

“Të shkosh në Horasan për të predikuar Islamin, është më me fitim për ty sesa të banosh afër Mekës!”

Ndërsa neglizhenca në thirrjen Islame, mund të lindë pasoja aq të rrezikshme, sa mund të çojë në shkatërrim një popull të tërë. Për këtë arsye, duhet bërë kujdes ndaj këtij qortimi që bën i Dërguari i Allahut **ﷺ**:

“Betohem në Allahun që më dhuron jetë se, ju ose do të urdhëroni të mirën dhe të ndaloni të keqen, ose Allahu do t’ju dërgojë ndonjë dënim, e atëherë do të luteni, por lutja nuk do t’ju pranohet!” (Tirmidhi, Fiten, 9.)

Kjo ngjarje e shpjegon më së miri rëndësinë që ka ftesa në punë të mira dhe pengimi nga e keqja:

Në bregun e Detit të Kuq, në qytezën Ejle jetonte një popull prej Bijve të Izraelit. Ky popull, në vend që të shtunave t’i linin të gjitha punët dhe të merreshin me adhurime, ata e shkelnin urdhrin hyjnor dhe dilnin të peshkonin. Për këtë arsye, ata u quajtën **As’habus-sebt** (populli i të shtunës).

Populli aty ishte ndarë në dy pjesë:

- 1- Njerëzit gjynahqarë që shkelnin ndalesat.
- 2- Njerëzit besimtarë dhe bamirës.

Njerëzit që ishin të lidhur me fenë, shpjegonin të drejtën dhe të shtrembëtën, por nuk mundeshin t’i bindnin gjynahqarët. Përfun-dimisht, edhe të mirët u ndanë në dy grupe:

- 1- Ata që i këshillonin shke-lësit e ligjit, por



Shërbimi i kumtesës, i cili zbukuron edhe këtë botë, edhe botën tjetër të njerëzve, është forma më e bukur e manifestimit të falënderimit dhe mirënjohjes sonë ndaj Allahut, për dhuntinë e besimit që Ai na ka dhuruar. A mund të mendohet ndonjë mirësi më e mrekullueshme për besimtarin, sesa ky laudërim që i bën Allahu i Madhëruar:

“E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: «Unë, me të vërtetë jam mysliman.»”

(Fussilet, 33.)



Është shumë interesant fakti se, në Ligjëratën e Lamtumirës, ishin të pranishëm rreth 120.000 sahabë. Mirëpo, prej gjithë këtyre sahabëve, vetëm 20.000 prehen në varrezat e Mekës dhe Medinës. Ndërsa të tjerët janë të përhapur në mbarë botën për të kumtuar Islamin dhe fjalën e Allahut të Madhëruar. Dhe, vendi i fundit që kanë mbërritur ka qenë varri i tyre.

që pas një farë kohe u mërzitën dhe humbën shpresën, duke e braktisur detyrën e kumtesës.

2- Besimtarët që vazhduan të qortonin dhe këshillonin njerëzit, duke u bërë ballë të gjitha vështirësive pa e humbur shpresën.

Lidhur me këta, në Kuranin

fisnik urdhërohet:

“Kur disa prej tyre thanë: «Përse këshilloni, kur e dini se Allahu do të na zhdukë ose do të na ndëshkojë ashpër?!» Këshilltarët u përgjigjën: «Për t’u arsyetuar para Zotit tuaj dhe që ju të mund të ruheni nga gjynahet!»» (A’raf, 164.)

Pas një farë kohe, ata që nuk iu bindën urdhrave hyjnorë, u dënuan duke u shndërruar në majmunë. Sipas disa komentuesve të Kuranit, në mesin e atyre që u dënuan, ishin edhe ata që shpërfillën detyrën e kumtit.

Fatzinjtë që u shndërruan në majmunë, për një farë kohe gjezdisën të dëshpëruar pranë të afërmeve të tyre që shpëtuan nga dënimi, të cilët u thoshin:

“A nuk ju porositëm ju që të ruheshit nga gjynahet?”

Ndërsa ata, tundnin kokat me lot në sy. Pas tre ditëve, të gjithë ata që ishin shndërruar në majmunë, vdiqën.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Allahu i Madhëruar nuk i dënon të pafajshmit për shkak të gjynaheve që bëjnë shumica. Përveç atyre që e shohin veprimin e gjynahut dhe nuk bëhen pengesë, megjithëse kanë fuqi ta bëjnë këtë.” (Ahmed, V, 192.)

Ajo çfarë është me rëndësi në misionin e ftesës për

Një ditë, Resulullahu ﷺ, hipi në minber dhe mbajti një ligjëratë. Pasi përmendi për mirë disa nga myslimanët, tha:

“Çfarë kanë disa që nuk ua tregojnë çështjet fqinjëve, që nuk ua mësojnë ato që ata s’i dinë, që s’i bëjnë ata të kuptueshëm, që s’i këshillojnë për të mirë dhe s’i ndalojnë nga gjërat që feja i sheh si të këqija?

Po disa të tjerë, ç’kanë që nuk pyesin dhe nuk mësojnë nga fqinjët për gjërat që s’i dinë dhe s’bëjnë përpjekje për t’u bërë të kuptueshëm?

Betohem në Allahun se, ose të diturit do t’ua mësojnë fqinjëve ato që s’i dinë duke i bërë edhe ata të ditur e të kuptueshëm, do t’ua këshillojnë të mirën dhe do t’ua ndalojnë të keqen dhe, po ashtu, edhe të paditurit do t’i pyesin fqinjët dhe do të mësojnë e përpiqen për t’i kuptuar çështjet fetare, ose, në të kundërt, (që të dy grupet) do t’i ndëshkoj në këtë botë!”

Pas këtij fjalimi, Profeti ﷺ, zbriti nga minberi dhe shkoi në shtëpi. Disa prej të pranishmëve thanë:

“Na duket se e pati fjalën për esh’aritë (jemenas) sepse ata janë njerëz të ditur, kurse fqinjët e tyre janë beduinë të trashë, e me natyrë të ashpër që jetojnë pranë oazeve!”



Kur esh'aritë e morën vesh këtë, erdhën te i Dërguari i Allahut ﷺ dhe i thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Ti ke përmendur një popull për të mirë, kurse ne për të keq. Çfarë nuk ju pëlqen tek ne?”

Profeti ﷺ, nuk tha asgjë, vetëm përsëriti fjalët që kishte thënë më parë. Mirëpo, esh'aritë nuk po e kuptonin dot nëse ishte fjala për ta, apo jo. Prandaj, për ta mësuar më mirë këtë, e pyetën disa herë të Dërguarin e Allahut ﷺ. Ndërsa ai, për çdo radhë përsëriti të njëjtat fjalë. Prandaj, esh'aritë i thanë:

“Atëherë, na jep një vit afat!”

I Dërguari i Allahut ﷺ u njohu një vit afat që ata t'ua mësonin fqinjëve çështjet fetare, dhe më pas këndoi këto ajete:

“Ata izraelitë që ishin mohues, u mallkuan me gjuhën e Dautit dhe të Isait, të birit të Merjemes, për shkak se kundërshtonin, shkelnin çdo kufi dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrin të bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!” (el-Maide, 78-79)

(Hajthemi, I, 164; Ali el-Muttaki, III, 684/8457)

kumtim dhe këshillim të së vërtetës, është përpjekja me të gjitha mundësitë në këtë rrugë me shpresën për të fituar kënaqësinë e Allahut të Madhëruar. Në fakt, edhe pse mund të jenë përdorur të gjitha mundësitë, mundet që të mos arrihen rezultatet e duhura. Por sidoqoftë, kjo gjë nuk duhet të shkaktojë dëshpërim e as demoralizim, sepse Ai që do të dhurojë udhëzimin, është Allahu. Ndërsa njeriut i takon të vazhdojë kumtesën Islame, duke iu mbështetur Allahut me besim të plotë, pa u mërzitur dhe pa u dëshpëruar.

Çështje që duhen pasur kujdes gjatë thirrjes Islame

Ashtu sikurse për çdo punë ka një metodë dhe rregull, edhe për thirrjen Islame ka parime shumë të rëndësishme që duhen ndjekur. Kumtimi në mënyrën e duhur, është po aq i rëndësishëm sa edhe vetë kumtesa. Kjo, sepse është e pamundur të pritët ndonjë dobi nga kumtimi që bëhet në një mënyrë të gabuar. Në të njëjtën kohë, kjo të ngarkon edhe me një gjynah të rëndë. Pasi këtu ka rrezik që, në vend të heqësh vetullat, mund të nxjerrësh sytë.

Pikat kryesore që duhen pasur kujdes në kumtimin e thirrjes Islame mund të radhiten si më poshtë:

- Para së gjithash, për të kumtuar të vërtetën dhe këshilluar të mbarën, duhet të njohësh dhe të jetosh drejtë, **të vërtetën** dhe **të mbarën**, sepse, kumtesa që bën i padituri është e mbushur

Një sahab ishte duke u ekzekutuar nga armiqtë. Para ekzekutimit, ekzekutuesi i dha tre minuta kohë, për të cilën sahabi e falënderoi dhe i tha:

“Domethënë, kam tre minuta kohë për të të kumtuar të vërtetën. Shpresohet të udhëzohesh!”



**“Ruajuni
ngatërresave, të
cilat nuk i godasin
vetëm ata që bëjnë
keq; dhe ta dini
se Allahu dënon
ashpër!”**

(Enfal, 25.)

me gabime, si nga aspekti i metodës, ashtu edhe nga aspekti i përmbajtjes.

- Për një kumtesë të pranueshme, duhet të zotërosh një shpirt delikat dhe një fytyrë të buzëqeshur që pasqyron bukurinë e Islamit. Po ashtu, duhet të bësh një jetë shembullore, të flasësh me një gjuhë shpirtërore që përhap mëshirë dhe të mos e shpërfillësh kurrë edukatën dhe delikatesën, sepse njerëzve nuk u pëlqen vrazhdësia dhe mungesa e edukatës.

Mevlana i nderuar ka thënë:

“Kur të qorton për shkak të ndonjë gabimi, edhe babai yt të duket agresiv dhe i tmerrshëm si një egërsirë...”

“Ky është efekti i shqetësimit që buron nga qortimi dhe vuajtja që të shkakton ai. Pra, edhe pse qortimi i babait është për të mirën tënde, qortimi dhe vuajtja që të shkakton ai, bën që mëshira dhe dhembshuria në zemrën e tij të duken si përbindësh...”



- Çfarëdo gjynahu dhe gabimi të ketë bërë, askush nuk duhet privuar nga kumtesa dhe ftesa në Islam. Me mendimin se edhe nga një shkëmb, madje edhe nga një mur mund të çelin sa e sa lule e bimë, askush nuk duhet privuar nga kjo mirësi, sepse mëshira e Allahut është e pakufishme.

Lidhur me këtë çështje, Profeti ﷺ, është shembulli më i mirë. Ai nuk ia mbylli derën e kumtesës Islame,

As Hebbar ibn Esved-it, i cili u bë shkak i vdekjes së vajzës së tij, Zejnebes, duke e rrëzuar nga deveja;

As Ikrimë ibn Ebu Xhehilit, i cili shfaqti të gjithë armiqtë e mundshme ndaj tij, deri në ngadhënjimin e Mekës;

As Vahshiut, i cili e martirizoi xhaxhain e tij, Hamzanë;

E as të shoqes së Ebu Sufjanit, Hindit, e cila kafshoi me plot mllef mëlçinë e xhaxhait të tij të martirizuar.

Po ashtu, edhe Vetë Allahu i Madhëruar kur e urdhëroi Musain **U**, të shkonte tek Faraoni, i cili kishte vrrarë me mijëra foshnje dhe pretendonte se ishte zot, e porositi t'i fliste atij me gjuhë të butë.

-Këshilluesi duhet të jetë si një riparues artist. Riparuesit i vijnë gjëra të prishura. Nëse gjërat nuk do të prisheshin, ose nëse nuk të silleshin tek ai për t'u riparuar, riparuesi nuk do të kishte mundësi ta ushtronte profesionin. Për këtë arsye, gjërat e prishura janë mirësi në syrin e riparuesit. Kësisoj, përcmimi i gjynahqarëve, përbuzja dhe dëbimi i tyre është veprim i gabuar. Një thirrës i vërtetë, i shikon gjynahqarët si zogj



Ebu Hurejre **ṭ, tregon:**

Dëgjonim (ndër sahabë këtë të vërtetë): Ditën e Kiametit, dikë do ta kapi për fyti një njeri i panjohur. Njeriu habitet dhe thotë:

“Ç’do nga unë? Unë as që të njoh ty!”

Kurse njeriu që e ka kapur për fyti, i thotë:

“Kur ishim në atë botë dhe më shihje në gabime e gjynahe, nuk më qortoje, e as më pengoje prej të këqijave.”

(Mundhiri, et-Tergib, III, 164/3506; Rudani, Xhemul-feuaid, V, 384.)

“A mos vallë ti (o Muhamed) do ta shkatërrosh veten, ngaqë ata (banorët e Mekës) nuk duan të besojnë?”

(Shuara, 3.)

“O Ali! Nëse Allahu e udhëzon dikë përmes teje, kjo është më e vyer për ty sesa gjithçka mbi të cilën lind Dielli!”

(Hakim, Mustedrek, III, 690.)

të plagosur dhe, duke i pranuar në sarajin e zemrës së tij, përpiqet t'i shërojë me mëshirë dhe duar të buta, pa i trembur dhe pa i bërë të ikin.

Asnjë mjek i denjë, nuk i mërzitet të sëmurit, duke i thënë: “Përse je sëmurë?”. Por, duke pasur parasysh dhimbjen dhe vuajtjen që ndjen ai, pa humbur kohë, i drejtohet plot dashuri dhe mëshirë për ta shëruar. Ai e ndjen veten përgjegjës për kurimin e tij. Kështu pra, edhe një i ri besimtar, duhet të jetojë në mesin e shoqërisë, me vetëdijen e një mjeku që shëtit nëpër dhomat e spitalit. Kur kjo ndjenjë, arrin të mbizotërojë sjelljet, atëherë bëhet jelek shpëtimi për ata që kanë devijuar nga rruga.

- Thirrësi duhet të gjejë një damar që të depërtojë në zemrën e bashkëbiseduesit, sepse çdo njeri ka natyrë të veçantë dhe jo çdokush mund të ndikohet nga të njëjtat gjëra.

Përkufizimi më i mirë që mund të bëhet për këtë çështje, është ky hadith i të Dërguarit të Allahut ﷺ:

“Lehtësoni, e mos vështirësoni! Përgëzoni, e mos ngjallni urrejtje!..” (Buhariu, Ilim, 11.)

Natyrisht, me kusht që të mos dëmtohet thelbi i fesë dhe të devijohet nga rruga e drejtë...



KUJDESI NDAJ HALLALLIT DHE HARAMIT

Të gjitha dhuntitë që zotëron njeriu, janë dhuratë e Allahut të Madhëruar. Po ashtu, këto dhunti janë amanete, për të cilat një ditë do të jepet llogari, sepse **“njeriu nuk është krijuar pa qëllim!”** Një ditë **“ai do të kthehet tek Allahu dhe do të japë llogari!”**⁵⁰

Për rrjedhojë, ndërkohe që përdorim dhuntitë shpirtërore dhe materiale që kemi, nuk duhet të mendojmë se jemi plotësisht të lirë. Ne jemi të detyruar t'i përdorim ato në mënyrë që të fitojmë pëlqimin e Allahut, i Cili na e kujton kështu këtë përgjegjësi:

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote!)” (Tekathur, 8.)

Pra, Allahu i Madhëruar ka vendosur disa rregulla që duhet t'i respektojmë, si kur i fitojmë mirësitë e Tij, ashtu edhe kur i përdorim ato. Këto janë shpallur si, “hallalle/të lejuara” dhe “hareme/të ndaluara”.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“O njerëz! Ushqehuni me të gjitha ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë dhe mos ndiqni gjurmët e djallit, sepse ai është njëmend armiku juaj i hapur.” (Bekare, 168.)



Harami ka dënim, ndërsa hallalli llogari. Ashtu si pasuria që nuk fitohet në rrugë hallall, edhe mirësitë



“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme.”

(Al-i Imran, 159.)

50. Shih. Mu'minun, 115.



Profeti ƒ , kishte fqinj një djalë hebre, i cili nuk kishte edukatë të keqe. Një ditë, ai u sëmur dhe Resulullahu ƒ , i shkoi për vizitë bashkë me sahabët e tij.

Ndërkohë, Resulullahu ƒ , e pyeti atë:

“A dëshmon se përveç Allahut nuk ka zot tjetër dhe se unë jam i Dërguari i Allahut?”

Djaloshi e pa të atin. I ati heshti, edhe djali heshti. Profeti ƒ , e përsëriti pyetjen për së dyti, pastaj për së treti. Pas të tretës, i ati tha:

“Thuaje fjalën që të ofrojnë të thuash!”

I riu tha shehadetin dhe pas një farë kohe ndërroi jetë. Ndërkohë, kur hebrenjtë nuk pranuan t'i dilnin për zot, Resulullahu ƒ , tha:

“Ne jemi më afër tij, sesa ju!”

Më pas, Profeti i nderuar ƒ , e lau atë, e qefinosi, e leu me erë të mirë dhe ia fali nama-zin. (Abdurrezak Musannef, VI, 34 - 35.)

hallall që nuk përdoren sipas pëlqimit të Allahut, do të jenë një përgjegjësi e madhe për të zotin në botën tjetër.

Të jesh i kujdesshëm ndaj hallallit dhe haramit, është një nga shkaqet më të rëndësishme që ndikon në rrjedhën e jetës së njeriut. Kjo, sepse hallalli bëhet shkak për hallall, kurse harami i hap rrugën një tjetër harami.

Gjatë një bisede, Ebu Bekr Verrak tha:

“Kur zgjohem në mëngjes dhe shoh njerëzit, e kuptoj se kush ka ngrënë hallall, e kush haram!”

Nxënësit e tij, pyetën me kureshtje:

“Si e kuptoni këtë?”

Ai e shpjegoi kështu:

“Nëse dikush, me t’u zgjuar në mëngjes, fillon të flasë fjalë të kota, përgojon dhe shan, e kuptoj që kjo vjen nga ushqimi haram që ka konsumuar. Por nëse dikush, që sapo zgjohet, ka në gjuhë dhikrin, shehadetin dhe istigfarin, ai njeri ushqehet me hallall... Kjo, sepse edhe hallalli, edhe harami pasqyrohet në veprimet e njerëzve, sipas veçorive të tyre...”

Krahas ndikimit fizik, ushqimi që hamë ka edhe ndikimin shpirtëror. Kafshata ndikon në shpirtin tonë në çfarëdolloj mënyre të ketë ardhur, hallall, haram apo e dyshimtë qoftë.

Mevlana ka thënë:

“Kafshatat, janë si fara. Frutat e saj janë idetë,



T’i ftosh njerëzit tek Allahu dhe e vërteta, duke i këshilluar për mirë dhe duke i penguar nga e keqja, është shërbimi më i mirë dhe më jetik që mund t’u bësh atyre. Për të zbatuar Librin e Zotit dhe Sunetin profetik në jetën tonë, para së gjithash është kusht që detyra e thirrjes Islame dhe shërbimit ndaj njerëzve të bëhet e dashur në zemrën tonë...

mendimet dhe qëllimet. Kafshatat që të frymëzojnë duke zgjuar tek ti dëshirën, pasionin dhe oreksin për adhurim dhe bindje, janë hallall. Kurse kafshatat që shqetësojnë zemrën, duke ndjellë përtacinë ndaj adhurimit dhe bindjes, janë haram. Shtoji pra kafshatat hallall në jetën tënde! E largohu prej kafshatave të dyshimta dhe haram, me qëllim që të arrini përkushtimin, duke shijuar kënaqësinë e adhurimit dhe bindjes!”

Kujdesi që tregohet ndaj hallallit dhe haramit, është një kriter që tregon nëse janë pranuar apo jo adhurimet. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka treguar se si dikujt që shkoi për Haxh me para haram, i ka ardhur një zë nga qielli dhe i ka thënë:

“Për ty, s’ka as lebejk, e as sa’dejk, sepse fitimi yt është haram, ushqimi yt haram dhe kafsha që ke hipur haram! Kthehu si gjynahqar, pa marrë asnjë sevap! Pikëllohu, ngaqë do të përballesh me atë që nuk të pëlqen!” (Hajthemi, III, 209 - 210.)

Një vëlla yni, që dikur punonte në Austri, na tregoi këto kujtime të tij:

“Dikur kam qenë një njeri i varur nga pija dhe kumari. Megjithëse çdo ditë e imja ishte përherë e më e keqe se dita e mëparshme, unë pandehja se po i jetoja në maksimum ditët e mia. Më vonë shkova si punëtor në Austri. Mirëpo, as atje nuk arrita t’i braktis dot këto vese të shëmtuara. Natyrisht që, kur isha në këtë gjendje, ashtu sikurse në Turqi, edhe aty kisha përreth njerëz zemërbardhë dhe dashamirës nga xhemati i xhamisë që përpiqeshin të më shpëtonin. Mirëpo, saherë që ata më këshillonin, unë i kundërshtoja dhe ua ktheja me fjalë të rënda.

Një ditë, duke ecur në rrugë, papritur m’u errësuan



sytë dhe pa e kuptuar rashë përdhe. Pastaj, hapa sytë në spital. Kisha pësuar hemorragji në stomak dhe fqinjët më kishin sjellë në spital. Përveçse nuk kisha para që të paguaja spitalin, unë kisha edhe shumë borxhe për shkak të pijes dhe kumarit. Kur dëgjova se pas pak do të më vinin disa vizitorë, u habita! Ndërkohë që po mendoja se kush mund ta vizitonte një njeri si unë, që kishte devijuar kaq shumë rrugën, u habita edhe më shumë, kur pashë ata që hynë në dhomë. Kjo, sepse ata që kishin ardhur për vizitë, nuk ishin shokët e mi prej botës së shëmtuar në të cilën kisha rënë, por njerëzit e xhematit të xhamisë së lagjes ku banoja. Pasi më uruan të shkuara, më dhuruan një buqetë me lule dhe më lanë një zarf, duke menduar se mund të më nevojiteshin. Ndërkohë që unë, i turpëruar, nuk po dija ç'të thosha përballë kësaj bujarie, ata më thanë se kishin menduar edhe për familjen e tij dhe se do ta ndihmonin edhe familjen time derisa unë të dilja nga spitali. Ajo çfarë munda të bëja përballë kësaj bujarie, mirësjelljeje dhe tolerance, ishte vetëm që t'u thosha faleminderit.

Sapo dola nga spitali, e mbajta frymën drejt e tek xhemati i xhamisë, sepse ata më ishin gjendur pranë në ditë të vështira. Hyra në xhami dhe, ashtu si dikush që pi ujë i djegur nga etja, edhe unë dola para Zotit tim, u pendova dhe rashë në sexhden e falënderimit. U luta që të përmirësohesha dhe të bëhesha një besimtar i mirë. Më pas, duke menduar, "se sa e bukur është kjo fe, që u ka dhënë virtyte kaq të larta këtyre njerëzve", nisa të mësoj dhe ta praktikoj fenë time."

“Haramet janë një zjarr! Atyre u zgjasin dorën vetëm ata që janë (me zemër) të vdekur. Nëse ata që u zgjasin dorën do të ishin të gjallë, do ta ndjenin djegien e atij zjarri.”

(Omer ibn Abdulaziz -rahmetullahi alejhi-)

Kujdesi ndaj mbulesës Islame

Kujdesi ndaj kufijve të hallallit dhe haramit, nuk duhet të jetë vetëm në ngrënie, pirje, apo marrëdhënie tregtare, por edhe në çështje që në ditët tona konsiderohen të thjeshta, siç është veshja.

Për të ruajtur dinjitetin dhe seriozitetin njerëzor që i ka dhuruar Allahu i Madhëruar, njeriu është i obliguar të mbulohet. Përndryshe, këto cilësi njerëzore shkojnë dëm. Nëse njeriu nuk bën kujdes ndaj kushteve që ka vënë feja në lidhje me veshjen, mund të bjerë në nivelin e krijesave që janë shumë më të ulëta se ai, për nga aspekti i nderit dhe dinjitetit. Kjo, sepse mbulesa ka lidhje të drejtpërdrejtë me turpin. Dhe, turpi, si një veçori që i përket vetëm njeriut, është një prej degëve të besimit.⁵¹

Ademit **U** dhe nënës sonë Havasë, iu zbuluan vendet e turpshme të trupit kur ata hëngrën prej pemës së ndaluar në Xhenet. Mirëpo, ata u turpëruan, megjithëse nuk kishin njeri tjetër përreth. Më pas, të

shqetësuar, u përpoqën të mbulohen me gjethet që gjendeshin aty rrotull. Kjo tregon se, mbulesa materiale dhe ana e saj shpirtërore, që është edukata dhe turpi, janë prej veçorive më rrënjësore që gjenden në natyrën njerëzore dhe tregues të devotshmërisë.

Ndaj, një i ri besimtar, nuk duhet ta marrë lehtë temën e



Një person nga ensarët tregon:

“...Kur Resulullahu ﷺ, po kthehej nga një xhenaze që e kishte varrosur, erdhi shërbëtori i një gruaje dhe e ftoi në shtëpi. Ndërsa Profeti ﷺ, iu përgjigj ftesës bashkë me sahabët. U soll ushqimi dhe i Dërguari i Allahut ﷺ, e zgjati dorën për të marrë. Më pas, të gjithë ata që ndodheshin në sofër filluan të hanin.

Mirëpo, ata vunë re se Resulullahu ﷺ, po mbante kafshatën në gojë dhe nuk po e gëlltiste. Më pas tha:

«*Ky është një mish deleje, që është marrë pa lejen e të zotit!*»

Për këtë arsye e lajmëruan menjëherë gruan, e cila erdhi dhe u shpjegoi çështjen:

«O Resulullah! Për të blerë këtë dele, dërgova një njeri në Baki¹, por nuk arriti të merrte gjë. Fqinji im kishte blerë një dele. Unë i çova fjalë dhe ia kërkova atë dele kundrejt çmimit. Mirëpo, për shkak se fqinjin nuk e gjetëm në shtëpi, unë lajmërova gruan e tij, e cila ma dha delen.»

Resulullahu ﷺ, që po dëgjonte këtë ngjarje, tha:

«Jepua ta hanë robërit e luftës!» (Ebu Davud, Buju, 3/3332; Ahmed, V, 293.)

1. Në disa transmetime të tjera është në formën Naki¹, i cili është një vend ku shiten dele pranë Medinës. Hattabi thotë se ky variant është i sakti. Edhe në Mishkat kalon në këtë mënyrë.



*“Këtë mëngjes,
m’u ndërpre
frymëzimi. Kështu
e kuptova se në
trupin tim kanë
hyrë disa kafshata
të dyshimta. Dija,
urtësia, dashuria
dhe mëshira, lindin
nga kafshata e
hallallit. Nëse prej
një kafshate vjen
gafleti/indiferenca,
dije se ajo kafshatë
është e dyshimtë
ose haram!”
(Mevlana)*

veshjes. Lidhur me këtë, duhen ndjekur urdhrat hyjnorë, duke respektuar normën e veshjes Islame. Dhe, gjatë zbatimit të këtij urdhri, duhet bërë shumë kujdes edhe nga luksi i tepërt dhe shpërdorimi, duke u veshur në mënyrë dinjitoze për një mysliman.

Gratë duhet të mbulojnë të tërë trupin, përveç duarve, fytyrës dhe këmbëve; kurse burrat duhet të mbulohen nga gjuri tek kërthiza. Është e ndaluar veshja me rroba aq të holla, sa të shfaqen pjesët e turpshme të trupit, e as aq ngushtë sa të duken linjat e trupit. Jashtë këtyre, me kusht që të bëhet kujdes në veshjen Islame, gjithkush është i lirë të vishet sipas shijes personale apo lokale, apo sipas kulturës.

Resulullahu ﷺ, kur pa që motra e madhe e nënës sonë Aishja ؓ, Esmaja, kishte veshur një rrobë transparente, ka kthyer kokën dhe, duke i treguar fytyrën dhe duart, i ka thënë:

“Esmā! Pasi femra hyn në moshën e pubertetit, nuk është e drejtë që ajo të shfaqë tjetër pjesë nga trupi, përveç këtyre e këtyre!” (Ebu Davud, Libas, 31/4104.)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka ndaluar që gratë dhe burrat t’u ngjajnë njëri-tjetrit në veshje. Ai na ka bërë të ditur se, meshkujt që vishen si femra dhe femrat që vishen si meshkuj, do të mbeten larg mëshirës hyjnore.⁵²

52. Shih. Buhariu,

Zinjaja

Një nga pikat që feja Islame dëshiron të realizojë, është edhe ruajtja e brezave dhe formimi i një shoqërie të shëndoshë. Një nga problemet më të mëdha të kohës, është deformimi moral. Prostitucioni, i cili shkatërron brezat dhe jetën familjare, prish edhe moralin dhe botën shpirtërore të njeriut. Në të njëjtën kohë, ai shkakton edhe shumë sëmundje.

Për këtë arsye, të gjithë profetët, që prej Ademit **U**, kanë treguar seriozitet të madh në çështjen e martesës, shpëtimin e njerëzimit, sepse mbrojtja e tij, është e mundur në sajë të një institucioni të shëndetshëm familjar. Brezat e krijuar jashtë martesës, të cilët nuk edukohen në familje, e prishin harmoninë e jetës shoqërore dhe e tronditin nga themelet rendin shoqëror.

Natën e Miraxhit, Resulullahu **Γ** me Xhibrilin **U**, kanë takuar disa njerëz duke vuajtur. Para tyre kishte mish të shijshëm të pjekur mirë dhe cofëtina të papjekura e të kalbura. Mirëpo, ata e linin mënjanë mishin e pjekur aq mirë dhe hanin mishin e cofëtinave. I Dërguari i Allahut **Γ**, i habitur pyeti se kush ishin ata. Xhibrili **U**, iu përgjigj:



Suffjan eth-Theuri, ka thënë:

“Fetaria e njeriut është aq sa ushqimi që ka hallall!”

Një ditë, e pyetën:

“I nderuar! A mund të na tregosh mbi virtytet e faljes së namazit në rresht të parë?”

Ai duke theksuar përsëri rëndësinë e kafshatës hallall, u përgjigj:

“Vëlla i dashur! Ti shiko se nga e fiton bukën tënde! Nëse fitimi yt është hallall, fale namazin në cilindo rresht të kesh dëshirë. Lidhur me këtë s’ke asnjë problem.”

Ishte natë. Siç e kishte bërë zakon, kalifi Omer **ؓ**, po shëtiste nëpër rrugët dhe rrugicat e Medinës, kur, papritur ndali. Zonja e shtëpisë pranë së cilës po kalonte, po thoshte:

“Moj bijë, hidhi pak ujë qumështit që kemi për të shitur nesër!”

Kurse vajza ia ktheu:

“Nënë, a nuk ka thënë kalifi që të mos i përziejmë qumështit ujë, a nuk e ka ndaluar ai një gjë të tillë?”

Duke iu kundërvënë ashpër të bijës, e ëma i tha:

“Moj bijë, e ku do ta marrë vesh kalifi në këtë orë të natës se po i hedhim ujë qumështit?”

Mirëpo, vajza që e kishte zemrën të gjallë prej frikë-respektit ndaj Allahut, përsëri s’e pranoi dredhinë e nënës për t’i hedhur ujë qumështit:

“Moj nënë! Ta zëmë se kalifi nuk sheh, po Allahu, as Ai nuk sheh? Ta fshehësh këtë hile nga njerëzit është e lehtë, por, a është e mundur ta fshehësh nga Allahu, Krijuesi i Gjithësisë, i cili sheh dhe di gjithçka?”

Përgjigjja me një ndjenjë frike të thellë ndaj Allahut, që ajo vajzë me zemër të mbushur plot me të vërteta hyjnore, i dha të ëmës, e preku thellë kalifin Omer **ؓ** ! Udhëheqësi i myslimanëve, duke e konsideruar atë vajzë jo si një njeri të thjeshtë, bijë e shitëses së qumështit, por si një mirësi me një devotshmëri të veçantë që kishte në zemër, e mori atë si nuse për të birin. Ja pra, edhe Omer ibn Abdulaziz, i cili konsiderohet si një prej kalifëve të drejtë, është nipi i kësaj gruaje të devotshme. (Shih. Ibnu’l-Xheuzi, Sifatus-Safve, II, 203 - 204.)

“Ata janë meshkujt prej Umetit tënd, të cilët kanë lënë gratë e tyre hallall dhe kanë shkuar me gratë që i kanë pasur haram dhe gratë që kanë lënë burrat e tyre dhe kanë shkuar me burrat që i kanë pasur haram.”
(Hajthemi, I, 67 - 68.)

Për t’u ruajtur nga rreziku i zinasë/kurvërisë, duhet respektuar me rigorozitet urdhri i Allahut: **“Mos iu qasni zinasë!...”** (Isra, 32.) Në këtë ajet të Kuranit, është ndaluar fuqimisht, jo vetëm zinaja, por të gjitha veprimet që të afrojnë tek ajo. Për shembull, shikimi i haramit është njëri prej tyre.

Xheriri **ت**, ka thënë kështu:

E pyeta **të Dërguarin e Zotit** **ر**, lidhur me dispozitën e shikimit padashje të haramit dhe ai m’u përgjigj:

“Ktheji menjëherë sytë në anën tjetër!” (Muslim, Adab, 45. Shih: Ebu Davud, Nikah, 43; Tirmidhiu, Edeb, 28.)

Në fakt, ai që sheh haramin, ka kryer **“zina syri”**. Po ashtu, edhe dëgjimi i haramit është zina e veshëve, të folurit- zina e gjuhës, prekja- zina e dorës, ecja- zina e këmbëve, mendimi dhe dëshira është zina e zemrës dhe e egos, përmes të cilave drejtohesh nga harami.⁵³

Resulullahu **ر**, lidhur me këtë temë ka thënë:

“Shikimi i haramit është një prej shigjetave të helmuara të Iblisit. Kushdo që e braktis shikimin e haramit për shkak të frikës ndaj Allahut, Ai do t’i dhurojë një besim, ëmbëlsinë e të cilit do ta ndiejë në zemër.” (Hakimi, IV, 349/7875.)



Në Kuranin Famëlartë, është urdhëruar që kur gratë të dalin jashtë, të veshin sipër një mbulesë (xhilibab), që meshkujt dhe femrat duhet të ruajnë shikimet e tyre nga harami dhe të ruajnë nderin e tyre. Po ashtu, është urdhëruar që gratë të bëjnë kujdes të mos tregojnë pjesët e trupit dhe të vënë mbulesat e kokës, në mënyrë që të mbulojnë kraharorët e tyre.

(Shih. El-Åhzab, 59; Nur, 30 - 31, 60.)

53. Shih. Buhariu, Isti’zan 12, Kader 9; Muslimi, Kader 20 - 21.

Fatkeqësisht, ditët e sotme, përmes mediave të shkruara dhe vizuale, veçanërisht nëpërmjet programeve negative të televizionit dhe faqeve të dëmshme të internetit, gjynahu i zinasë ka mundur të hyjë lehtësisht në shtëpitë e njerëzve. Ata që synojnë shkatërrimin e brezave të rinj, abuzojnë me këto mjete në mënyrë të paskrupullt.



Në një kohë kur haramet më të shëmtuara janë përhapur kaq shumë dhe gjynahet që përbëjnë kërcënim për jetën janë lehtësuar kaq shumë, ekziston vetëm një rrugë për të ruajtur veten: **Të mos e harrojmë asnjëherë Zotin tonë...**

Çastet kur njerëzit bien në gjynahe, duke u përlyer me harame, janë pikërisht ato kur harrohet Zoti i Madhëruar. Gjynahet që bëhen me apo pa vetëdije,

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Prej banorëve të Xhehenemit, janë edhe dy grupe që akoma nuk i kam parë (të cilët do të dalin më vonë):

Njëri është grupi që i rrahin njerëzit me kamxhikë si bishta lopësh. Kurse tjetri, janë gratë që duken të zhveshura, ndërkohë që janë të veshura, që imponojnë të tjerët të vishen si ato dhe kokat e të cilave i ngjajnë gungës së deveve. Ja pra, pikërisht këto gra nuk mund të hynë në Xhenet. Madje ato nuk do të arrijnë që të ndiejnë as aromën e tij që ndihet prej larg.” (Muslimi, Xhennet, 52.)

Me shprehjen “të zhveshurat, e veshura”, bëhet fjalë për ato që nuk vishen vetëm për zbukurim, por që kur dalin jashtë veshin rroba për të rënë në sy dhe për të qenë tërheqëse, të cilat janë të tejdukshme dhe të ngushta, aq sa të duken të gjitha linjat e trupit.

bëhen shkak që të ndotet dhe të ndryshket zemra, e cila është qendra e ndjesisë shpirtërore. Si përfundim, zemra verbohët dhe, ashtu siç nuk kënaqet nga gjërat e mira dhe të bukura, ashtu edhe nuk shqetësohet aspak prej gjërave të shëmtuara dhe të këqija, duke e pandehur mjerimin lumturi.

Nëna e të gjithë të këqijave është pija alkoolike

Me urdhrat dhe ndalesat që ka vendosur, Islami synon të mbrojë këto pesë gjëra:

Fenë, mendjen, jetën, brezin dhe pasurinë.

Çdo sjellje që dëmton këto pesë parime, të cilat zënë një vend të rëndësishëm në jetën e njeriut, është shpallur haram nga Allahu i Madhëruar.

Pijet alkoolike i bëjnë dëm fesë, mendjes, jetës dhe pasurisë së njeriut. Ato bëhen shkak i shumë problemeve individuale dhe shoqërore. Për këtë arsye, ato janë të ndaluara rreptësisht. Në Kuranin Fisnik urdhërohet

“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni! Vërtet, djalli me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?”

(Maide, 90-91.)



Nuk mund të ketë marrëzi dhe injorancë më të madhe sesa të ndërrosh lumturinë martesore me shëmtinë e imoralitetit!

*Mendimtari i madh,
Muhamed Ikbali shprehet:*

“O gruaja myslimane, shamia e së cilës, është perdjja e namusit tonë! Nuri në fytyrën tënde, është baza e kandilit të besimit tonë. Pastërtia e natyrës tënde, është mëshirë për ne nga Zoti... Ti je ajo që ia mëson shehadetin, sapo fëmija jonë ndahet nga qumështi... Ti je rojtarja që mbron amanetin e Umetit. Fatime është shembulli yt; mos ia ndaj sytë dhe zemrën asaj. Derisa edhe dega jote të japë një frut si Husejni...”



Kiameti është dita më e frikshme që do të shohë njeriu, sepse atë ditë, gjithësia do të shkatërrohet. Një prej shtatë kategorive të njerëzve që do të mbrohet atë ditë të tmerrshme, është guximtari, që e refuzon propozimin e një gruaje të bukur dhe të pushtetshme duke i thënë: “Unë i frikësohem Allahut!”.

(Shih. Buhari, Ezan 36, Zekat 16, Rikak 24; Muslimi, Zekat, 91.)

Kur u shpallën këto ajete, me urdhër të Resullullahut ﷺ, një sahabë doli nëpër rrugicat e Medinës dhe thërriste:

“Dijeni se pijet alkoolike janë ndaluar!”

Pas kësaj, u shpuan kacakët, e u thyen qypat, dhe pijet rrodhën si rrëke në rrugicat e Medinës!

Myslimanët e asgjësuan të gjithë sasinë e verës që kishin dhe nuk pinë më kurrë.

Më pas, Profeti ﷺ, tha:

“Padyshim se Allahu e ka mallkuar pijen, atë që e prodhon, vendin ku prodhohet, atë që e pi, atë që u jep të tjerëve të pinë, atë që e bart, atë që e shet, atë që e blen dhe atë që ha fitimin e saj!” (Shih. Ahmed, 53; II, 351; Nesai, Eshribe, 1 - 2; Hakim, II, 305/3101.)

Sa shembull i bukur është kjo ngjarje, e cila tregon kujdesin e sahabëve ndaj ndalesave të Allahut të Madhëruar! Ata i janë bindur plotësisht urdhrave hyjnore dhe kanë nxituar të arrijnë pëlqimin e Allahut, pa kundërshtuar dhe pa u justifikuar aspak.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Gjithçka që deh është haram! Edhe e pakta e asaj që shumica e saj të deh, është haram!” (Ibni Maxhe, Eshribe, 10; Nesai, Eshribe, 24, 48.)

“Pija është nëna e gjithë të këqijave.” (Ahmed, V, 238.)

“Ai që i beson Allahut dhe Ditës së Kiametit, të mos ulet në sofrën mbi të cilën është vendosur alkool.” (Tirmidhi, Edeb, 43/2801.)

Profeti Muhamed ﷺ ka thënë: “Disa njerëz nga Umeti im, do ta pinë alkoolin duke i vënë emra të tjerë!” (Ahmed, IV, 237.)

Detyra e një të riu musliman që i di këto paralajmërime profetike, është të tregojë të njëjtin kujdes që kanë treguar edhe sahabët fisnikë. Veçanërisht, duke i kushtuar vëmendje shprehjes së Profetit ﷺ, “do ta pinë alkoolin duke i vënë disa emra të tjerë!”, ai duhet të qëndrojë larg nga pijet alkoolike që ofrohen në treg me emra të ndryshëm.

Njeriu i varur nga alkooli dhe lëndët narcotike, e humbet aftësinë për të menduar drejtë dhe për të marrë vendime të sakta. Për rrjedhojë, duke humbur lumturinë familjare dhe respektin në shoqëri, ai bëhet një kriminel potencial.

Kumari

Kumari, i cili është rezultat i ambicies për të fituar shumë në mënyra të lehta, pa u munduar fare, është një nga haramet më të rrezikshme. Nuk duhet të harrojmë asnjëherë se, një ambicie që nuk arrihet të kontrollohet, e çon të zotin gjithmonë në shkatërrim.

Kumari është një batak i tillë, ku në këtë lojë nuk fiton askush, sepse nga harami s’ka asnjë të mirë. Edhe ata njerëz që duket sikur fitojnë, marrin gjynahe shumë të mëdha, sepse bëhen shkak i shkatërrimit të njerëzve dhe familjeve që u kanë marrë paratë.



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Çdo sy bën zina (duke parë haram). Kur gruaja lyhet me erë të mirë dhe kalon pranë një grupi (ku ka burra), ajo konsiderohet sikur ka bërë zina.”

(Tirmidhiu, Edeb, 35/2786; Ebu Davud, Terexhxhul, 7/4173; Nesai, Zinet, 35.)



Abdullah ibn Mes'udi
ؓ , ka thënë:

“Besimtari e sheh gjynahun si një mal, në rrezë të të cilit është ulur dhe ka rrezik t'i bjerë sipër nga çasti në çast. Ai vazhdimisht jeton me frikën se mos i gjithë ky mal i bie sipër. Kurse gjynahqari, e sheh gjynahun si një mizë që kalon para hundës së tij.” (Buhari, Deauat, 4; Muslimi, Teube, 3.)

Njeriu që luan kumar, në vend që të bëjë bamirësi me mundësitë materiale që i ka dhënë Allahu, tregon edhe mosbindje ndaj Allahut, por bashkë me veten, shkatërron edhe shumë familje të tjera.

Në shoqërinë e sotme, kumari është legjitimuar dhe është përhapur në mënyrë marramendëse. Disa lloje të kumarit, kanë filluar të praktikohen në formën e dëfrimit dhe argëtimit. Madje, ndonjëherë as që kuptohen se janë praktika të kumarit dhe, për rrjedhojë, tashmë pesha shpirtërore e kësaj sëmundjeje të keqe, nuk ndjehet fare.

Ndërkohë, **Resulullahu** ﷺ , e ka konsideruar si një gjynah të rëndë edhe përmendjen e kumarit. Madje, për ta penguar këtë ka thënë:

“...Kush i thotë shokut të tij: «Eja të luajmë kumar bashkë!», si shpagim për këtë fjalë, ai duhet t'u ndajë lëmoshë të varfërve (shumën me të cilat do luante kumar)!” (Buhariu, Edeb, 74.)

Ditët e sotme, kumari është lehtësuar dhe ka dalë aq shumë jashtë kontrollit, saqë ka shkuar deri tek fëmijët. Kjo gjendje, përbën një rrezik shumë të madh për të ardhmen, sepse fëmijët që lakmojnë për të fituar lehtësisht në sajë të kumarit, kur të rriten, do të kërkojnë të gjejnë rrugën më të lehtë për të fituar në çdo punë që të jenë. Një i ri që kushtëzohet prej kësaj, kur të dalë në jetë do kërkojë mundësitë për të arritur fitime të mëdha në mënyrë të shkurtër. Për shembull,

nëse do merret me tregti, do të kërkojë të bëhet menjëherë i pasur, nëse hidhet në politikë, do të përpiqet të ngjitet shpejt në karrierë, e nëse do fillojë universitetin, do dëshirojë të fitojë të gjitha privilegjet. Më e keqja është se, duke humbur kujdesin ndaj të lejuarës dhe të ndaluarës, ai do të vazhdojë të bëjë shumë padrejtësi dhe gjynahe. Dhe, kur nuk ia arrin qëllimit, pëson shqetësime dhe depresion të jashtëzakonshëm.

Si përfundim, në krye të pasojave të hidhura të erozionit që po përjeton shoqëria jonë e sotme në fushën e besimit dhe moralit, qëndron “sëmundja e kumarit”.

VETËDIJA NDAJ KONCEPTIT TË KOHËS

Jeta është një dhunti shumë e vyer dhe e limituar që Allahu i Madhëruar ia ka falur njeriut për ta përdorur vetëm një herë. Megjithatë, dhuntia me të cilën njeriu mashtrohet më shumë dhe e shpërdoron, është “koha”.

Është kusht i domosdoshëm që koha të përdoret për punët më të vyera, sepse në jetë, ka më shumë se një punë që mund të kryhet në çdo çast. Mirëpo, në atë çast duhet favorizuar më e rëndësishmja.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Gjithçka që deh është haram! Edhe e pakta e asaj që shumica e saj të deh, është haram!”

(Ibni Maxhe, Eshribe, 10; Nesai, Eshribe, 24, 48.)

Islami mbyll çdo rrugë që të çon tek e keqja dhe ndalon edhe sjelljen më të vogël që çon tek ajo. Ashtu siç ka ndaluar kumarin, ka ndaluar edhe prodhimin e mjeteve të kumarit.



Përveç dëmeve shpirtërore, alkooli shkakton edhe shumë dëme në fusha të tjera të jetës. Sipas raportit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, prej alkoolit burojnë:

- 85 % e krimeve (prej të cilëve 60 -70 % brenda familjes),
- 50 % të përdhunimeve,
- 50 % të ngjarjeve të dhunshme,
- 70 % të dhunës ndaj grave,
- 60 % të mosparaqitjes në punë dhe- 40 - 50 % të rasteve me sëmundje mendore.

90 % e fëmijëve që lindin nga prindër alkoolikë janë me probleme mendore. Rreziku i lindjes së një fëmije me të meta nga një grua alkoolike, është në një nivel të lartë, deri në 35 %, sepse alkooli pengon rritjen në mitrën e nënës dhe zhvillimin pas lindjes, duke u bërë shkak për prapambetje në zhvillimin mendor e trupor dhe çrregullime të sjelljeve.

Tek fëmijët e njerëzve të varur nga alkooli, rreziku i shfaqjes së depresionit dhe çrregullimeve në sjellje është më i lartë, sepse ata jetojnë në një mjedis familjar të mbushur me tensione dhe dhunë. Për rrjedhojë, shumica e këtyre fëmijëve, janë të pasuksesshëm në shkollë dhe në jetë.¹

1. Musa Tosun, "İçki", Diyanet İslam Ansiklopedisi, XXI, 463.

Ndërsa të tjerat, duhen renditur sipas gradës së rëndësisë. Ky është një parim i rëndësishëm, ndaj të cilit duhet bërë kujdes, me qëllim që koha të vlerësohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Zoti i Madhëruar thotë në suren Asr :

“Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.” (Asr, 1-3.)

Në suren Asr, e cila fillon me betimin për kohën, tregohet se koha që nuk vlerësohet me besim, punë të mira dhe këshillë për të vërtetën dhe durimin, është kohë e shpërdoruar që të çon në humbje. Përveç kësaj, këtu tregohet edhe se njerëzit e mashtruar me kohën përbëjnë shumicën.

Sa bukur që e shpreh **Resulullahu ﷺ**, rëndësinë e kohës:

“Nëse njeriu do të zvarritej përtokë (pra, duron çfarëdolloj vuajtje për hir të adhurimeve, bindjes dhe shërbimit në rrugën e Allahut), për të fituar pëlqimin e Allahut, që prej lindjes e derisa të plakët e të vdesë, Ditën e Kiametit, atij do t’i duket shumë e pamjaftueshme (do të dëshironte të kishte bërë edhe më shumë).”

(Ahmedi, IV, 185; Bejhaki, Shuab, I, 479; Hajthemi, I, 51; X, 225, 358.)

Nëse një besimtar bën një jetë të gjatë me adhurime, bamirësi dhe shërbime të ndryshme, madje, duke vuajtur në këtë rrugë, ai do të arrijë të mbledhë një kapital të madh për ahiretin e tij.



Sipas raportit zyrtar të shtetit anglez, dëmet që i kanë shkaktuar ekonomisë angleze shpenzimet spitalore si pasojë e grindjeve, plagosjeve dhe situata të tjera të ngjashme që lidhen me konsumimin e alkoolit, është afro 20 miliard sterlina britanike (30 miliardë dollarë).¹

1. Sean COUGHAN, *The Guardian*, Saturday March 27 2004, “Sobering thoughts about a claim”.

Nuk duhet harruar kurrë se, Islami, në themelet legjitime të secilës ndalesë ka ofruar edhe alternativën, pra, atë që është më e mirë dhe më e pastër. Prandaj, nuk është aspak e nevojshme të rendësh pas disa kënaqësive mashtruese dhe të përzihesh me haramet, ndërkohë që rrethi i të lejuarave është mjaft i gjerë.



Mirëpo, kur të kuptojë të vërtetën e botës tjetër me të gjithë qartësinë e saj, shpërblimin që u jepet adhurimeve farz dhe nafile dhe mirësitë që Allahu jep për këto, ai do të zgjohet me vdekjen dhe këto adhurime e vepra të mira i duken shumë pak. Atëherë, ai do të mërzhitet, pse nuk ka bërë më shumë. Sipas një transmetimi të Muhamed ibn Ebu Umejra, Profeti ﷺ, ka thënë:

“...Ai do të kërkojë të kthehet sërish në dynja, që të shtojë shpërblimet dhe sevapet.” (Ahmedi, IV, 185; Hajthemi, I, 51; X, 225.)

I Dërguari i Allahut ﷺ, na tregon kështu për këtë pendesë kaq përvëluese në Ditën e Kiametit:

“Banorët e Xhenetit do të ndjejnë keqardhje dhe pendesë vetëm për çastet që kanë kaluar pa kujtuar Allahun në këtë botë, jo për gjë tjetër!” (Hajthemi, X, 73 - 74.)

Në Islam nuk ekziston koha e lirë apo botëkuptimi i një kohe pushimi, që duhet kaluar pa bërë gjë. Përkundrazi, një njeri që lodhet duke punuar, duhet të merret me ndonjë punë edhe kur pushon, pra, të çlodhet duke punuar. Allahu i Madhëruar na këshillon:

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (me diçka tjetër) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Inshirah, 7-8.)

Pra, kur të përfundojë ndonjë adhurim apo punë e mirë, menjëherë duhet rendur pas tjetrës, sepse jeta e kësaj bote është vetëm një afat i

shkurtër kohor, që na është dhënë për të fituar ahiretin dhe kënaqësinë e Allahut. Sa bukur që e ka shprehur poeti këtë të vërtetë:

*Një orë e vetme është
jeta e kësaj bote,
këtë orë menjëherë në
bindje shpenzoje!*

Një i ri i vetëdijshëm, duhet të jetë **“Ibnu’l-Vakt / fëmija i çastit”!** Pra, duke ia ditur vlerën çdo çasti që jeton, ai duhet ta përdorë atë për të bërë përgatitje për ahiretin në mënyrën më të mirë të mundshme. Nëse nuk e bën një gjë të tillë, atëherë do ta çonte dëm kohën. Dhe, një kohë e çuar dëm, është një prej shkaqeve më të mëdha të pendesës.

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Dija vlerën pesë të gjërave, pa të ardhur pesë të tjera:

1. *Rinisë, para pleqërisë,*
2. *Shëndetit, para sëmundjes,*
3. *Pasurisë, para varfërisë,*
4. *Kohës së lirë, para angazhimit me punë,*
5. *Jetës, para vdekjes!”* (Hakim, Mustedrek, IV, 341; Buhari, Rikak, 3; Tirmidhi, Zuhd, 25.)

Gjatë gjithë historisë, dijetarët tanë e kanë vlerësuar shumë mirë kohën. Ata e kanë kaluar kohën e tyre duke lexuar Kuran, duke bërë dhikr, duke falur namaz, duke mësuar nxënës dhe duke shtuar dijet. Për rrjedhojë, ata kanë mundur të nxjerrin vepra të vyera dhe voluminoze.

Sa domethënës është ky ajet Kuranor, i cili shpjegon



“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, kumari, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!”

(Maide, 90.)

Shpërdorimi me punë të padobishme i kohës, që është një thesar shumë i vyer, do të thotë të vësh në rrezik jetën e botës tjetër. Për këtë arsye, për ata që kanë mundur të largojnë perdet e indiferencës, koha është një dhunti aq e vyer, saqë nuk mund krahasohet me asgjë tjetër.



gjendjen e mjerë në ahiret të atyre që kanë kaluar jetën duke e shpenzuar kot kohën:

“Atje, ata do të thërrasin: «O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira, e jo nga ato që kemi bërë!» (Atyre do t’u thuhet): **«Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi? Andaj, shijoni (dënimin)! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!»** (Fatir, 37.)

Kjo gjendje e robit të mirë të Allahut, Rebi ibn Hajthemit, është një shembull i bukur që na tregon se sa e rëndësishme është llogaria e vetvetes në çështjen e vlerësimit të kohës në mënyrën më të mirë:

Rebi ibn Hajthemi kishte hapur një varr në oborrin e shtëpisë. Kur ai e ndjente se i ishte ashpërsuar zemra, hynte në atë varr dhe qëndronte aty për njëfarë kohe. Aty futej në atmosferën e një vetllogarie, duke medituar rreth ditës kur do të vinte koha t’i jepte lamtumirën kësaj bote dhe ta ndiente nevojën e një istigfari dhe lëmoshe në varr dhe duke menduar llogarinë që do të jepte në botën tjetër. Më pas këndonte këtë ajet:

“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: «O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!»...” (Mu’minun, 99-100.) Ndërsa kur dilte nga varri thoshte me vete:

“O Rebi! Shiko, sot u ktheve mbrapsht. Do të vijë një kohë që nuk do të të plotësohet kjo kërkesë e jotja dhe nuk do të kthehesh më mbrapsht. Bëj kujdes që tani, shtoji veprat e

mira, përpjekjen në rrugën e Allahut dhe përgatitjet për botën tjetër!”

Një ditë **Resulullahu** ﷺ, tha:

“Nuk ka njeri që vdes dhe nuk do të pendohet!”

“Cili është pendimi i tyre, o Resulullah?” - e pyetën sahabët.

Atëherë, Profeti ﷺ, tha:

“Nëse është një mysliman i mirë, do të pendohet pse nuk e ka shtuar më shumë këtë gjendje; nëse është njeri i keq, do të pendohet që nuk ka hequr dorë nga të këqijat!”

(Tirmidhi, Zuhd, 59.)

Ashtu sikurse për çdo mirësi, shkakua kryesor i shpërdorimit, është moskuptimi i vdekjes në mënyrën e duhur. E në fakt, në tharmin e egos, ekziston një rebelim ndaj përkohësisë. Për këtë arsye, njeriu e sheh veten larg vdekjes.

Koha rrjedh sipas ligjeve që ka vendosur Allahu. Në këtë botë, të blesh apo të marrësh mbrapsht gjithçka, pak a shumë është e mundur, por, kohën e shkuar, kurrë!.. Koha e shkuar nuk mund të kthehet mbrapsht, nuk mund të blihet, nuk mund të jepet e të merret borxh!..

Çdo çast duhet vlerësuar mirë, sepse koha nuk ndalet për të pritur askënd. E shkuara nuk kthehet kurrë pas. Ndërsa e ardhmja është e mbushur plot me mistere dhe të panjohura. Vetëm koha që po jetohet është dhurata më e vyer për njeriun.

Vlerësoje aq mirë kohën që, edhe nëse të thuhet: “Nesër do të vdesësh!”, të mos ndiesh nevojë të ndryshosh asgjë nga programi yt!



*Çdo kohë agimi, për
ne hapet një fletë
e re nga kalendari
i jetës sonë. Si
do ta mbushim
këtë fletë të jetës
sonë? Çfarë do të
shkruajnë melekët
Kiramen Katibin sot
në dosjen tonë për
Ditën e Kiametit?
Ja pra, duke i bërë
llogaritë me zemër
të hapur ndaj
këtyre të vërtetave,
besimtari duhet ta
shpenzojë kohën për
punët më të mira.*

Veprimi më i mençur, është ta shfrytëzosh këtë kohë në mënyrën që e pëlqen Allahu, sa është ende e mundur.

Sot, askush nuk qëndron indiferent ndaj hedhjes në plehra qoftë edhe të një grimce të vogël floriri. Mirëpo, për fat të keq, shumica e njerëzve tregohen indiferent ndaj shpërdorimit të kohës, e cila nuk mund të blihet me asgjë.

Hasan el-Basriu ka thënë:

“Kam parë njerëz të tillë, të cilët ishin ambiciozë në vlerësimin e kohës, më shumë sesa e doni ju dërhemin dhe dinarin.”

“O biri i Ademit! Ti përbëhesh nga ditët, pra je kohë. Kur ikën një ditë, edhe ty të ikën një pjesë.”⁵⁴

Imam Shafiu ka thënë:

Jam shoqëruar me sufite dhe prej tyre kam mësuar dy parime të rëndësishme:

- Koha është si shpata, nëse nuk e pret ti, të pret ajo ty.
- Nëse e orienton egon drejt Allahut, s'ka më mirë, përndryshe, ajo do të orientojë në devijim!

Në Kuran dhe hadithe, njoftohemi se disa kohë janë më të vlefshme në krahasim me disa të tjera. Kështu, është kërkuar që njerëzit të jenë të kujdesshëm dhe vigjilentë me qëllim që ta përdorin në mënyrë të frytshme kapitalin e jetës së tyre.

Disa muaj, disa ditë,
madje edhe disa orë,



54. Ebu Gudde, Zamanın Kıymeti, İstanbul 2006, f. 26 - 27.

janë ndryshe krahasuar me disa të tjera. Prandaj, për të fituar shumë në një kohë të shkurtër dhe për bërë një jetë sa më fitimprurëse, është e domosdoshme të shfrytëzohen mirë këto kohë të vyera. Tre muajt e shenjtë dhe veçanërisht, Muaji i Madhërishtëm i Ramazanit, janë më të vyer krahasuar me muajt e tjerë. Ashtu siç janë edhe gjashtë ditët e para të muajit Sheuual, dhjetë ditët e para të Dhulhixhhes, muaji Muharrem dhe dita e Ashures, ditët 13-14-15 të muajit hënor, ditët e hëna dhe të enjte, dita e Xhuma dhe kohët e para agimit...

Me qëllim që të jemi gjithnjë



Imam Gazaliu ka thënë:

“Bir! Zëre se vdiqe sot! Do të mërzitësh shumë për momentet e indiferencës që ke kaluar në këtë jetë, e do të thuash: “Ah, sikur!”. Por më kot!”

“Kur të ngrihet në namazin e sabahut, çdo besimtar duhet t’ia kujtojë vetes këto:

«Jeta ime është kapitali im. Kur të më ikë jeta, do më ikë edhe kapitali dhe, tashmë nuk do të kem mundësi të fitoj. Kjo ditë që filloi, është një ditë e re. Allahu i Madhëruar më gostiti edhe sot duke më lejuar të jetoj. Nëse do të ma kishte marrë shpirtin, natyrisht që do të dëshiroja të më kthenin pas në këtë botë, qoftë edhe për një ditë, me qëllim që të bëja vepra të mira.» Tani, zëre se vdiqe dhe t’u dha leje të kthehesh në këtë botë për një ditë të vetme. Atëherë, sot mos iu afro aspak gjynaheve! Mos e kalo bosh as edhe një çast të vetëm të kësaj dite, sepse çdo frymë, ka një vlerë të paçmuar!”

Edhe sikur të gjitha dhuntitë e përkohshme të mblidheshin tek një njeri i vetëm, e ai të jetonte një mijë vite në lumturi, kjo nuk do të kishte asnjë vlerë!.. E në fakt, a nuk është kjo nëntokë e zezë që shkelim, vendi ku do të hyjë në fund?! A nuk merr mësim njeriu kur sheh se, freskia dhe gjallëria e çdo qenieje të përkohshme bluhet vazhdimisht në mullirin e kohës!?

vigjilentë ndaj kohës, Allahu i Madhëruar i ka fshehur disa kohë shumë të vyera, siç janë Nata e Kadrit, që është më e vyer se njëmijë muaj, koha e pranimit të duave ditën e Xhuma dhe gjatë çdo nate.

Kujdesi ndaj kohës që na mëson Islami

Një person që ka shkuar për të mësuar gjuhën në Gjermani, tregon:

Mësuesi ynë i gjermanishtes, ishte mjaft rreptë lidhur me kohën dhe nuk toleronte aspak. Ai e llogariste se kush dhe sa minuta vinte me vonesë dhe pas mësimit i mbante të mësonin aq kohë sa ishin vonuar. Natyrisht, kjo sjellje e tij nuk na pëlqente aspak.

Një ditë, një shoku ynë, i dënuar të mësonte në klasë 18 minuta pas mësimit, iu kundërvu mësuesit. Atëherë mësuesi i tha kështu:

“Miqtë e mi! Ju nuk e përdorni mirë kohën. Madje, ju edhe nevríkoseni ndaj kujdesit që unë tregoj në këtë çështje. Mirëpo, unë besoj se po veproj drejtë në këtë pikë.”

Më pas, nxori nga çanta e tij një orar treni dhe tha: “Shikoni këtë ju lutem!”

Aty ishin shënuar oraret e trenit me numra jo të plotë, si 7:17, 11:43, 15:19, 19:33. Kur i thamë se ato numra ishin të pakuptimtë për ne, ai na tha:

“Kur është përpiluar ky orar treni, është marrë shembull botëkuptimi Islam për kohën, sepse ne, nga myslimanët kemi mësuar ta përdorim dhe ta



Në Islam, një person që arrin moshën e pubertetit, është përgjegjës për dispozitat e fesë. Kur arrin moshën 17-18 vjeç, mund të krijojë familje dhe mund të bëjë marrëveshje tregtare. Tashmë, ai ka kapacitetin të mbajë të gjithë peshën e jetës.

Dhe, për ta bërë të mundur një gjë të tillë, Islami i kushton rëndësi të madhe periudhës së fëmijërisë, duke e filluar edukimin e njeriut që në moshë të vogël. Fillimisht bazohet në mësimin e njohurive themelore dhe e ruan njeriun nga dijet e kota dhe të padobishme.

Nëse analizojmë jetën e dijetarëve myslimanë, tabloja me të cilën përballemi është mahnitëse:

Imam Maliku, në moshën 17 vjeç ka përfunduar arsimin dhe ka filluar të japë mësim.

Imam Shafiiu, ka mësuar përmendësh librin e hadithit me titull "Muvatta" kur ishte vetëm 5 vjeç dhe ka filluar të japë fetva në moshën 15 vjeç.

Imam Evzai, kur është pyetur për fetva ka qenë 13 vjeç.

Sufjan ibn Ujejne është bërë hafiz kur ishte 4 vjeç.

Imam Buhariu, në shkollën fillore kishte mësuar përmendësh 15 mijë hadithe.

Ibni Sina, kur ishte 10 vjeç kishte mësuar në mënyrë të përsosur të gjithë Kuranin dhe shkencën e teorisë së letërsisë.¹

1. Për burimin e këtyre të dhënave, shih: Prof. Dr. Ibrahim Canan, İslam' da Zaman Tanzimi, İzmir, 2008, 72 - 73.

***I Dërguari
i Allahut
ﷺ, na ka
përcjellë
këto të
dhëna prej
Suhuf-ëve
që i janë
shpallur
Ibrahimit
ﷺ :***



***“Njeriu i mençur duhet ta
ndajë kohën në këtë mënyrë:***

- Një pjesë të kohës për lutje
dhe përgjërime ndaj Zotit.***
- Një pjesë për meditim mbi
artin dhe fuqinë e Allahut të
Madhëruar.***
- Një pjesë për llogarinë
e atyre që ka bërë në të
shkuarën dhe planifikimin
e atyre që do të bëjë në të
ardhmen.***
- Dhe një pjesë për të fituar
rrizkun prej hallallit.”***

***(Ebu Nuajm, Hulje, I, 167; Ibni Ethir, el-
Kamil, I, 124.)***

vlerësojmë kohën. Vendi nuk ka rëndësi për adhurimet tuaja. Nëse është i pastër, ju mund të kryeni adhurime në çdo vend të botës. Mirëpo, koha është shumë e rëndësishme, pasi çdo adhurim ka kohën përkatëse për kryerjen e tij. Madje, koha është kusht i adhurimit. Pra, nëse adhurimet i kryeni jo në kohën e tyre, ato nuk

pranohen. Në mënyrë të njëjtë, edhe kohët e namazeve, janë si oraret e trenit për ne, pra, e 18, e 17, e 13, e 10, e 9, etj. Madje, këto orare (të namazeve) ndryshojnë vazhdimisht. Sot mund ta falni namazin e sabahut deri në orën 6:21, por nesër mund ta falni deri në 6:22 dhe jo në 6:23. Nuk është vetëm namazi në këtë mënyrë. Edhe fillimi dhe mbarimi i agjërimit është po ashtu me orare të caktuara.

Po mirë, përse është kështu? Çfarë dobie mund të ketë një gjë e tillë? Si rezultat i kësaj, myslimanët janë vigjilentë ndaj kohës që ndryshon vazhdimisht... Ata e kuptojnë rëndësinë e kohës dhe përgatiten ta vlerësojnë mirë atë. Një mysliman që i kryen rregullisht adhurimet, është i detyruar të jetojë duke iu përshtatur minutave që ndryshojnë çdo ditë. Ja pra, edhe burimi frymëzues i botëkuptimit tonë ndaj kohës, është pikërisht ky kujdes i Islamit.”

Kësisoj, për të vlerësuar kohën në mëny-

rë sa më të dobishme të mundshme, parasëgjithash, duhet përdorur në mënyrë sa më të mirë të mundshme fuqia e “vullnetit”, sepse vullneti i njeriut, është më superior se të gjitha fuqitë që janë në natyrën e krijimit të tij. Për të vënë në lëvizje fuqinë e vullnetit, nevojitet një “besim” i fortë dhe dinamik, me të cilin mund të vihen në zbatim të gjitha dijet.

Krahas kësaj, vlerësimi i duhur i kohës, varet nga njohja e mirë e Allahut dhe një vetëdije e fortë ndaj përgjegjësisë, që duhet të zërë vend në zemra.


VETËDIJA E PËRGJEGJËSISË

Njeriu është më i nderuari i krijesave dhe stolia më e bukur e gjithësisë. Allahu i Madhëruar i ka dhuruar atij dhunti të panumërta,

*Imam Hasan ibn Rushejk
thotë:*

*“Për të çelur kyçët e botës
së meditimit, nuk ka çelës
më të mirë se të zgjohesh
dhe të punosh në kohën
para agimit, sepse në atë*

kohë, njeriu është larg preokupimeve të jashtme, problemeve dhe ambicieve të jetës. Atë kohë, ai hyn në atmosferën e qëndrimit me Allahun. Trupi i tij është çlodhur, ka ardhur në vete, është freskuar dhe gjallëruar. Shkurtimisht, koha para agimit, është periudha kur koha është më e mirë, flladi është më i ëmbël dhe vakti më i përshtatshëm mes natës dhe ditës. Kjo, sepse në atë kohë, drita mbulon errësinë. Kurse në mbrëmje ndodh e kundërta e kësaj; errësira bie mbi dritën.” (Shih. Ebu Gude, Zamanin Kiyemeti, f. 86.)





të cilat nuk ia ka dhënë krijesave të tjera. Krahas këtyre, Allahu i Madhëruar e ka vënë botën dhe gjithçka brenda saj në shërbim të njeriut dhe e ka bërë atë përgjegjës për përdorimin e tyre.

Njeriu duhet të jetë i vetëdij-

shëm për dhuntitë që i janë dhënë amanet, si pasuria, fëmijët, shëndeti, posti e karriera dhe duhet të përpiqet të jetë mirënjohës. Kjo, është e mundur nëse të gjitha këto përdoren në rrugë të Allahut.

Allahu i Madhëruar, ka caktuar kushte të ndryshme jete për secilin njeri, si një pjesë e sprovës së kësaj bote. Nëse të gjithë njerëzve do t'u jepeshin të njëjtat aftësi profesionale dhe të njëjtat veçori materiale e shpirtërore, nuk do të mund të bëhej fjalë për një jetë të ekuilibruar. Për këtë arsye, njerëzit janë nevojtarë për njëri-tjetrin, si dy duar që lajnë njëra-tjetrën.

Kjo situatë, lind disa të drejta dhe përgjegjësi për besimtarët në aspektin e besimit dhe ndërgjegjes. Allahu i Madhëruar, kërkon që njerëzit e dobët dhe të privuar, të durojnë ndaj vuajtjeve që përjetojnë dhe të arrijnë shpërblime. Ndërsa njerëzit e pasur dhe me aftësi, i ka urdhëruar të jenë mirënjohës, të mos mburren dhe të ndihmojnë vëllezërit e tyre nevojtarë.

A nuk është e nevojshme që një i ri herë-herë t'ia bëjë vetes këto pyetje:

Ti duhet ta kalosh çdo kohë me një vigjilencë të madhe.

Prandaj, shprehja "Konsiderojeni si Hidrin çdo njeri që shihni dhe si Natën e Kadrit çdo natë që kaloni!", për besimtarët e vërtetë është bërë një parim jete.

“Unë jam shëndosh e mirë, po filani përse është i gjymtuar apo i sëmurë? Unë jam i pasur, po filani përse është i varfër dhe pa mundësi?”

Ndërsa përgjigjja e këtyre pyetjeve dihet:

“Allahu i Madhëruar, ta ka lënë ty amanet dhe të bëri përgjegjës për të. Prandaj, je i detyruar që mundësitë që zotëron t’i ndash me ata që s’kanë mundësi.”

Profeti ﷺ, ka thënë:

“Ai që nuk shqetësohet me shqetësimet e vëllait mysliman, nuk është prej nesh!” (Hakim, IV, 352; Hajthemi, I, 87.)

Sërisht i Dërguari i Allahut ﷺ, ka treguar se besimtarët kanë përgjegjësi të mëdha ndaj njëri-tjetrit. Nisur nga kjo, besimtarët duhet të jenë të lidhur me njëri-tjetrin, si tullat e një muri, ose duhet të ndejnë dhimbjet e njëri-tjetrit, si organet e një trupi. Të flesh i ngopur, ndërkohë që fqinji fle i uritur, nuk përputhet aspak me moralin Islam. Me pak fjalë, të gjithë besimtarët janë amanet për njëri-tjetrin.

Allahu i Madhëruar i ka dhënë njeriut përgjegjësi, aq sa i ka dhënë forcë dhe mundësi. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka...” (Bekare, 286.)

E thënë ndryshe, njeriu ka përgjegjësi edhe nëse nuk bën aq sa ka mundësi. Pra, kjo do të thotë se ne jemi përgjegjës edhe për mirësitë që

Sikur njeriu ta jepte të gjithë pasurinë e tij si shpërblësë për të shpëtuar, kjo nuk do t’ia ndryshonte asnjë sekondë kohën e vdekjes; as do t’ia afronte, e as do t’ia shtynte për më vonë.





Koha rrjedh sipas ligjeve që ka vendosur Allahu. Në këtë botë, të blesh apo të marrësh mbrapsht gjithçka, pak a shumë është e mundur, por, kohën e shkuar, kurrë!.. Koha e shkuar nuk mund të kthehet mbrapsht, nuk mund të blihet, nuk mund të jepet e të merret borxh!..

nuk i bëjmë me aq sa kemi mundësi.

Në këtë kontekst, për ne besimtarët del në pah një çështje e rëndësishme. Për rrjedhojë, kur duam të japim zekatin e pasurisë sonë, llogaritja e tij është e qartë. Mirëpo, për zekatin e mirësive të tjera që zotërojmë,

llogaritja nuk është e qartë. Për shkak se nuk e dimë nëse i kemi kryer si duhet apo jo detyrat e tjera për të cilat kemi përgjegjësi, ne nuk mund t'i besojmë aspak namazeve dhe veprave tona të mira. Kjo, sepse mbase kufijtë e përgjegjësive tona janë më të gjerë dhe, ndoshta veprat e mira që bëjmë humbasin brenda kufijve të veprave tona.

Sahabiu Abdullah ibn Ummu Mektumi **ؓ**, ishte liruar nga përgjegjësia për të marrë pjesë në luftë, për arsye se ishte i verbër. Megjithatë, ai mori pjesë në luftën e Kadisijes duke thënë:

“Unë mund ta mbaj flamurin!”

Ai brez i bekuar e dinte shumë mirë se, sakrifica që bëhet kur vepron një të mirë, e shumëfishon shpërblimin e saj. Prandaj edhe sikur të jemi të privuar nga disa mundësi, ne nuk duhet të tërhiqemi në qoshe duke thënë: *“Ç’të bëj, s’kam mundësi!”* Por përkundrazi, ne duhet t’i kapërcejmë pengesat në këtë rrugë dhe të kryejmë përgjegjësitë tona.

Të gjithë njerëzit janë vëllezërit tanë, që prej

fëmijëve të jetimoreve, fëmijëve të braktisur në mëshirën e rrugëve, e deri tek të rinjtë e varur pas drogave. Të rinjtë, shumica e të cilëve ende nuk kanë arritur moshën e pjekurisë dhe janë si një degë e njomë pranverore, janë shtyrë drejt mbeturinave të shoqërisë përpara syve të botës. Me anë të helmeve që thithin, janë duke djegur mushkëritë dhe duke asgjësuar funksionet e trurit dhe të zemrës së tyre. Duke u kthyer në armiq të shoqërisë, ata bëhen pjesëtarë të detyrueshëm të bandave kriminale. Pra, sa e ndiejmë veten përgjegjës që nuk ua kemi kultivuar ndjenjat fetare, morale dhe atdhedashëse?

MENDJEMPREHTËSIA

Profetët janë më lart se njerëzit e tjerë nga çdo aspekt, duke filluar nga mendja, zgjuarsia dhe mendjemprehtësia. Ata zotëronin memorie të fortë, kapacitet të lartë perceptimi, logjikë të fuqishme dhe aftësi bindëse. Kjo aftësi quhet: “**fet Janet**”. Për rrjedhojë, edhe myslimanët duhet të marrin hisen e vet prej cilësisë “fet Janet” të profetëve dhe të bëhen të mençur, të zgjuar dhe mendjemprehtë.

Profeti ﷺ, ka thënë:

“Ruajuni mendjemprehtësisë së besimtarit, sepse ai shikon me dritën e Allahut.” (Tirmidhiu, Tefsir, 15/3127.)

Mendjemprehtësia, e cila është vetëm një pjesë e cilësive të profetëve, nënkupton sjelljen



Gjatë kohës kur në Egjipt kishte pllakosur zia e bukës, Jusufin ﷺ, e pyetën:

“Ti je një udhëheqës që menaxhon thesarin e shtetit. Përse e lë të uritur veten?”

Ai u përgjigj:

“Kam frikë se nuk do ta kuptoja gjendjen e të uriturve, nëse do të isha i ngopur!”

Erdhi një karvan tregtie dhe u vendos për të pushuar pranë Medinës së ndritur. Kalifi Omer **ﺗ**, u shqetësua se mos këtyre njerëzve të huaj u ndodhte ndonjë e keqe. Për këtë arsye, ai i tha Abdurrahman ibn Aufit **ﺗ** :

“Nëse mundesh, eja këtë natë e ta ruajmë atë karvan nga hajdutët!” Të dy bënë roje gjithë natës përreth karvanit. Gjatë kësaj kohe, nuk qëndruan pa bërë gjë, por falnin edhe namaz nafile/vullnetar.

Në një çast, Omeri **ﺗ**, dëgjoji një qarje fëmije. Shkoi në drejtim të zërit dhe i tha nënës së fëmijës:

“Ki frikë nga Allahu, sillu mirë me fëmijën!” Pastaj u kthye edhe një herë në vendin e tij. Kjo gjë u përsërit disa herë. Në fund, Omeri **ﺗ**, i nevrikosur i tha:

“Turp të kesh! Çfarë nëne jeni, pse e lë fëmijën të qajë tërë natën?!” Nëna, e cila nuk e njohte Omerin **ﺗ**, iu përgjigj:

“O rob i Zotit! Më ke mërzitur këtë natë! Unë përpiqem ta ndaj fëmijën nga gjiri, por ai këmbëngul që të pijë!” Omeri **ﺗ**, e pyeti:

“Përse do që ta ndash nga gjiri?” Gruaja tha:

“Sepse Kalifi Omer u lidh asistencë vetëm fëmijëve që ndahen nga qumështi.” Omeri **ﺗ**, të cilit pothuajse i ngriu gjaku, pasi mësoi sa muajsh ishte fëmija, i tha:

“Allahu të begatoftë! Mos u ngut që ta ndash nga gjiri!”

Kishte ardhur koha e namazit të sabahut. Omeri **ﺗ**, kishte dalë në mihrab dhe, nga një anë drejtonte namazin, nga ana tjetër qante. E, për shkak se po qante, njerëzit nuk po e kuptonin se çfarë po lexonte. Sapo dha selam, tha:

“Jazëk i qoftë Omerit! Kushedi sa fëmijë myslimanësh ka bërë të vuajnë!” Më pas urdhëroi një zëdhënës që të shpallte këto:

“Mos u ngutni t’i ndani fëmijët nga gjiri, sepse çdo fëmije që lind si mysliman, do t’i lidhet asistencë.” Më pas, e shkroi këtë urdhër dhe e dërgoi në të gjitha vendet Islame. (Ibni Sa’d, III, 301; Ibnu’l-Xheuzi, Menakib, f. 77.)

sipas nivelit mendor të bashkëbiseduesit, duke përdorur një zgjuarsi të mprehtë. E në fakt, një sjellje që gëzon dikë, mund të hidhërojë dikë tjetër.

Një mysliman mendjemprehtë, e di mjaft mirë se kujt, çfarë, kur dhe në ç' mënyrë do të flasë e do të sillet.

Sulejmani Γ , që në fëmijëri ishte një njeri me botëkuptim të



Imam Ebu Hanife kishte komshi një djalë të ri pijanec, i cili pinte nga mëngjesi deri në darkë. Ndërsa natën nuk rrinte rehat, por i shqetësonte njerëzit duke thirrur, e duke sharë me fjalor të pistë.

Një natë, ky i ri nuk u dëgjua fare. Për këtë arsye, Ebu Hanife u interesua nëse i kishte ndodhur ndonjë gjë të riut. Shokët e tij i thanë se ishte grindur për shkak të pijes dhe e kishin futur në burg. Ebu Hanifja u mërzi shumë për këtë. Prandaj shkoi në burg dhe iu lut autoriteteve që ta lironin. Mirëpo, nëpunësit i thanë se ai mund të lirohej vetëm me garanci. Për rrjedhojë, Ebu Hanife i doli garant dhe e shpëtoi nga burgu.

Kur mësoi këtë, i riu shkoi menjëherë tek Ebu Hanife dhe derdhi lot pendese, duke i thënë se, tashmë kishte hequr dorë nga pija. Më pas, ai i dha fjalën që këtej e tutje do të bëhej një fqinj dhe student i denjë për të. Ebu Hanife, e pa të riun me dhembshuri dhe me keqardhje i tha:

“Djalosh, në fakt ne të kemi lënë në humbje, sepse nuk u përpoqëm të vinim tek ti. Prandaj, je ti që duhet të na e bësh hallall!”



Në një hadith thuhet:

“Nuk është besimtar kush fle i ngopur, ndërkohë që fqinji i tij është i uritur!” (Hakimi, II, 15; Hajthemi, VIII, 167; Buhariu, el-Edebu’l-Mufred, nr. 112.)

Aliu ؑ , në një ferman që i dërgon valiut/gubernurit të Egjiptit, thotë:

“Mos i shih njerëzit, siç i sheh egërsira kopetë! Ushqeje zemrën me dashuri, dhembshuri dhe mirësi ndaj tyre, sepse pa përjashtim, çdo njeri është ose vëllai yt në fe, ose i njëjtë me ty në krijim...”

thellë dhe shumë i zgjuar. Lidhur me të, i Dërguari i Allahut ﷺ, na përcjell një ngjarje të tillë:

“...Njëherë e një kohë, jetonin dy gra bashkë me fëmijët e tyre. Gjatë një udhëtimiti, një ujk rrëmbeu fëmijën e gruas më të madhe në moshë. (Nga hidhërimi i madh) Gruaja iu drejtuar shoqes së saj dhe i tha:

«Ujku rrëmbeu fëmijën

tënd!»

«Jo!” -i tha tjetra, “rrëmbeu fëmijën tënd!»

Si përfundim, këto dy gra iu drejtuan Daudit ؑ , të gjykonte midis tyre. Mirëpo, Daudi ؑ , vendosi që fëmija i përkiste gruas më të madhe. Gratë dolën që aty dhe iu drejtuan djalit të Daudit ؑ , Sulejmanit ؑ , të cilin e njoftuan me vendimin e të atit. Sulejmani ؑ , tha:

«Sillmani një thikë, ta ndaj fëmijën ndër-mjet këtyre dy grave!» Mirëpo, gruaja më e vogël në moshë, u hodh menjëherë e tha:

«Mos e bëj të lutem! Allahu të mëshiroftë! Fëmija është i kësaj gruaje!»

Pas kësaj, Sulejmani ؑ , vendosi që fëmija i përket gruas së vogël.” (Buhari, Enbija, 40.)

Një shembull tjetër lidhur me mendjemprehtësinë, është edhe ky:

Timuri, i cili kishte mundur Jëlldërëm

Bejazidin në Ankara, i vuri haraç Osma-
nëve. Pas disa viteve, Ilhanët, kërkuan
të njënjtin haraç, duke pretenduar se
janë trashëgimtarët e Timurit. Mirëpo,
pashallarët e Perandorisë Osmane, e cila
e kishte marrë veten plotësisht në periudhën
e Muradit II, iu drejtuan sulltanit
duke i thënë:

*“Madhëri! Përse vazhdojmë t’u japim
ende haraç këtyre? T’i heqim qafe tashmë!..”*

Kësaj kërkese emocionale, Sulltan
Muradi II, i dha këtë përgjigje dome-
thënëse:

*“Ata nuk janë të vetëdijsëm për ngritjen
dhe fuqizimin tonë aktual. Nëse nuk do t’ua
japim tani paratë që kërkojnë, ata do të
mbledhin një ushtri, qoftë edhe për figurë,
dhe do të na sulmojnë. Ç’është e drejta, do të
thyheshin, por do të derdhej gjak myslimani...
Prandaj, hëpërhë vazhdoni t’ua jepni paratë që
kërkojnë! Nuk dua të derdhet gjak myslimani
për shkak të parasë!”*

*Mirëpo, delegatëve të
Ilhanëve tregojuni madhësh-
tinë e ushtrisë sonë, që të
kuptojnë fuqinë dhe poten-
cialin tonë, me qëllim që të
mos guxojnë më të kërkojnë
haraç nga shteti ynë, i cili
është pa diskutim shumë më
superior se i tyre!..”*

E në fakt, ndodhi
pikërisht ashtu siç e kish-
te parashikuar Sulltan
Muradi II.

Mevlana ka thënë:

“Shemsi më ka mësuar një gjë:

**«Nëse ka qoftë edhe një
mysliman të vetëm në botë që
ka ftohtë, ti nuk ke të drejtë të
ngrohesh!»**

**Unë e di që në rruzullin tokësor
ka besimtarë që kanë ftohtë,
prandaj edhe unë tashmë nuk
mund të ngrohem!..”**





Një grup myslimanësh emigruan në Abisini/Etiopi nën udhëheqjen e Xhaferr-i Tajjarit ﷺ. Nexhashiu i Abisinisë, që ishte i krishterë, u bë kureshtar për Kuranin Famëlartë dhe i kërkoi Xhaferr-i Tajjarit ﷺ, t'i lexonte disa ajete. Xhaferr-i ﷺ, u tregua mendjemprehtë dhe nuk lexoi ajetet që sfidonin femohuesit, por Suren Merjem, e cila shpreh lëvdata për profetin Isa ﷺ dhe nënën e tij të nderuar. Nexhashiu e dëgjoi leximin e Kuranit me emocione të thella dhe, i përplotur tha:

“Pa dyshim se këto që dëgjova, janë nga i njëjti burim drite me të vërtetat që solli Isai!” Pas njëfarë kohe ai u nderua me Islam. (Ibni Hishami, I, 358 - 360.)

Kësisoj, mendjemprehtësia dhe mençuria janë cilësi të domosdoshme të besimtarit.

THELLIMI NË MEDITIM

Hapi i parë që duhet hedhur për t'u thelluar në meditim, është të vëzhgosh përreth me syrin e urtësisë për të marrë mësim. Kjo, sepse në shumë vende të Kuranit Famëlartë, pasi numërohen mirësitë e Allahut, u drejtohet njerëzve duke thënë: **“...Kjo, me të vërtetë, është mësim për largpamësit.”**⁵⁵ Pra, njeriut i kërkohet ta shohë gjithësinë për të marrë mësim.

Në shumë ajete të ngjashme, urdhërohet: **“Thuaj: «A barazohet i verbri me atë që sheh? A s'po mendoni?»**⁵⁶, duke kërkuar nga njerëzit që të mos e shikojnë gjithësinë në mënyrë të rëndomtë, por me urtësi dhe mendjemprehtësi.

Njeriu duhet ta ngrejë kokën drejt Diellit në kohën e agimit dhe të shohë tablotë e ndryshme dhe shumëngjyrëshe të vizatuara në horizont. Ne mahnitemi përballë tablosë së një mjeshtri. Por, si mund të jemi indiferentë ndaj tablove kryevepra që Mjeshtri i gjithësisë pikturon çdo moment?

Shikoni një tulipan, një manushaqe! Vallë, në ç'vend të tokës së zezë i gjetën ato ngjyra? Po ai karafili i kuq? E kaltra, e roza,

55. Shih. Al-i Imran, 13; Nur, 44; Hashr, 2...

56. Shih. el-En'am, 50; Bekare, 219, 266; Muhammed, 24; Nisa, 82; Jasin, 68...

dhe buzëqeshjet që të çelin shpirtin, e luleve që luajnë nën rrezet e Diellit... Dhe bukuritë e tjera që s'mund të numërohen... Për një zemër që zotëron thellësi ndjenjash, çdo vend është ekspozitë mrekullish... Le të shohim buzëqeshjen e një luleje, vallëzimin e bletëve dhe fluturave, djegien e fluturës së natës, vajin e bylbylit, e më pas t'i kthehemi vetes! Të gjitha këto bukuri, janë vetëm një thërrime e bukurisë që reflektohet tek krijesat prej bukurisë së Krijuesit tonë, i Cili është burimi absolut i bukurisë.

Dielli që ndriçon gjënë me rrezet e para kur agon dita, na sjell përshëndetjen e ditës që sapo fillon dhe sikur na thotë: "Zgjohu!" e na shpie në një atmosferë vetëllogarie të tillë:

"Pa shiko, edhe këtë mëngjes t'u dhurua një fletë krejt e re nga libri i jetës. Si do ta mbushësh këtë fletë, e cila do të të nxirret para në Ditën e Kiametit? Çfarë mendon të përgatitësh sot për atë ditë kur do të të thuhet: **"Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!"**⁵⁷?"

Në mbrëmje, kur qielli fillimisht lyhet në të kuqe, e më pas valë-valë kthehet në të zezë, nata, me gjuhën e saj i thotë njeriut:

"Kaloj edhe një ditë. Iu afrove edhe një hap vdekjes. Tashmë më kot ankohesh! Sado të përpiqesh, s'ke mundësi ta kthesh mbrapsht ditën që kaloi. Tani edhe ti do ta lëshosh veten në krahët e gjumit, i cili është vëllai i vdekjes. Çfarë duhej të bëje, e çfarë bëre ti? Vëri para vetes ato që ke bërë e nuk ke bërë, dhe mendo!.. Mbase mund të mos e shohësh më dritën e mëngjesit!.."

57. Isra, 14.



Shah el-Kirmanj
ka thënë:

"Kush e ruan syrin e tij nga haramet, e largon veten nga ephset, ndjek Sunetin profetik dhe ushqehet me ushqim prej hallalli, mendjemprehtësia e tij nuk devijon asnjëherë!"

(Kushejri, Risale, pjesa e "Ebu Osman el - Xhebrj")

**Ebu Bekri [†],
ka thënë:**

**“Mendoje mirë
çfarë thua, kur e
thua dhe kujt ia
thua!”**



Shpirtrat që i drejtohen gjithësisë në këtë mënyrë medituese dhe frytdhënëse, e kuptojnë se kjo botë është një vend-sprove kalimtare, e jo një vend ku mund të vendosesh përjetësisht. Ata e kuptojnë edhe pabesinë e saj dhe, si përfundim e shohin se, i vetmi mik i vërtetë, është Allahu.

Mjerë për atë zemër që është larg meditimit në këtë botë, e cila është ekspozitë e urtësive dhe mësimëve hyjnore! Indiferenca ndaj gjuhës së trëndafilave e pemëve, krimbave e zogjve dhe moskuptimi i domethënieve të shumë qëndisjeve të fuqisë hyjnore që ekspozohen në dete, male e qiej, është si pasojë e verbërisë së syrit të zemrës.

Mevlana ka thënë:

*“Meqë lëvizjen e gurit
të mullirit e sheh, atëherë
shih më me kujdes dhe
vëre ujin që e bën të lëvizë!
Dheun, pluhurin e pe në ajër.
Pa shiko edhe erën që e ngre
lart! Çomlekun e mendimit
po shikon tek zien. Pa shiko
më me urtësi edhe zjarrin
që e zien atë! A është logjike
apo jo që të gjitha këto vila,*

*pallate e shtëpi të kenë një ndërtues? A është logjike që ky
shkrim që po lexon të ketë një shkruer, apo mos vallë shkrimet
që stolisin muret dhe mbushin faqet rreshta-rreshta janë pa
shkruer?*

*O njeri! A mund të më tregosh një gjë që ka ardhur
vetvetiu në këtë botë? Atë fije bari që mendon se rritet
vetvetiu, ndaje një herë nga dheu dhe shihe nëse është ashtu
apo jo?!”*

Para se t'i vinte profetësia, Resulullahu ﷺ, herë-herë shkonte në shpellën Hira në Malin Nur dhe qëndronte në vetmi. Edhe pasi u bë profet, hynte në itikaf dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. Nga kjo kuptojmë se, një mysliman, herë-herë duhet të qëndrojë në vetmi për të bërë llogarinë e vetes dhe për të medituar rreth gjithësisë. Pa e bërë këtë, ai nuk mund ta arrijë pjekurinë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Veçanërisht ata që do të bëhen udhërrëfyes për të tjerët, kanë më shumë nevojë për këtë meditim dhe vetëllogari.

Shkurtimisht, sytë që shohin, e kuptojnë se përballë pushtetit hyjnor, kjo botë është vetëm një prej miliona e trilion thërmijave të pluhurit që notojnë në hapësirë. Malet, fushat, oqeanet dhe njerëzit janë brenda kësaj thërmije pluhuri. Kështu pra, me këtë dobësi, njeriu është veçse një "hiç", me përjashtim kur i përkushtohet Zotit!..

VËLLAZËRIA dhe BASHKIMI

Feja Islame, krahas maturimit dhe zhvillimit të besimtarëve në aspektin e personalitetit, ka sjellë edhe disa parime të larta që sigurojnë qetësinë dhe shpëtimin e shoqërisë. Islami ka urdhëruar që individët të lidhen me njëri-tjetrin me dashuri nën ombrellën e vëllazërisë fetare. Ai synon ta bëjë shoqërinë si një trup të vetëm, duke motivuar për altruizëm dhe sakrificë. Shoqëritë që e përjetojnë këtë gjendje, ndërtojnë një "qytetërim virtytesh" shembullore, duke u lartësuar me shpirtin e vëllazërisë dhe bashkimit.



I Dërguari i Allahut

ﷺ, ka thënë:

“Zoti më urdhëroi që heshtja ime të jetë meditim, (edhe unë ua këshilloj edhe juve).”

(Ibrahim Canan, Hadis Ansklopedisi, XVI, 252, nr. i hadithit: 5838.)

Rreziku më i madh për shoqërinë, është anarkia që vjen si pasojë e mosmarrëveshjeve, ndarjeve dhe mosbindjeve. Që myslimanët të shpëtojnë nga kaosi dhe mosmarrëveshjet, duhet të zotërojnë ndjenjat e vëllazërisë. Dhe kjo, është e mundur vetëm nëse kapen fort pas Kuranit Famëllartë dhe traditës profetike të Profetit ﷺ.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të mëshiroheni!”

(Huxhurat, 10.)

“Prandaj, frikësojuni Allahut, rregulloni marrëdhëniet midis jush dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë!” (Enfal, 1.)

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut ndaj jush, sepse, kur ishit në armiqësi,



Zoti i Madhëruar, të gjitha krijesave u ka dhënë veçori të tilla, që të kenë prodhime të ndryshme, qoftë edhe me ato që ushqehen me ushqime të njëjta. Fjala vjen, nëse gjethen e një mani e ha një lopë apo një dele, prej saj prodhohet mish, qumësht dhe lesh. Nëse e ha krimbi i mëndafshit, ajo bëhet mëndafsh. Ndërkohë që kafsha e kthen barin në qumësht dhe mish, njeriu nuk ka mundësi të prodhojë qoftë edhe një gram mish apo qumësht prej tonelatash me bar në laboratorët kimike të pajisura me teknologjinë e fundit. Po ashtu edhe prodhimi i mjaltit, të cilin bletët e bëjnë prej pluhurit të luleve, e kapërcen fuqinë e njeriut. E njëjta gjë vlen edhe për ngjyrat, aromat dhe format e luleve të ndryshme, të cilat duken si barëra të thjeshtë.

Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër.” (Al-i Imran, 103.)

“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit.”

(Enfal, 46.)

Zoti i Madhëruar, urdhëron që besimtarët të jenë të bashkuar si një trup i vetëm. Po ashtu, këto urdhra lidhur me këtë çështje u janë shpallur edhe profetëve të mëparshëm.⁵⁸

Egoja dhe shejtani, ua fryn njerëzve ndjenjat e këqija, si lakmia, smira dhe interesi, duke i prishur marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin. Arma e përçarjes së këtyre dy armiqve të përjetshëm, është shumë e fuqishme dhe shkatërrimtare. Prandaj, për të mos i cenuar ndjenjat vëllazërore mes myslimanëve, duhet të mos i lihet hapësirë mllleveve dhe ndarjeve.

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Gjendja e besimtarit ndaj besimtarit tjetër, është si ndërtesa, pjesët e së cilës janë të lidhura fort me njëra-tjetrën.” Më pas, për ta bërë më të kuptueshme këtë, ka bashkuar gishtat e të dy duarve me njëri-tjetrin. (Buhari, Salat, 88, Mezalim, 5; Muslimi, Birr, 65.)

Në hadithe të tjera thuhet:

“Ju urdhëroj të bashkoheni dhe ju ndaloj nga ndarja, sepse shejtani është pranë të vetmuarit dhe larg dy njerëzve. Kush dëshiron të jetë në mes të Xhenetit, të mos ndahet nga shoqëria Islame!”

Duhet të meditosh, cila është urtësia dhe kuptimi i dhuntisë së jetës? Përse bota i është dhënë në shërbim njeriut? Nga erdhëm në këtë botë, që është si një han me dy porta, dhe për ku po shkojmë? Cila është streha ku mund të strehohemi në Kiamet, që është një shpërthim hyjnor?...



58. Shih. esh - Shura, 13.



Çdo grimcë në këtë gjithësi, i flet njeriut me zemër të gjallë. Të gjitha qeniet flasin vazhdimisht me gjuhën e tyre. Në gjithësi s'ka asnjë grimcë që s'e njeh Krijuesin e vet. I gjithë krijimi bart vulën e fuqisë së Krijuesit të Madhëruar, i Cili i krijoi nga asgjëja. Detyra e njeriut është të thellohet në meditimin e manifestimit të fuqisë dhe madhësisë hyjnore dhe të shohë këto vula hyjnore me syrin e urtësisë për të marrë mësim.

(Tirmidhi, Fiten, 7/2165; Ahmed, I, 26, V, 370 - 371.)

“Besimtarët, në dashurinë, dhembshurinë dhe mbrojtjen e njëri-tjetrit, i ngjajnë një trupi. Kur një organ i trupit sëmuret, edhe organet e tjera i kap pagjumësia dhe temperatura.” (Buhari, Edeb, 27; Muslimi, Birr, 66.)

Me qëllim që të mos cenohet bashkimi i myslimanëve, Resulullahu ﷺ, nuk i demaskoi hipokritët, edhe pse i dinte shumë mirë se kush ishin. Gjatë gjithë jetës së tij, ai i mbajti nën kontroll me të mirë dhe duroi ndaj të gjitha problemeve që i shkaktonin ata.

Nga ana tjetër, është e padiskutueshme se mes jetës sonë shoqërore dhe namazit, i cili i mbledh bashkë myslimanët pesë herë në ditë, ka një lidhje shumë të ngushtë. Gjithashtu, Allahu i Madhëruar, përmes adhurimeve, si namazi, haxhi, zekati, kurbanit etj., krijon një lidhje të fortë shpirtërore mes myslimanëve. Lidhur me këto, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Faleni namazin, jepeni zekatin dhe përkuluni në ruku bashkë me ata që përkulen (në namaz)!” (Bekare, 43.)

Në një tjetër ajet Kuranor urdhërohet:

“Vërtet, Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij, të radhitur si të ishin një ndërtesë solide.” (Saff, 4.)

Kur **Sulltan Muradi I**, po bënte xhihad në Rumeli, **Karamanoglu Alaaddin Beu** kishte

sulmuar tokat Osmane. Kur e mësoi këtë Murad Hydavendigari, mërzhitet shumë dhe shprehet:

“Shikoni ç’bën ky njeri mizor! Ne të luftojmë ditë-natë me femohuesit në një distancë prej një muaji larg, e ai vjen të plaçkitë pasurinë e myslimanëve! O luftëtarë! Si mund ta lë unë tani xhihadin dhe t’u nxjerr shpatën vëllezërve myslimanë?!”

Një prej shembujve më madhështorë lidhur me unitetin ka shfaqur edhe **Idris Bitlisi**, lideri i një fisi të madh në Anadollin lindor. Duke e mbështetur me gjithë shpirt projektin e Bashkimit Islam të **Sulltanit Javuz Selim**, ai pranoi t’i bashkojë të gjitha tokat me Shtetin Osman.

Sulltani Javuz Selim, tregoi respekt të madh për këtë personalitet, i cili ishte me origjinë kurde. Këtë respekt e tregon edhe fakti se Sulltani i dha atij fermanë me vulën e vet, por të paplotësuar, me qëllim që ai t’i përdorte për t’i dhënë titullin “bej” atyre që dëshironte. Mirëpo ai, duke treguar një shembull tjetër të virtytit të veçantë lidhur me vëllazërinë dhe bashkimin, asnjëherë nuk i plotësoi këta fermanë pa lejen e Sulltanit. Si rrjedhojë, synimet dashakeqe të Safevive mbi zonat dhe popujt e lindjes nuk u realizuan.

Në të njëjtën mënyrë, edhe **Barbaros Hajreddin Pasha**, i cili zotëronte Afrikën e Veriut, e bashkoi atë me Shtetin Osman me idenë e “Unitetit Islam”. Në këmbim të kësaj, Sulltan Sulejman Kanuni i dha atij postin e komandantit të Forcave Detare Osmane. Pas kësaj, brenda një periudhe të shkurtër kohore Mesdheu u bë një liqen i vogël

“Bëhu mik me njerëzit, sepse sa më i madh të jetë karvani, aq më lehtë thyhen kusarët.”

(Mevlana Xhelaledin Rumi)





“Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh.”

(Al-i Imran, 105.)

Osman. Krahas kësaj, u dërgua flotë detare edhe në Oqeanin Indian për të ndihmuar myslimanët e atij vendi.

Ndërkohë që Barbaros Hajreddin Pasha kishte mundësi të ishte sulltani i gjithë Algjerisë, hoqi dorë nga ky privilegj, duke ia bashkangjitur tokat Shtetit Osman. Kjo, përbën një vetëdije të lartë të besimit dhe një tablo të mrekullueshme virtytësh në emër të sigurimit të vëllazërisë dhe bashkimit të Umetit Islam.

Këshillimi

Këshillim, do të thotë që para se të fillohet një punë, të merren mendime nga njerëz të besueshëm në aspektin e dijes, përvojës dhe moralit.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“...këshillohu me ata për çështje të ndryshme!..”

(Al-i Imran, 159.)

“...(Shpërblimi i Allahut është më i mirë) ...për ata që këshillohen për punët e veta me njëri-tjetrin...”

(esh-Shura, 38.)

Kjo do të thotë se këshillimi, është një nga veçoritë më të rëndësishme të myslimanëve. Po ashtu, kur shohim në jetën e **Profetit ﷺ**, vërejmë se ai është këshilluar për çdo çështje:

Ebu Hurejre ؓ, ka thënë:

“Nuk kam parë askënd të këshillohet më shumë sesa Resulullahu ﷺ.” (Tirmidhi, Xhihad, 35/1714.)

Nuk ka dyshim, se shumë mendje marrin vendim më të saktë sesa një mendje. Resulullahu ﷺ, këtë të vërtetë e ka shprehur kështu:

“Kush bën istihare⁵⁹ nuk humbet, kush bën istishare (këshillohet) nuk pendohet dhe kush është kursimtar nuk varfërohet.” (Hejthemi, II, 280.)

Sado i mençur qoftë njeriu, është e pamundur që ai të dijë gjithçka. Prandaj, kur një i ri mysliman përballet me ndonjë çështje, nuk duhet të marrë vendime pa u këshilluar me specialistët e fushës.

Në fakt, mendja njerëzore përkufizohet si **“akl-i nakis”**. Kuptimi i kësaj është që, e vetme, mendja nuk mjafton të arrijë tek e vërteta dhe e drejta. Nëse kemi parasysh krimet që bëjnë njerëzit e mençur, kuptohet se, e vetme, mendja nuk e mbron njeriun nga veprat e gabuara.

Si pasojë e kësaj të metë, mendja duhet të përforcohet me mendje të tjera të shëndosha, sepse *“dy mendje janë më mirë se një”*.

Veçanërisht të rinjtë e kanë të domosdoshme të këshillohen me njerëz me përvojë dhe dije. Mevlana ka thënë:

59. Istihare: Namazi i istihares është një nga namazet vullnetare që është Sunet të falet kur myslimani është para ndonjë dileme dhe nuk di se cilën alternativë të marrë, nga dy e më tepër prej tyre.

Kur një i deleguar evropian dëshmoi faljen e namazit me përkushtim të ushtrisë Osmane në pauzën e Xhumasë në fushat e Hungarisë, mbeti i mahnitur dhe tha:

“50 mijë vetë të rreshtuar në rreshta të përkryer, me një thirrje të imamit lidhin duart dhe bëhen një trup i vetëm. Më pas, sërish me një thirrje të vetme, 50 mijë vetë bien në sexhde njëherësh para Allahut. E si mund të mbahen ushtritë e shkatërruara krishtere përballë një mase kaq madhështore?”

1. Ahmed Ersöz, Eđitimde Depremli Yıllar, Istanbul 1993, f. 70.



I Dërguari i Allahut
Γ ka thënë:

"Shejtani është ujk për njeriun. Njësoj si ujku që kap delen që shkëputet nga kopeja. Kujdes, mos u ndani në grupe! Mos u ndani nga xhami, nga shoqëria dhe xhamia!"

(Ahmed, II, 400; V, 335; Hakim, I, 73/59.)

"Të moshuarit shohin në një copë tulle, më shumë se sa shohin të rinjtë në pasqyrë."

Këshillimi që bëhet me sinqeritet, njëkohësisht nënkupton edhe vlerën që u jepet njerëzve prej të cilëve kërkohet këshilla. Në këtë mënyrë, forcohen edhe lidhjet reciproke të respektit dhe dashurisë.

Ndërkohë që këshillohesh, gjendja të tregohet ashtu siç është në të vërtetë. Nëse nuk veprohet në këtë mënyrë, nga këshillimi mund të dalin përfundime të gabuara.

Mirëpo, në këshillim ekziston edhe një pikë tjetër që duhet bërë kujdes: Të këshillohesh me njerëz kompetentë... Njeriu me të cilin këshillohemi duhet të ketë një mendje të shëndoshë, mendime të drejta dhe njëkohësisht të jetë ekspert i fushës.

Resulullahu Γ, ka thënë:

"Njeriu, të cilit i kërkohet këshillë, duhet të jetë i besueshëm (nuk duhet ta tradhtojë shokun duke fshehur të vërtetën)!" (Tirmidhi, Edeb, 57/2822.)

Sahabët e nderuar e pyetën:

"O Resulullah! Si të veprojmë kur të përballemi me ndonjë problem, zgjidhjen e të cilit nuk e gjejmë as në Kuran, e as në Sunet?" Resulullahu Γ, u përgjigj:

"Pyetni fakihët (juristët Islamë) e të devotshmit dhe këshillohuni me ta! Mos veproini me mendimin tuaj personal në atë çështje!" (Hejthemi, I, 178.)

Për shkak se Këshilli i Lartë i faraonit përbëhej nga njerëz interesaxhinj dhe ngatërrestarë, si përfundim i



konsultës u mor vendimi për të luftuar me Musain.⁶⁰ Dhe ky vendim fatëq, u bë shkak për shkatërrimin e përjetshëm të faraonit.

Në dekretin që **Aliu t**, i dërgoi **Malik ibn Harith el-Eshterit t**, thuhet:

“...Kujdes, mos e fut në Këshillin tënd koprracin, i cili të pengon nga e mira, duke të frikësuar me vështirësi dhe probleme ekonomike, frikacakun që të dobëson vullnetin për punë të mëdha dhe lakmitarin që të zbukuron lakminë, duke të futur në zullum! Sepse koprracia, frika dhe lakmia, janë vese aq të këqija, sa vetëm mendimi i keq për Allahun i bën bashkë në një vend...”

Për rrjedhojë, edhe njerëzit me të cilët bëhet këshillimi, duhet të bëjnë shumë kujdes. Resulullahu r, ka thënë:

“Nëse një vëlla mysliman këshillohet me dikë, e ai e drejton në rrugë të gabuar, ai e ka tradhtuar atë.” (Buhariu, el-Edebu'l-Mufred, nr. 259.)

Si përfundim, këshillimi është një parim i rëndësishëm Islam dhe një Sunet i bukur. Kështu që, këshillimi me njerëzit e duhur, edhe në çështjet e kësaj bote, edhe në çështjet fetare, është rruga më e drejtë.

Këshillimi i Omerit

Kur **Omeri t**, dëshironte të merrte vendime lidhur me çështjet e popullit, këshillohej me myslima-

Hasan el-Basri,
lidhur me dobinë
e këshillimit ka
thënë:

*“Për Allahun! Ata
që këshillohen,
orientohen në
zgjedhjet më të
mira që kanë
përballë.”*

(Buhari, el-Edebu'l-Mufred,
Nr. 258.)



60. Shih. esh- Shuara, 35 - 37.

nët. Të gjithë të diturit, të rinj apo të moshuar qofshin, ishin pjesë e Këshillit të Lartë të Omerit. (Buhari, Tefsir, 7/5, 110/4, I'tisam 2.)

Fillimisht, ai këshillohej me shumicën e myslimanëve që arrinte të takonte. Pastaj, merrte mendimin e Kurejshëve. E në fund, merrte edhe mendimin e sahabëve. Në këtë mënyrë, ai përpiquej të merrte vendimin më të saktë.

Kur Omeri t , përballë me një çështje të vështirë, këshillohej edhe më fëmijët dhe të rinjtë. Kështu, ai përfitonte nga mendjempreh-

tësia e tyre. (Bejhaki, es-Sunenu'l-Kubra, X, 113.)

Kur Omer ibn Abdulazizi u zgjodh kalif, si fillim formoi një grup këshilltarësh që ta këshillonin gjithnjë në të drejtë dhe të mirë. Ata e ndihmuan kalifin me paralajmërimet dhe këshillat që i dhanë. (Shih. Bejhaki, Kubra, X, 110.)

EDUKATA

Edukata është aq e rëndësishme në Islam, saqë për ta përkufizuar shkurtimisht atë, mund të thuhet, "Islami është edukatë!", sepse të gjitha urdhëresat Islame, njëkohësisht janë si nevojë e edukatës. Ndërsa ndalesat, janë në kundërshtim me të.

Edukata dhe morali i bukur i besimtarit, është tregues i besimit të tij të fortë.⁶¹ Pra, edukata, njëkohësisht është edhe pasqyra e një besimi të përsosur.

61. Shih. Ebu Davud, Sunet, 15/4682.

"Edhe mendja që kupton gjithçka, kur ndahet nga shokët, hutohet si shigjetari që i është thyer harku."

(Mevlana)



Edukata është maja më e lartë e moralit të bukur. Dhuntia më e mirë dhe më e vyer që Allahu mund t'i dhurojë një njeriu, është morali i bukur.⁶²

Po ashtu, Ditën e Kiametit, ajo që do të rëndojë më shumë në peshoren e veprave, është morali i bukur.⁶³ Njerëzit që Allahu dhe i Dërguari i Tij duan më shumë dhe të cilët do të jenë më afër Profetit ﷺ, në Xhenet, janë ata me moral dhe edukatë më të bukur.⁶⁴ Kësisoj, morali dhe edukata e bukur, janë një lloj vize Xheneti që u është dhuruar njerëzve për të arritur lumturinë e përrjetshme.⁶⁵

Edukatë, do të thotë të shpëtosh prej veçorive shtazore dhe të stolisesh me cilësi njerëzore. Edukata është metodologjia e çdo pune. Me një edukatë të mangët, është e pamundur të arrihet në nivelin e vërtetë njerëzor, sepse njeriu, nuk e bën njeri trupi i tij, por cilësitë e larta shpirtërore. Nisur nga kjo, Aliu ﷺ, ka thënë:

*“Edukata e njeriut, është më e rëndësishme se floriri i tij.”*⁶⁶ Pra, për njeriun është më e rëndësishme të jetë i edukuar, sesa të zotërojë gjithë pasurinë e kësaj bote.

Edukata është armiku i shejtanit. Për rrjedhojë, prindërit që nuk ia mësojnë edukatën fëmijës së tyre, i shtojnë një shok shejtanit. Njeriu i edukuar, është i mbrojtur nga e keqja e shejtanit

“Kush bën istihare nuk humbet, kush bën istishare (këshillohet) nuk pendohet dhe kush është kursimtar nuk varfërohet.”

(Hejthemî, II, 280.)



62. Shih. Ibn Maxhe, Tib, 1.

63. Shih. Ebu Davud, Edeb, 7/4799.

64. Shih. Tirmidhiu, Birr, 71/2018.

65. Shih. Tirmidhiu, Birr, 62/1004.

66. Doç. Dr. Abdulaziz Hatip, *Ali'den Hikmet Parlıtları*, stanbul 2006, f. 22.



“Të moshuarit shohin në një copë tulle, më shumë se sa shohin të rinjtë në pasqyrë.”

(Mevlana)

dhe çdo e keqe fizike apo shpirtërore. Sa bukur që e thotë poeti:

*Kurorë prej dritës hyjnore
paskësh qenë edukata,
Vendose atë kurorë, të
shpëtosh nga belaja*

Sufjan eth-Theuri, ka thënë:

“Edukata e bukur, shuan zemërimin e Allahut të Madhëruar!”

Morali më i përsosur dhe edukata më e lartë, është edukata në fe, pra, është edukata e treguar ndaj Allahut të Madhëruar, që është edhe qëllimi i tasavufit.

Pas edukatës ndaj Allahut, vjen edukata e treguar ndaj të Dërguarit të Tij ﷺ. Kjo edukatë, shtrihet në mënyrë zinxhir tek të gjitha krijesat e tjera, duke vazhduar me mësuesin, prindërit, besimtarët, etj.

Të parët tanë, me edukatën e tyre, nderin dhe dinjitetin që kanë treguar, kanë arritur të mahnitin gjithë botën. Për rrjedhojë, **Solomon Schweigger**, i cili ishte një prift protestant shumë fanatik, lidhur me edukatën e të parëve tanë, është shprehur kështu në ditarin e tij të udhëtimit:

“Ata njerëz, edhe në hamam mbulohen me diçka. Sa njerëz të edukuar që janë! Ne duhet ta mësojmë këtë edukatë nga këta barbarë (!).” (Iber Ortaylı, Osmanlı’yı Yeniden Keskfetmek, f. 88.)

Një i ri mysliman, duhet të marrë shembull edukatën e Profetit ﷺ, në çdo marrëdhënie ndërnjerëzore, në komunikim dhe sjellje. Enes ibn Maliku رضي الله عنه, e shpjegon kështu edukatën dhe moralin e të Dërguarit të Allahut ﷺ.

“I Dërguari i Allahut ﷺ, nuk fyente asnjëherë, nga goja e tij e bekuar nuk dilte kurrë asnjë fjalë e ashpër dhe nuk mallkonte. Kur donte të qortonte ndonjërin prej nesh, thoshte:

«Allahu i dhëntë mirësi, si e ka hallin ai që!..» (Buhari, Edeb, 38, 44.)

Aliu ﷺ, ka thënë:

“Mos iu përgjigj një fjale që është thënë me poshtërsi, sepse i zoti i asaj fjale, zotëron edhe shumë fjalë të tjera të ulëta si ajo dhe, sërish me to do të të përgjigjet.”

Të heqësh dorë nga edukata e mirë, tregon një indiferencë aq të madhe, saqë e ul njeriun më poshtë se kafshët dhe, si përfundim, e shpie atë në shkatërrim. Kjo sepse mungesa e edukatës, është si një pus i pafund, ku mund të zhytesh gjithnjë e më shumë. Kur ai ngop njërën prej dëshirave të egos, shfaqet një dëshirë tjetër më e keqe dhe më e ulët. E, nëse njeriu rend pas egos në këtë mënyrë, në fund patjetër që do të shkatërrohet. Siç na ka njoftuar edhe i Dërguari i Allahut ﷺ :

“Allahu i Madhëruar i urren ata që bëjnë vepra të pahijshme dhe flasin fjalë të shëmtuara.” (Tirmidhi, Birr, 62/2002.)

Jusuf Has Haxhibi ka thënë:


“Mos u thuaj njerëzve fjalë të rënda! Fjala e rëndë është një zjarr që digjet flakë. Kur e nxjerr atë nga goja jote, në fillim digjesh vetë.”

Me pak fjalë, pasuria e floririt dhe argjendit ikin, por pasuria e edukatës mbetet gjithmonë. Prandaj, një

Ibni Abbasi ﷺ, ka thënë:

“Në krye të çdolloj edukate, është respektimi i urdhrave dhe ndalesave të Allahut të Madhëruar, si në kohë rehatie, ashtu edhe në kohë vështirësie.”





*Miqtë e Allahut
kanë thënë:*

*“Adhurimi e çon
njeriun në Xhenet.
Ndërsa edukata
dhe respekti në
adhurim e çon atë
tek Allahu dhe e
afrojnë me Të.”*

i ri mysliman, para së gjithash duhet të mësojë rregullat e edukatës Islame, duhet t’u japë rëndësi atyre dhe duhet të bëhet shembull personal, duke i zbatuar vetë ato.

PËRDORIMI I FRYTSHËM I ENERGISË RINORE

Të gjitha mundësitë dhe dhuntitë që Allahu u ka dhuruar robërve të Vet, janë një tregues i qartë i mëshirës, dhembshurisë dhe dashurisë së Tij. Këto mirësi hyjnore u janë dhuruar robërve pa asnjë lloj pagese, pa punuar dhe pa e merituar. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se këto mirësi mund të përdoren pa asnjë kusht apo rregull. Pra, ato duhen vlerësuar brenda rregullave që ka caktuar Allahu i Madhëruar.

Ndërsa rinia, është mirësia më e vyer që i është dhënë birit të njeriut. Një njeri i mençur, kërkon dhe gjen mënyrën më të mirë për ta vlerësuar sa më bukur këtë mirësi të vyer dhe të kufizuar.

Vlera e rinisë kuptohet në pleqëri. E vërteta e përbashkët që e pohojnë të gjithë të moshuarit me përvojë është:

“Kurrë mos u mashtroni prej moshës së rinisë, sepse ajo kalon shumë shpejt!”

Sa bukur shprehet **Imam Rabbani:**

“Periudha e rinisë, që është koha më e nderuar, duhet harxhuar për veprat më të virtytshme.”

Një i ri besimtar, duhet të flasë me gjuhën e Kuranit dhe duhet të shmanget nga fjalori i ashpër dhe i pahijshëm, sepse shprehjet e vrazhda dhe të pahijshme, në vend që t'i afrojnë njerëzit, i largojnë ata; në vend që të bëjnë dobi, krijojnë kundërshtarë. Ja disa shembuj të komunikimit sipas gjuhës së Kuranit:

“ قَوْلًا لَّيِّنًا / **kaulen lejjina**” Fjalë të buta ndaj zullumqarit,

“ قَوْلًا مَّيْسُورًا / **kaulen mejsura**” Fjalë të lehta ndaj të skamurit,

“ قَوْلًا كَرِيمًا / **kaulen kerima**” Fjalë të bukura dhe të mira ndaj prindërve,

“ قَوْلًا سَدِيدًا / **kaulen sedida**” Fjalë të drejta dhe të sinqerta ndaj të gjithë njerëzve,

“ قَوْلًا مَعْرُوفًا / **kaulen ma'rufa**” Fjalë dashamirëse ndaj jetimëve dhe nevojtarëve,

“ قَوْلًا بَلِيغًا / **kaulen beliga**” Fjalë të urta dhe të qarta për të kumtuar dhe këshilluar...

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“...Do t'u thoni fjalë të mira njerëzve!..” (Bekare, 83.)

“Thuaje robërve të Mi, të flasin atë që është më e mira!” (Isra, 53.)

**“Mendja, e pyeti
zemrën time: «Çfarë
është besimi?».
Zemra, u përku-
l tek veshi dhe i
tha: «Besimi është
edukatë!»”**

(Mevlana)

Ndërsa **Mevlana Halid Bagdadi**, në një letër që i ka dërguar njërit prej nxënësve të vet, shprehet:

“Gjithkush le t’i drejtohet Allahut sa të ketë mundësi!.. Dëshira jonë lidhur me të dashurit tanë, është që të jenë të angazhuar me vepra të mira, të cilat do t’u zbardhin faqen nesër kur të dalin para Zotit. Allahu na ruajt prej asaj dite të tmerrshme që të zverdh fytyrën! Dijeni se, edhe punët e mira edhe ato të këqija, i përkasin vetëm atyre që i veprojnë ato.”

Një mysliman që i beson botës tjetër, e përdor në mënyrën më të frytshme kapitalin e jetës, me qëllim që ta mbushë librin e veprave me punë të mira. Çdo lloj mundësie për mirësi, që i del përpara, ai duhet ta shohë si një mundësi të dhuruar nga Allahu i Madhëruar. Ai nuk duhet të mashtrohet nga fakti se të tjerët nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur fesë apo veprave të mira. Krahas kësaj, ai duhet të shmanget edhe nga mendjemadhësia dhe krenaria, sepse egoja dhe iblisi gjithnjë i pëshpëritin: *“Sa shumë vepra të mira që ke bërë! Ah sikur të ishin të gjithë sikur ti!”*

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (me diçka tjetër) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Inshirah, 7-8.)

Nëse dikush vazhdon të qëndrojë larg shërbimit në rrugët e Allahut pa asnjë arsyetim, edhe sikur të hyjë në Xhenet, për shkak se ka pak të mira, do të jetë në shkallët e ulëta të Xhenetit.⁶⁷ Mirëpo, Ditën e Kiametit,



67. Shih. Ebu Davud, Salat, 232/1108. Krahaso: Muslimi, Salat, 130; Ebu Davud, Salat, 97/680.

njeriu do ta ndiejë nevojën edhe të një vepre të mirë, sado e vogël qoftë ajo.

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Ditën e Kiametit, njerëzit do të vendosen në rreshta. Ndërkohë, një nga njerëzit e Xhehenemit takon një nga njerëzit e Xhenetit dhe i thotë:

«O ti filan! A më mban mend? Njëherë kërkove ujë prej meje, e unë të dhashë.»

Ndërsa besimtari ndërmjetëson tek Allahu për atë njeri.

Një tjetër (prej njerëzve të Xhehenemit) shkon pranë njërit prej atyre të Xhenetit dhe i thotë:

«E mban mend, një ditë të kam dhënë ujë për të marrë abdes?» (pastaj kërkon ndërmjetësim prej tij) dhe ai ndërmjetëson për të.

Përsëri, njëri prej njerëzve të Xhehenemit, i thotë njërit prej atyre të Xhenetit:

«O ti filan! A e mban mend atë ditë kur më dërgove për një punë dhe unë shkova për ty?» Pastaj edhe ky xhenetli ndërmjetësoi tek Allahu për të.” (Ibn-i Maxhe, Edeb, 8.)

Natyrisht, nëse Allahu i Madhëruar dëshiron dhe jep leje, ndërmjetësimi i besimtarëve do të jetë i dobishëm.

Në fakt, ne nuk e dimë se cilat vepra do të bëhen shkak për shpëtimin tonë në jetën tjetër. Prandaj, ne duhet të nxitojmë për çdo punë të mirë, e madhe apo e vogël qoftë, duhet ta vlerësojmë mirë kohën dhe duhet të lodhemi pak në këtë botë.

E. M. Gray, ka studiuar cilësitë e përbashkëta të njerëzve të suksesshëm dhe në artikullin e tij lidhur me këtë çështje, shprehet:

“Njerëzit e suksesshëm, kanë bërë zakon gjërat që të



“Dëbimi i Iblisit nga Porta Hyjnore, ishte si pasojë e guximit që tregoi duke u shprehur pa edukatë ndaj Allahut...”

Nëse dëshiron t’ia shtypësh kokën shejtanit, hapi sytë dhe shih; ajo çfarë e shkatërron shejtanin është edukata! Nëse njeriu nuk ka edukatë, në realitet ai nuk është njeri, sepse dallimi mes njerëzve dhe kafshëve është edukata.”

(Mevlana)

Omeri ﷻ , ka thënë:

“Katër gjëra nuk kthehen kurrë:

Fjala e thënë.

Shigjeta e lëshuar.

Jeta e kaluar.

Mundësia e humbur.”

“Kush e kalon rininë duke u zbavitur, e kalon pleqërinë duke qarë!”

(A. Fuad Basgil)



pasuksesshmit nuk i pëlqejnë. Të jesh i suksesshëm në jetë, varet shumë nga planifikimi dhe përdorimi i mirë i kohës.”

(Ozcan Hidir, Vakit Disiplini, f. 78.)

Nuk duhet harruar se, sukseset e mëdha fshihen pas përpjekjeve me ato gjëra që janë të rënda për egon. Për rrjedhojë, një nga sahabët, Abdurrahman ibn Aufi ﷻ , thotë:

“Islami solli disa urdhra që nuk i pëlqejnë egos. Por, ne gjetëm më të mirën e të mirave në këto urdhra që nuk i pëlqenin egos. P.sh., ne dolëm nga Meka me Resulullahun ﷺ , për të emigruar. Por në sajë të këtij emigrimi, që u duk i vështirë për egon tonë, na u dhurua nder dhe fitore. Njëherë tjetër, siç shprehet edhe Allahu i Madhëruar në Kuran: **«Zoti yt të nxori nga shtëpia jote (për të luftuar) për të Vërtetën edhe pse kjo nuk i pëlqeu një grupi prej besimtarëve. Ata polemizojnë me ty për të vërtetën (luftën), e cila u ishte bërë e qartë, sikur të ishin duke u çuar drejt vdekjes së sigurt.»** (Enfal, 5-6.), dolëm së bashku me Resulullahun ﷺ , në Bedër. Edhe në këtë rast, Allahu i Madhëruar na dhuroi nder dhe fitore.

Me një fjalë, mirësitë më të mëdha, i arritëm në sajë të punëve të vështira për egon tonë.” (Hejthemi, VII, 26-27.)

Rahmet pastë, babai im **Musa Topbash**, ka thënë:

“Kur isha i ri, pëlqejja shumë të rrija me njerëzit e ditur. Përditë shkoja dhe qëndroja një copë herë me ta. Ata e dinin sinqeritetin tim dhe më mbanin afër. Më së shumti shkoja tek Elmallëllë Hamdi Efendiu. Atëherë isha rreth 13-15 vjeç. Atij i

thoshin dijetari i kohës. Megjithatë, ai ishte shumë modest. Atë e vizitonin shumë njerëz...

Në moshën 23-25 vjeç, frekuentova afro dy vite me radhë bisedat fetare të Mustafa Asim Joruk Efendiut. Edhe ky personalitet ishte në krye sa i përket modestisë. Madje, faktin se ai ishte hafiz Kurani, e mësova vetëm disa ditë para se të ndërronte jetë.

Mes viteve 1945-1955, vizitoja shpesh muhadithin Bekir Haki Jener Efendiun, për të cilin kisha shumë respekt. Ato vite, ai mbante vazë në xhaminë Sheh-zadebashi, e cila mbushej plot e përplot kur ligjëronte ai.

Një nga epiqendrat që përhapte dritë në shekullin e njëzetë, pa dyshim që ishte edhe komentuesi i Mesnevisë, Tahiru'l-Mevlevi Efendi... Sa herë që kisha mundësi, e vizitoja atë njeri të lartë e të edukuar dhe përfitoja nga bisedat e tij morale, historike dhe letrare.

Po ashtu, kur gjeja mundësi, shkoja për vizitë edhe tek njerëz të mëdhenj, dijetarë, njerëz të virtytshëm dhe me besim të pjekur, si Ali Jekta Efendi, Omer Nasuhi Efendi dhe Ali Fuat Bashgil, etj. Padyshim se edhe prej këtyre njerëzve kam përfituar mjaft."⁶⁸


Nëse rinia e konsumon energjinë e saj për të kënaqur dëshirat dhe kërkesat e egos, do të privohen nga mirësitë dhe mëshira e Allahut të Madhëruar. E,



Ebu Bekri r , ka thënë:

"Dynjaja është tregu i besimtarëve, nata dhe dita janë kapitali i tyre, veprat e mira janë mallrat e tregtisë, fitimi i tyre është Xheneti dhe humbja e tyre është Xhehenemi."

68. Shih. Allah Dostunun Dünyasından (Përg. Erkam Yayınları), f. 13-14, 36-37, 195-196, 60; Altınoluk, Nr. 162, f. 12, Gusht-1999; Sadik Dana, İslam Kahramanları, III, 170; Altınoluk Sohbetleri, V, 136 - 140.



Dijetari dhe poeti, Abbas ibn Hasani ka thënë:

“Dijeni se, mendja nuk mund të merret me gjithçka. Prandaj, ndajini në një anë gjërat më të rëndësishme! Nuk mund të interesohesh në mënyrë të veçantë as me çdokënd. Prandaj interesimin dhe kujdesin kushtojua njerëzve të mirë! Po ashtu, as bujaria jote nuk mund të arrijë çdokënd. Edhe atë fshihe për njerëzit e virtutshëm! Edhe nëse përpiqesh vazhdimisht, dita dhe nata nuk mjafton për të përballuar nevojat e tua. Prandaj ndaj mirë nga njëra-tjetra gjërat që duhet të bësh dhe ato që duhet të lësh!..” (Ebu Gʻudde, Zamanin Kiyemeti, f. 88-89.)

padyshim se të rinjtë që janë zhytur në një fatkeqësi të tillë, do të mbeten pas në çdo aspekt.

Një ditë e kësaj bote është më e vyer se njëmijë vite të botës tjetër

Kjo botë është vendi ku punohet për të fituar, ndërsa bota tjetër është vendi i shpërblimeve. Në botën tjetër nuk ka punë. E për rrjedhojë s’ka as fitime dhe as humbje. Prandaj dhe koha në këtë botë ka vlerë shumë të madhe.

Xhunejd Bagdadi ka thënë:

“Një ditë e kësaj bote, është më e vyer sesa njëmijë vite të botës tjetër, sepse veçoria e fitimit dhe humbjes i përkasin kësaj bote. Ndërsa në botën tjetër, nuk ekziston mundësia të bëhet diçka për të shpëtuar.”

Sipas një transmetimi, kur Iljasi **U** , takohet me melekun që merr shpirtat, rrëqethet paksa. Për këtë arsye, Azraili **U** , thotë:

“Ti je një profet, o Iljas! U frikësove nga vdekja?”

Iljasi **U** , përgjigjet:

“Jo, nuk u frikësova nga vdekja. Por u hidhërova nga fakti se më mbaroi jeta. Unë e kam kaluar jetën time duke bërë adhurime e duke ligjëruar dhe ndjeja ëmbëlsi të madhe prej të qenit rob i Allahut. Mirëpo tani do të jem peng në varr deri në Ditën e Kiametit. Për këtë arsye u pikëllova”.

Nxitimi në punë të mira

Nxitimi për vepra të mira, është tregues i një besimtari të pjekur. Sa bukur është shprehur **Mevlana**:

“Treguesi i pranimit të adhurimeve, është fillimi i një adhurimi tjetër pas tyre dhe rendja në punë të mira njëra pas tjetrës.”

Nderi i një mirësie, është atëherë kur bëhet pa u vonuar. Ja një shembull shumë domethënës lidhur me këtë çështje:

Resulullahu **ﷺ**, i motivoi sahabët në betejën e Bedrit dhe u kujtoi Xhenetin. Kur armiku u afrua shumë, tha:

“Ejani, ngrihuni për Xhenetin, gjerësia e të cilit është sa qiejt dhe Toka!”

Pas kësaj, **Umejr ibn Humam** **ؓ**, u hodh dhe pyeti:

“O i Dërguari i Allahut! A thatë «Xheneti, gjerësia e të cilit është sa qiejt dhe Toka»?”

“Po!” - i tha Profeti **ﷺ**.

“Sa mirë, sa bukur!” - tha Umejri **ؓ**.

Pas kësaj Resulullahu e pyeti:

“Përse po thua kështu?”

“Vallahi, o Resulullah! S’e thashë për gjë tjetër, përveçse nga dëshira për të qenë banor i Xhenetit.”
- u përgjigj ai.


Resulullahu **ﷺ**, i tha:

“Ti je prej banorëve të Xhenetit!”

Më pas, për të hyrë më i fuqishëm në luftë, Umejri **ؓ**, nxori disa hurma nga çanta dhe filloi t’i

Kush pandeh se rinia është kohë argëtimi, është në humbje. Në fakt, rinia është koha më e frytshme kur mund të fitohen besimi i fortë dhe zakonet e bukura, të cilat do t’i duhen njeriut përjetësisht.





“Mbrojtja e fëmijëve nga zjarri i Xhehenemit nga prindërit e tyre, është më e rëndësishme se mbrojtja nga zjarri i kësaj bote. Mbrojtja nga zjarri i Xhehenemit, arrihet duke u mësuar atyre besimin, farzet, haramet, adhurimet dhe duke i ruajtur nga njerëzit e pafë dhe të paedukatë. Zanafilla e gjitha të këqijave është shoqëria e keqe.”

(Musa Efendi -Allahu e mëshiroftë!)

hajë. Mirëpo nuk duroi shumë dhe tha:

“Nëse jetoj aq sa t’i haj këto hurma, kjo do të ishte vërtet një jetë e gjatë. Nëse qëndroj këtu derisa t’i haj hurmat, do të tregohesha si shumë lakmitar ndaj kësaj bote!” Pas kësaj i flaku hurmat që kishte në dorë, rrëmbeu shpatën dhe

luftoi me armikun. Si përfundim, ai arriti gradën e dëshmorit. (Shih. Buhariu, Megazi, 17; Muslimi, Imaret, 145; Muvatta’, Xhihad 42.)

Besimtari që dëshiron të mbushë librin e veprave me punë të mira dhe të arrijë një shkallë të lartë në Xhenet duhet të nxitojë dhe ta vlerësojë mirë kohën. Ai duhet të përpiqet të bëjë vepra të mira sa të ketë mundësi. Mirëpo, ndërkohë që garon për punë të mira, nuk duhet të nxitojë e t’i bëjë punët me mangësi dhe të meta, sepse Allahu i Madhëruar, dëshiron që çdo punë të bëhet me rregull dhe cilësi. Lidhur me këtë çështje, dijetari i shquar **Alijju’l-Keri**, bën një sqarim të tillë:

“Mes nxitimit drejt urdhrave të Allahut dhe nxitimit në kryerjen e tyre ka një dallim të madh. E para është e pëlqyeshme dhe lavdërohet, kurse e dyta është e qortuar.”

Të punosh deri në vdekje

Besimtari nuk ngopet me vepra të mira, derisa stacioni i tij i fundit të jetë Xheneti. Ndaj dhe në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!” (Hixhr, 99.)

Për besimtarët që jetojnë me këtë vetëdije, çdo

çast i jetës është koha për shërbim dhe përpjekje në rrugë të Allahut. Sa bukur që e shpjegon këtë të vërtetë, ky shembull:

Kur Sulltan Sulejman Kanuni, i cili e kishte komanduar vetë shumicën e luftërave të zhvilluara në periudhën e tij, po përgatitej për luftën e Zigetvarit, e cila do të ishte edhe e fundit për të, i vjen Sadrazami i tij, Sokullu Mehmet Pashai dhe i thotë:

“ Sulltani im! Ju i keni dhuruar popullit tuaj fitore të panumërta. Tashmë jeni lodhur. Gjithë jetën tuaj ia kushtuat Botës Islame. Duke marrë parasysh moshën tuaj, pjesëmarrja në këtë luftë, do të ishte shumë e vështirë për ju. Prandaj ju duhet të qëndroni në Stamboll dhe të vazhdoni qeverisjen këtu. Ndërsa në luftë do të shkoj unë, vezirët dhe pashallarët e tjerë. Pra, mos u shqetësoni për këtë!..”

Sulltan Sulejmani, i përgjigjet kështu Sokullu Mehmet Pashait:

“Dëgjo mirë Sokullu! Këtë amanet, transmetojua edhe brezit që do të vijë pas meje! Një padishah, duhet të dalë gjithmonë në luftë së bashku me ushtarët e tij, sepse atyre u shtohet trimëria kur e shohin padishahun e tyre. Kur armiqtë shohin se padishahu merr pjesë në luftë, u duket më e fuqishme ushtria që kanë përballë. Për këtë arsye, u bie morali dhe u thyhet guximi. Shkaku kryesor që sjell fitoren e luftës është fuqia shpirtërore!

Ne, që prej fëmijërisë kemi fituar përvojë të madhe në drejtimin e shtetit. Gjatë luftës, mund të ketë çaste që do

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Gjendja e kësaj bote në krahasim me botën tjetër, është sikur dikush prej jush të fusë gishtin në det dhe ta nxjerrë. Çfarë të nxjerri gishti (nga deti), aq është edhe kjo botë (në krahasim me botën tjetër)”

(Hakimi, Mustedrek, 4/319.)



të ndihet nevoja për këtë përvojë. Dhe shpesh, rrjedhën e ngjarjeve e vendosin çastet, minutat. Për këtë arsye, edhe pse jam i moshuar, do të marr pjesë në luftë!.. Si mund të dal nesër në *mahsher*⁶⁹ përpara të parëve të mi çlirimtarë nëse qëndroj në saraj dhe vdes me kokën në jastëk?!..

Pavarësisht moshës së tij të thyer, Sulltan Sulejmani doli në luftë në krye të ushtrisë. Në një moment gjatë luftës, karrot që mbanin topat ngecën në moçal dhe forca fizike e kafshëve nuk mjaftoi për



69. Mahsher: Vendi ku njerëzit do të mblihen menjëherë pasi të ringjallen, për të pritur fillimin e Gjykimit.

Një njeri i kërkon diçka Hasan el-Basriut. Ai ngrihet menjëherë në këmbë dhe i jep

këmishën e tij. Ata që ndodheshin aty thonë:

“O Hasan! Më mirë të kishe shkuar dhe t’i kishe dhënë diçka prej shtëpisë!”

Hasan el-Basriu u përgjigjet:

“Njëherë, në mesxhid erdhi një i varfër dhe tha: “Kam uri!”. Ne u treguam të pakujdesshëm dhe nuk i sollëm menjëherë për të ngrënë. E lamë në mesxhid dhe shkuam në shtëpitë tona. Kur erdhëm në namazin e sabahut, pamë se ai kishte vdekur. E qefinosëm dhe e varrosëm. Ditën tjetër, në mihrabin e mesxhidit, në formën e një shfaqjeje shpirtërore, qëndronte qefini me të cilin kishim mbështjellë të ndjerin një ditë më parë dhe mbi të shkruhej: “Merreni qefinin tuaj. Allahu nuk e pranoi!”

Atë ditë, u betova se, «që këtej e tutje, kur të shoh ndonjë nevojtar, nuk do t’ia vonoj ndihmën, por do t’ia plotësoj menjëherë nevojën!»”

1. Shih. Darir Mustafa Efendi, *Yüz Hadis Yüz Hikaye*, haz. S. Yıldırım - N. Yılmaz, stanbul 2001, s. 157.

t'i nxjerrë topat prej aty. Ushtria kishte përparuar dhe aty rrotull kishin mbetur pak ushtarë dhe disa pashallarë. Sulltani urdhëroi:

“Të gjithë njerëzit me grada të larta, përfshi edhe pashallarët, të hyjnë në moçal dhe t'u japin një dorë karrove të topave!..”

Të gjithë përveshën mëngët dhe hynë në moçal. Në sajë të entuziazmit shpirtëror që kishin, karrot e topave u nxorën nga moçali...

Sulejmani i Madhërishëm ndërroi jetë gjatë kësaj lufte dhe arriti gradën e dëshmorit.

Vdekjet e virtytshme që janë gdhendur në histori

Në një hadith fisnik thuhet:

“Si të jetoni, ashtu do vdisni dhe siç keni vdekur, ashtu do të ringjallen!..” (Munavi, Fejdul-Kadir, V, 663.)

Disa shembuj të gdhendur në histori të vdekjeve të mbushura me mësim dhe urtësi, të besimtarëve shembullorë, të cilët e kanë vlerësuar jetën me këtë vetëdije:

Halid ibn Uelidi **ؓ**, i cili i ka dhuruar triumfe të panumërta historisë Islame, të cilit i janë thyer nëntë shpata në dorë ditën e Mutes⁷⁰, i cili me tremijë ushtarë të ushtrisë Islame i kalli datën njëqind mijë ushtarëve të ushtrisë armike, i cili shkroi legjendë në Jermuk, ngadhënjimtari i Sirisë dhe siç është shprehur Profeti **ﷺ**, lidhur me të, “shpata e Allahut”, u sëmur në Humus



“Kur Meleku i Vdekjes i merr shpirtin pasanikut indiferent, e zgjon atë nga gjumi. E ai rreh gjoksin dhe bëhet pishman për pasurinë që në të vërtetë nuk e kishte të vetën dhe për vështirësitë që ka kaluar në këtë botë. Mirëpo, tashmë do të jetë shumë vonë.”

(Mevlana)

70. Shih. Buhariu, Megazi, 44.



**Në një hadith,
thuhet kështu:**

*“Besimtari nuk
ngopet nga asnjë
punë e mirë që
dëgjon, derisa
vendi i tij i fundit
që do të shkojë
të jetë Xheneti.”*

(Tirmidhi, Ilim, 19/2686.)

në vitin 21 Hixhri. Pranë kishte shokët e tij të luftës. Kur e ndjeu që po vdiste, kërkoi që t'i jepnin shpatën. E kapi dorezën e shpatës, e përkëdheli me dhembshuri dhe tha:

“Në dorën time janë shkatërruar shumë shpata.

Kjo është shpata ime e fundit që do të shohë vdekjen time. Ajo çfarë më mërzi më shumë, është vdekja në shtrat e këtij Halidi, i cili e ka kaluar gjithë jetën në sheshet e betejave dhe nuk ka parë shtrat me sy. Asnjë sahab i Resulullahut nuk ka vdekur i qetë në shtrat. Ata kanë rënë dëshmorë ose në sheshet e betejave, ose në mërgim duke përhapur Islamin në vise të largëta.

Ah Halid! Halidi që nuk mundi të bjerë dëshmor! Lufta nuk mundi të ma bluajë mishin. Përveç gradës së dëshmorit, nuk ka asnjë titull tjetër që të mos e kem fituar. Në trupin tim nuk kam asnjë pëllëmbë që të mos ketë marrë plagë nga shpatat apo heshtat. Kështu, në shtrat duhej të ishte fundi i një njeriu, që gjithë jetën ka kalëruar kalin nëpër beteja për të përhapur Islamin?!

E prisja vdekjen si dëshmor në sheshet e luftës, mbi kalin tim, duke vringëlluar shpatën ndaj armikut për hir të Allahut...”

Më pas tha:

“Po ju lë testamentin, më ngrini në këmbë!” Kur e ngritën në këmbë, u mbështet tek shpata dhe tha:

“Tani më lëshoni! Le të më mbajë shpata ime, të cilën e kam mbajtur deri tani.”

“Dua ta pres vdekjen në këmbë, sikur të isha në luftë. Pasi të vdes, kalin jepjani një trimi që mund të zhytet në

rreziqet e betejave. Do të vdes pa pasur asgjë tjetër, përveç kalit dhe shpatës. Varrin hapmani me këtë shpatë. Heronjtë e duan vringëllimën e shpatës.” Pas këtyre fjalëve, ra mbi shtrat dhe dorëzoi shpirtin, duke thënë shehadetin.⁷¹

Ushtria Islame nën komandën e Abdurrahmanit, djalit të Halid ibn Uelidit **ت**, doli në fushatë ushtarake me shpresën për t’u bërë pjesë e sihariqit dhe përgëzimit të Profetit të Allahut **ر**, i cili ka thënë:

“Padyshim se Kostandinopoja do të çlirohet. Sa komandant i mirë dhe sa ushtarë të mirë janë ata që do ta çlirojnë!”⁷²

Pavarësisht moshës së tij të thyer, në këtë ushtri bënte pjesë edhe Ebu Ejjub el-Ensari **ت**, i cili e ka mbajtur të Dërguarin e Allahut **ر**, rreth gjashtë muaj si mysafir në shtëpinë e tij, ka marrë pjesë në të gjitha luftërat bashkë me të dhe nuk ka përtuar kurrë për asnjë lloj shërbimi në rrugën e Allahut. Ky sahab i zgjedhur, zotëronte një vetëdije aq të lartë devotshmërie, sa asnjëherë nuk mjaftohej me veprat që bënte. Megjithëse ishte 80 e kusur vjeç, me një entuziazëm të madh që buronte nga besimi, po merrte pjesë për herë të dytë në betejën për Kostandinopojën. Mirëpo, ai u sëmur gjatë këtij udhëtimit dhe, kur iu afrua vdekja, iu drejtua shokëve të tij luftëtarë e u tha:

“Nëse vdes, merrmëni me vete dhe dërgomëni në vendin më të largët ku mund të arrini në tokat romake. Kur të përballeni me ushtrinë armike dhe nuk mund të çani më shumë, më varrosni nën këmbët tuaja!..” (Shih. Ahmed, V, 419, 416.)

71. Shih. Sadik Dana, slam Kahramanlari, v. 1, f. 68 - 69, Erkam Yayinlari, Istanbul, 1990.

72. Ahmed, IV, 335; Hakim, IV, 468/8300.

Kush ikën nga kjo botë, le të ikë në daç si skllav, në daç si sulltan, kapitali i tyre është vetëm aq sa kanë dërguar më parë (sa kanë qenë gjallë). Aty është vendi ku ndahet shapi nga sheqeri, ku shumë të varfër do të arrijnë thesare dhe shumë pasanikë indiferentë do të bëhen të varfrit e përjetësisë. Aty do të bëjnë dobi vetëm besnikëria ndaj Allahut dhe zemra e pastër.





Në një hadith fisnik thuhet:

“Kush e kërkon me gjithë zemër gradën e dëshmorit, Allahu i dhuron atë edhe sikur të vdesë në shtrat.”

(Muslim, Imare, 157; Nesai, Xhihad, 36.)

Shkurtimisht, Ejjub el-Ensari **t**, ndërroi jetë në këtë fushatë, duke u bërë prej fatlumëve të parë që ranë dëshmorë për çlirimin e Kostandinopojës. Sipas porosisë që la, ai u varros pranë mureve të qytetit, në lagjen që sot njihet me emrin e tij. Në këtë mënyrë, ashtu siç ka rendur gjithë jetën në rrugë të Allahut, edhe pas vdekjes

ai e ka vazhduar shërbimin e tij në këtë rrugë, duke i treguar ushtrisë Islame me varrin e tij, cakun që duhet të kapërcejnë për të shkuar më tutje.

Me qëllim që të bëhen përpjekje në rrugë të Allahut, është kusht që entuziazmi i besimit të qëndrojë i gjallë deri në frymën e fundit. Prandaj, zemra duhet të jetë gjithnjë bashkë me Allahun e Madhëruar. Një shembull i qartë i kësaj të vërtete, është edhe gjendja e Sulltan Javuz Selimit:

Pasi u kthye nga fushata e Egjiptit, në vitin 1520 **Sulltan Javuz Selimi** niset drejt Edirnesë për t’u përgatitur për një tjetër fushatë. Kur arrin në fshatin Ugras, ku i kishte vdekur edhe i ati, vë re se në shpinë i kishte dalë një lungë, të cilën megjithëse e paralajmëruan, e këput dhe e gjakos.

Shoqëruesi dhe shoku i tij i ngushtë, Hasan Xhani, e tregon kështu këtë ngjarje:

“Në shpinë i kishte dalë një çiban që i thonë «lungë». Brenda një kohe të shkurtër, lunga u zmadhua dhe u shndërrua në vrimë. Nga vrima ia shihnim mushkërinë. Ai vuante shumë. Ishte si një luan i plagosur, por, kurrsesi s’e pranonte sëmundjen dhe dobësinë! Ndërkaq, ai vazhdonte t’u jepte taktika dhe urdhra luftëtarëve të tij. Iu afrova pranë dhe, duke aluduar për gjendjen e vet, ai më tha:

«Ç'është kjo punë, o Hasan?»

Unë, e ndjeva se tashmë ai kish ardhur në fundin e udhëtimit të tij të përkohshëm në këtë botë dhe ishte afruar në krye të jetës së amshuar dhe, për këtë arsye, me hidhërimin e ndarjes që ma digjte zemrën, i thashë:

«Sulltani im! Siç duket, ka ardhur koha të bashkohesh me Zotin tënd!»

Sulltani u kthye nga unë, më pa i habitur në fytyrë dhe më tha:

«Hasan, Hasan, me kë pandeh se kam qenë deri tani!? Apo mos pe ndonjë të metë në orientimin tim te Zoti?»

I turpëruar nga këto fjalë, i thashë:

«Zoti mos e dhëntë, sulltani im! Nuk desha të thosha ashtu! Guxova të shprehem ashtu vetëm për të treguar se gjendja në të cilën ndodhemi ndryshon nga kohët e tjera, duke menduar për të ardhmen!»

Tashmë, i kredhur në botë të tjera, sulltani i madh më tha fjalët e tij të fundit:

«Hasan, këndoje suren Jasin!»

Fillova të këndoj me sytë e përplotur. Kur arrita te ajeti «Selam», ia dorëzoi Zotit shpirtin e vyer!»

Të arrish ta shndërrosh vdekjen nga humbje në fitore, duke e bërë jo ditë zie, por ditë dasme, është veçori vetëm e atyre që përgatiten për vdekjen dhe dinë të vdesin. Një nga fatlumët që janë bashkuar me Zotin, pas një jete të begatë në



Jeta e mbushur plot me luftëra dhe triumfe e Sulltan Mehmed Fatihut, mori fund po gjatë një beteje. Ai doli me një ushtri madhështore prej treqind mijë ushtarësh dhe askush nuk dinte se për ku ishin drejtuar. Mirëpo, kur ishin ende në krye të udhëtimit, u helmua dhe ndërroi jetë në Gëbze. U takua me Zotin e tij duke qenë pjesë e sihariqit të Profetit ﷺ dhe duke gëzuar gradën e dëshmorit.

rrugën e Tij, është edhe ushtari shembullor me emrin **Zabit Muzaffer**, i cili i ka dhuruar historisë Islame një kujtim të pashoq.

Ky i ri me gjoksin plot besim, i cili tregoi përpjekje heroike në Luftën e Çanakalesë, nuk është ndalur nga lufta edhe pas kësaj beteje, duke vrapuar të mbrojtë atdheun edhe në frontin e lindjes. Ai u plagosur rëndë gjatë një përleshjeje të përgjakshme dhe, duke lënë pas një kujtim të dytë dhe sublim për brezat pasardhës, piu sherbetin e dëshmorit. Zabit Muzafferi, i cili u përlesh në frontin e parë dhe ra dëshmor në krye të detyrës, në frymën e fundit, kur zëri nuk i dilte më dhe sytë nuk mund të shprehnin asgjë, nxjerr nga xhepi një zarf, merr një mbeturinë nga toka, e lyen me gjakun e plagës dhe fillon të shkruaj:

“Ushtar! Nga është kibla?!”

Ata që gjendeshin përreth, e drejtuan nga kibla Muzafferin, i cili donte t’ia dorëzonte Allahut shpirtin në drejtim të Qabes, duke ia plotësuar dëshirën e tij të fundit Zabiti, të cilit iu mbush fytyra me dritën e takimit me Allahun. Ai ia dorëzoi shpirtin e tij Zotit si dëshmor.

Ja pra, nëse një rob nuk ka devijuar kurrë nga drejtimi i kiblës, çfarëdoj profesioni dhe detyrë të ketë bërë gjatë jetës, në njëfarë mënyre Allahu i Madhëruar do t’ia bëjë të mundur t’i drejtohet kiblës edhe çastet

e fundit të jetës. Ata që kanë jetuar në përputhje me Kuranin dhe Sunetin dhe kanë gjetur kiblën duke mos dalë asnjëherë nga korniza e teuhidit, si në jetën profesionale, ashtu edhe në follenë familjare, në marrëdhëniet



***O shehid, bir shehidi! Nga unë mos kërko varr;
Për ty krahëhapur po qëndron ai Profet!..***

(Mehmed Akif Ersoj)

ndërnjerëzore dhe përgjegjësitë fetare, në përgjithësi bëhen pjesë e atmosferës qetësuese të kiblës edhe në frymën e fundit.

Zotërimi i idealeve të larta

Një mysliman duhet të ketë gjithmonë ideale të mëdha dhe duhet të punojë për t'i realizuar ato. Edhe sikur të mos ia arrijë qëllimit, duhet ta dijë se Allahu i Madhëruar do t'i shpërblejë patjetër përpjekjet e tij.

Osmani **†**, urdhëroi komandantët e ushtrisë që të kalonin Ngushticën e Gjibraltarit dhe të hynin në Andaluzi. Ai mendonte të lehtësonte çlirimin e Kostandinopojës, duke u bërë presion nga perëndimi. Për rrjedhojë, atyre që morën pjesë në fushatën e Andaluzisë, u shkroi këtë letër:

“Kostandinopoja mund të çlirohet vetëm prej Andaluzisë. Nëse e çlironi Andaluzinë, edhe ju do të bëheni ortakë në shpërblimin e atyre që do të çlirojnë Kostandinopojën më vonë. Ue’s-salam!”⁷³

Kështu, në kohën e Osmanit **†**, u realizuan çlirimet në Afrikën Veriore dhe, Bizanti, që ishte fuqia më e madhe përballë Islamit, filloi të shtrëngohej nga perëndimi.

Në periudhën Emevite, **Ukbe ibn Nafiu †**, nga brezi i tabiinëve, u dërgua në Afrikë. Ukbe **†**, zaptoi



Trimin Sulltan Javuz Selimin, e shohim si një luan kur kaloi shkretëtirën Sina; si një besimtar falënderues, modest dhe me sy të përplotur kur hyri në Egjipt dhe si një dervish që e orienton veten drejt vetëllogarisë dhe të zhytur në kënaqësitë e thella hyjnore kur gjendej në Yskydar.

73. Ibni Kethir, el-Bidaje, VII, 144; Ibnu'l-Ethir, el-Kamil, III, 93; Muhamed Hamidullah, “Fet’hu'l-Endulus (Spanja) fi Khilafeti Sejjidina Uthman sene 27 li'l-Hixhre”, I. U. Ed. Fak. İslam Teknikleri Enstitüsü Dergisi, İstanbul 1978, VII, 221 - 225.



Të arrish ta shndërrosh vdekjen nga humbje në fitore, duke e bërë jo ditë zie, por ditë dasme, është veçori vetëm e atyre që përgatiten për vdekjen dhe dinë të vdesin.

zonën e Kajravanit, ku caktoi si administrator Zuhejr ibn Kajsini dhe i tha:

“Unë ia shita veten Allahut të Madhëruar. Ndaj dhe do të vazhdoj të luftoj deri në pafundësi me ata që e mohojnë Atë.” Më pas, e porositi për gjërat që dëshironte të bëheshin pas tij.

Ndërkohë që Ukbe **t**, vazhdonte çlirimet, i doli përpara pengesa detare. Ai e drejtoi kalin në det dhe tha:

“O Zot! Sikur të mos ishte gjithë ky det, do të përparoja drejt vendeve të tjera, duke bërë xhihad në rrugën Tënde!” (Shih. Ibnu’l-Ethir, el-Kamil fit-Tarih, IV, 105 - 106.)

Sulltani Javuz Selimi, i cili është edhe një nga sulltanët më shquar në historinë Osmane, kur po kthehej nga Kajroja për në Stamboll, më 10 Shtator 1517, tregoi horizontin e gjerë të idealeve dhe objektivave të një besimtari të përsosur, me këto fjalë që janë shënuar në histori:

“Zemra ma do të dal në Andaluzi prej Afrikës Veriore dhe më pas të kthehem sërish në Stamboll prej Ballkanit!”

Pas fushatës së Egjiptit, Javuzi filloi të interesohej edhe për myslimanët e Indisë dhe të Lindjes së Largët. Ai thërret Sadrazamin Piri Mehmed Pashën dhe duke aluduar në vendin ku më vonë do të hapej Kanali i Suezit, tha:

“Këtu e bashkoj Detin Mesdhe me Detin e Kuq dhe shkoj në Indi prej detit!”

Me këtë, Javuzi shprehu qëllimin që të pengonte dhunën që po ushtronin portugezët mbi myslimanët në Indi, duke bërë edhe shumë përgatitje për këtë. Madje Piri Mehmed Pasha kishte prodhuar edhe topat që nevojiteshin për çlirimin.

Një ditë, sulltani kishte pyetur për gjerësinë e botës. Për këtë arsye, atij i sollën një hartë të botës, të cilën ai e pa me habi dhe nënçmim. Më pas tha:

“Për një sulltan mbase, por për dy sulltanë është pak!” Pastaj e hodhi hartën poshtë këmbëve të kalit dhe e ngriti kalin me dy këmbët e para.

Këtu duhet të theksojmë se, nëse çlirimet bëhen për të ujitur tokën me gjak, ky është një krim. Shpata, e vetme, është vetëm një copë hekur. Me një shpatë që nuk përdoret për një qëllim sublim, nuk mund të bëhen as çlirime. Shpata përdoret vetëm për të eliminuar dhunën në botë dhe për të hapur rrugën e udhëzimit Islam. Çlirimi i vërtetë, është ai i zemrave.

Shërbimi

Një nga fushat më të bukura ku mund të përdoret energjia e rinisë, është shërbimi që bëhet për hir të Allahut. Shërbimi, është detyra jonë shoqërore e devotshmërisë, për të cilën Allahu na ka bërë përgjegjës. Jeta e besimtarit, fiton begati, thellësi kuptimi dhe sublimitet në sajë të shërbimit ndaj të gjitha krijesave. Lumturia e vërtetë fitohet përmes shërbimit ndaj të tjerëve për hir të Allahut.

Allahu i Madhëruar na ka dhuruar begati të panumërta dhe me anë të këtyre begative dëshiron që ne t'i shërbejmë krijesave të Tij. Ata që mendojnë vetëm rahatën e vet dhe nuk nxitojnë në shërbim, pavarësisht mirësive dhe mundësive që u janë dhuruar, i ngjajnë një peme pa fruta.

Allahu i Madhëruar ka vendosur një sekret të madh në shërbim. Shërbimi ndaj njeriut, i cili është krijuar për



“Ai që nuk ka një qëllim për të cilin ia vlen edhe të vdesësh, nuk mund të ketë as qëllim për të cilin ia vlen të jetosh.”



**Sukseset më të
mëdha janë arritur
prej atyre që kanë
mundur të thurin
ëndrra të mëdha
dhe pozitive.**

të adhuruar Allahun, në një farë mënyre është në gradën e adhurimit ndaj Allahut.

Allahu i Madhëruar, bëhet zgjidhësi i problemeve personale të atyre që i shërbejnë fesë së Tij dhe përpiqen të zgjidhin problemet e të tjerëve. Kurse ata që shqetësim të

vetëm kanë hallet e veta, i lë vetëm për vetëm me hallet e tyre.

Neglizhimi i një shërbimi që duhet bërë në rrugën e Allahut, në aspektin shpirtëror, mundet të shkaktojë edhe shkatërrimin e njeriut. Për shkak të vështirësisë që paraqiste fushata ushtarake e Tebukut, Ebu Hajthemi **ṭ**, fillimisht qëndroi në Medinë dhe nuk mori pjesë në ushtrinë Islame që u nis drejt Tebukut. Një ditë, familja i kishte përgatitur një gosti në çardakun e oborrit të shtëpisë. Kur e pa këtë tablo, për një çast Ebu Hajthemi **ṭ**, mendoi se si mund të ishte gjendja e të Dërguarit të Allahut **Ṛ** dhe e sahabëve të tij. Aty ndjeu një dhimbje në zemër dhe tha me vete:

“A është e drejtë kjo që po bëj unë, ndërkohë që ata po përballen me vështirësi në rrugën e Allahut nën këtë të nxehtë?!”

Nën presionin e këtyre mendimeve, ai doli menjëherë për udhë pa e prekur fare sofrën dhe e arriti ushtrinë Islame në Tebuk.

Kur Resulullahu **Ṛ**, pa se kishte mbërritur Ebu Hajthemi **ṭ**, u gëzua shumë nga ky veprim i tij dhe tha:

“O Ebu Hajthemi! Për pak do të shkatërrohesh!..”
Më pas iu lut Allahut të Madhëruar që ta falë atë. (Ibni Hisham, IV, 174; Vakidi, III, 998.)

Përpjekja në rrugë të Allahut, mund të ndryshojë sipas mundësive dhe aftësive të secilit. Jo gjithkush është përgjegjës për të njëjtën gjë. Dikush punon sa ka mundësi me pasurinë e tij, dikush me jetën e tij, dikush me dijen, dikush me të folurën, e dikush tjetër me forcën fizike.

Lidhur me shërbimin, jeta e Sulltanit Mehmed Fatih, është një nga shembujt më të mirë që të rinjtë mund të ndjekin. Mendja dhe shpirti i këtij sulltani të madh, janë mbajtur vazhdimisht që prej fëmijërisë me planet dhe strategjitë e çlirimit të Kostandinopojës. Si rezultat i kësaj, ai ka arritur ta marrë Kostandinopojën, pas një rrethimi të jashtëzakonshëm 53 ditor, të mbushur me vështirësi dhe vuajtje.

Menjëherë pas çlirimit, u organizua një ceremoni e madhe dhe, në Sheshin e Shigjetës u bë një garë e gjuajtjes me shigjeta. Kjo shfaqje vazhdoi për tre ditë me radhë. Në gostinë që kishte shtruar për ushtarët, Sulltan Fatihu u shërbeu personalisht atyre, duke lexuar hadithin: *“Zotëria i një populli, është ai që u shërben atyre!”*⁷⁴ Pastaj ndau shumë dhurata dhe mirësi. Atë ditë, Akshemseddini (mësuesi i Sulltan Fatihut) u ngrit në këmbë dhe tha:

“O ushtarë, heronj të Islamit! Dijeni mirë se, ky hadith i të Dërguarit të Allahut ﷺ, është thënë për ju:

74. Bejhaki, Shuab, I, 334; VI, 334; Dejlemi, Musned, II, 324; Ali el-Muttaki, Kenz, Nr: 24834.



As që mund të mendohet që një i ri mysliman të merret me zbavitje të ndaluara nga Allahu. Ndërsa angazhimi me zbavitje të konsideruara të lejueshme dhe të padobishme apo të padëmshme për njerëzit, quhet shpërdorim kohe. Për rrjedhojë, zbavitjet e një myslimani duhet të jenë gjithmonë të ligjshme dhe të dobishme.



Sa bukur e ka shprehur Shejh Sadi faktin se shërbimi duhet vlerësuar si begati:

“Falënderoje Allahun që të ka dhënë mundësinë të veprosh mirë, sepse me mirësinë dhe bujarinë e Tij, nuk të ka lënë pa punë. Kush i shërben sulltanit, duhet t’i jetë mirënjohës atij, sepse e ka marrë në punë.”

«Padyshim se Kostandinopoja do të çlirohet. Sa komandant i mirë dhe sa ushtarë të mirë janë ata që do ta çlirojnë!» (Ahmed, IV, 355; Hakim, IV, 468/8300.)

Mos i shpërdorni pasuritë që keni fituar, por shpenzojini në vende të mira dhe për mirë! Ndajini me popullin e këtij vendi! Dëgjojini fjalët e Sulltanit tuaj dhe bindjuni atij!”

Më pas, duke u kthyer nga Sulltan Fatihu, i tha:

“Madhëri! U bëre bejja e syve për Osmanët! Rrofsh gjithnjë kështu si luftëtar në rrugën e Allahut!” Pas kësaj, bëri tekbir me zë të lartë.⁷⁵

Ky triumf i madh, nuk e shtyu kurrë Fatihun në pasivitet. Ai qëndroi rreth 18 ditë në Stamboll dhe, pasi vendosi sigurinë në qytet, doli sërish në fushatë ushtarake për të realizuar një ëndërr tjetër.

Gjatë periudhës 32 vjeçare të pushtetit të tij, Sulltani Mehmed Fatih, ka qëndruar në Stamboll vetëm disa muaj. Ndërsa pjesën tjetër të jetës e ka kaluar nga një luftë në tjetrën. Si rezultat, ai ka marrë afërsisht 200 kështjella, 14 shtete dhe dy perandori.

Sa bukur e shpreh kjo ndodhi entuziazmin shpirtëror që gjendet në themelet e përpjekjes dhe vullnetit të tij në rrugën e Allahut:

Sulltan Fatihu, kishte nisur fushatën ushtarake ndaj Perandorisë Romake të Trabzonit. Për t’iu afruar qytetit nga pas, duhej kaluar përmes një terreni malor dhe me pyll. Ndonjëherë grupit të druvarëve u duhej

të hapnin rrugën përpara. Në një vend ku rruga nuk ishte e përshtatshme, Fatihut i rrëshqiti kali. Ndërkohë që Fatihu po përpiqej të mbahej në një shkëmb, iu gjakosën duart. Kur e ëma e Uzun Hasanit, zonja Sara e vuri re këtë, mendoi se ishte momenti i duhur dhe i tha:

“Bir! Ti je sulltan, bir sulltani! Je një sundues i fuqishëm! A ia vlejnjë gjithë këto vuajtje për një kështjellë të vogël si ajo e Trabzonit?”

Në fakt, Uzun Hasani, kishte krijuar lidhje farefisnore me Perandorinë Romake të Trabzonit dhe, për këtë arsye e kishte dërguar të ëmën që t’i lutej Fatihut të hiqte dorë nga kjo fushatë. Fatihu, ashtu si ishte me duar të gërvishtura, u drejtua dhe i jep asaj një përgjigje të mrekullueshme:

“O nënë plakë! A s’e di ti, se kjo që mbajmë në duar është shpata e fesë Islame? Mos pandeh se të gjitha këto mundime që po heqim janë vetëm



Ebu Saidi ؓ , tregon:

“Gjatë ndërtimit të xhamisë së Profetit ﷺ , ne bartnim nga një qerpiç, kurse Ammar ibn Jasiri ؓ , bartte nga dy, një për vete, një për Profetin ﷺ . Kur Profeti ﷺ e pa, i shkundi pluhurin dhe i tha:

“O Ammar! Pse nuk mban nga një qerpiç si shokët e tu?”

Ammari u përgjigj:

“Sepse për këtë pres shpërblim nga Allahu i Madhëruar!”

Atëherë Profeti ﷺ , i fërkoi shpatullat e i tha:

“O bir i Sumejes! Për njerëzit e tjerë ka një shpërblim, ndërsa për ty, dy shpërblime!” (Ahmed, III, 91; Ibni Kethir el-Bidaje, III, 256.)



Profeti ﷺ, ka thënë:

“Zotëria i një populli, është ai që u shërben atyre!”

(Bejhaki, Shuab, I, 334; VI, 334.)

Shërbimi është një manifestim i mëshirës. Ndërsa mëshira, që është fruti më i rëndësishëm i besimit, kërkon që të ndash çdo gjë që ke me të varfrit dhe të lehtësosh varfërinë e tyre.

për një copë toke të thjeshtë! Dije, se të gjitha përpjekjet tona janë në shërbim të fesë së Allahut! Për t’i udhëzuar njerëzit në rrugë të drejtë! Që nesër, kur të dalim para Allahut, të mos na nxihet fytyra! Nëse kemi në dorë mundësitë e kumtimit dhe lartësimit të Islamit

dhe, parapëlqejmë rehatinë e trupit, duke iu shmangur disa vuajtjeve, a do mund ta meritojmë titullin veteranë luftime? Nëse nuk ua çojmë Islamit jomuslimanëve, nëse nuk bëhemi pengesë e harbimit të tyre, me ç’fytyrë do të dalim në audiencën hyjnore?”⁷⁶

Gara në shërbim

Kur po shkonte në betejën e Bedrit, Profeti ﷺ, e ndaloi ushtrinë në Bujutu’s-Sukja, një milje larg Medinës. Të vegjlit në moshë i ktheu pas (në Medinë). Sa’d ibn Ebi Uakkas ؓ tregon:

“Pak para se i Dërguari i Allahut ﷺ, t’i kthejë pas djemtë me moshë të vogël, vura re që im vëlla Umejri po përpiquej të fshihej, dhe e pyeta:

«Çfarë ke, o vëlla?»

“Kam frikë se mos i Dërguari i Allahut më sheh të vogël e më kthen! Mirëpo unë dëshiroj shumë të dal në luftë dhe kam shpresë që Allahu do të ma mundësojë të bie dëshmor!” - tha ai.

Dhe, me të vërtetë që, kur im vëlla iu paraqit të Dërguarit të Allahut, ai e pa të vogël dhe e urdhëroi:

«Ti kthehu pas!»

Për këtë arsye, Umejri filloi të qajë. Atëherë, Profeti

Γ e lejoi. Meqë Umejri ishte i vogël, shpatën ia lidhja unë. Kur ai ra dëshmor në Bedër, ishte vetëm 16 vjeç!” (Vakidi, I, 21; Ibni Sa’d, III, 149 - 150.)

Njëherë tjetër, kur Profeti Γ, doli për në betejën e Uhudit, ndaloi përsëri në një vend dhe po inspektonte ushtrinë. Të rinjtë në moshë për të marrë pjesë në luftë i lejonte, ndërsa të vegjlit i kthente pas. Mes të kthyerve ishin edhe Themure ibn Xhundeb dhe Rafi ibn Hadixh. Dhuhejr ibn Rafi, duke dashur që Rafi ibn Hadixhi të merrte pjesë në luftë, tha:

“O i Dërguari i Allahut, Rafiu qëllon mirë me shigjetë!”

Rafi ibn Hadixhi e tregon kështu vazhdimin e ngjarjes:

“Në këmbë kisha meste dhe, duke u ngritur në majë të gishtave, u përpoqa të dukeshja më i gjatë. Kështu, i Dërguari i Allahut më dha leje të qëndroja në ushtri. Kur Themure ibn Xhundeb dëgjoi se mua më ishte dhënë leje, i tha njerkut të vet, Murej ibn Sinan:

«Baba, i Dërguari i Allahut Γ i dha leje Rafiut, kurse mua më ktheu pas. Mirëpo unë e mund atë në mundje!» Murej †, ia tregoi situatën Profetit Γ, i cili na tha:

«Ejani, bëni mundje!»

U mundëm dhe, si përfundim, Themure më mundi. Atëherë, i Dërguari i Allahut Γ, i dha leje edhe atij.” (Taberi, Tarih, II, 505 - 506; Vakidi, I, 216.)

Kryetari i fisit Bijtë e Selimes, nga ensarët, Amr ibn Xhemuh †, ishte një sahab që çalonte. Ai kishte katër fëmijë dhe merrnin pjesë në beteja bashkë me të Dërguarin e Allahut Γ. Kur Profeti do të dilte për në luftën e Uhudit, edhe Amri deshi të merrte pjesë në luftë. Të bijtë i thanë:

***Qëllimi i
xhihadit në
rrugë të Allahut,
nuk është vetëm
lufta me shpatë.
Shpata është
një copë hekuri
që përdoret
në raste të
domosdoshme
për të eliminuar
padrejtësinë dhe
për të përhapur
të drejtën.
Ngadhënjimi i
vërtetë është ai i
zemrave.***



“Ti je i arsyetuar, nuk ke përgjegjësi për të marrë pjesë në luftë. Ne do të luftojmë edhe në vendin tënd!”

Amri u tha:

“Në fakt, ju më penguat të hyja në Xhenet Ditën e Bedrit. Vallahi, edhe sikur të mbetem gjallë sot, një ditë kam për të rënë dëshmor dhe do të hyjë në Xhenet!” Pastaj iu kthye së shoqes:

“Ndërkohë që të gjithë bien dëshmorë dhe hyjnë në Xhenet, a mos vallë unë do të rri pranë jush?”

Menjëherë mori mburojën dhe, pasi u lut: *“Allahu im, mos më kthe prapë në familjen time!”*, shkoi pranë të Dërguarit të Allahut ﷺ, të cilit i tha:

“Djemtë e mi kërkojnë të më lënë në Medinë. Më pengojnë të dal në luftë me ty. Vallahi, unë dëshiroj të vë këmbën në Xhenet kështu topall siç jam!”

I Dërguari i Allahut ﷺ i tha:

“Allahu i Madhëruar të ka justifikuar. Xhiahadi nuk është detyrim për ty!”

Amri ﷺ, i tha:

“O i Dërguari i Allahut! A nuk e konsideroni me vend që unë të luftoj gjer në vdekje



Sa bukur e reflektojnë thellësinë shpirtërore të Sulltan Fatihut këto vargje, që i shkruante me pseudonim “Avni”:

“T’i bindem urdhrët «luftoni për Allahun» është qëllimi im,

Veç për fenë Islame është i gjithë mundi im!”

“Jam besnik i profetëve dhe miqve të Allahut,

Dhe shpresa e çlirimeve e fitoreve, është përherë tek mirësia e Allahut!”

në rrugën e Allahut, të bie dëshmor dhe pastaj të ec me këtë këmbë topalle në Xhenet?" Profeti ﷺ, i tha:

"Po, është me vend!" Kurse të bijve të Amrit u tha:

"Tashmë mos e pengoni më babanë tuaj nga lufta, se, ndoshta, Allahu ia mundëson të bjerë dëshmor!"

Amri u kthye nga kibla dhe bëri këtë lutje:

"Allahu im! Bëma të mundur të bie dëshmor! Mos më kthe prapë te njerëzit e familjes, të mërëzitur e të dëshpëruar!" Pas kësaj, ai mori pjesë në luftë.

Ky sahabi i mbushur plot me entuziazmin për të rënë dëshmor, më në fund ra dëshmor së bashku me njërin nga të bijtë e tij. Lidhur me të, Profeti ﷺ, tha:

"Betohem në Allahun që ka qenien time në dorë, se unë e pashë Amrin tek po ecte në Xhenet duke çaluar!" (Vakidi, I, 264 - 265; Ibni Ethir, Usulu'l-Gabe, IV, 208.)

Ajo çfarë i takon një myslimani, është që të mos i shohë si të mjaftueshme shërbimet që bën, por me mendimin se çfarë mund të bëjë tjetër, të jetë gjithnjë në kërkim të shërbimit. Një nga shembujt më konkret të kësaj, janë **jeniçerët** Osmanë. Jeniçerët, të cilët në rininë e tyre vringëllonin shpatat në fushëbeteja, kur arrinin në moshën që u thinjej mjekra dhe nuk kishin më fuqi të luftonin, i gjenin vetes një tjetër mundësi shërbimi. Duke mbajtur në shpinë një torbë uji prej meshini dhe në duar një tas të kallajisur, ata shëtisnin sokak më sokak dhe mundoheshin të fitonin sevape duke shpërndarë ujë për shpirt të Husejnit ﷺ, i cili ra dëshmor në Qerbela, i djegur nga etja për ujë. Ata shpërndanin ujë duke thënë "për shpirt të dy Hasanëve (Hasani dhe Husejni)".⁷⁷



"Ne nuk i kapërcyem distancat e kësaj rruge vetëm duke lexuar librat e tasavufit, por duke i praktikuar brenda mundësive ato që lexonim dhe duke i shërbyer popullit. Të gjithë i çuan drejt një rruge, ndërsa ne na çuan në rrugën e shërbimit."

(Ubejdullah Ahrar)

77. A. Turan Alkan, Osmanlı Ansiklopedisi, İst. 1996, İz Yay. V, 20.



Një besimtar i përkushtuar në shërbim, është njeri altruist. Është një njeri që e di se shpëtimi i vet kalon përmes përpjekjes dhe shërbimit për të shpëtuar të tjerët. Në fakt, Allahu nuk e do njeriun që mendon vetëm interesin e vet, të vrazhdë, egoist dhe koprrac.

Rregullat e arta të shërbimit

1. Asnjë shërbim nuk duhet nënvlerësuar, sepse mundësia e shërbimit është një dhunti e madhe dhe, një shërbim që duket si i parëndësishëm, mund të jetë shumë i vyer tek Allahu. Për këtë arsye, për të arritur kënaqësinë e Allahut, duhet të nxitojmë në çfarëdolloj shërbimi.

2. Mundësia për të shërbyer, është një dhunti e Zotit, e cila mund të mos u jepet të gjithëve. Ka shumë njerëz që, megjithëse kanë aftësi të shumta për të shërbyer në fusha të ndryshme, nuk kanë mundësi për të shërbyer për shkak të pamundësisë së kohës dhe vendit. Ata që shërbejnë, duhet ta falënderojnë shumë Allahun, që u ka dhuruar këtë mirësi dhe, po ashtu, duhet t'u jenë mirënjohës atyre të cilëve u shërbejnë, sepse janë bërë shkak i kësaj mirësie. Pasi, në sajë të tyre, ata kanë arritur kënaqësinë e Allahut.

3. Njeriu i shërbimit, nuk zmbrahet për arsye të përballjes me rreziqe dhe vështirësi, përkundrazi ai duhet të marrë edhe më shumë fuqi, sepse niveli i një shërbimi është sipas nivelit të vështirësisë dhe sakrificës që bëhet. Shërbimi nuk është një dëshirë që vjen e ikën, por një detyrë e lartë që duhet kryer me dashuri dhe zell deri në frymën e fundit. Në këtë kontekst, furnizimi i njeriut të shërbimit duhet të jetë durimi, ndërsa mbështetja e tij, Allahu i Madhëruar.

4. Një besimtar që shërben nuk duhet të harrojë asnjëherë këto dy gjëra:

- a. Allahun e Madhëruar.
- b. Vdekjen, pra përkohësinë.

Po ashtu duhet të harrojë dy gjëra:

- a. Të mirat që ka bërë, që të mos e kaplojë mendjemadhësia.

b. Gabimet që janë bërë kundrejt tij, që të mos e urrejë askënd. Pra, duhet të arrijë tek falja hyjnore, duke falur çdokënd.

Të mos mashtrohesh pas botës

Ka shumë njerëz që i kanë konsumuar kot shigjetat e kohës me vlerën e arit, që gjenden në torbën e shigjetave të jetës. Njësoj si fëmijët që konsumojnë kohën duke u gënjyer pas lodrave... Për rrjedhojë, të lësh mënjanë të vërtetën dhe të gjëmosh iluzionin, nuk do të thotë tjetër veçse të çosh dëm jetën dhe të mbetesh duarbosh dhe me zemrën në errësirë.

Resulullahu ﷺ, ka thënë kështu:

“Kush dëshiron ahiretin, Allahu i vendos në zemër prej pasurisë së Tij dhe ia rregullon punët. Tashmë kjo botë i shkon pas, duke iu bindur. Kush ka për qëllim këtë botë, Allahu ia vendos varfërinë mes dy syve dhe ia ngatërron punët. Si përfundim, në dorën e tij nuk vjen asgjë më tepër nga kjo botë, përveç asaj që i është caktuar.” (Tirmidhi, Kijamet, 30/2465.)

Zgjedhjet që i japin formë jetës

Zgjedhja e shoqërisë

Gjendja morale dhe shpirtërore e njeriut është diçka ngjithëse. Pra, kalon nga një njeri tek tjetri. Nëse njeriu shoqërohet me njerëz të mirë, i drejtohet së mirës, nëse shoqërohet me të këqij, mbetet nën ndikimin e së keqes. Kjo gjendje është një nga ligjet kryesore të psikologjisë njerëzore. Të vjetrit e kanë shprehur këtë duke thënë: **“Sheh molla mollën e piqet.”**



Ashtu siç është e pamundur për Diellin që të mos ngrohë, ashtu është e pamundur edhe për shpirtrat e lartë, që të mos mëshirojnë njerëzit, t'i shmangen shërbimit, të qëndrojnë pa ndjenja përballë vuajtjeve dhe brengave dhe të mos përhapin mirësi përreth.

Njeriu merr nga gjendja e atij që vlerëson dhe me të cilin qëndron, sepse personaliteti dhe karakteri i njeriut, është i prirë t'i ngjajë dhe të imitojë të tjerët. Për rrjedhojë, njeriu, me apo pa vetëdije, kopjon veçoritë e dikujt tjetër, ndaj ndjen afërsi dhe dashuri. Kjo pikë, është me shumë rëndësi veçanërisht në periudhën e rinisë, kur formohet personaliteti dhe karakteri i njeriut.

Ndaj dhe Zoti i Madhëruar, në Kuranin Famëlartë urdhëron:

“...qëndroni me ata që janë të singertë (në fjalë dhe në vepra)!” (Teube, 119)

Me të vërtetë që njeriu fiton ndjenja të përbashkëta me njeriun ndaj të cilit ndien dashuri, si



Muhamed Ikbali, e shpjegon me këtë shembull rëndësinë e sakrificës në rrugë të shërbimit:

“Një sorkadhe po qante hallet me një sorkadhe tjetër:

«Këtej e tutje do të jetoj në Qabe (vendi në të cilin është e ndaluar gjuetia) dhe në Haremin Sherif. Aty do të fle e zgjohem dhe aty do të kulloj, sepse nëpër lugina kanë zënë pusi gjahtarët, të cilët rendin ditë-natë pas një sorkadhe sybukur. Tashmë dua të shpëtoj një herë e mirë nga gjahtarët. Le të gjejë pak rehat edhe shpirti im!..»

Sorkadhja tjetër që po e dëgjonte, i tha:

«O mike e mençur! Nëse do të jetosh, jeto brenda rrezeve. Mprehe gjithmonë veten dhe jeto më e mprehtë se një shpatë prej çeliku të pastër! Rreziku e sprovon forcën. Ai na tregon se çfarë potenciali ka trupi dhe shpirti ynë.»»

mendimet, ndjenjat, mënyrën e jetesës dhe prirjet. Për rrjedhojë, qëndrimi me njerëzit e devotshëm, bëhet shkak i përparimit në drejtim pozitiv.

Në këtë pikë, natyrisht që është me rëndësi shmangia prej indiferentëve dhe gjynahqarëve. Sa bukur e shpreh këtë të vërtetë kjo thënie: **“Kush fle me të verbër, zgjohet i vëngër.”**

Lidhur me këtë temë, Profeti ﷺ, ka dhënë këtë shembull:

“Shembulli i shokut të mirë dhe atij të keq është si ai që bart aromë të mirë me atë që punon si farkëtar. Mbartësi i aromës së mirë ose do të dhurojë një aromë të mirë, ose do t’ia blesh, ose atij do t’i vijë aromë e mirë. Ndërsa farkëtari, ose do të djegë rrobat, ose do të ngjisë erën e keqe.” (Buhari, Buju, 38.)

Shejh Sadi-i Shirazi, pasi jep si shembull ngjarjen e Shokëve të Shpellës në Kuranin Famëlartë, thotë:

“Qeni, i cili qendroi bashkë me të devotshmit, u bë mik dhe e meritoi të përmendet në Kuran. Kurse gruaja e Nuhut ﷺ dhe ajo e Lutit ﷺ, të cilat u shoqëruan me gjynahqarët, ranë në mohim dhe u bënë rrugëtarët e Xhehenemit.”

Mevlana ka thënë kështu:

“Beto hem në Allah se, gjarpri i keq është më i mirë sesa shoku i keq! Gjarpri i keq i merr jetën njeriut. Por shoku i keq, e hedh njeriun në zjarrin e përherëshëm, e djeg, e përcëllon! Edhe sikur të mos flasë, njeriu merr vese nga shoku i keq! Zemra merr fshehurazi moralin e tij, e përvetëson atë dhe edukatën e tij të keqe e bën edukatë të vetën! Shoku i padrejtë dhe pa dobi, merr edhe dobinë tënde e ikën!”

Lidhur me ata që ushqejnë

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Bota dhe ato që janë brenda saj, janë të pavlera. Këtu bëjnë përjashtim vetëm përmendja e Allahut, ato që të afrojnë tek Allahu, dijetari që jep dije dhe nxënësi që studion.”

(Tirmidhi, Zuhd, 14.)





**“Banorët e tokës
hanë njëri-tjetrin
për gjërat që
banorët e varreve
janë penduar!”**

**Sa talent i bukur
i zemrës është ai
me të cilën kupton
gjuhën e gurëve të
varrit!**

dashuri ndaj të këqijve dhe dëmin që sjell miqësia me ta, **Imam Rabbani**, jep një shembull të tillë:

“Ai që shoqërohet me kumarxhinjtë, ndoshta nuk luan kumar dhe mendon se nuk është ndotur. Mirëpo, për sa kohë që vazhdon të shoqërohet me kumarxhinjtë, ndikohet negativisht prej tyre dhe me kalimin e kohës fillon ta shohë normale kumarin, gjë që është një shkatërrim shpirtëror.”

Për këtë arsye, një mysliman duhet të shoqërohet me njerëz të mirë dhe, po ashtu edhe vetë duhet të tregohet shok i mirë. Resulallahu ﷺ, ka thënë:

لَا تُصَاحِبْ إِلَّا مُؤْمِنًا وَلَا يَأْكُلْ طَعَامَكَ إِلَّا تَقِيًّا

“Shoqërohu dhe qëndro vetëm me besimtarin! Ndërsa ushqimin tënd ta hanë vetëm njerëzit e devotshëm!” (Ebu Daud, Edeb, 16; Tirmidhi, Zuhd, 56/2395.)

“Për Allahun e Madhëruar, më i miri nga shokët është ai i dobishmi për shokun e vet...” (Tirmidhi, Birr, 28.)

Një tjetër çështje është edhe kjo:

Nëse njeriu shoqërohet me dikë, të njëjtë me të në dije, edukatë dhe mendje, ai gjen rehati. Lidhur me këtë, Mevlana ka thënë:

“Zogu fluturon vetëm me llojin e vet. Takimi me ata që s’janë të llojit të vet, është si të hysh në varr. Ndërkohë që çdo lloj tërheq llojin e vet, si mund të jetojë një sorkadhe e brishtë me gomarë e lopë?..”

“Ah, këto vuajtje që na jep miku që nuk na përshtatet!.. Ah, plagët e thella që ata kanë hapur në zemrën tonë! O njerëz të lartë, o njerëz të mëdhenj; mbliidheni mendjen dhe kërkoni miq të mirë dhe shokë të përshtatshëm për veten tuaj!”

Zgjedhja e profesionit

Një nga zgjedhjet që i jep drejtim jetës së njeriut, është edhe zgjedhja e profesionit. Një mysliman duhet të zgjedhë një profesion që e bën të meritojë pëlqimin e Zotit të Madhëruar dhe i bën dobi njerëzve. Një zgjedhje e gabuar në këtë pikë, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë tek lumturia e përhershme. Kur zgjidhet një profesion, nuk shikohet rëndësia që ka ai në sytë e njerëzve, por para së gjithash duhet parë legjitimiteti dhe pranueshmëria tek Allahu i Madhëruar. Një punëtor që e fiton rrizkun e tij në rrugë hallall, ka aq vlerë tek Allahu i Madhëruar, saqë nuk mund të krahasohet me një njeri me pozita të larta që drejton punë të pista.

Zgjedhja e bashkëshortit/es

Allahu i Madhëruar i ka krijuar të gjitha krijesat në çift. Ndërsa vetminë dhe njëshmërinë e ka bërë një cilësi vetëm për Vetën e Tij. Për rrjedhojë, të gjitha krijesat e tjera kanë nevojë për njëra-tjetrën.

Nga ana tjetër, Allahu i Madhëruar, ka vendosur mes mashkullit dhe femrës një ndjenjë dashurie dhe dhembshurie, si një proces përgatitor drejt dashurisë së Tij. Dhe, për realizimin e këtyre mbi një bazë të ligjshme, ka urdhëruar të krijohet çerdhja familjare me anë aktit të martesës. Nga kjo pikëpamje, çerdhja familjare, është edhe një shkallë e pazëvendësueshme drejt dashurisë së Allahut, edhe një ligj hyjnor për

Resulallahu ﷺ, ka thënë:

“Vetmia është më e mirë se shoqërimi me njerëz të këqij. Ndërsa një shok i sinqertë, është më i mirë sa vetmia...”

(Hakim, III, 343; Bejhaki, Shuab, 256/4993.)



Dashuria për njerëzit e mirë dhe urrejtja ndaj të këqijve, e gëzoni shpirtërisht njeriun. Ndërsa e kundërta e kësaj, pra të ushqesh dashuri ndaj atyre që nuk e meritojnë dhe të urresh njerëzit e mirë, e bën njeriun fatkeq. Prandaj njeriu duhet të bëjë shumë kujdes se ndaj kujt ushqen dashuri dhe kë urren.

vazhdimësinë e brezave. Pra, martesë është edhe një nevojë fiziologjike, por edhe një bazë themelore për zhvillimin shpirtëror.

Në sajë të martesës, dëshirat epshore kthehen në ideale me lindjen dhe edukimin e brezave të dobishëm. Lidhur me temën në fjalë, Allahu i Madhëruar, na ka këshilluar të lutemi në këtë mënyrë:

رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ
وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

“...«O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prekje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!»” (Furkan, 74.)

Kur zgjidhet bashkëshorti/ja për të krijuar një familje të lumtur, është kusht të respektohen me rigozitet rregullat që ka vendosur Islami. Thelbi i këtyre rregullave është:

Ata që do të martohen, nuk duhet ta zgjedhin bashkëshorten/in, vetëm për arsye të bukurisë sipërfaqësore apo pasurisë, të cilat janë të përkohshme. Një martesë që realizohet vetëm për dëshira dhe kënaqësi trupore, zakonisht, nuk e jep frutin e dashurisë dhe afërsisë, sepse në këto martesë, njerëzit zakonisht bëhen robër të dëshirave të egos.

Kësisoj, kur martohet, njeriu duhet të bëjë zgjedhje duke i dhënë rëndësi cilësive themelore shpirtërore, si besimi dhe morali. Lidhur me këtë Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Një grua martohet për katër gjëra: devotshmë-



rinë, prejardhjen, pasurinë dhe bukurinë. Martohu me të devotshmen që të gjeni mirësinë.” (Buhari, Nikah, VI, 123; Muslimi, Rada, 53.)

Në fakt, ky hadith, në të njëjtën kohë përfshin edhe cilësitë që duhet të kërkohen tek burri për t’u martuar, sepse për çdo mysliman, gjëja më e çmuar pas devotshmërisë, është që njeriu me të cilin martohet, të jetë

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Do të vijë një kohë, kur nuk do të ketë asgjë më me vlerë se këto tri gjëra: Paraja hallall, një vëlla që të shoqëron me gjithë shpirt dhe një Sunet me të cilin mund të veprohet.”

(Hejthemi, I, 172.)

vepërmirë. **Burri i mirë është shtylla e patundshme e sarajit të qetësisë, ndërsa gruaja e mirë, është stolia më e çmuar e oborreve të lumturisë.**

Po ashtu, duhet bërë kujdes edhe në çështjen e ekuilibrit të niveleve mes familjeve. Ky ekuilibër caktohet duke vlerësuar elemente të ndryshme si pasuria, kultura dhe zakonet e përbashkëta.

Të gjithë jemi dëshmitarë se, kur të rinjtë tanë bëjnë zgjedhje të gabuara në martesë, përfundojnë duke shkatërruar veten, fëmijët dhe familjet e tyre me divorce të paarsyeshme. Por më e keqja është, kur shumë njerëz të paditur, nuk i afrohen martesës dhe shkatërrohen, duke hyrë në vorbullën e gjynaheve dhe haremeve.

**Një ditë,
sahabët e pyetën
Resulullahun ﷺ :**

“Kush është njeriu më i mirë, me të cilin mund të shoqërohemi?”

Resulullahu ﷺ, u përgjigj:

“Ai që, kur e shihni, ju kujton Allahun; kur flet, ju shton diturinë dhe që me veprat e tij, ju orienton drejt botës tjetër.”

(Hejthemi, X, 226.)



“Kush martohet me grua të mençur, ka arritur gjithçka. Gruaja e mençur është një thesar i paçmueshëm. Kush e ka atë, duhet të jetë i mëshirshëm ndaj saj, të sillt mirë me të dhe ta vlerësojë...

Ajo çfarë dua të them me grua të mençur, është gruaja që e njeh Allahun dhe të Dërguarin e Tij ashtu siç duhet, kryen detyrat e devotshmërisë me rigorozitet, e respekton burrin e vet dhe plotëson çdo kërkesë të ligjshme të tij.”

(Musa Efendi -Allahu e Mëshiroftë!)

Për shkak se janë në kundërshtim me qëllimin e krijimit të njeriut, lidhjet jashtëmartesore nuk përfundojnë përveçse me shkatërrim dhe dështim total. Dhe, prej kësaj situatë dëmtohen shumë edhe individ, edhe familja, edhe shoqëria. Allahu i Madhëruar, për të mbrojtur

robërit e Tij prej këtyre rreziqeve, e ka shpallur lidhjen jashtëmartesore si një gjynah të madh dhe ka caktuar ndëshkime të rënda për të.

Me pak fjalë, lidhja martesore është një status që ka të bëjë vetëm me njerëzit dhe xhinët, të cilat janë qenie të ngarkuara me përgjegjësi. Kurse krijesat e tjera janë të lira në këtë pikë. Mbrojtja e nderit, është e domosdoshme për ruajtjen e dinjitetit dhe ndjenjave njerëzore.

Zbavitja dhe koha e lirë

Në botëkuptimin Islam, nuk ekziston nocioni i “kohës së lirë”. Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (me diçka tjetër) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Inshirah, 7-8.)

“Zbavitja” me të cilën merret njeriu për t’u çlodhur, kur lodhet nga puna e tij e përditshme, duhet të jenë punë të nevojshme dhe të dobishme. Në fakt, as që mund të mendohet që një i ri mysliman të merret me zbavitje të ndaluara nga Allahu. Ndërsa angazhimi me zbavitje të konsideruara të lejueshme dhe të padobishme apo të padëmshme për njerëzit, quhet shpërdorim kohe. Për rrjedhojë, zbavitjet e një myslimani duhet të jenë gjithmonë të ligjshme dhe të dobishme.

Nuk duhet harruar, se njerëzit i krijojnë vetë zakonet. Mirëpo, më pas bëhen robër të atyre zakoneve. Një angazhim që nis nga një kureshtje e pafajshme, ka potencialin që më pas të ndryshojë kryekëput gjithë jetën e njeriut.

Për shembull, një i ri, i cili e vlerëson kohën e lirë duke lexuar libra të dobishëm, nuk ka të njëjtën cilësi jete me atë që e kalon jetën duke shpërdoruar kohën me lojëra kompjuterike dhe shëtitje nëpër faqet zbavitëse të internetit. Ndërkohë që një njeri, i cili e shpenzon kohën me gjëra të dobishme, e pasuron jetën e tij edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, dikush tjetër që e vret kohën me zbavitje që janë vetëm shpërdorim kohe, do të tërhiqet në pragun e një falimentimi dhe pendimi të madh.

Për rrjedhojë, njeriu duhet të jetë më i kujdesshëm ndaj zbavitjeve dhe zakoneve tërheqëse, si sporti, muzika, lojërat dhe dëfrimet.

Lidhur me sjelljet e gabuara që njerëzit i kanë bërë zakon, Mevlana jep një shembull të tillë:

Një njeri fjalëmbël, por me karakter të ashpër, kishte mbjellë një shkurre me gjemba në rrugë. Kalimtarët ankoheshin duke i thënë: *“Shkuli këto!”* Mirëpo, ai nuk i dëgjoi.

Shkurrja me gjemba rritej vazhdimisht. Njerëzve u gjakoseshin këmbët dhe u griseshin rrobat nga gjembat sa herë që kalonin aty.

Kur valiu e urdhëroi *“shkuli këto!”*, ai tha: *“mirë, do t’i heq ndonjë ditë.”* Kështu vazhdoi

Ekulibri dhe harmonia mes bashkëshortëve në martesë, është mjaft e rëndësishme, sepse siç thotë edhe Mevlana:

“Nëse njëra prej këpucëve të shtrëngon këmbën, atëherë asnjëra nuk hyn në punë.”





Martesa është rruga e profetëve, Suneti i Resulullahut ﷺ, pranvera e brezave, nderi dhe edukata e burrit dhe e gruas, kështjella e namusit dhe dinjitetit dhe privilegj për njeriun.

për ca kohë t'i premtonte, duke thënë, "i heq nesër, i heq pasnesër". Ndërkohë, gjembat lëshuan rrënjë dhe u forcuan më shumë.

Një ditë valiu i tha: "O ti që nuk mban fjalën! Mos e zovrrit urdhrin tonë!"

Njeriu që kishte mbjellë shkurren i tha:

"Zotëri, kemi plot ditë përpara, mos u merakosni! Një ditë do ta shkul këtë shkurre!" Pas kësaj, valiu i tha: *"Ti thua që nesër e kryen këtë punë, por dëgjoje mirë këtë: ato gjemba po forcohen gjithnjë e më shumë. Ndërsa ai që do ta shkulë, po plaket dhe po i bie fuqia. Shpejto, mos e harxho kot kohën!"*

Ja pra, edhe ti pranoje si një gjemb çdo ves tëndin! Sa e sa herë të kanë shpuar këmbën e të kanë gjakosur ato gjemba! Ti u sëmure nga natyra jote. Mirëpo, për shkak se ti nuk ke ndjenja, nuk e kupton as shkakun e sëmundjes tënde.

Mirë që nuk e kupton se vesi yt i shqetëson dhe i mundon të tjerët, por as plagën që të ka shkaktuar ty nuk e vëren? Në këtë gjendje, ti je shqetësim dhe vuajtje si për vete, ashtu edhe për të tjerët!

Ti, o merre sëpatën dhe godite burrërisht, duke e shkukur si Aliu ؑ, portën e kështjellës së Hajberit, ose atë gjemb, bëje fidan të një trëndafili. Pra, shartoje me fidanin e trëndafilin, që gjembat e tua të transformohen në kopsht trëndafilash...

Resulullahu ﷺ, i ka nxitur myslimanët të bëjnë veprimtari të ndryshme, si gjuajtja me shigjetë, noti, gara me kuaj dhe deve, etj. Po ashtu, edhe gratë i ka këshilluar të merren me veprimtari të përshtatshme

me natyrën e tyre, si qëndisje, qepje, punë shtëpie, etj. Siç shihet, secila prej këtyre ka dobi. Në këtë mënyrë, kur njerëzit janë të lirë, ruhen nga rënia në punë të gabuara dhe zhvillohen vazhdimisht. Ata përgatiten në çdo aspekt që ta përfaqësojnë Islamin në mënyrën më të mirë të mundshme. Mirëpo, ajo që duhet të bëjmë kujdes këtu, është që kur të merremi me këto veprimtari, duhet të ruajmë kriteret Islame, si në aspektin e veshjes, ashtu edhe në atë të vendit ku veprojmë. P.sh., nuk duhen zhvilluar verimtari sportive me kostume që nuk i përshtaten veshjes Islame dhe në ambiente të përbashkëta për femra e meshkuj.

Sulltanët Osmanë, jashtë kohës së administrimit të shtetit, janë marrë me disiplina të ndryshme të artit. Shumë prej tyre ishin të zotë në poezi, letërsi, kaligrafi dhe muzikë. Për shembull, Sulltan Mehmed Fatihu, kishte një interes të veçantë për kopshtarinë. Përveç kësaj, ai bënte edhe unaza që vendoseshin në gisht për shigjetë, tokëza për rripa dhe këllëfë shpatash.

Sulltan Javuz Selimit i pëlqente të merrej me argjendari.

Sulltan Mahmudit të I i pëlqente të merrej me gdhendje vulash dhe argjendari. Veprat e tij i shiste në treg dhe fitimin e ndante si sadaka. Një ditë, kur veziri i tha:

"Madhëri! Thesari i popullit është edhe i juaji. Përse mundoheni kaq shumë?"



Ashtu sikurse fizika nuk e pranon zbrazëtinë, as zemrat nuk e pranojnë atë. Siç shprehet edhe Imam Shafiiu: "Nëse nuk e angazhon veten me të vërtetën, do të të angazhojë e kota!"

Kohën e shkuar është e pa mundur ta rikthesh. Prandaj, kjo është dita më e mirë për të bërë vepra të mira. Po ashtu, kjo është edhe dita më e mirë për t'ia dorëzuar amanetet Pronarit të vërtetë. Ndaj është thënë se: "Është shkatërruar ai që thotë, e bëj nesër!"



Sulltani iu përgjigj:

*"Së pari, thesari i popullit duhet shpenzuar për popullin. Së dyti, paraja që fitohet me djersën e ballit ka tjetër shije."*⁷⁸

Sulltan Abdulhamidi II, kishte interes të veçantë për hipizmin, notin dhe qitjen. Krahas aftësisë së tij në punët e dekoreve dhe zbukurimeve, ai ishte edhe një mjeshtër i vërtetë si marangoz. Shpesh herë, ai çlodhej duke punuar në punishten e tij. Sa e bukur është kjo ngjarje që i atribuohet atij:

Lufta Turko-Greke në vitin 1897 përfundoi me fitoren e turqve. Mirëpo, gëzimin e Sulltan Abdulhamidit e eklipsonte një shqetësim. Sulltani i kishte sjellë në Stamboll të gjithë të plagosurit e luftës, të cilët kishin filluar të kuroheshin në Spitalin Gumushsuju, në Spitalin Etfal të sapo përfunduar në Shishli dhe në ndërtesën e ekspozitës ngjitur me Sarajin Jëlldëz. Ai e ndiqte përditë gjendjen e pacientëve. Një ditë, Sulltani i mëshirshëm shkoi tek punishtja e vet dhe i thirri kapiten Mehmed Efendiut:

"Eja, mjeshtër Mehmedi! Priti njëqindpesëdhjetë dru për bastunë!"

Ndërkaq, kapiteni habitet dhe pyet me kureshtje:

"Urdhri është urdhër, por për çfarë duhen gjithë këto bastunë, madhëri?"

Sulltani, të cilit i dukej në fytyrë lumturia për një punë të mirë, u përgjigj:

78. Shih. Zeki Kusoglu, Dunku Sanatimiz ve Kulturumuz, Istanbul 1994. F. 26.

“Konstatova se shumica e ushtarëve tanë kishin marrë plagë në këmbë. Edhe sikur të shërohen, më tutje atyre do t’u nevojiten bastunë. Kur të dalin nga spitali, e të shkojnë në vendin e tyre, do t’ju dhuroj nga një bastun.”



Sulltan Sulejman Kanuni, kishte një shpirt artisti, ashtu si shumë sulltanë të tjerë. Për rrjedhojë, kjo e kishte drejtuar atë tek poezia. Ai ka shumë poezi të bukura të shkruara me pseudonimin “Muhibbi”. Numri i odeve në gjithë krijimtarinë e tij i afrohet tremijëshit...





RINIA DHE EDUKIMI



VIRTYTI I MËSIMIT TË DIJEVE TË DOBISHME

Dituri, është të njohësh veten

Të gjitha dijet përbëhen vetëm nga zbulimi i ligjeve që Allahu i Madhëruar ka vendosur tek krijesat dhe fenomenet. Përparimi i dijes, mundësohet prej shtimit të këtyre zbulimeve. Mirëpo, të zbulosh këto ligje natyrore dhe të kapesht vetëm pas tyre, nuk përbën “njohjen” në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Dije, do të thotë të njohësh Pronarin e vërtetë të këtyre ligjeve që sundojnë gjithësinë, duke kaluar prej shkakut tek shkaktari, prej artit tek artisti. Pra, të mund të perceptosh madhështinë dhe fuqinë e Tij. Dhe, si rezultat i kësaj, të përpiqesh për të fituar pëlqimin e Tij.

Dije, do të thotë të njohësh veprat e madhështisë dhe fuqisë hyjnore dhe të kuptosh gjuhën e gjendjes së qenieve. Njohja e urtësisë, do të thotë të mund të zgjidhësh enigmat hyjnore që manifestohen në gjithësi.


Dije, do të thotë të gjesh atë që i përgjigjet nevojës tënde. Dhe, nevoja më e madhe, ashtu

*I Dërguari i Allahut
ﷺ, ka thënë:*

*“Mësimi i diturisë
është farz për çdo
mysliman.”*

*(Ibni Maxhe, Mukaddime,
17.)*

*Po ashtu, Profeti
ﷺ, ka kërkuar
mbrojtje tek
Allahu, prej
diturisë së
padobishme, që
nuk e shpien robin
tek e vërteta dhe
devotshmëria
dhe që nuk e
largojnë atë as nga
çmenduritë e egos.*



Dituria e vërtetë dhe e dobishme, mund të merret duke bashkuar dijet fizike dhe ato shpirtërore. Këto dy aspekte të dijes, janë si dy flatra. A keni parë ndonjë zog që fluturon vetëm një krah?...

sikurse na bëhet e ditur edhe në Kuran, është: **“Të mund të japësh shpirt si musliman”⁷⁹.**

Kush e mëson dijen me këtë qëllim, pra, që mund ta kthejë atë në “kulturë”, ai bëhet vërtet prej “njohësve”.

Fjalët e **Junus Emresë** lidhur me këtë çështje, bartin një urtësi dhe enigmë të veçantë:

*Dituri do të thotë të dish, veten të njohësh,
Nëse veten s’e njeh, është e kotë të lexosh?
Qëllimi i leximit, është që robi Zotin të njohë,
Nëse lexon e nuk njeh, kjo punë është e kotë!
Njëzetënëntë rrokje nga kreu në fund i lexon,
Elif thua ti, mësuesi, çfarë do të thotë?*

Njohuritë ekzoterike dhe fizike nuk i mjaftojnë njeriut. Ato mund të jenë vetëm një mjet drejt dijes së vërtetë. Dituria e vërtetë dhe e dobishme, mund të merret duke bashkuar dijet fizike dhe ato shpirtërore. Këto dy aspekte të dijes, janë si dy flatra. A keni parë ndonjë zog që fluturon vetëm një krah?...

Krahas përpjekjes për të arritur dijen e vërtetë, ka edhe prej atyre që u bëjnë padrejtësi njerëzve, duke i përdorur dijet për ambiciet e tyre të ulëta. Në të vërtetë, këta janë tradhtarët e dijes. Për rrjedhojë, me qëllim

që dija të jetë e dobishme, është e domosdoshme të eliminohen dobësitë e egos, ndërsa mendja dhe vullneti t’i nënshtrohen Kuranit dhe Sunetit. Dija që merret e privuar prej edukimit shpirtëror, e shpie njeriun në rrugë të gabuar dhe kthehet në një mjet vetëmashtrimi.



Për fat të keq, sot, në marrjen e dijeve, i jepet më tepër rëndësi aftësive mendore të njeriut. Ndërsa moralit, karakterit dhe personalitetit nuk po u kushtohet vëmendje sa duhet. Mirëpo, bartja e dijes në mënyrën e duhur, varet po nga këto virtyte. Njeriu që nuk ka mundur ta kthejë dijen në urtësi, fjala vjen, pasi të jetë diplomuar për drejtësi, në vend që të përhapë drejtësinë dhe të vërtetën, ai mund të kthehet në kriminel. Po ashtu edhe dikush që ka mbaruar për mjekësi, në vend që të shërojë, mund të kthehet në kasap njerëzish.

Ndërsa një drejtor i privuar nga ndjenjat e mëshirës dhe dashurisë, në sajë të dijes, shndërrohet në një tiran që dhunon vartësit e tij. Njerëz të tillë, në sajë të dijes, mund të shkaktojnë dëme shumëfish më tepër se një i paditur.

Me pak fjalë, dija duhet të jetë një kapital që ndriçon edhe botën e brendshme të njeriut edhe botën pas vdekjes.

Dija është për të punuar

E vërteta e dijes zbulohet duke e praktikuar atë. Dijetari që nuk i praktikon dijet e tij, është një hamall pa qëllim, si **“gomari i ngarkuar me libra”**⁸⁰. Dija është dije atëherë kur ajo e shpie njeriun drejt Zotit, drejt së vërtetës, drejt devotshmërisë dhe drejt veprave të mira. Përndryshe edhe shejtani kishte dituri, po ashtu edhe



“Sado të kesh lexuar, nëse nuk vepron siç i ka hije dijes tënde, atëherë je injorant.”

(Shejh Sadi-i Shirazi)

80. Shih. El-Xhum'a, 5.

"Fjala e urtë, me të cilën nuk veprohet, është si një rrobë e stolisur e marrë hua!.."

(Mevlana)

Karuni ishte i ditur. Mirëpo, dituria ua ka ekzagjeruar egon, duke i çuar ata drejt një mendjemadhësie dhe mburrjeje të tmerrshme.

Nga kjo pikëpamje, nëse dija nuk përvetësohet siç duhet, nuk kthehet në vepra dhe nuk reflektohet në moral, do të thotë se të gjitha përpjekjet kanë shkuar dëm. Profeti ﷺ, ka kërkuar mbrojtje nga Allahu nga një dituri e tillë:

"Allahu im! Strehohem tek Ti, prej dijes së padobishme, zemrës së hallakatur, egos së pangopur dhe lutjes që nuk pranohet." (Muslim, Dhikr, 73; Nesai, Istiadhe, 13, 65.)

Imam Gazali ka thënë:

"Nëse mëson se të ka mbetur një javë nga jeta, medemos që në një kohë kaq të shkurtër do të ishe marrë me dije të dobishme. Menjëherë do t'i ktheheshe zemrës dhe do të

kishe ndërprerë çdo lidhje interesi apo ambicieje të kësaj bote, duke u munduar të zbukuroheshe me virtyte të mira. E në fakt, gjithmonë ka mundësi që njeriu të vdesë nga çasti në çast. Prandaj, merru me dije që do ta shtojnë frikën ndaj madhështisë së Allahut dhe do ta ekuilibrojnë jetën tënde shpirtërore!"

Kur Selman-i Farisiu **t**, po ecte bregut të lumit Tigër, shoku i tij u ul dhe piu ujë. Selmani **t**, i tha:

"Pa pi edhe një herë!"

"U ngopa!" - iu përgjigj ai.

Selmani tha:

"A mendon se nga aq sa ke pirë ti është pakësuar uji i lumit?"



“Jo!” - i përgjigjet shoku.

Atëherë Selmani **t**, e këshilloi në këtë mënyrë:

“Ja pra, kështu është edhe dituria, nuk pakësohet. Prandaj, merru me dituri që të bën dobi!” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 188.)

Dija që shpëton jetë

Një gjuhëtar kishte hipur në një anije. Gjatë udhëimit, u vu të bisedojë me lundërtarin me krenari dhe mburrje për diturinë e tij. Herë pas here i bënte pyetje të ndryshme lundërtarit dhe, pasi mori përgjigjen “nuk e di”, duke u mburrur me dijen e vet, tha:

“Sa keq! Me injorancën që ke, e paske çuar kot gjysmën e jetës!”

Edhe pse lundërtari zemërmirë u prek nga kjo sjellje përçmuese e gjuhëtarit, ai u tregua i matur dhe nuk iu përgjigj. Ndërkaq, filloi një furtunë e fortë dhe e tërhoqi anijen në një vorbull të tmerrshme. Në ato çaste, kur të gjithë i kapi paniku, lundërtari iu drejtua gjuhëtarit dhe e pyeti:

“Profesor, a di të notosh?”

I zverdhur, i mbledhur shuk dhe me një zë të dridhur nga frika, gjuhëtarit iu përgjigj:

“Jo, nuk di!”

Pas kësaj përgjigjeje, lundërtari iu drejtua gjuhëtarit me keqardhje dhe i tha:

“Mua më kishte shkuar gjysma e jetës kot, ngaqë s’kam ditur gjë nga gramatika, ndërsa tani e gjithë jeta jote do të shkojë kot, ngaqë s’di të notosh! Anija jonë nuk

“Dije nuk është ajo dijetari që ke mësuar përmendësh, por ajo prej së cilës ke pasur dobi.”

(Imam Shafiu)



*“O bir, kam një
këshillë për ty:
Mundohu të jesh
gjithmonë i ditur,
i edukuar dhe
i devotshëm!..
Lexo veprat e të
parëve dhe ec në
rrugën e Ehlibejtit
dhe Ehli Sunet vel
xhemaat! Mëso
fikh dhe largohu
sa më shumë nga
inJORantët!..”*

(Abdulhalik Guxhduvani)

ka shans të shpëtojë prej kësaj vorbulle. O profesor! A nuk e ke ditur se në këtë det, mësimi i notit është më i dobishëm dhe më i domosdoshëm se mësimi i gjuhës?...”

Ndërkohë që kjo anije e trupit të përkohshëm po përpëlitet të mbijetojë në vorbullën e vdekjes, njohuritë që nuk shndërrohen në urtësi dhe i shërbejnë vetëm rehatisë së egos, nuk do të kenë asnjë dobi.

Mundësia e vetme për të shpëtuar nga mbytja në vorbullën e gjynahut, është njohja e hallallit dhe haramit dhe zbatimi i tyre. Ja pra, vetëm një dituri e tillë na shpie në lumturinë e të dy botëve.

EDUKIMI PROFESIONAL

Padyshim që zgjuarsia, aftësia dhe prirjet që Allahu i Madhëruar i ka dhënë gjithsecilit janë të ndryshme. Si rezultat i aftësive dhe natyrave të ndryshme njerëzore, kanë dalë në pah edhe profesione të ndryshme. Për vazhdimësinë e rendit shoqëror, ka nevojë për çdo profesion dhe specialist të tij. Pika e parë që duhet bërë kujdes gjatë përzgjedhjes së profesionit, është respektimi i kufijve të hallallit dhe haramit.

Feja jonë, e ka konsideruar si adhurim punën, profesionin dhe fitimin në rrugë hallall, duke i kushtuar shumë rëndësi këtyre. Të gjithë profetët kanë pasur nga një zanat. Zekerija **U** ishte marangoz, Daudi **U**, ishte farkëtar, ndërsa Idrisi **U**, ishte rrobaqepës. Po kështu, edhe Profeti ynë Muhamedi **r**, ka qenë bari dhe është marrë me tregti.

Resulullahu ka thënë:



Një ditë, një i varfër nga myslimanët e Medinës erdhi te Profeti ﷺ dhe i kërkoi diçka për të ngrënë. I Dërguari i Allahut ﷺ, e pyeti:

“A nuk ke asgjë në shtëpi?”

“Kam një qilim, me njëren pjesë të të cilit mbulohevi, ndërsa pjesën tjetër e kemi shtruar në tokë, si dhe një safë uji.” -tha i varfëri.

I Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“M'i sill mua ato!”

Ai e sollti qilimin dhe safën e ujit. Profeti ﷺ, i mori në dorë ato dhe pyeti të pranishmit:

“Kush do t'i blejë këto?”

Njëri nga sahabët tha se mund të jepte një dirhem për to. Mirëpo, Profeti ﷺ, tha disa herë:

“A nuk ka ndonjë që jep më shumë?”

Më pas, ia shiti një sahabiu që dha dy dirhem. Teksa po i jepte paratë sahabiut të varfër, i tha:

“Me një dirhem merri familjes diçka për të ngrënë. Me paratë që do të teprojnë, bli një sëpatë dhe ma sill mua!”

Më pas, Profeti ﷺ, i vendosi sëpatës një bisht me duart e tij dhe i tha:

“Tani shko prit dru dhe shiti! Puno pesëmbëdhjetë ditë, pastaj eja te unë!”

Pas pesëmbëdhjetë ditësh burri i varfër erdhi sërish tek Profeti ﷺ. Ai kishte fituar dhjetë dirhem dhe me ato para kishte marrë rroba dhe ushqime për vete dhe familjen.

Profeti ﷺ, u gëzua shumë dhe tha:

“Për ty është më mirë kështu, sesa të të duket lypja si një njollë në fytyrë Ditën e Kiametit...” (Ebu Daud, Zekat, 26/1641; Ibni Maxhe, Tixharat, 25.)



“Askush nuk ka ngrënë rrësk më të mirë sesa prej asaj që ka fituar vetë. Edhe i Dërguari i Allahut, Daudi ﷺ, hante prej punës së duarve të veta.” (Buhari, Buju’, 15, Enbija, 37.)

As’habët e Suffes, të cilët merreshin vetëm me dituri dhe adhurim, punonin

aq sa mund të përballonin nevojat elementare. Këta sahabë, të cilët kishin fuqinë dhe forcën e duhur, bënë çfarëdolloj pune, si sjellja e druve nga mali, bartja e ujit etj. Me paratë që fitonin ndanin sadaka ose u blinin ushqim shokëve.⁸¹ Për shkak të ndershmërisë dhe maturisë, nuk kërkonin asgjë nga askush.

Ukbe ibn Amri ﷺ, ka thënë:

“Kur zbriti ajeti i sadakasë⁸², filluam të punonim si hamallë dhe dhuronim nga ajo që fitonim...” (Buhari, Zekat, 10; Muslim, Zekat, 72.)

Omeri ﷺ, nuk pëlqente aspak përtacinë dhe shpërdorimin e kohës. Ai thoshte:

“Nuk më pëlqen t’ju shoh tek rrini kot, pa u marrë ose me punë të kësaj bote, ose me punë të botës tjetër.” (Ebu Gudde, Zamanin Kiymeti, f. 97.)

Një fjalë e urtë thotë: “Lëvizja ka begati.” Njeriu duhet të jetë gjithnjë i angazhuar me vepra të mira dhe nuk duhet t’i japë mundësi egos dhe shejtanit, duke qëndruar kot pa bërë asnjë punë.

Në një hadith thuhet:

“Allahut të Madhëruar i pëlqen kur e sheh robin e Tij të lodhur nga rendja pas hallallit.”

(Sujuti, Xhamiu’s-Sagir, I, 65.)

81. Buhari, Megazi 28, Xhihad 9; Ibni Sa’d, III, 514.

82. Ajeti i sadakasë është ajeti 103 i sures Teube: “Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira! Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ata. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.”

Nga ana tjetër, njeriu që rri kot, fillon të merret me fjalë të panevojshme. Dhe, kur flet kot, dëmton edhe veten edhe të tjerët. Për këtë arsye, Omeri **t** , i këshillonte në këtë mënyrë djemtë e vet:

“Kur të arrini mëngjesin, shpërndahuni për qark (secili t’i gjejë një punë vetes!). Mos rrini të mbledhur në një vend, sepse kam frikë se, nëse qëndroni të mbledhur në një vend, mund të ngatërroheni me njëri-tjetrin, të urreheni dhe t’i bëni keq njëri-tjetrit.” (Buhari, el-Edebu’l-Mufred, no: 415.)

Për rrjedhojë, çdo i ri mysliman është i detyruar t’i vlerësojë në mënyrën më të mirë të mundshme mundësitë që i ka dhuruar Zoti i Madhëruar. Kushdo dhe çfarëdo aftësie të ketë, duhet të përpiqet ta zhvillojë veten në atë drejtim. Fjala vjen, ai që ka aftësi për shkencë, duhet të merret me shkencë të dobishme dhe të përpiqet të arrijë nivelin më të lartë në atë fushë. Ndërsa dikush që ka aftësi drejtuese, krahas diturive të drejtimit dhe menaxhimit, duhet të mësojë edhe përgjegjësitë e veta. Kjo vlen për të gjitha aftësitë e tjera profesionale.

Resulullahu **r** , ka thënë:

“Më i dobishmi prej njerëzve, është ai më i dobishmi për të tjerët.” (Bejhaki, VI, 117; Ibni Haxher, Metalib, I, 264.)

“Sikur të kisha mundësi të rifilloja jetën, do të bëhesha ose mësues i etur për Allahun dhe të vërtetën, ose një mjek që përhap shërim, sepse që të dyja janë në shërbim të njerëzimit.”

(Musa Topbash -Allahu e mëshiroftë!)



“Kurani Famëlartë është mishëruar në gjendjet dhe cilësitë e profetëve. Nëse e lexon dhe e praktikon Kuranin me devotshmëri, zëre se je takuar me profetët dhe miqtë e Allahut! Kur lexon historitë e profetëve kafazi i trupit bëhet gjithnjë e më i ngushtë për zemrën!”

(Mevlana)

KURANI FAMËLARTË

Udhëzuesi i jetës së të riut mysliman

Në Kuranin Famëlartë urdhërohet:

“I Gjithëmëshirshmi ua ka mësuar Kuranin (robërve të Tij), ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë.” (Rahman, 1-4.)

Allahu i Madhëruar, pikësëpari ka folur rreth mësimit të Kuranit, e më pas rreth krijimit të njeriut. Nga kjo mund të kuptojmë se:

“Allahu i Madhëruar e ka krijuar njeriun që t’i mësojë Kuranin. Po ashtu, edhe të folurën dhe artin e fjalës së bukur ia ka mësuar me qëllim që të kuptojë Kuranin.”

Nisur nga kjo, njeriu duhet të kuptojë se ai është krijuar për fe dhe dije dhe ka përgjegjësi të madhe ndaj Kuranit, sepse nderi dhe dinjiteti i njeriut është i mundur duke jetuar në rrugën që ka treguar Kurani.

E në fakt, librat e shkruar për njëmijekatërqind vite me radhë në botën Islame, me të cilat janë mbushur bibliotekat, janë shkruar për të shpjeguar një libër të vetëm, pra Kuranin Famëlartë.

Kurani Famëlartë, është një dhuratë e mrekullueshme që Allahu u bën zemrave të besimtarëve. Besimtarët që duan të bisedojnë me Allahun, duhet të marrin pjesë në sofrën e mirësive të Tij dhe duhet të shërbejnë në atë sofër. Për të përfituar nga begatitë e kësaj sofre, duhet të mos e kursesh



respektin dhe nderimin ndaj Kuranit Famëlartë. Po ashtu, duhet ta lexojmë e ta mësojmë mirë atë, të jetojmë si një Kuran i gjallë mbi tokë dhe t'ua mësojmë atyre që nuk e dinë.

Padyshim se Kurani është shpallur që t'i dhurojë besimtarëve lumturinë e dy botëve. Njeriu që nuk përqafton Kurandin, ka lënë pas krahëve devotshmërinë ndaj Allahut, duke u treguar mosmirënjohës ndaj mirësisë së të qenit njeri.

Mirëpo, njerëzit indiferentë, të cilët dëgjojnë vetëm zërin e Kuranit, duke mos arritur t'i kuptojnë urtësitë në thellësitë e tij, privohen edhe nga begatia e tij e vërtetë. Prandaj, leximi i Kuranit Famëlartë duhet të bëhet duke medituar, pra, duke menduar urtësitë në urdhëresat dhe ndalesat e tij dhe duke marrë mësim prej historive që ndodhen në të. Sa domethënëse që është kjo shprehje e Omerit:

"Suren Bekare e kam mbaruar në dymbëdhjetë vjet dhe në shenjë mirënjohjeje bëra kurban një deve." (Kurtubi, Tefsir, I, 40.)

Kjo, sepse leximi i Kuranit nga Omeri, nuk përfshinte vetëm fjalët. Ai ishte një lexim i zhytur në urtësitë dhe enigmat e Kuranit, duke i ndjerë dhe përjetuar gjykimet e tij. Vetëm kështu është e mundur të përfitosh me të vërtetë nga Kurani.



Ebu Dheri ؓ , tregon:

"O Resulullah! Këshillomë!" -i thashë.

"Të këshilloj devotshmërinë, sepse ajo është zanafilla e çdo pune." - më tha ai.

"O Resulullah! Këshillomë edhe pak!" -i thashë përsëri.

"Lexo Kuran dhe përmend Allahun, sepse për ty, Kurani është dritë në Tokë dhe furnizim në qiell!" - tha ai.

(Ibn-i Hibban, Sahih, II, 78.)



Për sahabët e Profetit ﷺ, zbritja e shpalljes, ishte si një sofër hyjnore e zbritur nga qielli me shijen e të cilës nuk ka të ngopur. Sapo dëgjonin se ishte shpallur një ajet, nxitonin menjëherë drejt asaj gostie hyjnore me një dëshirë të madhe dhe, mes emocioneve të papërshkruara, përpiqeshin të merrnin përgjigjen e pyetjes: “Vallë në cilën vepër është pëlqimi i Allahut?”.

Ebu Abdurrahman es-Sulemi tregon:

“Një nga sahabët e Resullullahut ﷺ, që na mësonte Kuranin, na tha:

«Ne merrnim dhjetë ajete nga Profeti ﷺ dhe, pa i mësuar fjalët dhe veprat në këto ajete, nuk kalonim tek dhjetë të tjerat. Resullallahu ﷺ, na e

mësonte edhe dijen, edhe praktikën në të njëjtën kohë.»

(Ahmed, V, 410; Hajthemi, I, 165.)

Për të kuptuar Kuranin Famëlartë, për ta ndjerrë, për ta dëgjuar dhe deshifruar atë, na nevojitet një zemër e pastër, sepse Kurani Famëlartë, misteret e tij ia hap vetëm zemrave të pastra. Një zemër e nxirë nga gjynahet, nuk kupton asgjë prej mistereve të Kuranit Famëlartë.

Mevlana ka thënë:

“Para se të lexosh ajetet e Kuranit Famëlartë dhe hadithet e Profetit ﷺ, rregullo veten! Nëse nuk i ndjen aromat e këndshme në kopshtin e trëndafilave, mos e kërko të metën tek kopshti, por në zemrën dhe hundën tënde!..”

Neglizhenca ndaj Kuranit Famëlartë, është një gabim i madh që errëson jetën shpirtërore të njeriut. Për këtë arsye, ne nuk duhet ta neglizhojmë mësimin e Kuranit as për vete, as për fëmijët tanë. Të bësh njëmijenjë sakrificë vetëm e vetëm që fëmija të mësojë një gjuhë të huaj, duke përzgjedhur dhe bërë krahasime mes kolegjeve, ndërkohë që nënvleftëson kurset e Kuranit, duke i privuar fëmijët nga fjala hyjnore, është një vetëmashtrim shumë i hidhur...

Historia është dëshmitare se individët, familjet dhe popujt, kanë jetuar me dinjitet për aq kohë sa kanë

Ebu Bekir Verrak kishte një fëmijë të vogël, i cili mernte mësim Kurani nga mësuesi i tij. Një ditë, ai u kthye nga shkolla duke u dridhur dhe i zverdhur në fytyrë. Babai i habitur, e pyeti:

“Ç’ka ngjarë, ç’ke kështu, përse u ktheve më herët nga shkolla?”

Djali iu përgjigj:

“Baba i dashur! Sot mësuesi më mësoi një ajet, që kur e mendoj kuptimin e tij, bëhem kështu!”

“Cili ajet është ai, mor bir?” -e pyeti i ati.

Fëmija i vogël nisi të këndonte:

“Nëse mohoni, si do të mbroheni prej Ditës në të cilën fëmijët do të thinjen?” (Muzzemmil, 17.)

Më pas, prej frikës dhe peshës së këtij ajeti, fëmija i vogël ra në shtrat i sëmurë dhe, pa kaluar shumë kohë ia dorëzoi shpirtin Zotit të Madhëruar.

Ebu Bekir Verrak e vizitonte shpesh varrin e të birit dhe duke qarë thoshte:

“O Ebu Bekir! Djali yt mësoi një ajet nga Kurani dhe e dorëzoi shpirtin nga frika prej Allahut. Kurse ti lexon Kuran prej kohësh dhe ende nuk ke frikë as sa një fëmijë prej ligjeve hyjnore!..”

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Çdo profeti që është dërguar, i është dhënë patjetër një mrekulli, në sajë të së cilës njerëzit do të besonin. Dhe, mrekullia që m'u dha mua është Kurani Famëlartë, i dërguar prej Allahut. Për këtë arsye, shpresoj që Ditën e Kiametit Umeti im të jetë më i shumtë se umetet e tjera.”

(Buhari, l'tisam, I)



ndjekur mësimet e Kuranit Famëlartë. Shteti Osman, i cili u themelua mbi respektin ndaj Kuranit Famëlartë, ka sunduar me shekuj të tërë mbi tokë. Madje, edhe popujt që nuk e kanë pranuar Kuranin Famëlartë, si bota perëndimore, paqen dhe mirëqenien që përjetojnë në këtë botë ia kanë borxh disa parimeve që i zbatojnë pa i ditur se janë prej Kuranit.

Mrekullia më e madhe e Profetit të fundit

Kurani Fisnik, nuk është si disa mrekulli që ndodhin dhe përfundojnë brenda një kohe të caktuar, por një mrekulli si në fjalë, ashtu edhe në kuptim, që i drejtohet mendjes dhe zemrës së njeriut. Për sa kohë të ekzistojnë mendja dhe dija, ajetet e Kuranit do të pasqyrohen dhe do të kuptohen, duke nxjerr në pah të gjitha hollësitë që përmban ai. Në çdo shekull do të ekzistojnë shkencëtarë që do ta pranojnë mrekullinë e Kuranit. Në këtë mënyrë, Umeti i të Dërguarit të Allahut ﷺ, do të vazhdojë duke u shtuar.

E në fakt, zbulimet shkencore që janë bërë pas shumë shekujsh, e kanë vërtetuar vazhdimisht mrekullinë e Kuranit Famëlartë. Studimet e kryera në shumë fusha si embrionologjia, astronomia, fizika, gjeografia, mjekësia dhe sociologjia, e vërtetojnë këtë fakt ditë pas dite.

Për shembull, para 1400 viteve, yjet përdroreshin vetëm për të shtënë fall dhe për t'u orientuar gjatë udhëtimeve. Atëherë nuk diheshin aspak distancat mes tyre dhe veçoritë që kishin. Mirëpo Allahu i

Madhëruar, në ajetet 75 dhe 76 të sures Uakia, urdhëron:

“Betohem në vendet e yjeve! E, ky është betim i madh, veç sikur ta dinit!”

Ekspertët e fizikës dhe astrofizikës së ditëve të sotme, shprehën se “vendet e yjeve” janë “vrimat e bardha”, ku ata lindin dhe “vrimat e zeza”, ku ata vdesin e zhduken.

Vrimat e bardha janë një depo energjie e paimagjinueshme, të cilat bartin në vetvete një energji të tillë, sa mund të lindin me miliarda yje. Këto janë farat e galaktikave.

Kurse vrimat e zeza, që janë zbuluar pas viteve 1950, janë një varrezë e mistershme yjesh. Këto asgjësojnë në errësirën e tyre gjithçka materiale që ekziston përreth tyre, përfshi edhe vetë kohën.

Krahas kësaj, ashtu siç shprehet edhe ajeti **“Kur yjet të shuhën.”** (Murselat, 8.), vrimat e zeza nuk janë yje, por vendi i një ylli të shuar. Kjo e vërtetë, tregon se me sa kujdes janë përzgjedhur fjalët e përdorura në Kuran.

Allahu i Madhëruar, në këtë dhe në ajete të tjerë të ngjashëm, i tregon njeriut të shekullit të 21-të manifestimin e madhështisë dhe fuqisë hyjnore në qiell. Në ditët tona, shkenca mund t’i shprehë distancat në hapësirë vetëm me “vite dritë”, gjë që e vështirëson perceptimin njerëzor.

Kjo çështje, që në suren Uakia ceket me një betim të madh, vetëm kaq është arritur të kuptohet nën dritën e njohurive të shekullit tonë. Padyshim



Në ajetin Kuranor urdhërohet:

“Ne e kemi ndërtuar qiellin me fuqinë Tonë dhe Ne e zgjerojmë atë.”

(Dharijat, 47.)

Shkencëtarët, vetëm në shekullin e 21-të kanë arritur të zbulojnë se nebulozat po largohen vazhdimisht nga galaktika jonë. Më pas, duke u nisur nga ky zbulim, ata hodhën teorinë e zgjerimit të vazhdueshëm të gjithësisë.

Duke u bazuar në zbulimet shkencore të bëra gjatë periudhës 1400 vjeçare, vërtetohet se Kurani Famëllartë është gjithnjë në krye, kurse dituria njerëzore i ujen nga pas duke e komentuar dhe vërtetuar atë...



që ajeti Kuranor përmban edhe shumë urtësi të ndryshme që duhet të shpjegohen.

Gjithashtu, në Kuranin Fisnik gjenden edhe shumë ajete që aludojnë në rrumbullakësinë e Tokës. Në njërin prej tyre urdhërohet:

“...Ai e bën natën të kalojë në ditë dhe ditën në natë!...” (Zumer, 5.)

Fjala “*tekuir*” që përdoret në këtë ajet, shpreh mbështjelljen e një trupi sferik si koka, me diçka tjetër duke i ardhur përçark. Për shembull, siç mbështillet çallma duke e rrotulluar.

Ndërsa në lidhje me lëvizjet e Hënës dhe të Diellit, në suren Jasin urdhërohet:

“Dielli sillet në drejtimin e vet të caktuar. Kështu e ka paracaktuar i Plotfuqishmi, i Gjithëdijshmi. Hënës i kemi caktuar faza; ajo përditë hahet e bëhet si rremi i përkulur i hurmës. As Dielli nuk mund ta arrijë Hënën e as nata nuk mund t’ia kalojë ditës; të gjitha lundrojnë në orbitat e veta.” (Jasin, 38-40.)

Në shekullin e shtatë, kur kanë zbritur ajetet e Kuranit, ishte e pamundur të mendohej se Hëna dhe Dielli bëjnë një lëvizje sferike në orbitën e tyre. Të gjitha këto, tregojnë se Kurani është gjithnjë para, kurse shkenca e ndjek atë nga pas.

Nisur nga kjo, fjalët e Mevlanës lidhur me Kuranin Famëllartë, po kuptohen çdo ditë e më mirë:

“Pjesa e dukshme e Kuranit Fisnik, mund të shkruhet edhe me një shishe bojë. Ndërsa për të shprehur të gjitha të fshehtat që përmban

ai, nuk do të mjaftonte edhe sikur të kishim gjithë detet pa brigje, si bojë dhe gjithë tokën me pemë, si lapsa."

Që prej 14 shekujsh është e pamundur të gjendet ndonjë ajet që bie ndesh me shkencën dhe dijen. Përkundër kësaj, çdo zbulim dhe shpikje që është bërë në çdo shekull, ka shërbyer për ta kuptuar më mirë madhësinë e Kuranit. Kurani Fisnik i është përgjigjur më së miri nevojave të një beduini para 1400 viteve dhe ka qenë rregullatori më ideal i jetës së tij. Sot, ai përmban dije që përfshijnë edhe nivelin më të lartë të shkencëtarëve dhe vazhdon të mahnisë botën e shkencës. Kjo, sepse ai është i mbushur me dijet më të përsosura, që u paraprijnë të gjitha zbulimeve shkencore që kanë ndodhur dhe do të ndodhin deri në Ditën e Kiametit.

STUDIMI I HADITHEVE DHE HISTORISË SË PROFETIT ﷺ

Kushti i parë i dashurisë, është të mos harrosh atë që dashuron dhe të përpiqesh t'i ngjash atij në shprehje, sjellje, ndjesi dhe mendim. Krahas këtyre, duhet ta ndjekësh atë në çdo çast të jetës dhe të ruhesh nga rënia në kundërshtim me të. Nisur nga kjo, me qëllim që të kemi një zemër të mbushur me dashuri ndaj Profetit ﷺ, pikësëpari duhet mësuar dhe praktikuar mirë Suneti i tij.

Pa u njohur jeta e tij dhe pa u zbukuruar zemrat me dashurinë për të, është e pamundur të jetosh një Islam të pranueshëm. Madje, edhe meritimi i

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

"Beto hem në Allahun, në duart e të Cilit gjendet shpirti im, se asnjëri prej jush nuk ka besuar me të vërtetë, derisa unë të mos jem për atë më i dashur se vetja e tij, nëna e tij, babai i tij, fëmijët e tij, dhe gjithë njerëzimi!"

(Buhari, Iman, 8.)





Ebu Dheri ؓ , ka thënë:

“Për Zotin, kur i Dërguari i Allahut ﷺ, emigroi në botën tjetër, na kishte lënë në një gjendje të atillë, sa që edhe nëse një zog rrihte krahët në qiell, ajo na kujtonte një hadith të Profetit ﷺ, sepse ai ka thënë: «Juve ju është shpjeguar gjithçka që ju afron tek Xheneti dhe ju largon nga Xhehenemi!»”

(Ahmedi, V, 153, 162.)

dashurisë së Allahut, është i varur nga bindja e plotë ndaj Profetit ﷺ.⁸³ Kjo është edhe arsyeja që Resulullahu ﷺ, i ka dhënë rëndësi të madhe “dashurisë”.

Muhamedi ﷺ, është “i Dërguari i Fundkohës” dhe “Profet i fundit”. Për këtë arsye, ai është personaliteti shembullor

më i mirë për gjithë njerëzimin deri në Ditën e Kiametit.

Nga jeta e profetëve të mëhershëm, në ditët tona kanë ardhur informacione tejet të kufizuara. Mirëpo, lidhur me të Dërguarin e Fundkohës, janë transmetuar pothuajse të gjitha shprehjet dhe sjelljet e tij, që nga më të thjeshtat, deri tek më të koklaviturat. Bota e tij e brendshme, është ndjekur hap pas hapi, aq sa është mundur të pasqyrohet në fjalë, dhe është shënuar në histori si një pllakat nderit. Për rrjedhojë, njeriu i vetëm në histori, të cilit mund t’i verifikohet jeta deri në detajet më të imta, është Muhamedi ﷺ. Dhe, pikërisht kjo është ajo që lartëson moralin Islam nga teoria në praktikë dhe e bën atë më superior se sistemet e tjera morale.

Detyra jonë, është të mësojmë në mënyrën më të mirë të mundshme jetën dhe hadithet e Profetit ﷺ, t’i praktikojmë dhe t’ua mësojmë ato të tjerëve.

Në fakt, jeta e Resulullahut ﷺ dhe hadithet e tij, janë një burim i pazëvendësueshëm për të kuptuar Kuranin Famëlartë. Këto janë shpjegimet

e para dhe më të përsosura të Kuranit Fisnik. Përveç këtyre, familjarizimi i një myslimani me kulturën Islame, varet nga bërja e një jete duke marrë shembull jetën e Resulullahut ﷺ.

Kësisoj, një i ri mysliman, parimet më të bukura, më të drejta dhe më sublime lidhur me çdo fushë të jetës, mund t'i gjejë në jetën e Profetit ﷺ. Këtë të vërtetë, mendimtari dhe personaliteti i shquar gjerman Johann Wolfgang Goethe, e ka pohuar në këtë mënyrë:

“Askush nuk mund të hedhë një hap më të përparuar se parimet e jetës së Muhamedit. Me gjithë sukseset e tyre, të gjitha ligjet dhe rregullat e vëna nga evropianët, janë të mangëta në krahasim me kulturën Islame. Ne, kombet e Evropës, pavarësisht mundësive tona qytetëruese, jemi ende në shkallaren e parë të shkallës në të cilën Muhamedi ka arritur në krye. Nuk ka dyshim se askush nuk ka për ta kaluar dot atë në këtë garë. Dhe për shkak se ky libër (Kurani) është tejet praktik, nuk do ta humbë kurrë ndikimin dhe do t'i mbledhë rreth vetes kombet e tjerë.”

AS'HABI SUFFE:

Shkolla e dijes dhe urtësisë

I Dërguari i Allahut ﷺ, i ka kushtuar rëndësi të madhe edukimit dhe arsimimit të sahabëve. Prandaj,



I Dërguari i Allahut ﷺ, në Haxhin e Lamtumirës ka thënë kështu:

“...Po ju lë një amanet të tillë që, për sa kohë të kapeni fort pas tij nuk do ta devijoni rrugën. Ai është Libri i Allahut dhe Suneti i Profetit...”

(Hakim, I, 171/318.)

në pjesën e pasme të Mesxhidit Nebevi ndërtoi një suffe (çardak, vend me hije), të hapur përreth dhe të mbuluar me gjethe hurmash nga sipër. Aty qëndronin myslimanët që vinin nga larg dhe ata që ishin të varfër e pa familje, të cilët morën emrin “As’habi Suffe” ose “Ehli Suffe”.⁸⁴

Në disa burime, përmenden emrat e më shumë se njëqind sahabëve, që bënë pjesë tek As’habi Suffe. Nevojat e tyre i plotësonte Profeti ﷺ, i cili, po ashtu nxiste edhe sahabët e tjerë që kishin mundësi të mira ekonomike.

Ebu Hurejre ؓ, i cili edhe ai vetë ishte prej sahabëve të Suffe-s, ka thënë:

“Banorët e Suffe-së ishin mysafirët e Islamit. Ata nuk kishin as

84. Ibni Sa’d, I, 255.



I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Kush i hyn një rrugë në kërkim të dijes, Allahu e orienton atë në njërën prej rrugëve drejt Xhenetit. Melekët, në shenjë kënaqësie për atë që po bën, i shtrijnë flatrat e tyre mbi atë që kërkon dije! Për dijetarin kërkon falje çdo krijesë në qiej e në Tokë, madje edhe peshqit në ujë. Epërsia e dijetarit ndaj adhuresit, është si epërsia e Hënës së plotë ndaj yjeve të tjerë! Dijetarët janë trashëguesit e profetëve. Profetët nuk lënë trashëgim as ar, as argjend. Trashëgimia e tyre është dija. Kush e merr këtë trashëgimi, ka marrë vërtetë një mirësi të madhe.”

(Ebu Davud, Ilim, I/364; Tirmidhi, Ilim, 19/2682)

një familje ku mund të strehoheshin, as pasuri, e as njerëz. Kur vinte ndonjë sadaka, Profeti ﷺ, ua dërgonte menjëherë atyre dhe nuk merrte asgjë prej saj. Por, nëse vinte ndonjë dhuratë, ai merrte një pjesë për vete, e pjesën tjetër ua dërgonte sahabëve të Suffe-s. Kështu, ai i ndante dhuratat bashkë me ta.” (Buhari, Rikak, 17.)

Përsëri Ebu Hurejre ؓ, ka thënë:

“Unë kam parë shtatëdhjetë persona prej sahabëve të Suffe-s. Asnjëri prej tyre nuk kishte rrobë aq sa ta mbulonte gjithë trupin...” (Buhari, Salat, 58.)

As’habi Suffe ishin njerëzit që qëndronin më pranë burimit të fesë dhe më të rregulltit në tubimet e Resulullahut ﷺ. Ata merrnin një edukim të nivelit të lartë dhe intensiv. Për këtë arsye, edukimi i tyre ishte më i shpejtë. Mësuesit e tyre, duke filluar prej Resulullahut ﷺ, ishin sahabët e ditur dhe të rinj, si Ubej ibn Ka’b, Ibni Mes’ud, Muadh ibn Xhebel dhe Ubade ibn Samit ؓ.

Në përgjithësi, sahabët që kanë transmetuar më shumë hadithe, kanë qenë prej tyre. Ebu Hurejre ؓ, i cili ishte më kryesori prej tyre, ka thënë:

“Njerëzit habiten duke thënë: «Ebu Hurejre transmeton shumë hadithe!»... Por, ndërkohë që vëllezërit e mi muhaxhirë merreshin me tregti në çarshi e pazar, e vëllezërit e mi ensarë merreshin me bujqësi në ara e kopshte, Ebu Hurejre qëndronte pranë Resulullahut, shihte shumë gjëra, që ata nuk mund t’i shinin dhe mësonte përmendësh ato që ata nuk mund t’i mësonin.” (Buhari, Ilim, 42.)

Delegacionet që vinin për një kohë të shkurtër në Medinë për të mësuar Islamin, nga një anë

Profeti ﷺ, ua mësonte Kuranin sahabëve edhe në kushtet më të vështira. Një ditë, Ebu Talha ؓ, pa Resulullahun ﷺ, teksa u mësonte Kuranin sahabëve të Suffe-s duke qëndruar në këmbë. Ai zotëri i profetëve, kishte lidhur gur në bark, që të mund të drejtonte shpinën e tij të kërrusur nga uria.

(Ebu Nuajm, Hilje, I, 432)



Më e vlefshmja prej edukatës, është kur robi i njej dhe i ruan kufijtë e vet. Për këtë arsye, është thënë: "Pranë dijetarit ruaj gjuhën, pranë evliave zemrën, në sofër dorën dhe në shtëpinë e huaj syrin!"

takoheshin me Profetin ﷺ, nga ana tjetër mësonin prej sahabëve të Suffe-s çështjet që nuk i dinin. Kur nevojitej ndonjë mësues i Islamit jashtë Medinës, sërish zgjidhej nga mesi i këtyre sahabëve.

RESPEKTI NDAJ MËSUESIT

Respekti ndaj mësuesit është parimi themelor i edukimit. Shembulli më i bukur i këtij fakti, është respekti që kanë treguar sahabët për Profetin ﷺ. Kur ata dëgjonin Profetin ﷺ, qëndronin me një edukatë dhe qetësi të atillë, sikur të kishin një zog mbi kokë dhe kishin frikë se mos trembej e ikte.⁸⁵ Ata, në asnjë mënyrë nuk e ngrinin zërin në prani të Profetit ﷺ dhe, këdo që fliste me zë të lartë, e qortonin menjëherë. Madje, sahabët e mëdhenj, si Ebu Bekri dhe Omeri Ⓜ, flisnin me zë të ulët me Profetin ﷺ, sikur po i thoshin diçka të fshehtë. Po ashtu, për shkak të respektit të madh që kishin ndaj tij, ata nuk e shikonin fytyrën e tij të bekuar aq sa të ngopeshin duke e parë.⁸⁶

Ngadhënjimtari i Egjiptit, **Amr ibn As** Ⓜ, ka thënë:

"Kam qëndruar një kohë të gjatë me Resulullahun ﷺ. Mirëpo, për shkak të ndjenjës së turpfit që kisha pranë tij dhe respektit të madh që ushqeja për të, nuk arrita ta ngre dot kokën e ta shihja fytyrën e tij



85. Shih Buhariu, Xhihad, 37; Ebu Davud, Tib 1, Sunnet 24; Nesai, Xhenaiz, 81; Ibni Maxhe, Xhenaiz, 37.

86. Shih Tirmidhiu, Menakib, 16/3668; Deauat, 98/3535; Ahmed, IV, 240.

të bekuar e të ndritur, sa të ngopesha me të. Nëse sot më thonë: «Na e përshkruaj Resulullahun! Na e trego atë!», më besoni, se nuk e bëj dot.»

(Muslim, Iman, 192; Ahmed, IV, 199.)

Sahabët e dëgjonin me vëmendje të Dërguarin e Allahut ﷺ dhe përpiqeshin t'i kuptonin, t'i zbatonin dhe t'i predikonin në mënyrën më të mirë ato që thoshte ai. Njëherë, në kohën e jacisë, Profeti ﷺ, u tha sahabëve:

“Nesër mblihduni për namaz, sepse dua t'ju njoftoj në lidhje me një çështje!” Një prej sahabëve, u tha shokëve:

“O filan! Ti mbaj mend fjalën e parë që do të thotë Resulullahu, ti tjetri të dytën, ndërsa ti fjalën tjetër pas saj, me qëllim që të mos na shpëtojë asgjë prej fjalëve të Profetit...” (Hejthemi, I, 46.)

Kur Sulltan Mehmet Fatihu mori Kostandinopojën dhe po hynte në qytet si fitimtar, njerëzit e pritën me lule. Mirëpo, ai u prezantoi mësuesin e vet, Akshemsedinin, dhe u shpreh se ato lavdërime dhe përgëzime në të vërtetë i takonin atij. Atë ditë, ai u tha kështu njerëzve që kishte përreth:

“Gëzimi dhe qetësia që shihni tek unë, nuk është vetëm për shkak të çlirimit të këtij qyteti, por edhe për shkak se një mik i shtrenjtë dhe i bekuar i Zotit, si Akshemsedini, ndodhet në kohën tonë dhe pranë meje...”

Po ashtu, Sulltan Fatihu, shumicën e nëpunësve i paguante dy-tre akçe në ditë, sipas standardit të jetesës së asaj kohe, ndërsa mësuesit pesëdhjetë akçe në ditë. E, disa dijetarëve të mëdhenj, si Ali Kushçu, u kishte caktuar dyqind akçe në ditë dhe u jepte mirësi të shumta si familjes, ashtu edhe të afërmve të tyre.



Profeti ﷺ, ka thënë:

“Epërsia e dijetarit ndaj adhuruesit, është si epërsia ime ndaj atij që ndodhet në nivelin më të ulët midis jush!..”

(Ebu Daud, Ilm, I.)

Djali i Sulltan Jëlldërëm Bajezitit, princi Sulejman, ishte ndëshkuar lehtë nga mësuesi për shkak të mosinteresimit që tregonte ndaj mësimave. I zemëruar keq prej kësaj, princi shkoi menjëherë në saraj dhe iu ankua të atit. Ndërsa Sulltan Bajeziti thirri menjëherë mësuesin dhe e pyeti:

“Pse e ndëshkove Sulejmanin, o mësues?”

I qetë dhe serioz, mësuesi i dha Sulltanit këtë përgjigje historike:

“Madhëria im! Princi juaj, nesër do të kërkojë drejtimin e shtetit dhe populli do t’i mbetet atij amanet! Nëse ai mbetet i paditur, do t’i bëj dëm popullit të tij. Vërtet, ai tani është princ, por nuk është bërë ende kompetent i shkencave shpirtërore e natyrore! Unë jam i detyruar ta edukoj ashtu siç duhet, sepse jam ngarkuar me përgatitjen e tij!”

Bajeziti i uli sytë përdhe me respekt dhe i tha:

“Ke të drejtë, mësues! Nëse është nevoja, edhe mua më ndëshkoni! Për sa kohë që të kemi mbi krye mësues si ju, ne do të vazhdojmë të sundojmë botën!”

Mësuesi, i cili e kuptoi mesazhin e hollë në përgjigjen e Sulltanit, të nesërmen, kur Jëlldërëm Bajeziti hyri në orën e mësimin dhe e pyeti mësuesin se pse ia kishte ndëshkuar të birin, nuk e përfilli fare atë. Kështu, kur princi e pa se grada shpirtërore e mësuesit ishte më e lartë se e të atit, e kuptoi gabimin dhe, prej asaj dite u bë një nxënës i zellshëm në mësim!

Siç shprehet edhe historiani Latifi, kurdo që Sulltan Fatihu mësonte ekzistencën e një dijetari të rëndësishëm, sado larg të ishte, ai e ftonte atë në vendin e vet me dhurata të shumta dhe i jepte pozita të larta. Për shembull, kur njëri prej dijetarëve më të mëdhenj të kohës në matematikë dhe astronomi, Ali Kushçu, ishte duke ardhur në Stamboll, Sulltan Fatihu i caktoi atij njëmijë akçe për çdo vend që do kalonte, si respekt ndaj dijes së tij.

E kur erdhi në Stamboll, i gjithë populli ishte ngritur në këmbë. Deri në atë kohë, askush nuk ishte pritur në këtë mënyrë. Gjithashtu, Sulltan Fatihu u dërgonte çdo muaj një sasi të madhe të hollash edhe dijetarëve që vazhdonin punën në zonën e tyre.⁸⁷

Ky respekt dhe interes i madh

87. Mustafa Runyun-Osman Keskiöğlü, Fatih Devrinde İlim ve O devirde Yetişen İlim Adamları, Ankara 1953, s. 6-7, 13, 18.



Sulltan Javuz Selimin dhe ushtrinë e tij, e zuri një shi i furishëm në rrethinat e qytetit Adana. Vendi u kthye i gjithi në një det balte. Sulltan Javuz Selimi po ecte duke biseduar me Kemal Pashazaden, njërin prej dijetarëve të njohur të kohës. Papritmas, kali i Kemal Pashazades u tremb dhe këmba e tij spërkati me baltë kaftanin e Sulltanit! Kemal Pashazade u dëshpërua shumë dhe iu zbeh fytyra. Mirëpo, Sulltan Javuz Selimi, u kthye nga ai dhe duke buzëqeshur, i tha:

“Balta e spërkatur nga këmba e kalit të dijetarit, është nder dhe bekim për ne! Kur të vdes, këtë kaftan të përbaltur shtrojeni mbi varrin tim!”

*Vdekja e dijetarit
është sikur vdekja
e botës.*

që tregojnë ndaj njerëzve të dijes, ka qenë mbështetja dhe forca më e madhe që siguroi interesin dhe zhvillimin e dijes në Shtetin Osman.

Personalitetet e mëdhenj, si Shejh Edebali i Osman Gazit, Emir Sulltani i Jëlldërëm Bajezitit, Haxhi Bajram Veliu i Muradit të II, Mehdi Pasha i Bajezidit të II, Merkez dhe Synbyl Efendia i Sulltan Kanunit, Aziz Mahmud Hudaji i Muradit të III, Ahmedit të I dhe Muradit të IV, janë shembujt më të famshëm të respektit dhe dashurisë mes mësuesit dhe nxënësit.



RINIA DHE MORALI



ZOTËRIMI I MORALIT TË BUKUR

Morali i bukur është një nga cilësitë që Allahu i Madhëruar dëshiron të shohë tek robërit e vet. Nisur nga kjo, zotërimi i moralit të bukur, është treguesi më i qartë i afërsisë sonë ndaj Allahut. Po ashtu, kjo është një vlerë sublime që kurorëzon nivelin e jetës sonë fetare.

Morali i bukur, që përbën nderin dhe dinjitetin e njeriut, shpreh edhe identitetin e tij më të qartë. Për këtë arsye, morali është një cilësi e lartë e birit të njeriut.

Qëllimi i moralit, është t'i japë njeriut vetëdijen se është duke jetuar gjithmonë nën vëzhgimin e kamerave hyjnore. Krahas kësaj, morali synon pastrimin e njeriut prej cilësive të papjekura, duke e ngritur atë në nivelin e njeriut të përsosur. Pra, të gdhendë në natyrën e tij cilësitë e larta si delikatesa, finesa, mirësjellja, turpi, bujaria, dhembshuria, mëshira, etj. Nisur nga kjo, morali është një pjesë e pandashme e fesë dhe besimit, madje, është në statusin e shpirtit dhe esencës së tyre. Për rrjedhojë, edhe Resulullahu ﷺ, e ka përkufizuar detyrën e tij me këto fjalë:

“Unë jam dërguar të përsos moralin e bukur!” (Muvatta', Husnu'l-Hulk, 8.)

*I Dërguari i Allahut
ﷺ, ka thënë:*

*“Ditën e Kiametit,
në peshoren e robit
besimtar nuk do të
peshojë asgjë më
tepër se morali i tij
i bukur. Allahu i
Madhëruar, e urren
atë që bën veprime
të shëmtuara dhe
flet fjalë të pista.”*

(Tirmidhi, Birr, 62/2002)



Një ditë, Aliu **ﺕ** , tha:

“Subhanallah! Sa mbrapa mbesin disa njerëz në vepra të mira. Shumë e çuditshme! Dikujt i vjen vëllai mysliman për një nevojë, e ai nuk e sheh veten nevojtar për të bërë mirësi (nuk ia plotëson nevojën vëllait të tij)! Nëse ai njeri nuk ka nevojë për sevap, as frikë nga dënimi nuk ka?! E në fakt, atij i duhet të nxitojë drejt moralit të bukur, sepse ai e shpie njeriun në shpëtim.”

Ndërkaq, ngrihet një njeri dhe e pyet:

“Të qofshin falë nëna dhe babai im, o prijësi i besimtarëve! A i keni dëgjuar këto nga Profeti **ﷺ** ?”

Aliu **ﺕ** , u përgjigj:

“Po, por në fakt kam dëgjuar edhe më të bukur se kjo, që është: Kur u sollën robërit e fisit Tajj, një grua nga mesi i tyre, me një gjuhë të pastër tha:

«O Muhamed! Nëse e sheh të përshtatshme, na liro! Mos lejo që fiset arabe të qeshin me ne. Unë jam bija e kryetarit të këtij fisi. Babai im mbronte nderin dhe dinjitetin e njerëzve, shpëtonte të robëruarit, ndihmonte borxhlinjtë dhe të sëmurët, ushqente të uriturit, vishte nevojtarët, mirëpriste mysafirët, i ushqente ata dhe përhapte selamin. Ai nuk e kthente kurrë duarbosh askënd që vinte për një nevojë. Unë jam vajza e Hatemi Tai.»

Pas kësaj, Resulullahu **ﷺ** , tha:

«O grua! Këto që numërove ti, janë cilësitë e besimtarëve të vërtetë. Nëse babai yt do të ishte mysliman, do ta mëshironim dhe do të sillëshim mirë me të. Lirojeni këtë grua, sepse babai i saj e donte moralin e bukur. Po kështu edhe Allahu i Madhëruar e do moralin e bukur.»

Ebu Burde **ﺕ** , u ngrit në këmbë dhe pyeti i habitur:

«O Resulullah! A e do Allahu moralin e bukur?»

Resulullahu **ﷺ** , u përgjigj:

«Betohem në Allahun, i Cili ka në dorë jetën time, askush nuk do të mund të hyjë në Xhenet pa zotëruar moral të bukur!» (Bejhaki, Detail, nr: 2087 (Vefdu Tajj); Shuab, VI, 241/8013)

Kjo do të thotë se, është e pamundur të mendohet një jetë fetare e shkëputur nga morali i bukur. Një besim që nuk është stolitur me vlera morale, është si një dritë e qiririt pa mbrojtëse. Ai është gjithnjë i ekspozuar ndaj rreziqeve të mëdha përball fatunave të egos dhe shejtanit.

Prandaj, ne duhet ta mbrojmë fenë dhe besimin tonë, me moralin e bukur, që është si një mburojë shpirtërore. Lidhur me këtë Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Xhibrili më ka thënë se Allahu i Madhëruar ka urdhëruar:

«Kjo fe, është ajo që Unë kam zgjedhur për Vetën dhe me të cilën jam i kënaqur. Kësaj (feje), i shkon vetëm bujaria dhe morali i bukur. Për sa kohë të jetoni si myslimanë, ngrijeni këtë (fe) me këto dy virtyte!» (Hajthemi, VIII, 20; Ali el-Muttaki, VI, 392)

Sa bukur e shpreh kjo ngjarje faktin se morali i bukur, është si një urë shpirtërore që e shpie njeriun drejt udhëzimit dhe besimit:

Sahabiu Hakim ibn Hizam **ؓ**, ishte një i afërm i nënës sonë Hadixhe **ؓ** dhe ishte njeri me moral të bukur. Ky sahab, edhe para se të bëhej mysliman, ishte bujar, i butë dhe bamirës i madh. Në kohën e injorancës, ai i pengonte baballarët që donin t’i varrosnin të gjalla bijat e tyre, duke i blerë prej tyre dhe duke i marrë nën kujdesin e vet. Po ashtu, në atë kohë, ai ka liruar njëqind skllëvër dhe ka dhuruar njëqind deve në kohën e haxhit, për t’u bërë kurban

Që njeriu të arrijë të bëhet mysliman jo vetëm fizikisht, por edhe shpirtërisht, ai duhet të stoliset me virtyte të mira dhe të braktisë veset e këqija.



Fruti i parë i një besimi të përsosur, është mëshira. Sa më shumë që njeriu të përsoset në besim, edhe bota e tij shpirtërore zgjerohet vazhdimisht, derisa bëhet një vatër mëshire, që përfshin të gjitha krijesat.

dhe për t'iu shpërndarë nevojtarëve. Edhe pasi u bë mysliman, ai dhuroi përsëri njëqind deve dhe liroi njëqind skllëvër për hir të Allahut. Një ditë shkoi tek Profeti ﷺ dhe e pyeti:

“O i Dërguar i Allahut, në kohën e injorancës kam bërë disa mirësi, si dhënia e sadakasë, lirimi i robërve dhe kujdesi ndaj lidhjeve farefisnore... A do të kem ndonjë shpërblim për këto?”

Profeti ﷺ, u përgjigj:

“Në fakt, ti për hir të këtyre mirësive që ke bërë më parë je nderuar edhe me Islam!” (Buhari, Zekat 24, Buju 100, Itk 12, Edeb 16; Muslim, Iman, 194-196.)

Nisur nga kjo, ne duhet ta mendojmë mirë vlerën që ka tek Allahu morali i bukur, i cili bëhet shkak i udhëzimit në besim, që është edhe mirësia më e madhe e njeriut në këtë jetë. Po ashtu, duhet menduar se, përderisa morali i bukur bëhet shkak i udhëzimit edhe të mohuesve, atëherë kushedi se në çfarë gradash të larta e ngrenë besimtarin!..

Padyshim se, mënyra më e mirë për të arritur moralin e bukur, është dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe atyre që ndjekin rrugën e tij. Ky është kushti i parë për t'iu kapur pas hallkës së virtyteve. Ndërsa largimi prej dashurisë ndaj tyre, e çon njeriun

drejt vorbullës shkatërruese të moralit të keq dhe indiferentizmit.

Mëshira

Mëshira, është xhevahiri më i zgjedhur për njerëzimin në këtë botë, e cila na çon drejt takimit me Allahun e Madhëruar.



Besimtari i mëshirshëm është bujar, modest, shërbyes dhe njëkohësisht, një mjek i zemrave që injekton në shpirta vaksinën e jetës.

Fruti i parë i besimit tek një besimtar, është dhembshuria dhe mëshira. Një zemër larg saj nuk mund të konsiderohet e gjallë. Për rrjedhojë, kur hapim Kuranin Fisnik, cilësitë e para hyjnore që na dalin përballë janë **“Rrahman”** dhe **“Rrahim”**.

Më pas, në më shumë se 300 ajete të tjerë, këshillohet mëshira. Allahu i Madhëruar, Vetën e Tij e ka prezantuar si **“Më mëshiruesi i mëshiruesve”** dhe na ka urdhëruar neve, robërve të Tij, që të pajisemi me këtë moral hyjnor. Për rrjedhojë, zemra e një besimtari, që është e mbushur plot me dashurinë ndaj Allahut, duhet t'i përfshijë të gjitha krijesat e Tij me mëshirë dhe dhembshuri.

Dhembshuria dhe mëshira e **të Dërguarit të Allahut ﷻ**, kishte përmasa universale. Një ditë, ai tha:

“Betohem në Allahun, i Cili më ka në dorën e Tij, se pa mëshiruar njëri-tjetrin, nuk mund të hyni në Xhenet!”

Sahabët thanë:

“O Resulullah! Të gjithë jemi të mëshirshëm!”

I Dërguari i Allahut ﷻ, tha:

“Mëshira (për të cilën e kam fjalën), nuk është siç e kuptoni ju, vetëm ajo për njëri-tjetrin. Përkundrazi, është mëshira që përfshin të gjitha krijesat, (po) mëshira që përfshin të gjitha krijesat!..” (Hakim, IV, 185/7310.)

Një person i tha Resulullahut ﷻ:

“O Resulullah! Kur ther ndonjë dele për kurban, më dhimbset dhe e mëshiroj.”



Resulullahu ﷻ, ka thënë:

“Allahu i Madhëruar, i Cili është Rrahman, i mëshiron ata që mëshirojnë. Tregoni mëshirë dhe dhembshuri ndaj atyre që janë në Tokë, që t'ju mëshirojnë ata që janë në qiell!”

(Tirmidhi, Birr, 16/1924.)

Sic na ka bërë të ditur i Dërguari i Allahut ﷺ, një grua gjynahqare, e cila i kishte dhënë të pijë ujë një qeni, u bë prej banorëve të Xhenetit vetëm për arsye të kësaj mëshire që ka treguar. Përkundër kësaj, një grua që adhuronte Zotin, pësoi dënimin e Xhehenemit, vetëm sepse ishte sjellë në mënyrë të pamëshirshme ndaj një maceje, duke e lënë atë të ngordhë urie.

(Shih. Muslim, Selam, 151-153.)



Resulullahu ﷺ, i tha duke e përsëritur dy herë:

“Nëse mëshiron një gjallesë, qoftë ajo edhe një dele, edhe Allahu do të mëshirojë ty.” (Ahmed, III, 436; Hakim, IV, 257.)

Sërisht Resulullahu ﷺ, është shprehur:

“Kush mëshiron, edhe kur është duke prerë një zog, Allahu do ta mëshirojë Ditën e Kiametit.” (Teherani, Kebir, VIII, 234/7915; Bejhaki, Shuab, VII, 482)

Myslimanët, sillen me butësi dhe mëshirë ndaj robërve të Zotit, qofshin këta edhe armiqtë e tyre. Vëllai i Mus’ab ibn Umejrit, Ebu Azizi, kishte qenë bajraktari i idhujtarëve në betejën e Bedrit, ku edhe u zu rob. Ai e tregon kështu mëshirën dhe dhembshurinë, me të cilën është trajtuar nga myslimanët gjatë kohës kur ishte rob:

“Më kishin dorëzuar tek një grup i ensarëve. Gjatë kthimit nga Bedri, kur vinte ushqimi i drekës dhe i darkës, bukën ma jepnin mua, kurse vetë e kalonin vaktin me hurma të thata. Kjo, sepse i Dërguari i Allahut ﷺ, i kishte porositur që të silleshin mirë me robërit. Nëse diku i binte në dorë një copë bukë, menjëherë ma jepte mua. Mua më vinte zor dhe ia ktheja bukën ndonjërit prej tyre. Mirëpo, edhe ai ma jepte përsëri mua dhe nuk e prekte aspak bukën me dorë.”

(Ibni Hisham, II, 288; Hajthemi, VI, 86.)

Esma binti Ebi Bekr ؓ, ka thënë:

“Në periudhën e injorançës, e kam dëgjuar Zejd ibn Amrin, i cili rrinte në këmbë, i mbështetur në murin e Qabes dhe thoshte:

«O popull i Kurejshëve! Për Zotin, përveç meje asnjëri prej jush nuk është në fenë e Ibrahimit ﷺ !»

Zejdi i shpëtonte vajzat që do të varroseshin për së gjalli dhe u falte jetën. Një njeriu që donte të vriste vajzën e vet, i ka thënë:

«Mos e vrit! Unë do të marr përsipër të gjitha nevojat e saj!» Kur vajza u rrit, ai iu drejtua të atit të saj duke i thënë:

«Nëse dëshiron, ta dorëzosh ty, nëse jo, unë do të vazhdoj të kujdesem për të.»» (Buhari, Menakibu'l Ensar, 24.)

Kjo ndjenjë mëshire që ndodhej tek Zejdi, e ka mbrojtur atë nga idhujtaria dhe mohimi, duke i bërë të mundur të emigrojë në botën tjetër si njeri dhe besimtar i mirë (hanif). Lidhur me të, Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Ditën e Kiametit, ai do të ringjallet si një popull i veçantë mes meje dhe Isait ﷺ.” (Hejthemi, IX, 416.)

Modestia

Për të arritur pjekurinë shpirtërore, një besimtar, pikësëpari duhet të jetë modest. Ata që e konsiderojnë veten të përsosur, nuk përpiqen të ndreqin gabimet dhe të metat e tyre, sepse ata as që e pranojnë ekzistencën e gabimeve.

Në ajetet e Kuranit, urdhërohet që njeriu të heqë dorë nga mendjemadhësia dhe arroganca:

“Mos ec nëpër tokë me mendjemadhësi, se ti, në të vërtetë, nuk mund ta çash tokën e as të arrish lartësinë e maleve.” (Isra, 37.)

“Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhënjtë e mburracakët!” (Lukman, 18.)



Kush do Zotin, do edhe krijesat e Tij. Kush është mik me Allahun, është mik edhe me krijesat e Tij. Ndërsa, të shohësh të gjitha krijesat më syrin e dhembshurisë dhe mëshirës së Krijuesit, është si rezultat i pajisjes me moralin hyjnor.



Imam Shafiiu ka thënë:

“Më i larti i njerëzve për nga vlera, është ai që nuk sheh ndonjë vlerë tek vetja.”

Kurse Bahaudin

Nakshibendi ka thënë:

Bota është grurë e unë kashtë,

Të gjithë janë të mirë, e unë i mbrapshtë!

Në një hadith fisnik thuhet:

“Kush tregon një gradë modesti për hir të Allahut të Madhëruar, Ai e lartëson atë një gradë. E, kush tregon një gradë mendjemadhësi ndaj Allahut, Ai e ul atë një gradë. Si përfundim, Allahu e ul atë në gradën esfeli safilin (në më të ulëtën e të ulëtëve).” (Ibni Maxhe, Zuhd, 16.)

Resulullahu ﷺ, i përgjigjej edhe ftesës së robërve, e hera- herës hipte edhe në gomar. Ai shpesh i merrte njerëzit pas në kafshën e vet të udhëtimit, hante i ulur në tokë, vishte rroba lesi të ashpër, milte delet dhe u shërbente vetë mysafirëve. Ai u plotësonte nevojat grave të veja, të varfërve dhe të dëshpëruarve, duke mos ngurruar të ecë bashkë me ta për t’u ardhur në ndihmë.⁸⁸

Kur Selman Farisiu **ؓ**, ishte guvernator i Medain-it, nga Shami erdhi një person, i cili kishte me vete edhe një ngarkesë me fiq. Selmani kishte veshur vetëm një rrobë dhe një aba. Personi nga Shami nuk e njihte atë. Kur e pa në atë gjendje, i tha:

“Eja, barte këtë!” Selmani **ؓ**, e mori ngarkesën dhe e vuri në shpinë. Kur populli e pa këtë, iu drejtuan personit nga Shami dhe i thanë:

“Ky që po të bart ngarkesën, është guvernator!”

Edhe pse ai i tha: *“Më falni, nuk ju njoha!”*, Selmani **ؓ**, iu përgjigj:

88. Shih. Tirmidhi, Xhenaiz, 32/1017; Ibni Maxhe, Zuhd, 16; NeN sai, Xhum'a, 31; Hakim, I, 129/205, II, 506/3734; IV, 132/7128; Hejthem, IX, 20.

“S’ka problem, nuk do ta zbres ngarkesën nga shpina pa e çuar në shtëpinë tuaj.” (Ibni Sa’d, IV, 88.)

Sa bukur që është shprehur poeti:

Mos u mburr fort me mall e pasuri, “a ka si unë!” mos thuaj

Se të fryn ndonjë furtunë, e të shpërndan si duaj...

Bujaria

Bujari, është t’i japësh atij që nuk ka, prej asaj që ke. Niveli më i lartë i bujarisë, është “isar-i”, pra, të japësh kur ke nevojë për vete. Përkufizimi më i bukur i “isar-it”, na jepet në këtë ajet fisnik:

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: «Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura.» Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim.” (Insan, 8-11).

Bujaria është një nga cilësitë e Allahut. Një nga emrat e Tij të bukur është **“Kerim”**, që do të thotë: mirëbërësi i përsosur dhe bujari i pafund. Po ashtu edhe emrat Rrahman, Rrahim, Uehhab, Latif,

“Nëse një sundimtar e mposht një sundimtar tjetër, ose e vret, ose e fut në burg atë. Mirëpo, nëse i njëjti sundimtar, sheh një të plagosur, një të mjerë, apo të varfër, ia mjekon plagën dhe e ndihmon atë.

Nëse mbajtja e vetes për të lartë dhe mburrja për faktin se je sundimtar nuk do të ishte një helm, përse sundimtari fitues duhet ta vriste sundimtarin e mundur pa faj dhe, pse duhet ta mëshironte atë varfanjakun, duke i bërë mirësi, edhe pse ai nuk i ka shërbyer asgjë? Ja pra, mjafton të shikoni këto dy situata, që të kuptoni se çfarë helmi është mendjemadhësia.”

(Mevlana)





Aliu ؑ , ka thënë:

“Janë dy mirësi që nuk e di se cila prej tyre më gëzon më shumë:

E para, kur një njeri vjen tek unë (më zgjedh mua) duke shpresuar se unë mund t’ia plotësoj nevojën dhe më kërkon ndihmë me sinqeritet të plotë;

Ndërsa e dyta, kur Allahu i Madhëruar ia plotëson nevojën këtij personi ose ia lehtëson çështjen në sajën tim...”

Teuuab, Gaffar, Afuv, Rauf dhe Hadi, shprehin bujarinë hyjnore në aspekte të ndryshme.

Po ashtu, edhe i Dërguari i Allahut ﷺ, ishte një njeri aq bujar, saqë kur i kërkohej ndonjë gjë, nuk thoshte kurrë “jo”.⁸⁹ Ai, lidhur me vlerën e bujarisë dhe ata që e zotërojnë këtë virtyt, ka thënë:

“Bujaria është një nga pemët e Xhenetit, degët e së cilës janë të lëshuara në këtë botë. Kush kapet pas ndonjërës prej degëve të saj, ajo do ta shpie në Xhenet. Kurse koprracia, është një nga pemët e Xhehenemit, degët e të cilës janë të zgjatura në këtë botë. Kush kapet pas ndonjërës prej degëve të saj, ajo do të hedhë në Xhehenem!...” (Bejhaki, Shuab, VII, 435)

Bujaria është një produkt i mëshirës që vjen prej besimit. Në një hadith fisnik thuhet:

“Dy cilësi nuk bëhen kurrë bashkë tek një mysliman i vërtetë. Ato janë koprracia dhe morali i keq!...” (Tirmidhi, Birr, 41/1962.)

Shejh Sadi, në veprën e tij “Bostani”, shprehet:

“Mirësitë që zotëron, jepi vetë sa je gjallë, sepse kur të vdesësh, nuk do t’i kesh më!.. Kush e çon vetë furnizimin në botën tjetër, ka arritur një mirësi të madhe, sepse askush nuk ta kruan shpinën duke menduar për ty... Atë mund ta kruash vetëm me thonjtë e tu!

Nëse të vjen ndonjë nevojtar në derë, mos e kthe duarbosh. -Zoti mos e dhëntë!-; mbase një ditë edhe ti mund bëhesh nevojtar dhe do shëtisësh derë më

derë!.. Meqë sot nuk shkon në derën e askujt për të kërkuar diçka, si falënderim për këtë, ndihmoje nevojtarin që vjen në derën tënde!”

Megjithatë, bujari, nuk do të thotë të shpenzosh vend e pa vend, por t’u bësh bamirësi robërve të Allahut, me kujdes dhe duke qenë i vetëdijshëm për vlerën e mirësive. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar ka ligjëruar këto norma:

“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë!” (Isra, 29)

Sakrifica dhe shqetësimi me hallet e vëllait musliman

Një besimtar duhet të interesohet për vëllezërit e tij besimtarë dhe të shqetësohet për hallet e tyre. Madje, ai duhet të përpiqet të plotësojë nevojat e tyre, para të vetave.

Treguesi më i qartë i dashurisë është sakrifica. Madhësia e dashurisë matet me madhësinë e sakrificës që bëhet për hir të dashurisë. Prandaj, besimtarët që ushqejnë dashuri ndaj Allahut dhe fesë së Tij, duhet të dhurojnë për hir të Allahut dhe të pranojnë disa vështirësi në mënyrë vullnetare.

Sakrifica prej pasurisë dhe jetës, është një kusht i rëndësishëm për fitimin e Xhenetit. Këtë fakt, e bën të ditur ky transmetim:

Beshir ibn Hasasije **ؓ**, rrëfen:



Gjithkush duhet të jetë bujar sipas mundësisë. Një ditë, profeti Muhamed **ؐ tha:**

“Një dërm e ka kaluar (në vlerë) njëqindmijë dërm.”

Sahabët pyetën:

*“Si është e mundur kjo, o Resulullah?” Profeti **ؐ**, tha:*

“Një burrë kishte dy dërm. Më të mirin prej tyre e dhuroi për hir të Allahut. (Pra dhuroi gjysmën e pasurisë së tij.) Kurse një tjetër (që ishte shumë i pasur) dhuroi (vetëm) njëmijë dërm nga pasuria e tij.”

(Nesai, Zekat, 49.)



Osmani † , ka thënë:

*“Nëse tregohesh
indiferent ndaj vetes dhe
nuk parapërgatitesh për
të, padyshim se askush
nuk bën përgatitje për
ty. Mos e harro kurrë,
se patjetër do të dalësh
para Allahut. Prandaj,
përgatite veten dhe
furnizimin për të!
Kujdes, mos bëj gabim
që këtë punë t’ia lësh
dikujt tjetër!”*

“Shkova tek **Resulullahu** ﷺ, për t’i dhënë besën. Ai më vuri kusht që të dëshmoja se përveç Allahut s’ka zot tjetër dhe se ai ishte i Dërguari i Tij, të falja namazin, të jepja zekatin, të kryeja haxhin, të agjëroja Ramazanin dhe të luftoja në rrugë të Allahut. Ndërsa unë i thashë:

«O i Dërguar i Allahut! Vallahi, dy prej këtyre nuk i bëj dot. Ato janë lufta në rrugë të Zotit dhe sadakaja. Njerëzit thonë se Allahu e dënon atë që i shmanget xhihadit. Mirëpo, unë kam hall se kur të dal në fushëbetejë, do më kaplojë frika nga vdekja dhe do të iki nga lufta. Sa i përket

sadakasë, unë kam vetëm disa dhen dhe nja katër a pesë deve. Ato janë burimi i jetesës së familjes sime dhe kafshë udhëtimi.»

Resulullahu ﷺ, mblodhi dorën, e tundi dhe tha:

«Xhihad s’bën, sadaka s’jep! Po mirë, me çfarë do të hysh në Xhenet?»

Pas kësaj, i thashë:

«O Resulullah! Ta japë besën!», dhe u betova për të gjitha kushtet që më vuri i Dërguari i Allahut ﷺ.” (Ahmed, V, 224.)

Në Luftën e Çanakalesë, ushtarët myslimanë ndiqnin moralin e sahabëve fisnikë, të edukuar nën kujdesin e të Dërguarit të Zotit ﷺ. Një nga këta, ishte edhe Husejni, i cili ishte plagosur shumë rëndë dhe po mjekohej. Gjendja e tij nuk ishte aspak e mirë, gjë për të cilën edhe vetë ai ishte i vetëdijshëm. Për këtë arsye, sapo bëhej gati të kafshonte bukën që i kishin dhënë shokët, papritur u ndal. Duke preferuar vëllezërit e fesë para vetes dhe me një dashuri të madhe për besimin tha:

“Miqtë e mi! Nuk është e drejtë ta ha unë këtë bukë, sepse vdekja ime është afruar shumë. Merreni këtë dhe jepjani trimave që do të jetojnë!..”

Pas kësaj, ai ia zgjati bukën shokut të tij të luftës, Mustafait. Sado që këmbëngulën duke ia refuzuar, ata nuk arritën ta bindin. Kështu, pas një kohe të shkurtër, ky trim vetëmohues dhe me kraharorin e mbushur plot besim, piu sherbetin e dëshmorit me kënaqësinë dhe gëzimin që i dha furnizimi shpirtëror që kishte arritur.

Nisur nga kjo, besimtarët me zemër të ndjeshme dhe të butë, që digjen nga malli për t’u takuar me Zotin e Madhëruar, duhet të mësohen të qëndrojnë pranë të hidhëruarve dhe të merren me hallet e tyre. Madje, shërbimin ndaj robërve të Allahut, duhet ta konsiderojnë si adhurim ndaj Tij, ndërsa shërbimin ndaj popullit, si shërbim ndaj Profetit ﷺ.

Sinqeriteti dhe çiltërsia

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Veprat janë sipas qëllimeve...” (Buhari, Iman, 41.)

Në këtë kontekst, të gjitha veprat e mira, duke filluar prej adhurimeve, është kusht të bëhen vetëm për hir të Allahut. Ja pra, sinqeritet, do të thotë t’i bësh veprat vetëm për hir të Allahut dhe të mos i përziësh aspak me qëllime të tjera personale. Krahas kësaj, është e domosdoshme t’i pastrojmë zemrat tona prej çdo papastërtie shpirtërore, duke filluar prej syfaqësisë dhe arrogancës, sepse këto janë sëmundje shpirtërore që e turbullojnë dhe asgjësojnë sinqeritetin.

Njeriu që kërkon kënaqësinë e Allahut, duhet të qëndrojë pranë të hidhëruarve. Sipas një transmetimi, një ditë, Musai ﷺ, iu lut Allahut duke thënë:

“O Zot! Ku mund të të kërkoj?” Allahu i Madhëruar i tha:

“Më kërko pranë njerëzve zemërthyer!”

(Ebu Nuajm, Hilje, II, 364).



Ebu Bekri ؓ , ka thënë:

“Allahu nuk i pëlqen fjalët e atij që nuk e bën edhe veprën.”

Kushti kryesor i pranimit të veprave tek Allahu, është sinqeriteti. Ajo çfarë është shpirti për trupin, është edhe sinqeriteti për veprat.

Pas vdekjes së njërit prej sunduesve dhe heronjve të Horasanit, Amr ibn Lejsit, një njeri i mirë, e kishte parë në ëndërr dhe mes tyre ishte zhvilluar ky dialog:

“Si u soll Allahu me ty?”

“Allahu më fali.”

“Për shkak të cilës veprë të fali Allahu?”

“Një ditë isha ngjitur në majë të një mali. Kur pashë numrin e madh të ushtarëve të mi, më pëlqeu shumë ajo pamje dhe mendova:

«Ah sikur të kisha jetuar në kohën e Resulullahut ﷺ dhe ta kisha mbështetur me ndihmë...» Ja pra, në sajë të këtij qëllimi dhe dëshire, Allahu i Madhëruar më fali.” (Kadi Ijaz, Shifa, II, 28-29.)

Mirëpo, një qëllim kaq i bukur, nuk arrihet lehtësisht. Për ta arritur këtë, duhet të zotërosh një sinqeritet dhe çiltërsi të lartë.

Njërin, prej robërve të dashur të Allahut, e pyetën:

“A keni përjetuar ndonjë ngjarje lidhur me sinqeritetin, që ju ka lënë mbresa?”

“Po, kam përjetuar.” - tha ai dhe vazhdoi të tregonte:

“Kur isha në Mekë humba qesen me para dhe ngela në vështirësi. Po prisja të më vinin ca para nga Basra, por nuk po vinin. Flokët dhe mjekra më ishin rritur goxha shumë. Vajta tek një berber dhe e pyeta: «A më qeth për hir të Allahut, sepse nuk kam para?»



Atë moment berberi ishte duke qethur dikë tjetër. Por menjëherë më bëri me shenjë një vend bosh dhe më tha: *“Ulu aty!”*. Pastaj e la myshteriu të presë dhe filloi të më qethë mua. Kur myshteriu që po priste filloi të bënte fjalë, berberi i tha:

«Ju kërkoj ndjesë zotëri. Juve po ju qeth me para, por ky njeri më kërkoi ta qeth për hir të Allahut. Punët që janë për hir të Allahut gjithmonë kanë përparësi dhe nuk kanë ndonjë interes material. Njerëzit as nuk mund ta dinë



Djali i Ebu Xhehlit, Ikrimë, në fillim ishte një armik i përbetuar i Islamit. Për këtë arsye, kur u çlirua Meka, hipi në një anije dhe u arratis nga frika e vdekjes. Gjatë udhëtimit në det, i zuri një furtunë e fortë. Ata që ndodheshin në anije thanë:

“Tani bëhuni të singertë (dhe drejtohuni vetëm Allahut), sepse këtu, idhujt tuaj nuk mund t’ju bëjnë dobi.”

Atë moment, zemra e Ikrimës iu ndriçua nga e vërteta dhe u shpreh kështu:

“Pasha Allahun, nëse në det do të më shpëtojë vetëm singëriteti, atëherë edhe në tokë nuk mund të më shpëtojë asgjë tjetër përveç tij. Allahu im, të jap fjalën se, nëse më shpëton nga kjo situatë, do të shkoj menjëherë tek Muhamedi ﷺ, do ta vendos dorën time mbi dorën e tij dhe padyshim që ai do të jetë falës dhe bujar.”

Pasi shpëtoi nga stuhia, Ikrimë ؓ, e zbatoi menjëherë vendimin që mori dhe shkoi direkt para Resulullahut ﷺ, ku u bë mysliman.

(Nesai, Tahriru'd-Dem, 14/4064)

Një djalosh kishte shkuar në sarajin e sulltanit dhe kishte shprehur dashurinë për vajzën e tij. Kur vajza e mori vesh, doli dhe i tha djaloshit:

“Merri këto njëmijë dërhem dhe mos fol më gjëra të tilla, që na dëmtojnë të dyve!” Kur e vuri re se djali nuk po hiqte dorë, atëherë vajza i tha:

“Merri këto dymijë dërhem!”

Më në fund, kur marrëveshja shkoi deri në dhjetëmijë dërhem, djaloshi pranoi. Kësaj here, vajza i tha:

“Çfarë dashurie qenka kjo, që t’u verbuan sytë pas parave dhe nuk po më sheh më? A e di dënimin për ata që preferojnë diçka tjetër, përveç meje?” Pas këtyre fjalëve, ajo urdhëroi t’ia heqin kokën djaloshit, i cili nuk ishte i sigurtë në dashuri.

Kur një njeri i urtë e dëgjoi këtë ngjarje, ra përtokë pa ndjenja. Pasi erdhi në vete, tha:

“O njerëz! Shikoni si e pësojnë dashuritë false në këtë botë! Po ai që pretendon se e do Allahun, e në të vërtetë i drejtohet dikujt tjetër, ç’përfundim mund të ketë në botën tjetër?!”

Sa bukur e ka përmbledhur Mevlana moralin e kësaj ndodhie:

“Njeriu vlerësohet sipas asaj që kërkon!”

dhe as nuk mund ta paguajnë shpërblimin e punës për hir të Allahut!»

Pasi më qethi, berberi më futi në xhеп disa monedha ari me zor dhe më tha:

«Këto i ke për nevojat më urgjente dhe ma bëj hallall, sepse kaq mundësi kam!»

Ditën e nesërme më erdhën paratë që po prisja nga Basra dhe unë i çova berberit një qese me flori. Berberi tha:

«Nuk i marr kurrë! Robi nuk mund ta paguajë kurrë shpërblimin e punës për hir të Allahut! Shkoni, vazhdoni rrugën tuaj. Allahu ju dhëntë paqe dhe mirësi!»

I kërkova hallallëk dhe u ndava me të, por tash e dyzetë vjet, çdo mëngjes bëj dua për të.”

Pra, veprat kaq të sinqerta, të cilat bëhet vetëm për hir të Allahut të Madhëruar, do të shpërblehen me mirësi që i kanë hije vetëm Atij.

Nderi dhe turpi

Nder, do të thotë të ruash veten nga çdo dëshirë e ulët. Kjo gjë është një veçori njerëzore. Është veçoria më e rëndësishme që e dallon njeriun nga krijesat e tjera. Humbja e nderit, do të thotë të humbasësh dinjitetin njerëzor dhe të biesh në nivelin e krijesave të tjera.

Ndërsa turpi, që është një pjesë prej besimit, nënkupton qëndrimin larg gjërave që konsiderohen të shëmtuara dhe të këqija, maturinë në sjellje dhe vepra dhe ruajtjen e kufijve në çdo çështje. Ndjenja e turpit është themeli i të gjitha mirësive dhe e kundërta e çdo lloj të keqeje dhe të shëmtuare.



“Nëse nuk do të kesh zemër të shqetësuar, atëherë shpëto nga shqetësimet zemrat e shqetësuar!”

(Shejh Sadi-i Shirazi)

Osmani ﷻ , ka thënë:

“Sa perde e bukur është ruajtja e syrit nga harami.”

Nderi, është një cilësi virtuoze, që i është dhënë njeriut ndër të gjitha krijesat. Mirëpo nëse njeriu e humbet këtë cilësi njerëzore, atëherë bie në nivelin e krijesave të tjera.



Allahu i Madhëruar, shprehet kështu lidhur me robërit e Tij të ndershëm:

“(Ata) të cilët e ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme), përveçse me gratë e tyre ose me skllavet që kanë në zotërim - dhe, për këtë, nuk janë fajtorë, ndërsa ata që kërkojnë përtej kësaj, pikërisht ata janë shkelës (të kufijve).” (Mu’minun, 5-7.)

I Dërguari i Allahut ﷺ, i ka dhënë aq shumë rëndësi nderit, sa që ka marrë besën nga gratë, posaçërisht për ruajtjen e nderit.⁹⁰ Dhe, duke iu drejtuar të gjithë besimtarëve, ka thënë:

“Kush më jep fjalën që do të ruajë atë që ka mes dy nofullave (gjuhën) dhe namusin, unë i jap fjalën se do të hyjë në Xhenet!” (Buhari, Rikak, 23.)

Ndërsa lidhur me turpin, Profeti ﷺ, ka thënë:

“Turpi është prej besimit dhe, kush është i turpshëm, do të jetë në Xhenet! Kurse paturpësia vjen prej ngurtësimit të zemrës. E, kush ka zemër të ngurtë, është në Xhehenem!..”

(Buhari, Iman, 16.)

“Turpi dhe besimi janë bashkë në një vend. Kur ikën njëri, ikën edhe tjetri!” (Taberani, Eusat, VIII, 174; Bejhaki, Shuab, VI, 140.)

Mbizotërimi i ndjenjës së turpit, nderit, edukatës dhe mirësjelljes mes meshkujve dhe femrave, është një çështje mjaft e rëndësishme. Në përgjithësi, lidhja e jashtëligjshme mes një mashkulli dhe një femre, fillon përmes “shikimeve”. Për këtë arsye, meshkujt dhe femrat muslimane

90. Shih. Mumteherine, 12

janë urdhëruar të mos e shikojnë njëri-tjetrin me ndjenja epshore dhe të bëjnë kujdes ndaj veshjes sipas Islamit. Dhe, kur u duhet të flasin me njëri-tjetrin, duhet të ulin kokën poshtë dhe të mos përdorin fjalë apo sjellje provokuese.⁹¹

Ata që duan përhapjen e paturpësisë në shoqëri, i shkaktojnë të keqen më të madhe vendit dhe popullit të tyre. Po ashtu edhe ata vetë pësojnë dëmin më të madh, sepse paturpësia, siç na tregon i Dërguari i Allahut ﷺ, është shkak shkatërrimi.

“Pa dyshim se, kur Allahu, i Cili është Aziz dhe Xhelil, dëshiron të shkatërrojë një rob, Ai ia heq dhe ia merr turpin. Dhe, kur ia heq turpin, ai rob pëson vetëm dënim. Kur ai pëson dënimin (e Zotit), i hiqet edhe cilësia e të qenit “i sigurt”. Kur i hiqet siguria, i hiqet edhe mëshira. Kur i hiqet mëshira, ai pëson mallkimin dhe bëhet i mallkuar. Kur mallkohet dhe bëhet i mallkuar, atij i shkëputet lidhja që ka me Islamit!” (Ibni Maxhe, Fiten, 27.)

Ashtu si në çdo çështje, ne duhet të bëjmë kujdes të madh edhe në lidhje me veshjen sipas kritereve që ka vendosur feja jonë. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Ruhuni nga lakuriqësia! Pranë jush gjenden melekë që nuk ndahen prej jush. Ata ndahen vetëm kur njeriu kryen nevojën dhe i afrohet (seksualisht) gruas së vet. Turpërohuni prej tyre dhe silluni mirë me ta.” (Tirmidhi, Edeb, 42/2800.)



Siç transmeton Enesi ؓ , një ditë, teksa po shkonte tek Osmani ؓ , pa në rrugë një grua, bukuria e së cilës i mbeti në mendje. Me këto mendime në kokë, ai hyn tek Osmani ؓ , i cili kur e sheh, i thotë:

“O Enes! Në sytë e tu ka gjurmë zinaje!”

I habitur nga kjo, Enesi ؓ , e pyet Osmanin ؓ :

“A mos vallë, shpallja (hyjnore) vazhdon edhe pas të Dërguarit të Allahut!?”

Osmani ؓ , i përgjigjet:

“Jo! Kjo është një urtësi dhe një perceptim i saktë.”

1. Kushejrju, Ri'sale, Bejrut, 1990, f. 238

91. Shih. Nur, 30 - 31

Në Perandorinë Osmane, nderi dhe namusi i njerëzve ishin të garantuara. Për shembull, në një ferman që Sulltan Fatihu ka nxjerrë pas çlirimit të Bosnjës, urdhërohet:

"Kujdes! Ushtarët e mi të mos gjenden në krye të burimit, në kohën kur vajzat serbe shkojnë për të mbushur ujë!.."

Përmes këtij fermi, Sulltan Fatihu ka ruajtur edhe ushtarët e vet, edhe pjesëtarët e komunitetit të krishterë të cilin e qeveriste.

Burimi i dëshirave dhe ndjenjave epshore, është imagjinata dhe fantazia. Për këtë arsye, zemrat duhet t'i angazhojmë përherë me ndjenja të bukura, ndërsa mendjet me mendime sublime. Krahas kësaj, lidhur me këtë çështje, është kusht i domosdoshëm edhe ruajtja nga shokët e këqij.



Besnikëria dhe mbajtja e fjalës

Besueshmëria dhe besnikëria, janë disa nga cilësitë kryesore të myslimanit. Allahu i Madhëruar urdhëron:

Në kohën e Sulltan Kanunit, në Francë sapo kishte filluar të shfaqej një paturpësi që quhej kërcim. Kur e dëgjoi këtë, Sulltani, menjëherë i dërgoi mbretit të Francës këtë urdhër:

"... Dëgjova se në vendin tuaj qenka shpikur një argëtim i ulët, që bie ndesh me moralin dhe turpin, ku meshkujt dhe femrat përqafohen me njëri-tjetrin para njerëzve për të kërcyer! Dhe, për shkak se jemi fqinj kufitar, është e mundur që kjo paturpësi të përhapet edhe në vendin tim. Nisur nga kjo, sapo të merrni këtë letër, ndalojeni menjëherë këtë paturpësi! Përndryshe, padyshim që jam i fuqishëm të vij e ta zhduk vetë atë paturpësi."

Sipas historianit të famshëm Hammer, pas kësaj letre, kjo paturpësi u ndalua për njëqind vjet me radhë në Francë.

“...Dhe përmbushni zotimet! Me të vërtetë, për zotimet do të jeni përgjegjës!” (Isra, 34.)

Ndërsa një prej cilësive të besimtarëve që kanë arritur shpëtimin, Allahu i Madhëruar e shpreh kështu:

“(Ata) të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra.”

(Mu’minun, 8.)

Një gjë nuk duhet ta harrojmë kurrë, se të gjitha premtimet që u jepen njerëzve dhe të gjitha marrëveshjet e bëra me ta, në të njëjtën kohë, janë si premtime që i janë dhënë Allahut të madhëruar. Për rrjedhojë, është e domosdoshme që këto marrëveshje dhe premtime të bëra para Allahut, të respektohen dhe të çohen në vend.

Profeti ﷺ, ishte në zenitin e besnikërisë. Këtë cilësi të tij, janë detyruar ta pranojnë dhe pohojnë edhe armiqtë e tij më të përбетuar.⁹² I Dërguari i Allahut ﷺ, asnjëherë nuk ka thënë gjëra të pavërteta, madje, edhe kur ka qenë duke bërë shaka, ai nuk ka devijuar nga besnikëria dhe fjala e drejtë.

Lidhur me ata që nuk janë të besueshëm dhe nuk i qëndrojnë fjalës së dhënë, ka shumë qortime të ashpra. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Janë katër vese, të cilat nëse gjenden te një



Enes ibn Maliku [ؓ], ka thënë:

Në shumë prej ligjëratave që na mbante, Profeti ﷺ, thoshte shpesh këto fjalë:

“Kush nuk është i besueshëm, nuk ka iman. Dhe kush nuk e mban fjalën, nuk ka as fe!”

(Ahmed, III, 135, 154.)

92. Shih. Buhariu, Bedu'l-Vahj, 6; Muslimi, Xhihad, 74; Taberi, Tef-sir, VII, 240; Ibni Kethir, el-Bidaje, III, 113.

Ebu Musa ؓ , ka thënë:

**“O i Dërguar i Allahut!
Kush është më i virtytshmi
ndër myslimanët?”**

Profeti ﷺ , u përgjigj:

**“Ai, nga dora dhe gjuha
e të cilit janë të sigurt
myslimanët e tjerë.”**

**(Buhari, Iman, 4, 5, Rikak, 26;
Muslim, Iman, 64, 65.)**



njeri, e bëjnë atë plotësisht hipokrit. Nëse dikush nga ju ka ndonjë nga këto vese, tek ai ka mbetur një ves hipokrizie, derisa ta braktisë atë: Kur i lihet një amanet, e tradhton atë; kur flet, gënjen; kur premtion, nuk e mban atë dhe e tepron në armiqësi, duke bërë padrejtësi.” (Buhariu, Iman, 24; Mezalim, 17; Muslim, Iman, 106.)

Nëse dikush nuk jep siguri përreth, kjo tregon dobësimin e besimit të tij, humbjen e dinjitetit dhe të parimeve Islame. Lidhur me këtë, Omeri ؓ , është shprehur:

“Robit mos i shikoni namazin që fal dhe agjërimin që mban! Shikoni nëse thotë të vërtetën kur flet, e ruan amanetin kur i besohet diçka dhe a bën kujdes ndaj hallallit dhe haramit në çështjet e kësaj bote!” (Bejhaki, Kubra, VI, 288; Shuab, IV, 230, 326.)

Sa bukur që është shprehur Zija Pasha:

Njeriut besnikëria i shkon, edhe sikur të jetë dhunuar,

Ndihmëtari i të drejtëve është Allahu i Madhëruar!..

Kurse Said Pasha shprehet:

*Mos ki frikë armikun,
edhe sikur zjarr të jetë, nuk të djeg ty!*

*Qëndro i patundur, se
Allahu nuk të turpëron ty!*

Falja

Të falësh gabimet e njerëzve dhe të mbulosh të metat e tyre, është një cilësi sa e vështirë, aq

edhe e rëndësishme. Ky virtyt i bukur i pëlqyer nga Allahu i Madhëruar, është tregues i përsosmërisë së besimit dhe moralit. E në fakt, një nga emrat e bukur të Allahut të Madhëruar, është “*el-Afuw*”, i cili shpreh faljen e Tij gjithëpërfshirëse. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Tregohu falës, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!” (A’raf, 199.)

“...(Prandaj o Muhamed) **tregohu falës dhe i mirë** (ndaj tyre).” (Hixhr, 85.)

Falës i vërtetë, është ai që e fal fajtorin ndërkohë që ka mundësi dhe të drejtë ta ndëshkojë atë. Ky është virtyti i vërtetë.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Atë që e mposht zemërimin e tij, ndërkohë që ka mundësi të bëjë atë që duhet (të hakmerret), Ditën e Kiametit Allahu i Madhëruar, e thërret para syve të të gjithëve dhe e lë të lirë të zgjedhë në mesin e hyrivoë.” (Ebu Daud, Edeb, 3/4777; Tirmidhi, Birr, 74, Kiamet, 43; Ibni Maxhe, Zuhd, 18.)

“...Sa më shumë që njeriu ua fal gabimet njerëzve, aq më shumë e lartëson Allahu nderin e tij...” (Muslim, Birr, 69; Tirmidhi, Birr, 82.)

Sunduesi absolut i “faljes” është Allahu i Madhëruar. Ndërsa besimtarët mund të falin aq sa dashuri kanë për Allahun në zemrat e tyre. Duhet menduar se, ai që nuk tregon vullnet për të falur robërit e Allahut dhe përpiqet vetëm për interesat dhe ambiciet e veta, si mund të kërkojë falje nesër para Allahut?! E rëndësishme, është të arrish të meritosh faljen, duke falur vazhdimisht edhe të tjerët.



“Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre.”

(Ahzab, 23.)

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Trim i vërtetë nuk është ai që mposht rivalin në mundje, por ai që mposht zemërimin e tij.”

(Buhari, Edeb, 76; Muslim, Birr, 107, 108.)

Shembujt më të bukur lidhur me faljen, i gjejmë në jetën e **Resulullahut ﷺ**. Ditën e çlirimit të Mekës, për hir të *Fjalës së Dëshmisë*, ai e fali **Hindin**, e cila në betejën e Uhudit, kishte kafshuar plot mllef mëlçinë e xhaxhait të tij të dashur, **Hamzait ﷺ**.

Po ashtu, për këtë arsye e fali edhe **Hebbar ibn Esuedin**, armikun e përbetuar të Islamit, i cili goditi me shtizë të bijën e tij, **Zejneben ﷺ** dhe shkaktoi vdekjen e saj duke e rrëzuar nga deveja. Madje, Profeti ﷺ, e ndaloi edhe aludimin për të kujtuar se çfarë kishte bërë ai më parë.⁹³

I Dërguari i Allahut ﷺ, i falte pa asnjë ngurrim të gjitha padrejtësitë që bëheshin kundrejt personit të tij. Mirëpo, atë nuk mund ta qetësonte askush në lidhje me krimet që bëheshin ndaj popullit, derisa e vërteta dhe drejtësia të viheshin në vend. Kjo, sepse falja ka të bëjë me fajet që bëhen vetëm ndaj personit që fal. Por, nëse faji ka të bëjë me një shoqëri, atëherë është e domosdoshme të mbrohet e drejta e asaj shoqërie. Për rrjedhojë, nëse falet një fajtor i tillë, është e sigurt që kjo do t'i hapë rrugët padrejtësive edhe më të mëdha.



Drejtësia

Emri i hyjnor **“el-Adl”**, që është nga emrat e bukur të Allahut të Madhëruar, tregon se Allahu është i drejtë dhe vetë drejtësia. (Tirmidhi, Deauat, 82/3507.)

Islami ka urdhëruar drejtësinë në çdo çështje. Nëse njerëzit e bëjnë

drejtësinë të sundojë, atëherë bëjnë edhe një jetë fetare të qetë dhe shpirtërore, me të cilën është i kënaqur Allahu i Madhëruar. Kështu, duke fituar të gjitha mirësitë e kësaj bote dhe tjetrës, ata arrijnë lumturinë e përjetshme.

Drejtësia është aq e rëndësishme, saqë ai i cili e ruan atë, ngrihet dhe zhvillohet materialisht në këtë botë, edhe sikur të jetë femohues. Ndërsa ai që vepron në kundërshtim me drejtësinë, ngelet mbrapa dhe bie në mjerimin e problemeve materiale dhe shpirtërore në këtë botë, edhe sikur të jetë besimtar. Përveç kësaj, ai do të pësojë dënim për padrejtësinë e tij edhe në botën tjetër.

Kur të mos ekzistojë drejtësia, nuk mund të bëhet më fjalë për ligj, mëshirë dhe harmoni mbi tokë. Gjatë gjithë historisë, kur njerëzit janë zhytur në tirani dhe çdo gjë ka dalë nga kontrolli, Allahu i Madhëruar ka dërguar profetë për të rimëkëmbur drejtësinë. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni), Allahu është për ata vlerësuesi më i drejtë. Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë! Nëse ju ngatërroni dëshminë ose i shmangeni asaj, vërtet që Allahu e di se çfarë bëni ju.” (Nisa, 135.)

Resulullahu ﷺ, tregon:

“Një njeri nga popujt para jush u mor në llogari dhe nuk iu gjet asgjë prej mirësive. E në fakt, ai kishte qenë një njeri i pasur, i cili shkonte mirë me njerëzit. Ai e urdhëronte shërbyesin e tij që t’u falte borxhet të varfërve në vështirësi. (Për këtë arsye) Allahu i Madhëruar, i Cili është Aziz dhe Xhelil, urdhëroi: «Ne jemi më falës se ai! Mbulojani gjynahet!»”

(Muslim, Musakat, 30; Ahmed, IV, 120.)





“Çfarë është drejtësia? Drejtësi është të ujitësh pemët frutore. Çfarë është padrejtësia? Të ujitësh gjembat. Njeriu që nuk e njeh drejtësinë, i ngjan dhisë që i jep të pijë këlyshit të ujkut (që kur të rritet, do t’i marrë jetën asaj.)”

(Mevlana)

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Ditën e Kiametit, njeriu më i dashur për Allahun e Madhëruar dhe ai, i cili do të gjendet më afër Tij, është administratori (ose pushtetari) i drejtë. Ndërsa njeriu më i urreyer për Allahun dhe ai, i cili do të jetë më larg Tij, është administratori zullumqar.”

(Tirmidhi, Ahkam, 4/1329; Nesai, Zekat, 77.)

Myslimani nuk duhet të veprojë me drejtësi vetëm kur gjykon, por në çdo kohë dhe në çdo çështje, edhe kur të masë e peshojë, edhe kur të dëshmojë. Ai nuk duhet t’i ndahet drejtësisë as kur është i zemëruar, e as kur është i qetë.⁹⁴

Kur Sulltan Bajeziti arriti me ushtrinë e tij para qytetit të Konjës, portat e qytetit ishin mbyllur. Ishte koha e shirjeve dhe çdo anë e fushës së Konjës ishte mbushur me grumbuj elbi dhe gruri. Mirëpo, për shkak se populli u strehua në kala me nxitim, nuk mundën t’i fusnin brenda edhe të korrat. Ndërkohë, edhe ushtria Osmane kishte nevojë për elb dhe grurë. Për rrjedhojë, ushtarët u afruan nën kala dhe i bënë thirrje popullit:

“O popull! Ushtria jonë ka nevojë për elb dhe grurë. A po vini të na shisni?”

Populli u habit nga ky propozim dhe disa vetë prej tyre, dolën nga qyteti duke thënë:

“Të shohim, a po thonë të vërtetën?!”

Ndërkohë, Sulltan Bajeziti, për t’i paraprirë çdo situatë, u dha ushtarëve këtë urdhër:

“Këta janë vëllezërit tanë myslimanë. Kurrsesi mos u bëni padrejtësi dhe respektoni të drejtën e robit! Pronarët e elbit të na shesin me vullnetin e tyre (pa detyrim)!..”

Kështu, ata që dolën nga kalaja, shitën me dëshirën e tyre dhe me çmimin që kërkuan vetë. Pasi morën akçet, u kthyen në kala me një kënaqësi dhe habi të madhe.

Kur populli i Konjës e panë këtë drejtësi dhe humanizëm të pashoq, hapën portat e qytetit qosh më qosh me dëshirën e tyre dhe i pranuan brenda Osmanët. Po kështu, edhe disa qytete të tjera përreth që e dëgjuan këtë ngjarje, dërguan përfaqësuesit e tyre tek Osmanët dhe i ftuan ata në qytetet e tyre, duke thënë:

“Mirë se të vini! Administrojini ju qytetet tona!”

Nga ana tjetër, drejtësia nuk duhet vonuar kurrë, sepse drejtësia më e keqe, është ajo që shfaqet me vonesë. Edhe sikur gjykimi në fund të jetë i drejtë, drejtësia e vonuar, në një farë mënyre është një lloj padrejtësie.

Disa njerëz, në sajë të oratorisë dhe të zgjuarsisë së tyre, mund ta mbulojnë padrejtësinë që bëjnë. Mirëpo, në të vërtetë, ata kurrë nuk do të shpëtojnë.⁹⁵ Ata që i kanë shpëtuar drejtësisë njerëzore në këtë botë me njëmijë hile e dredhi, një ditë, do të detyrohen të japin llogari, të përlurur dhe të pafuqishëm përpara Allahut të Madhëruar, i cili është “Gjykuesi i gjykuesve” dhe do të përfundojnë në një humbje të thellë.

95. Shih. Buhariu, Shehadat 27, Hijel 10, Ahkam 20; Muslim, Akdije 4.

Një ditë Resulullahu ﷺ, tha:

“A e dini se kush janë «sabikun»-ët që Ditën e Kiametit do të vrapojnë drejt hijes (të parët, për të shpëtuar nga i nxehti i madh dhe vështirësitë)?”

Sahabët thanë:

“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri!”

Profeti ﷺ, tha:

“Ata janë njerëzit që pranojnë kur u jepet të drejtë, japin bujarisht kur u kërkohet një e drejtë dhe që kur gjykojnë mbi të tjerët, sillen sikur po gjykojnë për veten e tyre.”

(Ahmed, VI, 67, 69.)



**Nëse në historinë
tënde ke një Fatih
që ka dalë në
gjyq përballë një
shtetasi të vet,
duke i dhënë botës
një botëkuptim
shembullor të
drejtësisë, mos
harro se ti je
pasardhësi i një
populli të madh!..**



Resulullahu ﷺ, na ka paralajmëruar me këto fjalë:

“Kush i ka bërë vëllait të fesë ndonjë padrejtësi në nder apo në pasuri, të hallallohet me të para se të vijë Dita e Kiametit, ku nuk do të ketë flori dhe argjend. Në të kundërtën, nëse ka vepra të mira, do t’i merren prej sevapeve të tij aq sa ka bërë padrejtësi (dhe i jepet atij që i është bërë padrejtësi). Por nëse nuk ka vepra të mira, do të merren prej gjynaheve të vëllait që i ka bërë padrejtësi dhe do t’i ngarkohen atij.”

(Buhari, Medhalim, 10, Rikak, 48.)

Ummu Seleme ؓ ka thënë:

“Një nga porositetë e fundit të Profetit tonë të dashur ishte kjo:

“Bëni kujdes namazin! Bëni kujdes namazin! Respektoni të drejtat e atyre që keni nën vete!”

Resulullahu ﷺ, i përsëriti aq shumë këto fjalë, sa që edhe kur gjuha e tij e bekuar nuk arriti të fliste më, vazhdoi t’i thoshte në vete këto. (Ahmed, VI, 290, 315.)

Një njeri, e teproi me fyerje ndaj Haxhaxhit në prani të një njeriu të urtë. Mirëpo, i urti i dha këtë mësim:

“Mos e fyej aq shumë atë njeri, sepse Allahu i Madhëruar do ta dënojë Haxhaxhin për njerëzit, të cilëve u ka shkatërruar jetën dhe pasurinë. Mirëpo çështja nuk përfundon me kaq. Nga ana tjetër, Allahu do të dënojë edhe ata që i kanë hyrë në hak Haxhaxhit, duke dhunuar dinjitetin e tij.”

Dikujt i bëhet padrejtësi, e më pas ky njeri e ofendon aq rëndë atë që i ka bërë padrejtësi, sa që ofendimet e tij barazohen me gjynahun e atij që i bëri padrejtësi. Madje, për shkak se e tepron në këtë çështje, ai i hyn në hak atij që i ka bërë padrejtësi, duke rënë edhe vetë në gjynah.⁹⁶

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Nëse ndëshkoni, ndëshkoni aq sa jeni ndëshkuar, por, nëse duroni, kjo është më e mira (rrugë) për të durueshmit.” (Nahl, 126.)

Shkurtimisht, sado e fuqishme mund të duket një tirani, fundi i saj është humbja. Po ashtu, sado e vështrirë të duket drejtësia, fundi i saj është plot dritë dhe paqe. Myslimani, i cili është gjithmonë i drejtë, kudo dhe me këdo, fiton dashurinë e Allahut dhe të atyre që e duan Atë, duke arritur lumturinë në të dyja botët.

Butësia dhe toleranca

Allahu i Madhëruar na e ka prezantuar Vetën si, “*el-Halim*”, pra, i Butë dhe Tolerant. Kjo cilësi e bukur e preferuar e Allahut, është edhe një prej cilësive të profetëve.

Butësia dhe toleranca, që janë rezultati më i natyrshëm i virtyteve të bukura si mëshira, dhembshuria dhe dashuria, është një parim i rëndësishëm edhe në marrëdhëniet njerëzore. Po ashtu, ky është urdhri i Allahut të Madhëruar dhe natyra e Profetit ﷺ.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

Omeri ؓ, ka thënë:

“Dëshmitari më i fshehtë e një vepre të keqe, është ndërgjegjja jonë”

Ndërgjegjja është treguese e nivelit të njerëzisë tonë.



96. Babanzade Ahmed Naim, Islam Ahlakinin Esaslari, Istanbul 1963, f. 86.

Një prej sahabëve iu afrua të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Unë kam disa shërbyes, të cilët më gënjejnë, më tradhtojnë dhe më kundërshtojnë vazhdimisht. Për këtë arsye, unë i shaj dhe i rrah. Ç’do të ndodhë me mua për shkak të tyre?”

I Dërguari i Allahut ﷺ, i tha:

“Tradhtia, gënjeshtria dhe kundërshtimi i tyre ndaj teje dhe dënimit që u ke dhënë ti atyre, do të llogariten. Nëse dënimi që u jep ti del i barabartë me fajin e tyre, për ty s’do të ketë asgjë, qoftë në favor, qoftë në disfavorin tënd. Nëse dënimi që u jep ti del më pak se faji i tyre, kjo do të jetë në favorin tënd. Por, nëse dënimi që u jep ti, është më i madh se faji i tyre, do të jesh i detyruar ta shlyesh tepricën, e cila do të merret prej teje me metodën e «kisas»-it (sy për sy e dhëmb për dhëmb)!”

Sahabi u tërhoq mënjanë dhe filloi të qajë me ngashërim. Atëherë, i Dërguari i Allahut ﷺ, i tha:

“A nuk e lexon fjalën e shenjtë të Allahut të Madhëruar, që thotë: **«Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrre sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.»**”¹

Pas kësaj, sahabi tha:

“Vallahi, o i Dërguari i Allahut! As për mua, e as për ata nuk ka ngelur rrugë tjetër më e mirë përveç ndarjes! Jini dëshmitar, se që të gjithë i kam liruar!”

(Tirmidhi, Tefsir, 21/3165.)

1. Enbija, 47.

“Kudo që të gjendet butësia, ajo e zbukuron atë vend. Çdo sjellje pa butësi, është e shëmtuar.” (Muslim, Birr, 78, 79.)

“Kujt i është falur butësi, i janë falur edhe mirësi. E kujt nuk i është falur butësi, është privuar edhe nga mirësitë.” (Tirmidhi, Birr, 67/2013.)

Një ditë, Enesi **t**, tha:

*“Nuk kam nuhatur aromë më të këndshme se aroma e të Dërguarit të Allahut **r** dhe nuk kam prekur as atllas, e as mëndafsh më të butë se lëkura e tij!”*

Nxënësi i vet, Thabiti, që po e dëgjonte, i tha:

*“O Ebu Hamza, ti jeton sikur çdo çast e sheh të Dërguarin e Allahut **r** dhe ia dëgjon zërin e bekuar, apo jo?”*

Enesi **t**, u përgjigj:

“Po! Vallahi, shpresoj që edhe Ditën e Kiametit të takohem me të! Kur t’i shkoj pranë, do t’i them:



Bartholomeus Georgieviç, i cili ra rob i turqve në luftën e Mohaçit (1528) dhe, që më pas u la i lirë, ka shkruar një libër me titull: “Traditat dhe zakonet e turqve”. Në librin e tij, ai shprehet:

“...Gjykatësit myslimanë nuk bëjnë dallime dhe për të gjithë zbatojnë të njëjtën drejtësi. Kush vret, vritet. Kush grabit ose merr me zor diçka varet. Madje, edhe një jeniçer, i cili mori qumësht prej një gruaje pa i paguar paratë, u dënua sipas drejtësisë. Këtë e kam parë në Siri.”

1. Onur Bilge Kula, “Simboli turk në kulturën gjermane”, Ankara 1993, fq. 165.

Një person, e kishte ofenduar Imam Shabiun, i cili ishte nga dijetarët e tabiinëve. E megjithatë, ai, me mjaft butësi, iu përgjigj:

“Nëse ato që thua janë të vërteta, Allahu më faltë mua! Nëse janë të gabuara, të faltë ty!”



«O i Dërguari i Allahut, të erdhi shërbëtori yt i vogël!»

I shërbeva dhjetë vjet të Dërguarit të Allahut ﷺ, në Medinë. Atëherë unë isha një fëmijë i vogël dhe jo çdo punë që i kryeja, ishte ashtu siç e donte ai. Megjithatë, i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk ka bërë kurrë «uf!» për asgjë që kam bërë dhe, kurrë nuk më ka qortuar duke thënë: «Sikur ta kishe bërë kështu këtë punë!»» (Ahmed, III, 222. Veçanërisht shih. Buhari, Saum, 53, Menakib, 23; Muslim, Fedail, 82.)

Muauije ibn Hakem ؓ, rrëfen:

“Kur po falnim namaz pas të Dërguarit të Allahut ﷺ, dikush nga xhemati teshtiu. Unë menjëherë i thashë «Jerhamukallah!» (Allahu të mëshiroftë!). Xhemati filloi të më shikonte ters. Për këtë arsye thashë:

«O ç’më gjeti! Përse më shikoni ashtu?» Kësaj here ata filluan të rrahin gjunjët me duar. Kur e kuptova se ata po mundoheshin të më ndalonin së foluri, unë u nxeha, por prapë nuk fola.⁹⁷

Nëna dhe babai im i qofshin falë të Dërguarit të Allahut ﷺ. Unë nuk kam parë mësues më të mirë se ai, as para tij, e as pas Tij. Për Zotin, ai as nuk më qortoi, e as nuk më rrahu. Kur e fali namazin, me një gjuhë të butë më tha:

«Ky adhurim quhet namaz. Kur falet namaz, nuk fliten fjalë të kësaj bote, sepse namazi përbëhet nga këndimi i tesbihëve, tekbirëve dhe Kuranit.» Ose përdori shprehje të njëjta me këto.”

Pas kësaj, thashë:

«O i Dërguari i Allahut!

⁹⁷ Gjatë namazit nuk është e lejuar të merresh me punë të tjera përveç ibadetit. Mirëpo, sjelljet e sahabëve në këtë ngjarje duhen justifikuar. Pasi, atëherë Islami sapo kishte nisur të përhapej dhe njerëzit dita-ditës po mësonin edukatën e ibadetit.

Unë sapo jam bërë mysliman...»". (Muslim, Mesaxhid, 33.)

Ashtu sikurse të gjitha cilësitë, edhe butësia dhe toleranca kanë një kufi. Asnjëherë nuk duhet t'i nënshtrohesh padrejtësive apo të tolerosh shkeljen e ligjet hyjnore, në emër të butësisë dhe tolerancës. Kjo lloj sjellje, e cila konsiderohet si butësi gomari, është një sjellje mjaft e gabuar, sepse u jep kurajë dhe u shton dëshirën dashakeqësve për të bërë të këqija.


Mirësjellja (Mos lëndo dhe mos u lëndo)

Njeriu është krijesa më e nderuar dhe më e përsosur e Allahut të Madhëruar. Ndërsa zemra e tij, është vend-shikimi hyjnor. Nga kjo, kuptohet qartë se sa gjynah i rëndë është t'i thyesh zemrën qenies njerëzore.

Myslimani duhet të ketë një zemër delikate e të butë dhe nuk duhet të lëndojë askënd, sepse, besimtari që ka përkufizuar dhe ka dashur Resulullahu ﷺ, është njeriu, i cili shkon mirë me të gjithë dhe të gjithë shkojnë mirë me të.⁹⁸

Resulullahu ﷺ, e tregon kështu gjendjen e myslimanit:

"Mysliman i vërtetë është ai që prej gjuhës dhe dorës



*Omeri ؓ, ka
thënë:*

*"Tregohu i fortë,
pa ushtruar dhunë
dhe i butë, pa
treguar dobësi."*

*Kjo, sepse teprimi
në ashpërsi lind
urrejtje. Ndërsa
teprimi në
tolerancë dobëson
autoritetin. Suksesi
është i mundur
duke mbajtur
ekuilibrin mes
këtyre të dyjave.*

98. Shih. Ahmed, II, 400, V, 335.



“Nëse e dini kush ndodhet brenda kësaj foleje zemre, atëherë ç’është kjo sjellje e pahijshme që bëni para derës së asaj zemre? Budallai respekton xhaminë që është ndërtesë e njeriut, por zemrën e tij e thyen pa problem.”

(Mevlana)

së të cilit janë të sigurt myslimanët e tjerë. Ndërsa muhaxhir (emigrant) i vërtetë është ai që braktis ato që ka ndaluar Allahu.”

(Buhari, Iman, 4, 5, Rikak, 26; Muslim, Iman, 64 - 65.)

Mevlana, e shpjegon kështu vlerën e zemrës:

“Nëse je i zgjuar, bëj tavaf Qaben e zemrës, sepse kuptimi i vërtetë i Qabes që mendon se është e bërë prej dheut, është pikërisht zemra... Dije mirë se, nëse lëndon apo thyen një zemër që është vend-shikimi hyjnor, sevapi që do të fitosh, nuk mund ta shlyejë gjynahun e thyerjes së zemrës, edhe sikur të shkosh në këmbë deri në Qabe.”

“Zemra e rrënuar, së cilës ti nuk i jep vlerë as sa një fije kashte, është më lart edhe se Arshi, edhe se Kursia, edhe se Lehvi, edhe se Kalemi!.. Kurrë mos e përbuz zemrën, qoftë edhe e pavlerë, sepse edhe në atë gjendje, ajo është më e larta e të lartave. Zemra e rrënuar, është genia ku vështrohet Allahu. Sa i bekuar është ai shpirt që e rimëkëmb atë. Të rregullosh një zemër të thyer dyqind copash, tek Allahu, është më me vlerë se shumë vepra të mira... Hesht! Edhe sikur të kesh dyqind gjuhë në çdo qime, e të flasësh, zemra, kurrë nuk mund të shpjegohet.”

Shejh Sadi këshillon:

“Nëse e di që një lajm do ta lëndojë një zemër, atëherë hesht, le ta thotë dikush tjetër!”

Sa bukur janë shprehur njerëzit e urtë:

“Nuk ka më fatkeq se ai që lëndon njerëzit, sepse Ditën e Fatkeqësisë nuk i bëhet ndihmë askush.”

“Mos e rrëno gemin e trëndafilin në vjeshtë, që të mos privohesh nga bukuria e tij në pranverë!”

Junus Emre shprehet:

*Nëse një zemër ke thyer njëherë,
Jo ky namaz që fal!
Por edhe shtatëdhjetedy kombe të vijnë,
Nuk të pastrojnë fytyrë e duar!*

Sado i vështirë të jetë moslëndimi i të tjerëve, relativisht, kjo është në dorën e njeriut. Mirëpo, njeriu duhet edhe të mos lëndohet nga askush, gjë që është edhe më e vështirë, sepse nuk është e lehtë të komandosh dëshirat dhe zemrën.

Kur do të “mos lëndosh”, e bën gjuhën të hesht, mirëpo zemra vazhdon të ankohet në heshtje. Por, kur do të “mos lëndohesh”, bashkë me gjuhën, duhet të heshtësh edhe zemrën. Dhe, të arrish të heshtësh zemrën, është aftësi vetëm e besimtarëve të përsosur. Për rrjedhojë, nëse moslëndimi i të tjerëve është fillimi i rrugës, moslëndimi nga të tjerët, është fundi i saj. Mes këtyre të dyjave është një distancë e madhe që duhet kapërcyer.

Shkurtimisht, të bësh një jetë në paqe me adhurime dhe shërbime, duke shijuar kënaqësinë e madhe të besimit, pa lënduar askënd dhe pa u lënduar prej askujt, është një prej cilësive më të larta të moralit Islam.

Durimi

Durim, do të thotë të mos e humbësh ekuilibrin përballë situatave të ndryshueshme materiale dhe shpirtërore, të ruash maturinë, të tregosh tolerancë dhe të jesh i qëndrueshëm në rrugën që rrëfen mendja dhe feja.



“Gëzo zemra, sepse kjo është haxhi më i madh.

Një zemër, është më me vlerë sesa mijëra Qabe.

Qabeja është një ndërtesë që e ka bërë Ibrahim, i biri i Azerit.

Kurse zemra është vend-shikimi i Allahut, i cili është Xhelil dhe Ekber.”

(Molla Xhami)



**Zejd ibn Thabit ؓ ,
ka thënë:**

*“Kush nuk mund të
komandojë gjuhën
dhe zemrën, nuk
mund të ketë as
butësi!”*

Për shkak se përmban të gjitha bukuritë morale, vendi i durimit në fenë tonë, është shumë i lartë. Po ashtu, edhe një nga emrat e Zotit të Madhëruar është “es-Sabur”. Pra, Allahu i Madhëruar, i afatizon robërit e Tij dhe, brenda këtij afati kohor, Ai i furnizon edhe ata që tregohen mosmirënjohës ndaj Tij. Nëse Zoti ynë do të

hakmerrej menjëherë ndaj gjynahqarëve në këtë botë, atëherë kushedi si do të katandisej gjithësia!..

Durimi është gjysma e besimit, është çelësi i qetësisë dhe lumturisë. Aspekti tokësor i tij është dhimbje, por aspekti i botës tjetër, është një lumturi e madhe, sepse Allahu i Madhëruar është me ata që durojnë. Durimi është një virtyt i madh, që të çon drejt mirësive të Xhenetit. Po ashtu, për arsye se çdo lloj mirësie dhe përfitimi i lartë gjendet tek ky virtyt, tek të gjithë profetët dhe robërit e mirë të Allahut, e kanë bërë atë pjesë të karakterit të tyre.

Në Kuranin Famëlartë, durimi përmendet në mbi shtatëdhjetë vende. Në ajete të ndryshme, durimi jepet si këshillë për Profetin ﷺ dhe, në emër të tij, edhe për gjithë myslimanët. Disa nga këto ajete janë:

“O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni!” (Al-i Imran, 200.)

“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit.” (Bekare, 153.)

“...Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë!” (Zumer, 10.)

Ndërkohë Resulullahu ﷺ, në një hadith lidhur me llojet dhe virtytet e durimit, shprehet:

“Durimi është tre llojesh: Durimi ndaj fatkeqësive, durimi në devotshmëri (ndaj Allahut) dhe durimi ndaj gjynaheve (largohet prej tyre).

Kush i duron fatkeqësitë (pa u qarë) deri sa t’i hiqen, Allahu i shkruan atij (e ngre) treqind gradë, ku distanca midis dy gradëve është sa mes qiellit dhe Tokës.

Kush bën durim në bindjen ndaj Allahut, Ai i shkruan gjashtëqind gradë, ku distanca midis dy gradëve është sa mes Tokës dhe shtatë kate poshtë saj.

Dhe, kush bën durim ndaj një gjynahu, Allahu i shkruan nëntë-qind gradë, ku distanca midis dy gradëve është sa mes Tokës dhe Arshit të Allahut.” (Sujuti, el-Xhamiu’s-Sagir, II, 42; Dejlami, II, 416.)



Djali i Abdullah ibn Zubejrit ؓ, Amiri ؓ, kur ndihmonte dikë,

ndiqte një metodë shumë delikate për të mos e lënduar atë: Ai e vendoste qesen e parave pranë këpucëve të atyre që ndihmonte, kur ata ishin në sexhde, në mënyrë që ata ta ndjenin, dhe largohej prej aty pa u vënë re.

Kur e pyetën: “Përse nuk ua dërgon ndihmën pas ndonjë personi tjetër?”, ai u përgjigj:

“Nuk dua që ndonjë prej tyre, të ulë kokën kur të përballlet me personin që dërgoj, ose me mua!”

(Ibnu'l-Xheuzi, Sifat'u's-Safve, II, 411.)



Rruga e mesme dhe maturaia

Feja Islame urdhëron ndjekjen e një mesatareje, pa e tepruar dhe pa neglizhuar, në asnjë çështje fetare dhe të kësaj bote. Pra, këshillon të ndiqet rruga e mesme, duke e bërë gjithçka ashtu si duhet brenda krite-reve normale.

Allahu ynë i Madhëruar, e ka krijuar gjithësinë me një ekuilibër madhështor. Ndërsa në Kuranin Famëlartë urdhërohet kujdesi dhe ruajtja e këtij ekuilibri. Për rrjedhojë mënyra më e rëndësishme për të arritur mesataren, është të jetojmë në përputhje me urdhrat hyjnorë. Kur dilet jashtë kufijve të përcaktuar nga Allahu i Madhëruar, humbet ekuilibri dhe gjithçka shkon drejt kaosit dhe shkatërrimit. Në një ajet Kuranor urdhërohet:

“Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Balancën (për çdo gjë), që ju të mos e shkelni atë.” (Rrahman, 7- 8.)

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Puna më e mirë, është ajo që bëhet duke ruajtur ekuilibrat (pa e tepruar dhe pa neglizhuar).” (Bejhaki, Shuab, V, 261.)

Ajo që siguron vazhdimësinë e një pune, është ekuilibri (rruga e mesme), prej të cilit nëse largohesh, asaj pune i vjen fundi. Kjo, sepse kalimi në njërin ekstrem (teprimi) në tjetrin (neglizhimi), është i shpejtë. Lidhur me këtë çështje, ky hadith është shumë domethënës:

“Janë shkatërruar ata që e teprojnë me fjalë dhe vepra!” (Muslim, Ilim, 7.)

Shkurtimisht, një mysliman duhet të jetë i ekuilibruar në ndjenja, fjalë dhe sjellje.

I Dërguari i Allahut

ﷺ, ka thënë:

“Durim i vërtetë, është ai që tregohet në çastet e para të fatkeqësisë!”

(Buhari, Xhenaiz, 32.)

Një tjetër cilësi që pëlqen Allahu i Madhëruar, është edhe maturia, që do të thotë, të mos nxitohet gjatë kryerjes së një pune, të mendohet mirë për fillimin dhe fundin e punës që do bëhet dhe të veprohet me kujdes. Ky është një virtyt që minimizon mundësinë e gabimeve dhe e ruan njeriun nga një pendim i pado-bishëm.

Islami i jep rëndësi të madhe të vepruarit me kujdes dhe maturi, sepse gjërat që në shikim të parë duken të parëndësishme, në fund mund të shkaktojnë probleme të pariparueshme. Sa domethënës është ky shembull që na jep Mevlana në veprën “Mexhalisi Seb’a”:

“Kur një zog sheh një thërrime, kontrollon njëqind herë, duke parë para, mbrapa, djathtas e majtas, se mos ka ndonjë kurth. Për shkak se mendja e zogut mendon gjithmonë të keqen, frika e tij për jetën është më e madhe sesa dëshira për ushqim.”

Resulullahu ﷺ, duke lavdëruar një sahab të kujdesshëm e të matur, tha :

“Ti ke dy cilësi që Allahu i pëlqen: Je njeri i butë dhe i matur.” (Muslim, Iman, 25, 26; Ebu Daud, Edeb, 149; Tirmidhi, Birr, 66/2011.)

Sërish, Profeti ﷺ, është shprehur kështu:

“Maturia e ka burimin nga Allahu i Madhëruar, kurse nxitimi është prej shejtanit.” (Tirmidhi, Birr, 66/2011.)

Megjithatë, në punët për të cilat dihen mirë se janë të mbara, nxitimi është i domos-

Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Rruga e mesme, maturia dhe mbarësia në gjendje dhe vepra, janë një prej njëzetekatër pjesëve të profetësisë.”

(Ebu Daud, Edeb, 2/4776; Tirmidhi, Birr, 66/2010; Muvatta, Shaar, 17.)



I Dërguari i Allahut
ﷺ, ka thënë:

“Mikun duaje me masë, sepse një ditë mund të bëhet armiku yt. Edhe armikun urreje me masë, sepse një ditë mund të bëhet miku yt.”

(Tirmidhi, Birr, 60/1997.)

doshëm. Mirëpo, ky nxitim është i nevojshëm në momentin kur merret vendimi për një punë të mbarë. Përndryshe, të ngutesh gjatë kryerjes së asaj pune, duke mos treguar kujdesin e duhur, nuk është aspak e drejtë.

Trimëria

Trimëri, është forca e zemrës dhe guximi që tregohet përballë rreziqeve. Trimëri e vërtetë, është dorëzimi dhe nënshtrimi ndaj përcaktimit të Allahut të Madhëruar. Për rrjedhojë, myslimani që i beson përcaktimit hyjnor dhe i mbështetet Allahut, nuk i shkon kurrë burracakëria.

Një herë, Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Është e afërt koha kur popujt e huaj do t’ju sulmojnë si egërsirat e uritura drejt ushqimit.” E pyetën:

“A është kjo për shkak se do te jemi pak, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha:

“Jo, ju do të jeni të shumtë, por atëherë do të jeni të pavlerë si shkuma e detit. Allahu do të nxjerrë nga zemrat e armiqve tuaj frikën prej jush, e do të fusë dobësinë në zemrat tuaja.” Kur u pyet:

“Ç’është dobësia, o i Dërguari i Allahut?”, ai u përgjigj:

“Dashuria ndaj dynjasë dhe frika nga vdekja!” (Ebu Daud, Melahim 5/4297.)

Është e pamundur të imagjinohet një njeri më i guximshëm se Profeti ynë (s.a.s). E në fakt, në jetën e tij nuk është parë asnjëherë të ketë bërë ndonjë veprim të papërshtatshëm për shkak të frikës apo



panikut. Përkundrazi, në sajë të durimit dhe qëndresës së tij përballë situatave tejet të jashtëzakonshme, ai është bërë shembull për mbarë njerëzimin.

Aliu **ﺕ**, ka thënë:

*“Ndërkohë që lufta në Bedr vazhdonte me gjithë ashpërsinë e saj, ndonjëherë, ne fshiheshim pas Profetit **ﷺ**. Ai ishte më i guximshmi ndër të gjithë ne dhe ai gjendej më afër radhëve të armikut.”* (Ahmed, I, 86.)



Ai luftonte gjithnjë në krye, me qëllim që feja e Allahut të ishte më e larta. Në betejën e Hunejnit, në fillim u përjetua një shpërbërje në radhët e ushtrisë myslimane. Mirëpo, Profeti **ﷺ**, nuk u lëkund për asnjë moment. Ai përparonte vazhdimisht me kafshën mbi të cilën kishte hipur, duke i shtuar guximin sahabëve dhe, si përfundim, u arrit fitorja me ndihmën e Allahut.⁹⁹

Aliu **ﺕ**, ka thënë:

“Nuk njoh asnjë nga muhaxhirët që të mos ketë emigruar fshehtazi, me përjashtim të Omer ibn Hattabit. Kur do të nisej për të emigruar, ai ngjeshi shpatën, hodhi harkun supit, mori në dorë heshtën dhe shigjetat dhe shkoi në Qabe. Në atë kohë, paria e idhujtarëve mekas ndodheshin pranë Qabes. Pasi e bëri tavaf shtatë herë rreth Qabes, u afrua tek ata dhe u tha:

«Ja, edhe unë po shkoj në Medinë! Ata që duan t’i lënë nënat të qajnë, gratë të veja e fëmijët jetimë, të vijnë pas meje dhe të më dalin para pas kësaj lugine!»

Omeri **ﺕ**, ka thënë:

“Për sa kohë që nuk ju shoh, më i dashuri për mua ndër ju, është ai që ka emrin më të bukur. Ndërsa kur ju shoh, më i dashuri prej jush, është ai me moralin më të mirë. E, kur t’ju provoj, më i dashuri prej jush, është ai më fjaldrejtj.”

99. Shih. Muslim, Xhihad, 76 - 81.

Bera t , ka thënë:

“Vallahi, kur fillonte të ashpërsohej lufta, ne strehoheshim pas të Dërguarit të Allahut r . Më trimi prej nesh, ishte ai që mund të qëndronte në një rresht me Resulullahun r .”

(Muslim, Xhihad, 79.)

Mirëpo, askush nuk e ndoqi dot pas!” (Ibni Esir, Usdu'l-Gabe, IV, 152-153.)

Ummu Umare C, ishte një nga gratë sahabe që mori pjesë në betejën e Uhudit dhe luftonte kudër armikut me harkun dhe shigjetat e saj. Kur Resulullahu r , u kthye në Medinë pas betejës, tha:

“Gjatë luftës, sa herë që hidhja shikimin majtas a djathtas, shikoja gjithnjë Ummu Umaren që luftonte pranë meje.” (Ibni Haxher, el-Isabe, IV, 479.)

Me pak fjalë, në sajë të mbështetjes tek Allahu, besimtarët nuk frikësohen nga asgjë tjetër përveç Allahut.¹⁰⁰ Ata i zbatojnë urdhrat e Allahut me trimëri dhe qëndresë të fortë. Po ashtu, duke e përdorur trimërinë e tyre me zgjuarsi dhe urtësi, ata dinë se ku dhe si të veprojnë.

RUAJTJA NGA MORALI I KEQ

Cilësitë e kundërta me moralin e bukur, formojnë moralin e keq. Aty ku nuk gjendet drejtësia, bujaria dhe besnikëria, aty gjenden tirania, padrejtësia, shpërdorimi, koprracia dhe tradhtia.

Ruajtja nga morali i keq, e çon njeriun në shpëtimin e përjetshëm. Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë!” (Shems, 9.)

Resulullahu r , i cili përfaqëson majat njerëzore në aspektin e moralit të bukur, ka thënë:

“Dy cilësi nuk mund të gjenden

100. Shih. Ahzab, 39.



kurrë tek një besimtar i vërtetë: Koprracia dhe morali e shëmtuar!” (Tirmidhi, Birr, 41/1962.)

“Allahu është Bujar e Bamirës, prandaj e do fort bujarinë. Po ashtu, Ai e do edhe moralin e lartë dhe nuk pëlqen aspak moralin e keq.” (Sujuti, el-Xhamius-Sagir, I, 60.)

Nisur nga kjo, është e domosdoshme të qëndrojmë larg nga çdo cilësi e keqe që nuk e pëlqen Allahu i Madhëruar dhe e lëndon të Dërguarin e Tij ﷺ. Disa prej tyre mund t’i radhisim në këtë mënyrë:

Lakmia dhe smira

Lakmia dhe smira, janë burimi i të gjitha gjynaheve. Në një hadith fisnik thuhet:

“Tri gjëra janë burimi i të gjitha gjynaheve dhe, prej tyre duhet të ruheni patjetër:

1. *Arroganca, që e bëri Iblisin të mos i bënte sexhde Ademit ﷺ.*

2. *Lakmia, që e bëri Ademin ﷺ, të hante nga pema e ndaluar në Xhenet.*

3. *Smira, që e bëri djalin e Ademit ﷺ, Kabilin, të vrasë të vëllain e vet, Habilin.” (Sujuti, el-Xhamius-Sagir, I, 101.)*

Smira, nënkupton mospëlqimin e njeriut ndaj caktimit të Allahut për të, gjë e cila konsiderohet si një guxim i tepruar, siç është kundërshtimi i vullnetit të Allahut. Mirëpo, Allahu i Madhëruar, i Cili i do shumë robërit e Tij, çdokujt i ka dhënë begati të ndryshme. Për rrjedhojë, në vend që njeriu të smirojë



Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Beto hem në Allahun, me vullnetin e të Cilit jetoj, se do të dëshiroja të luftoj në rrugë të Allahut, të bija dëshmor në rrugën e Tij, të ringjallesha për të rënë dëshmor dhe prapë të ringjallesha për të rënë përsëri dëshmor!..”

(Muslim, Imare, 103.)



*“Guximi, e shpie
njeriun në triumf,
pavendosmëria, në
rrezik, kurse frika
në vdekje.”*

(Sulltan Javuz Selimi)

mirësitë që Allahu u ka dhuruar të tjerëve, ai duhet të falënderojë për mirësitë që i janë dhënë vetë atij. Kjo, sepse ka shumë njerëz, të cilët janë të privuar edhe nga ato mirësi që kemi ne. Për këtë arsye, kurimi i vetëm i lakmisë dhe smirës, është i mundur vetëm nëse dorëzimi ndaj caktimit të Allahut dhe mjaftueshmëria me mirësitë e arritura, mbështillen

me paqen shpirtërore. I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Mjaftueshmëria është një thesar i pashterur.” (Dejlami, Musned, III, 236/4699.)

Të meditosh siç duhet mbi madhësitinë dhe begatitë hyjnore, i fal paqe zemrës së besimtarit. Kur shohim gjallesa si gjarpri, akrepi apo breshka, duhet të mendojmë: *“Edhe unë mund të isha krijuar kështu!”* Në sajë të këtij meditimi, ne bëhemi më të vetëdijshëm ndaj rëndësisë së mirësive të Allahut. Për shembull, kush do të pranonte nëse i thoshin: *“M’i jep sytë, të jap botën...”?!* Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Nëse do t’i numëronit mirësitë e Allahut, nuk do të mund t’i llogarisnit ato!..” (Nahl, 18.). Ndërsa mirësitë më të mëdha që kemi, janë:

- Ndër të gjitha krijesat, ne jemi krijuar si njerëz.
- Kurani Famëlartë është zbritur dhe na drejtohet neve.

- Jemi populli i Profetit të fundit të Allahut, Muhamedit ﷺ.

Shejtani është krijesa e parë, tek i cili është vërejtur smira. Për shkak se ishte krijuar nga zjarri, ai e konsideronte veten më lart se Ademi, i cili u krijua nga dheu. Prandaj, ai e kundërshtoi Allahun e Madhëruar.

Thuhet se, kur Musai U , po ngjitej në malin Tur, ishte takuar me një të moshuar që siguronte jetesën duke bartur dru në kurriz. I moshuari iu drejtua Musait U dhe iu lut:

“Një fqinji im ka gomar, me të cilin i bart drutë. Kurse unë i bart në shpinë edhe pse jam në këtë moshë. Lutju Allahut të Madhëruar të më dhurojë edhe mua një gomar!”

Kur po zbriste nga mali Tur, Musai U , i ktheu këtë përgjigje të moshuarit:

“Allahu i Madhëruar do të të dhurojë një gomar. Mirëpo, komshiut tënd do t’i dhurojë edhe një gomar tjetër!..”

Kur e dëgjoi këtë, plaku u hodh e tha:

“Jo, nuk e dua!.. Mos të më japë as mua, e as atij...”

Shembuj të tillë si ky, që tregojnë sesa prirje e keqe dhe shqetësuese është smira, ka me shumicë. Por në fakt, dëmi kryesor i smirës, është për smirëziun. E kjo i ngjan atij që synon të godasë tjetrin me gurë, e i bie vetes.

Mirëpo, zilia nuk është e tillë, sepse ajo ka të bëjë më tepër me aftësitë shpirtërore. I Dërguari i Allahut U , ka thënë:

“Vetëm këta dy lloj njerëzish mund të kihen zili: Njëri



Resulullahu U , ka thënë:

“Kurrë mos kini smirë, sepse smira i ha të mirat e njeriut, ashtu siç ha zjarri drutë.”

(Ebu Daud, Edeb, 44; Ibni Maxhe, Zuhd, 22.)



**Ahmed ibn Hanbeli
ka thënë:**

*“Njeriut i mjafton
pasuria e pakët,
por jo pasuria e
shumtë!”*

**Pasuria më e
bukur është
mjaftueshmëria.
Njeriun nuk e bën
të pasur pasuria,
por mjaftueshmëria
që tregon.**

*është ai, të cilit Allahu i ka dhënë
Kuranin, e ai angazhohet dhe
punon me të ditë e natë. Tjetri
është ai, të cilit Allahu i ka dhënë
pasuri, e ai e dhuron atë ditë e
natë.”* (Muslim, Musafirin, 266, 267. shih.
Buhari, Temenni, 5; Teuhid, 45.)

Përgojimi

Përgojim, është të flasësh pas shpinës së një vëllai mysliman, në lidhje me një të metë, të cilën sikur ta dëgjonte ai, do të mërztetej ose do të turpërohej. Po ashtu, edhe shprehja me shenja, nënkuptimet, aludimet dhe imitimet bëjnë pjesë në përgojim.

Një ditë, Resulullahu ﷺ, pyeti:

“A e dini çfarë është përgojimi?”

Sahabët thanë:

“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë!”

Atëherë, Resulullahu ﷺ, tha:

“Përgojim, është përmendja e vëllait të fesë me diçka që ai nuk do ta pëlqente.”

Sahabët pyetën:

“Po nëse vëllai e ka vërtet atë të metë që përmendet?”

Resulullahu ﷺ, tha:

“Nëse ajo me të cilën e përmend është vërtet tek ai, e ke përgojuar. Por, nëse nuk e ka, atëherë ke shpifur!” (Muslim, Birr, 70; Ebu Daud, Edeb, 40/4874.)

Allahu i Madhëruar i ka dhënë njeriut një vlerë të tillë, sa që e ka shpallur krim të rëndë edhe përmendjen e të metave në mungesë të tij.

Përgojimi është një gjynah i madh që shkatërron vëllazërinë Islame dhe që vret shpirtin e vëllazërisë

dhe bashkimit, duke shpërndarë helmin e urrejtjes dhe armiqësisë në zemra. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Mjerë për çdo përqeshës e shpifës!” (Humeze, 1.)

Fudajl Ibn Ijadi ka thënë:

“Aty ku hyn përgojimi, del e ikën vëllazëria.”

Përvoja ka dëshmuar se, ata që e diskreditojnë vëllain e tyre në fe për shkak të ndonjë të mete apo gabimi, pa kaluar shumë fillojnë e bëjnë edhe vetë atë gabim. Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Kush e diskrediton vëllain e fesë për shkak të ndonjë gjynahu, nuk vdes pa e bërë edhe vetë atë gjynah!” (Tirmidhi, Kijamet, 53/2505.)

Në themel të përgojimit gjenden mendjemadhësia, arroganca, pëlqimi i vetes, nënçmimi i robërve të Allahut, smira, urrejtja dhe shumë vese të tjera të këqija. Dhe kjo mjafton për të treguar se në çfarë gjendjeje të mjeruar është një zemër që nuk arrin të shpëtojë dot nga vesi i përgojimit.

Zemërimi

Zemërimi është një cilësi e rrezikshme që mund ta mplakë e ta konsumojë njeriun në mënyrë të menjëhershme. Ajo është një gjendje që të verbon mendjen dhe zemrën, të prish ekuilibrin dhe të shpie drejt çmendurisë. Këtë e tregon edhe fakti se, shumica e njerëzve që mbushin burgjet, janë pre e një zemërimi momental.

Bota e brendshme e njerëzve të zemëruar, është e mbushur

“Jeta e materialistit, është si të pish ujë deti. Sa më shumë të pish, aq më shumë etesh, e sa më shumë të etesh, aq më shumë do pish.”

(Muhjiddin Arabi)



“...Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë!..”

(Huxhurat, 12.)



me “urrejtje, hakmarrje, fyerje, grindje dhe vrasje”.

Kapitulli i zemërimit në librin e jetës, është një histori fatkeqësie. Mënyra e shpëtimit nga ky rrezik fatal, është ruajtja e ekuilibrit dhe qetësisë në momentet e zemërimit, duke zgjedhur vëllazërinë, faljen dhe durimin.

Një ditë, Ebu Derda **ؓ**, i tha Resulullahut **ؐ**:

“Më mëso diçka që do të më çojë në Xhenet!”

Profeti **ؐ**, i tha:

“Mos u zemëro!” (Buhari, Edeb, 76; Tirmidhi, Birr, 73.)

Ndërsa në një tjetër hadith, Resulullahu **ؐ**, është shprehur:

“Bëni kujdes! Ka njerëz që zemërohen ngadalë dhe tërhiqen shpejt nga zemërimi i tyre. Ka edhe prej atyre, të cilët zemërohen shpejt dhe qetësohen shpejt. Këto dy veçori ekuilibrojnë njëra-tjetrën. Për rrjedhojë, s’ka përse të lavdërohen apo të dënohen (këto sjellje).

Kujdes! Ka edhe njerëz që zemërohen shpejt dhe qetësohen me vonesë. Më i miri prej tyre, është ai që zemërohet vonë dhe qetësohet shpejt. Kurse më i keqi prej tyre, është ai që zemërohet shpejt dhe qetësohet vonë.” (Tirmidhi, Fiten, 26/2191; Ibni Maxhe, Fiten, 18; Hakim, IV, 551/8543; Bejhaki, Shuab, VI, 309.)

Zemërimi, është dobësia njerëzore më e rëndësishme, që ia lehtëson punën shejtanit. Kur njeriu zemërohet,

shejtani luan me të, siç luan një fëmijë me top.

Njeriu më i mençur është ai që kontrollon zemë-

rimin e tij. Pra, zemërimi është armiku më i madh i mendjes. Ndaj dhe është thënë:

“Kur vjen zemërimi erren sytë, kur ikën ai skuqet fytyra!”

Resulullahu ﷺ, zemërohej vetëm atëherë kur cenohesh ndonjë e drejtë dhe këmbëngulej në të. Por, pasi vinte në vend drejtësinë, qetësohej. Ai nuk zemërohej asnjëherë dhe nuk debatonte me askënd për veten e tij.

Lidhur me njerëzit që gëlltisnin zemërimin dhe i falin të tjerët, Allahu i Madhëruar ka thënë:

“(Ata) të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.” (Al-i Imran, 134.)

Resulullahu ﷺ, e këshillon kështu njeriun e zemëruar:

“Kur dikush prej jush të zemërohet, të ulet, nëse është në këmbë! Nëse i kalon zemërimi, s’ka më mirë, e nëse jo, atëherë le të shtrihet!” (Ebu Daud, Edeb, 3/4782; Ahmed, V, 152.)

Ebu Vail rrëfen:

“Një ditë, shkuam tek Urve ibn Muhamed. Një njeri që gjendej aty, tha disa fjalë, të cilat e nevrikosën Urven. Për këtë arsye, Urve u ngrit, mori abdes, erdhi pranë nesh dhe na tha se Resulullahu ﷺ, ka thënë:

“Zemërimi është prej shejtanit, e ai është krijuar prej zjarrit. Zjarri fiket me ujë. Prandaj, kur dikush prej jush të zemërohet, le të marrë abdes!” (Ebu Daud, Edeb, 3/4784; Ahmed, IV, 226.)

Këtu, duhet të theksojmë se, zemërimi, është i

Aishja C,
shprehet:

“Sa e çuditshme është që njeriu lan gojën pas ushqimit hallall dhe jo pasi përdor fjalë të këqija për vëllain e tij në fe!”

(Ahmed ibn Hanbel, Zuhd, I, 59.)





I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

*“Bëni kujdes!
Zemërimi është një
zjarr në zemrën e
njeriut. A nuk e shihni
se si i skuqen sytë dhe i
fryhen damarët e qafës
njeriut të zemëruar?
Kush e ndjen se po
fillon të zemërohet,
të ulet ose të shtrihet
menjëherë!”*

*(Tirmidhi, Fiten, 26/2191; Ibn-i
Maxhe, Fiten, 18.)*

dënueshëm kur vjen prej shkaqeve egoiste dhe djallëzore. Por, nëse ai vjen për shkaqe hyjnore, pra, vetëm për hir të Allahut, atëherë ky lloj zemërimi konsiderohet virtyt. Aq sa e rëndësishme është të mposhtësh zemërimin për të fituar kënaqësinë e Allahut, po aq e rëndësishme është edhe të zemërohesh për hir të Allahut.

Dëshira për luks dhe shpërdorimi

Njeriu duhet të kontrollojë veten dhe të bëjë kujdes të mos e sforcojë buxhetin e tij për të realizuar çdo dëshirë që i shkon në mendje. Pasi kjo, bën që njeriu të ngarkohet me një peshë tejet të rëndë e të pësojë shqetësime dhe probleme. Në sajë të kartave të kreditit, të cilat janë përhapur shumë në ditët tona, njeriu mund të marrë lehtë gjithçka që dëshiron. Shumë njerëz të mashtruar nga kjo, po shkatërrohen duke rënë në vorbullën e borxheve dhe interesave bankare, për shkak të shpenzimeve pa kriter që kanë bërë. Për rrjedhojë, shumë çerdhe të lumtura, janë shkatërruar, ose janë drejt shkatërrimit vetëm për këtë arsye.

Edhe sikur të ketë gjendje të mirë ekonomike, njeriu nuk duhet të shpërdorojë, sepse për çdo mirësi do të jepet llogari. Myslimani që është i vetëdijshëm për këtë, nuk shpenzon pa pasur nevojë, por përpiqet të jetojë në mënyrë modeste dhe mundësitë që zotëron, i shpenzon në rrugë të Allahut.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Jepuni të afërmve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepruar. Dorëshpuarit me të vërtetë, janë vëllezërit e shejtanit dhe, shetjani është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.”

(Isra, 26-27.)

Sulltan Javuz Selimi bënte një jetë mjaft të thjeshtë. Çdo vakt hante vetëm një lloj ushqimi dhe përdorte pjata druri. Ai jetonte në këtë mënyrë që të ruante veten nga kënaqësitë e kësaj bote. Një ditë, kur pa se i biri, Sulejmani (Kanuni), kishte veshur një rrobë shumë të stolisur, iu drejtua me këto fjalë:

“Biri im, qenke stolisur aq shumë, saqë nuk i paska lënë nënës të veshë gjë!..”

Ndërsa atyre që e pyesnin se, përse vishej kaq thjeshtë, u përgjigjej:

“Të vishesh me rroba të bukura dhe të stolisura, nuk është asgjë tjetër veçse një vështirësi. Përse ta durojmë kot një vështirësi të tillë?”

Ai e vishte një rrobë, derisa ajo të vjetërsohej. Po kështu vepronte edhe paria e shtetit, duke marrë shembull prej tij.

Një herë, mbërriti lajmi se në Stamboll, do të vinte i dërguari i Venedikut. Për këtë arsye, vezirët (ministrat), ndjenë nevojën të ndërrojnë rrobat që u ishin vjetërsuar shumë dhe, këtë nevojë, ia bënë të ditur Sulltanit, i cili ua pranoi kërkesën.

Ditën që do të vinte i dërguari i Venedikut, të gjithë vezirët dolën para Sulltanit me rrobat e reja. Mirëpo, u habitën shumë

Ashtu siç jep frymën e fundit një gjallesë kur bie në zjarr, ashtu jep shpirt edhe mendja, kur zjarri i zemërimit bie në zemër.





Omeri † , ka thënë:

“Kur Allahu të na japë me bollëk, kujdesuni për veten dhe vishuni mirë (vishuni pastër, pa kaluar në shpërdorim)!”

(Muvatta', Libas, 3.)

nga ajo që po u shihnin sytë, sepse Sulltani kishte veshur po atë rrobë të vjetër si më parë. Ai ishte ulur në fronin e tij, kishte nxjerrë shpatën e mprehtë nga këllëfi dhe e kishte vendosur në basamakun e fronit. Rrezet e dritës që vinin nga dritarja, binin mbi shpatën, e cila të verbonte sytë nga shkëlqimi.

Pasi përfundoi takimi dhe i dërguari doli, Sulltan Javuzi i tha sadrazamit (kryeministrit):

“Pasha! Arrije të dërguarin dhe pyete si iu dukëm?”

Pak më vonë, sadrazami erdhi dhe përcolli përshtypjen e të dërguarit:

“Madhëri! I dërguari tha: «Vezullimi i shpatës m'i verboi aq shumë sytë, sa nuk munda ta shohë fare Sulltanin...»

Sulltani buzëqeshi dhe, duke i treguar shpatën me gishtin tregues, tha:

“Për sa kohë që shpata jonë të jetë e mprehtë, syri i armikut do të shohë vetëm atë, e jo neve! Mirëpo, Allahu na ruajt, nëse një ditë shpata jonë nuk do të presë dhe nuk do të shkëlqejë, atëherë, armiqtë tanë, do të na shohin më nënçmim dhe do t'u duket vetja më superiorë!..”

Këto ideale, e bënë Perandorinë Osmane një shtet që sundonte botën. Mirëpo, me kalimin e kohës, kur u dhanë pas kënaqësive të kësaj bote, ruajtja e kufijve dhe pasurisë u vështirësua shumë. Me humbjen e kësaj force shpirtërore që e mbante shtetin lart, në plan të parë dolën argëtimet dhe u cenua shpirti luftarak. Luksi dhe shpërdorimi u shtuan aq shumë, saqë për

njëfarë kohe, një bulbe tulipani shitej njëmijë monedha floriri. Në këtë mënyrë, filloi gara e luksit me shtetet perëndimore, duke ndryshuar edhe fatin e një shteti të madh. Për rrjedhojë, përveç sarajit të Topkapës, i cili është shëmbëlltyrë e modestisë dhe finesës, të gjithë sarajet e tjerë luksozë, janë ndërtuar gjatë viteve të fundit të Perandorisë Osmane.

Zgjedhja e Modelit të Gabuar

Për nga natyra, njeriu është i prirë të marrë shembull njerëzit që admiron dhe t'i imitojë ata sipas aftësisë që ka. Veçanërisht, në periudhën e rinisë, kur ndërtohet karakteri dhe personaliteti, kjo cilësi ka një rol jetik. Pra, të arrish të zgjedhësh dhe të ndjekësh shembujt e duhur, është si të gjesh çelësin e lumturisë së përjetshme.

Personalitetet që përbëjnë shembullin më ideal për njeriun, padyshim që janë profetët dhe njerëzit e devotshëm që ecin në gjurmët e tyre. Kjo, sepse profetët, të cilët mbështeten në shpalljen hyjnore, janë udhërrëfyes që kanë ardhur duke përforsuar njëri-tjetrin. Kurse filozofët, të cilët synojnë t'i tregojnë rrugën njerëzve dhe veprojnë vetëm sipas mendjes së tyre, kanë ardhur duke përgënjeshtuar dhe shkatërruar sistemin e mendimit të njëri-

Bujaria dhe sakrificia, janë pjesë e moralit të lartë që lëvdon Islami. Prandaj, të gjithë duhet të pajisen me këtë lloj morali me aq sa kanë mundësi, duke sakrifikuar qoftë edhe pak nga rehatia dhe komforti personal, dekori i shtëpive dhe shpenzimet ditore. Të mendosh vetëm komoditetin personal, pa e vrarë mendjen për të tjerët, pra, të jesh indiferent ndaj njerëzve përreth, nuk mund të jetë morali i një myslimani.





Ideali i brezit të sahabëve, ishte pajisja me moralin e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Për këtë arsye, ajo shoqëri jetonte me modesti dhe thjeshtësi. Shpërdorimi, si konsumi i tepruar, grykësia, luksi dhe pompoziteti, ishte një stil jetese që brezi i sahabëve nuk e njihte. Të pasurit e tyre ishin falënderues dhe bujarë, ndërsa të varfrit e tyre, ishin durimtarë dhe mirënjohës.

tjetrit. Për rrjedhojë, ata nuk kanë arritur të udhëzojnë dot, as veten e as shoqërinë.

“Mos dëgjoni urdhrat e atyre që e teprojnë në të keqe, të cilët bëjnë ngatërresa në Tokë e nuk sjellin përmirësim!” (Shuara, 151-152.)

Për shembull, megjithëse Aristoteli ka vendosur disa rregulla lidhur me filozofinë e moralit, nuk mund të gjejmë asnjë njeri të vetëm, i cili ka mundur të arrijë lumturinë duke zbatuar mendimet e tij. Kjo, sepse zemrat e filozofëve nuk janë rafinuar, egot e tyre nuk janë pastruar dhe mendimet e sjelljet e tyre nuk janë pjekur me ndihmën e veçantë të shpalljes hyjnore.

Ndërkohë që as filozofët që e kanë kaluar tërë jetën me mendim, nuk kanë mundur të udhëzojnë njerëzit, si mund të jenë udhërrëfyes për rininë, yjet e kinemasë, artistët, sportistët dhe personalitete të tjerë, të cilët e kanë kalbur jetën e tyre në botën e qejfit dhe kënaqësive?! Vallë, ku të shpie rruga e brezave që janë ndjekës të tyre?!

Në krye të personaliteteve që një i ri mysliman duhet të ketë si udhërrëfyes në jetën e tij, vjen i Dërguari i Allahut ﷺ. Më pas vijnë sahabët dhe pas tyre robërit e devotshëm të Allahut...

E në fakt, që nga koha e Ebu Xhehlit, e gjer më sot, shumë femohues janë detyruar të pohojnë personalitetin madhështor të Profetit ﷺ.

Për shembull, Michael Hart, shkencëtari amerikan, i cili në vitin 1979 bëri një studim lidhur me 100 njerëzit me ndikim më të madh në botë, regjistroi në kompjuter aftësitë, përpjekjet, arritjet dhe sukseset e nje-

rëzve të mëdhenj. Pas një pune shumë mujore, në bazë të informacioneve të regjistruara, kompjuteri zgjodhi personalitetin më të madh të botës: Profetin Muhamed ﷺ ...

Pas këtij studimi, revista franceze *Le Point*, e shpalli Muhamedin ﷺ, “**njeriun e vitit**” 1979.

Kur gazetat e datës 29 Dhjetor 1979 bënë këtë lajm, si arsyetim të këtij përfundimi shkruan:

“Megjithëse Muhamedi jetoi mes viteve 571- 632, ndikimi i tij në botë po rritet si ortek dhe me miliona njerëz po ecin ende në rrugën që ka treguar ai.” (Revista Zafer 97/3-8.)

E në fakt, të ecësh në rrugën që ka treguar ai, është dera e vetme e paqes, lumturisë, mëshirës dhe shpëtimit për njeriun...



Orientimi drejt luksit dhe shpërdorimit, shkakton degjenerimin e shoqërive, duke i çuar ato drejt fatkeqësive të mëdha. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar na ka ndaluar të ndjekim ata që kanë shkelur kufijtë dhe janë kapluar nga çmenduria e shpërdorimit:

PËRFUNDIM

*“O njeri i mençur,
pasuria e një
populli nuk është
paraja, argjendi,
kumashi dhe floriri.
Pasuria e tij e
vërtetë, janë fëmijët
e fortë, të shkathët
dhe punëtorë, të
cilët kanë mendje
të gjallë dhe të
shëndetshme.”*

(Muhamed Ikbāl)

Rinia ka një rëndësi mjaft të veçantë për jetën e popujve, sepse ajo është e ardhmja e çdo shoqërie dhe burimi më i rëndësishëm i fuqisë. Çdo shoqëri, që dëshiron të marrë nën kontroll të ardhmen e vet dhe të ruajë vlerat e veta kombëtare e shpirtërore, duhet të edukojë gjenerata me dije, edukatë dhe karakter të fortë. Vetëm shoqëri të tilla mund të shikojnë me shpresë drejt së ardhmes.

Përndryshe, ato shoqëri që neglizhojnë brezat e rinj, që nuk i kushtojnë vëmendje arsimimit dhe edukimit të tyre, që ushqejnë vetëm trurin dhe trupin e tyre, duke i lënë të uritur në zemër dhe në shpirt, zhduken nga arena e historisë mes gjakut dhe lotëve.

Është dëshmuar historikisht, se një nga themelet solide që ka mbajtur në këmbë paraardhësit tanë, Osmanët, është pajisja e brezave të rinj me entuziazmin dhe dashurinë e besimit.

Veçanërisht, shehzadet (princat) që do të bëheshin sulltanët e së ardhmes, kanë marrë një edukim special. Sulltanët, jeta e të cilëve u kalonte sa në një luftë në tjetrën, kanë marrë përballë shehzadet dhe kanë vendosur në mendje e tyre të reja,



themelet e një shteti që do të sundonte me shekuj të tërë. Njëri prej tyre, ka qenë Ertugrul Gazi, i cili e ka këshilluar kështu djalin e tij, Osmanin:

"Shih, o bir!

Mua më lëndo, por Sheh Edebalin jo! Ai është dielli shpirtëror i fisit tonë. Peshorja e tij nuk gabon asnjë dërhëm!

Kundërshtomë mua, por jo atë! Nëse më del kundër mua, hidhërohem e prekem. Por, nëse i del kundër atij, sytë e mi s'të shohin më, e, edhe nëse të shohin, ato nuk të vërejnë!

Këto fjalë nuk janë për të mirën e Edebalit, por për të mirën tënde! Prandaj konsideroi këto fjalë si amanetin tim!"

Ndërsa këshillat e Shejh Edebalit drejtuar Osman Gazit janë këto:

"O bir! Këtej e tutje, ndarja na takon neve, bashkimi ty; plogështia, neve, e qortimi, inkurajimi dhe edukimi, ty!..."

"O bir! Je i fortë, i fuqishëm, i mençur dhe i gojës... Por, nëse nuk e di, ku dhe si t'i përdorësh këto, shkapërderdhesh e humbet me flladin e mëngjesit... Zemërimi dhe egoja bëhen bashkë, e ta mposhtin mendjen. Prandaj duhet të jesh gjithmonë i duruar, i vendosur dhe i vullnetshëm!..."

Nuk duhet të jetë e vështirë të mendohet e ardhmja e një të riu që është rritur me këshilla të tilla. Për rrjedhojë, ai djalosh, prej një bejliku që përbëhej vetëm nga katërqind kalorës, - me vullnetin e Allahut- ndërtoi një shtet madhështor.

Një tjetër djalosh, që rrallë mund të haset në histori, që me çlirimimin e Stambollit ka mbyllur një



"...Respektoji, shpërbleji dhe bëju mirësi dijetarëve të mirë e të vërtetshëm që i japin forcë shpirtërore shtetit. Nëse dëgjon se në një vend tjetër ndodhet një dijetar, një i urtë apo njeri i devotshëm, ftoje në vendin tënd me delikatesë dhe respekt, me qëllim që punët e fesë dhe shtetit, të jenë në rrugën e duhur në sajë të begatisë dhe ndihmës së tyre!"

(Këshillat e Osman Gazit ndaj të birit, Orhan Gazit)

Sulltan Mehmet Fatihu ishte ende 14 vjeç. Një mesnatë, kur mësuesi i tij po shëtiste nëpër shkollë, vëren se në dhomën e Mehmetit kishte ende dritë. Ai hyn në dhomën e tij me kureshtjen se, “vallë, ç’po bën shehzadeja në këtë orë?” Ai sheh një sërë dokumentesh mbi tryezën e tij: Planet e çlirimit të Stambollit... Kështu pra, shehzade Mehmeti, që në atë moshë vriste mendjen se: “Si mund ta çliroj Stambollin? Cila ishte enigma e mureve të pakapërcyeshme deri në atë kohë dhe si mund t’i kapërcej ato?”



epokë dhe ka filluar një tjetër, është Sulltan Mehmet Fatihu. Idealet, entuziazmi dhe përpjekjet e tij që në vogëli, ishin treguesit e parë që parashikonin se sa njeri i madh do të bëhej. Ndaj dhe babai i tij, Muradi II, i cili i kishte vërejtur këto aftësi dhe prirje të tij, ka shprehur dy herë gatishmërinë e vet që t’ia linte fronin, edhe pse Mehmeti ishte ende shumë i ri në moshë.

Një ditë, shehzade Mehmeti, pa të atin në kopshtin e sarajit dhe, pasi e pyeti për shëndetin dhe punën, fillon të bisedojë me të. Gjatë kësaj bisede, i ati i jep këto këshilla:

“Biri im! Dije mirë se, vazhdimësia e çfarëdo gjëje, nuk është e mundur vetëm me dhunë dhe egërsi, me shpatë dhe forcën shtypëse. Lidhur me këtë çështje, e rëndësishme është të kesh një zemër të mbushur me besim, mençuri, maturi, durim, largpamësi dhe qëndresë vetëmohuese ndaj sprovave tejet të vështira dhe përvojën, e cila përfitohet si rezultat i të gjitha këtyre. Mënyra e parë, pra, dhuna dhe forca, jo vetëm që s’është gjithmonë e vlefshme, por ka edhe shumë pengesa. Po ashtu, as mënyra e dytë nuk vlen gjithmonë e vetme. Për të arritur sukseset e mëdha, duhen përdorur të dyja njëkohësisht. Mos harro se, edhe pse fitoret e mëdha të etërve tanë duken sikur janë

arritur nën hijen e shpatës, në të vërtetë, ato janë realizuar me arsye, logjikë, dashuri për besimin dhe si rezultat i këtyre, edhe me ndihmën e Allahut të Madhëruar!

Biri im! Kurrsesi mos hiq dorë nga drejtësia, qoftë edhe për një çast, sepse Allahu i Madhëruar është i Drejtë dhe e do të drejtin...”

Ja pra, Sulltan Mehmet Fatihu, i ndoqi dhe i respektoi me gjithë shpirt këto këshilla dhe porosi, të cilat e ndërtuan pak nga pak botën e tij shpirtërore që në vitet e vegjëlisë dhe rinisë, duke e ndriçuar edhe të ardhmen e tij...

Çdo sulltan, që i ka dhuruar Perandorisë Osmane triumfe njëri më të vyer se tjetri, e ka arritur atë sukses në sajë të ëndrrave dhe idealeve që ka thurur që në kohën kur ka qenë shehzade.

A nuk ishte dashuria për të rënë dëshmorë e të rinjve, kraharori i të cilëve ishte i mbushur me besim, fuqia shpirtërore që e ktheu në arenë heroizmi fushëbetjën e Çanakalesë?

Sa vjeç ishte Kënallë Murati kur ra dëshmor? Po tetari Sejid, vallë, sa vjeç ishte kur po mbante gjylen e topit 276 kilogramësh? Sa vjeç ishte kapiten Hasani, kur e la fëmijën jetim pa e parë fare dhe në testament porositi që fëmijës së tij të sapolindur t'i vihej emri "Didar"? Sa vjeç ishin dëshmorët e regjimentit të 57-të? Sa vjeç ishin oficer Jahja Çavush dhe 63 shokët e tij, të cilët bënë një mbrojtje të pashembullt në historinë e botës kundër tri regjimenteve armike?

Në fakt, gjetja e përgjigjeve të këtyre pyetjeve, nuk është e vështirë. Kur shohim epigrafet në varrezat e dëshmorëve të Çanakalesë, vërejmë se mosha e dëshmorëve tanë të shenjtë, ka qenë mes 16 dhe 23 vjeç. Padyshim se

Cili ishte shpirti që e çoi Ullubatlle Hasanin me shokë mbi muret e Bizantit? Entuziazmi për të arritur një ideal sublim... Ata u ngjitën me një ideal të tillë mbi mure, saqë duke u ngjitur, brohorisnin me entuziazëm të madh duke thënë: "Sot erdhi radha jonë të biem dëshmorë!". Ata nuk e shihnin as zjarrin e bizantinëve që s'e shuante as uji, as vajin e valuar që derdhej mbi ta, e as shiun e shigjetave që derdhej prej bedenave... Synimi i tyre i vetëm, ishte të bëheshin pjesë e përgëzimit të Profetit ﷺ. Ja pra, fuqia që shkroi legendën e ngadhënjimit, ishte entuziazmi i besimit të këtyre të rinjve.



në kujtimet e shenjta të çdo shtëpie të Anadollit, oxhaku i së cilës nxjerr tym, gjendet një dëshmor i Çanakalesë. Çdo familje është një jetime e Çanakalesë. Dhe kjo, është një medalje nderi që përcillet nga brezi në brez.

Historia është dëshmitare, se ata që edukojnë breza të vetëdijshëm me cilësi dhe virtyte shpirtërore, do të bëhen të përjetshëm. Amanetet e fesë, atdheut dhe flamurit kanë mbërritur deri në ditët tona, duke u mbajtur me nder mbi supet e këtyre brezave të mbushur me një besim të tillë. Ndërsa fundi i atyre që janë zhytur në errësirën e indiferencës së verbër, në botën e qejfeve dhe kënaqësive egoiste, duke i kthyer shpinën Kuranit dhe jetës shpirtërore, ka qenë gjithmonë i keq. Lidhur me këtë çështje në një hadith fisnik thuhet:

“Padyshim se Allahu, me këtë Kuran, disave ua rrit vlerën, ndërsa disa të tjerë i poshtëron!” (Muslim, Musafirin, 269.)

Ja pra, në këtë manifestimin hyjnor duhet kërkuar edhe urtësia, se si një fis, që njëherë e një kohë përbëhej vetëm nga katërqind çadra, u bë një perandori e cila u themelua mbi respektin e pashoq ndaj Kuranit Famëlartë, u përhap në disa kontinente dhe u bë shtet global.

Në kohën e Sulltan Javuz Selimit, amanetet e shenjta u sollën në Stamboll dhe u vendosën në një ambient të veçantë në Sarajin Topkapë. Prej asaj kohe, Sulltan Javuz Selimi filloi traditën e leximit të Kuranit Famëlartë në atë ambient, që vijoi me shekuj të tërë. Ky fakt tregon qartë respektin legjendar që Osmanët treguan ndaj Islamit dhe simboleve të tij të shenjta. Kjo është edhe arsyeja që Perandoria Osmane



***Flamurin, flamur e bën gjaku që është mbi të!
Toka atdhe quhet nëse dikush vdes për të!***

(Mithat Xhemal Kuntaj)

sundoi për më shumë se gjashtëqind vjet, me nder dhe famë, duke gëzuar mirësi të veçanta hyjnore.

Nuk duhet harruar se, në themelet e madhëshitë materiale dhe shpirtërore të popujve, qëndron respekti ndaj urtësive të botës shpirtërore. Madhështia prej më tepër se gjashtëqind vitesh që gëzoi Shteti Osman, buron nga rëndësia që i kanë kushtuar ata botës shpirtërore.

Nisur nga kjo, detyra jonë është të edukojmë breza besimtarësh, të lidhur me vlerat shpirtërore dhe atdhetare, sepse mbrojtja e besimit, nderit, dinjitetit, jetës dhe pasurisë, arrihet duke mbrojtur atdheun. Ashtu si gjyshërit tanë që kanë jetuar në këto toka dhe na i kanë lënë trashëgim ato duke sakrifikuuar jetën dhe pasurinë e tyre, ashtu edhe ne duhet t'ua lëmë trashëgim brezave pas nesh këtë atdhe të bekuar, kumbimin e Kuranit, ezanin dhe flamurin sovran.

Nëse unifikohemi me vlerat kombëtare dhe shpirtërore të të parëve tanë, atëherë do t'i bartim me nder amanetet e shenjta që na kanë lënë ata. Përndryshe, të shikosh në heshtje ndërkohë që vlerat tona kombëtare dhe shpirtërore janë duke u shkatërruar, është një indiferencë shkatërrimtare, që mund të rezultojë me humbjen e amaneteve. Sot duhet të përpiqemi t'i mbrojmë sa më mirë amanetet e fituara me jetë, me qëllim që nesër të mos detyrohemi përsëri të paguajmë rëndë kostot e tyre. Historia dëshmon se, amanetet që nuk janë ruajtur, kanë humbur dhe nuk janë fituar më derisa janë merituar përsëri.

Fara që hodhën Osmanët me katërqind kalorës, u bë një rrap (çinar) i madh, degët e të cilit bënë hije në tre kontinente, jetuan gjashtë shekuj me nder e dinjitet, e më pas, duke lënë një sërë shtetesh të vogla jetime, mori formën e një tyrbeje madhështore në varrezat e historisë. Detyra jonë, është të bëhemi mirëmbajtësit e merituar të kësaj tyrbeje...





*“Mbrotjta e fesë, atdheut, flamurit dhe kombit, varet vetëm nga edukimi i një rinie sakrifikuese.”
(Musa Topbash -Allahu e mëshiroftë!)*

Nëse në një betejë bien dëshmorë të vërtetë për hir të Allahut, të atdheut dhe të kombit, ashtu siç ndodhi në Çanakale, pas këtyre flijimeve vijnë fitore të mëdha. Përndryshe, nëse në një betejë vdesin vetëm gërmadhat, pra, zemrat me botë shpirtërore të zbrazët, pas tyre nuk mbetet asgjë tjetër veçse një grumbull rrënojash.

Sa domethënëse janë këto fjalë të një mendimtari:

“Dallimi i vetëm mes popujve sundues dhe të sunduar, është si një gram, i cili e bën njërën anë të peshores më të rëndë se tjetra. Nëse ke një grusht njerëzish të edukuar, je popull sundues, nëse jo, je i sunduar...”

Ja pra, ajo çfarë pret populli ynë dhe e gjithë bota, është ky grusht njerëzish. Një grusht njerëzish të përkushtuar ndaj Allahut, që e kanë bërë zemrën vatër të madhe për të gjitha krijesat dhe prej shpirtit të të cilëve derdhet mëshirë për mbarë botën!..

Vërtet që, kur njerëzit bien ngushtë, janë në vështirësi ose nuk u shkojnë punët mbarë, presin t’u vijë një shpëtimtar. Për rrjedhojë, gjithnjë kërkohen njerëz si Omer ibn Abdulazizi, Osman Gazi, Javuzi, Kanuni, Fatihu dhe komandantët besimtarë të Betejës Çlirimtare të Çanakalesë.

Ky kërkim, është pozitiv në aspektin e vetëdijshmërisë ndaj nevojave reale. Mirëpo, nëse i gjithë ky kërkim kthehet në përpjekjen për ta nxjerrë njeriun ideal, atëherë ai është pikërisht momenti i gjetjes së njeriut të duhur. Ndërsa kërkimi dhe pritja pa përpjekje, nuk sjell asnjë dobi. Zemrat dembele dhe të ndryshkura që nuk rrahin, nuk mund të shpëtojnë dot nga mbytja në vorbullat e oqeanit të jetës.

Lum si ata të rinj që e lexojnë si duhet tablonë e shembujve dhe virtyteve të së kaluarës dhe që japin kontributin e tyre me shërbime

të dobishme për fatin e gjithë Umetit Islam... Lum si brezat e rinj fisnikë dhe njohës vlerash, rrënjët e të cilëve janë në të kaluarën, e degët në të ardhmen...

Allahu na bëftë njerëz të idealeve sublime që arrijnë pëlqimin e Tij! Allahu na ruajt të gjithëve nga mbytja në pellgun e egos, duke u mashtruar pas lodrave të pavlera të kësaj bote të përkohshme! Allahu na bëftë të gjithëve besimtarë me zemër të madhe, që shpërndajnë paqe dhe mëshirë për mbarë njerëzimin!

Amin!



O djalosh trim!

*Ti je vazhdimi dhe pasardhësi i një populli të madh! Je pasuesi i një qytetërimi plot virtyte dhe përfaqësuesi i sotëm i të shkuarës tënde të ndritur. Shpirti yt, le të edukohet gjithnjë me këtë vetëdije dhe personaliteti yt le të piqet vazhdimisht me këtë seriozitet! Siç shprehet edhe poeti Nexhip Fazëll:
"Dega që nuk i pëlqen rrënjët e saj dhe fruti që nuk i pëlqen degët e tij, kalben pa u pjekur."*

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	5
-----------------	---

Një djalosh shembull për të gjitha kohërat:

MUHAMEDU'L EMIN **Γ** /13

Nevoja e njeriut për të marrë shembull.....	15
Shembulli dhe lideri i vetëm, Muhamedi Γ	17
Çfarë rinie jetoi Resulullahu Γ ?.....	21
Profeti Γ dhe të rinjtë.....	27
<i>Të rinjtë i motivonte për dije</i>	28
<i>Të rinjtë që pëlqen Allahu dhe i Dërguari i Tij</i>	29
<i>Të rinjtë ishin bashkëudhëtarët e Profetit Γ</i>	31
<i>Profeti Γ i vlerësonte të rinjtë</i>	31
<i>Bartën Islamin në kontinente të ndryshëm</i>	33
Myslimanët e parë.....	34
Detyrat që u jepte Resulullahu Γ të rinjve.....	40

TË RINJTË NË KURANIN FAMËLARTË / 45

Të rinjtë në Kuranin Famëlartë.....	47
Ibrahimi U	47
Ismaili U Djaloshi që iu flijua Zotit.....	50
Jusufi U	54
<i>Një sprovë e rëndë</i>	54
<i>Kumtimi i së vërtetës edhe në burg</i>	55
<i>Ekipi i Jusufit U , i përbërë nga të rinjtë</i>	56

Musa U dhe ndihmësi i tij, Jusha U	57
Shokët e shpellës.....	57
Shokët e Rakimit.....	59
Lukmani U dhe i biri	62
Jahja U	63
Isai U	64
Merjemja.....	65
Asija.....	67

BOTËKUPTIMI I JETËS PËR TË RIUN MYSLIMAN / 69

Botëkuptimi i jetës për të riun mysliman.....	71
Vetëdija fetare, gjuhësore dhe historike.....	75
a. Vetëdija fetare.....	75
<i>Dobitë e besimit në botën tjetër.....</i>	82
b. Vetëdija gjuhësore	85
<i>Objektivi janë fjalët Kuranore.....</i>	86
<i>Feja jeton përmes gjuhës.....</i>	87
<i>Duhet të jemi të kujdesshëm ndaj "gjuhës së trilluar"</i>	88
c. Vetëdija historike	90
<i>Tablo krenarie.....</i>	92
<i>A përsëritet historia?.....</i>	94
<i>Ti je një popull i madh!.....</i>	95
MËSIMI I ISLAMIT	98
TË JETOSH ISLAMIN.....	102
<i>Të rinjtë sahabë ishin të dhënë pas adhurimit.....</i>	105
<i>Rregullat e jetës shoqërore (Muamelat).....</i>	106
DASHURIA NDAJ ALLAHUT	107
DASHURIA NDAJ PROFETIT.....	112

<i>Dashuria ndaj sahabëve të nderuar</i>	116
<i>Dashuria e brezave të mëvonshëm</i>	121
BINDJA NDAJ URDRHAVE TË ALLAHUT DHE TË DËRGUARIT TË TIJ	122
TË ZGJEDHËSH AHIRETIN NË VEND TË DYNJASË	129
Eliksiri i të riut mysliman: NAMAZI	134
<i>Ata që nuk falin namaz</i>	139
<i>Pesë kohët e namazit</i>	140
<i>Namazi i Xhumasë</i>	141
<i>Përkushtimi në namaz</i>	141
<i>Falja e namazit në kohën e parë</i>	145
<i>Falja e namazeve me xhemat</i>	147
<i>Namazi deri në frymën e fundit</i>	150
VËLLAZËRIA NË FE	151
<i>Të mos mbash mëri</i>	155
<i>Të zgjidhësh problemet e vëllait</i>	157
<i>Mbështetja e vëllait të fesë</i>	158
HAKU I ROBIT	159
E drejta e prindërve	163
E drejta e familjes	167
Detyrat ndaj të afërmeve	171
THIRRJA ISLAME	175
Çëshje që duhen pasur kujdes gjatë thirrjes Islame	183
KUJDESI NDAJ HALLALLIT DHE HARAMIT	187
Kujdesi ndaj mbulesës Islame	192
Zinaja	195
Nëna e të gjitha të këqijave është pija alkoolike	199
Kumari	201
VETËDIJA NDAJ KONCEPTIT TË KOHËS	203
<i>Kujdesi ndaj kohës që na mëson Islami</i>	212
VETËDIJA E PËRGJEGJËSISË	215
MENDJEMPREHTËSIA	219
THELLIMI NË MEDITIM	224

VËLLAZËRIA dhe BASHKIMI	227
Këshillimi	232
Këshillimi i Omerit	235
EDUKATA	236
PËRDORIMI I FRYTSHËM I ENERGJISË RINORE	240
<i>Një ditë e kësaj bote është më e vyer se njëmijë vitet të botës tjetër</i>	246
<i>Nxitimi në punë të mira</i>	247
<i>Të punosh deri në vdekje</i>	248
<i>Vdekjet e virtytshme që janë gdhendur në histori</i>	251
Zotërimi i idealeve të larta	257
Shërbimi	259
<i>Gara në shërbim</i>	264
<i>Rregullat e arta të shërbimit</i>	268
Të mos mashtrohesh pas botës	269
Zgjedhjet që i japin formë jetës	269
<i>Zgjedhja e shoqërisë</i>	269
<i>Zgjedhja e profesionit</i>	273
<i>Zgjedhja e bashkëshortit/es</i>	273
<i>Zbavitja dhe koha e lirë</i>	276

RINIA DHE EDUKIMI / 283

VIRTYTI I MËSIMIT TË DIJEVE TË DOBISHME	285
Dituri, është të njohësh veten	285
Dija është për të punuar	287
Dija që shpëton jetë	289
EDUKIMI PROFESIONAL	290
Udhëzuesi i jetës së të riut mysliman: KURANI FAMËLARTË	294
Mrekullia më e madhe profetit të fundit	298
STUDIMI I HADITHEVE DHE HISTORIËS SË PROFETIT ﷺ	301
AS'HAB-I SUFFE: Shkolla e dijes dhe urtësisë	303
RESPEKTI NDAJ MËSUESIT	306

RINIA DHE MORALI / 311

ZOTËRIMI I MORALIT TË BUKUR	313
Mëshira	316
Modestia	319
Bujaria	321
Sakrifica dhe shqetësimi me hallet e vëllait mysliman	323
Sinqeriteti dhe çiltërsia	325
Nderi dhe turpi	329
Besnikëria dhe mbajtja e fjalës	332
Falja	334
Drejtësia	336
Butësia dhe toleranca	341
Mirësjellja (Mos lëndo dhe mos u lëndo)	345
Durimi	347
Rruga e mesme dhe maturia	350
Trimëria	352
RUAJTJA NGA MORALI I KEQ	354
Lakmia dhe smira	355
Përgojimi	358
Zemërimi	359
Dëshira për luks dhe shpërdorimi	362
Zgjedhja e modelit të gabuar	365
PËRFUNDIM	368

